Drenusha Zajmi Hoxha

ENGJËJT VDESIN NDRYSHE

(ROMAN)

2007

- *Ti ishe fare i ri kur të vdiq nëna?*
- *Nuk e di, nuk më kujtohet...*
- *Nuk të kujtohet kur humbe nënën tënde?*

–Jo, nuk më kujtohet nëse kam qenë ndonjë herë i ri.

I

- Shtëpia e familjes Spahiu gjendej në pjesën më të bukur të qytetit, mu në zonën e lashtë të tij, që vizitohej thuajse gjithë vitin nga turistët. Ishte një vilë dykatëshe, jo fort e madhe, e futur në fund të një rrugice të ngushtë, të shtruar me pllaka prej guri të lëmuara nga këmbët e ecarakëve për vite e dekada me radhë. Vila kishte pamjen e një kulle fort tërheqëse, të ndërtuar me shijen e hollë të një artisti, në një stil disi të kombinuar midis klasikes dhe modernes. Në të gjitha anët e saj kishte dritare të mëdha me korniza të drunjta, që dilnin mes mbulesës me pllaka dhe që dukeshin sikur copa shkëmbinjsh të ngjitura në mur. Në krye, shtëpia mbulohej nga një pullaz i lartë, që pastaj ndahej në disa të tjerë më të vegjël, të cilët mbulonin ballkonet e bukura me rrethoja hekuri të punuara me dorë; në ballkonet derdheshin lule nga të gjitha llojet e nga të gjitha ngjyrat. Nga sytë kureshtarë, shtëpinë e ruante një mur i gurtë, pak më i lartë sesa ishin zakonisht muret rrethues të shtëpive në atë qytet. Pas atij muri, kush mund të kishte sy për të parë, do të zbulonte një oborr të bukur në formë parku.

Shtëpia kishte edhe një kopsht të vogël prapa saj, ku binin dritaret e disa apartamenteve të ndërtuara rishtas në rrugën tjetër. Në kopsht dilej veç nga kuzhina. Aty ndodhej një tavolinë e vogël dhe një ndenjëse fort e rehatshme, që kreu i shtëpisë, Bujari, i përdorte si vend pune gjatë gjithë verës; po edhe gjatë vjeshtës së parë, kur bënte mot i mirë. Kishte aty qetësinë e duhur për të lexuar a për të shkruar. Gjelbërimi i oborrit, lulet e bukura që i kishte mbjellë dhe i përkujdeste e shoqja, Besa, krijonin një mjedis shumë çlodhës, ku Bujari, si lexonte shumë apo pasi shkruante faqe të tëra me formula, i hidhte sytë e i linte t'i pushonin pak. Aty buzë asaj tavoline Bujari ndjehej njëherësh edhe në kopsht edhe në shtëpi; përpara kishte gjithë atë bukuri të natyrës, me lule e gjelbërim, ndërsa pas shpinës kishte kuzhinën, me atë erën ndjellëse të gjellëve, që zienin mbi shporet. Apo me rrjedhën e ujit, kur Besa lante zarzavatet për sallatën jeshile, që ai e donte shumë. Dhe kur koka i ishte rënduar e sytë zinin t'i shponin nga formulat e pabindura, ai linte për një çast gjithçka, i vinte duart mbi tavolinë dhe shikimin e treste atje mbi jaseminët e bardhë a mbi manushaqet erëmira. I shëtiste pastaj sytë lule më lule, derisa ndjente se i qetësoheshin diçka. Atëbotë Besa e kishte gati një kafe sade, fare pa sheqer, siç e pinte ai; ajo afrohej lehtë-lehtë nga pas shpinës së tij, dhe veç kur ia qaste filxhanin përpara mbi tavolinë e i thoshte me zë të butë: "Kafen, Bujar, se të ftohet". Ai niste atëherë ta rrufiste kafenë e rëndë allaturka dhe ashtu lodhshëm, përmes formulash a nëpër vargje ekuacionesh që i lëvrinin në sy, ndodhte që t'i përvijohej jeta e tij. Herë një pjesë, herë një tjetër, si paragrafët e një romani që shkruhej e prishej sa herë, po që, gjithsesi, ai ia dinte lidhjen.

Vendlindja e Bujarit ishte disa dhjetëra kilometra larg qytetit ku ai banonte; ishte një qytezë fare e vogël që përkundej mes dy qytetesh të mëdha. Njëri nga qytetet e mëdha ishte kryeqyteti i vendit; tjetri, i dyti për nga madhësia, kishte një histori të bujshme mijëvjeçare. Kësisoj, njëri me madhësinë e tjetri me madhështinë, të dy qytetet e mëdha dukej se e kishin futur në mes qytezën e vogël dhe e tërhiqnin sa njëri, sa tjetri, sikur donte sekush ta merrte për vete. Qyteza ishte vendosur në një bregore të bukur, gjithë gjelbërim, por, mbase tamam pse ishte në mes të dy qendrave më të mëdha të vendit, kishte mbetur fare pa zhvillim. Por banorët e saj e donin, ndonëse iu duhej të largoheshin për një perspektivë më të mirë. Duke mos gjetur në vendin e lindjes mundësitë për një jetë më të gjallë e më të duhur, e braktisnin qytezën dhe shpërnguleshin në njërin nga dy qytetet e mëdha. Më të shumtët yshteshin në kryeqytet. Së pari shkonin aty për studime, pastaj, po të gjenin punë, qëndronin për gjithë jetën. Të tjerë përgjonin ndonjë vajzë dhe, me dashuri a me mblesëri, krijonin martesë gjithë e gjithë për të vënë këmbë në kasaba, siç thuhej motit. Kryeqyteti, pavarësisht rrëmujës e kaosit që mbretëronte brenda tij, gjithsesi ofronte më shumë mundësi për një jetë më të mirë.

Edhe Bujari, kur mbaroi të mesmen, shkoi t'i kryente studimet e larta në kryeqytet. Vijoi atje fakultetin e kimisë. Si u diplomua, pati shumë dëshirë të qëndronte aty, po shpejt e pa se nuk mjaftonte veç të dëshironte. Kaluan disa javë dhe ai nuk po nuk arrinte të punësohej. Ishte një zhgënjim i beftë ky për një djalosh të sapo diplomuar, që përkundej në plot ëndrra për një të ardhme të ndritshme. Ku do t'i çonte tani pesë vitet e studimeve mbi libra e laboratorë, apo do të syrgjynosej atje në atë qytezën romantike në faqe të bregores? Çdo të bënte në të? Apo t'i çonte ditët me ëndërrime buzë lumit të tij të fëmijërisë?.. Por, ja që të dy qytetet e mëdha, ashtu siç e kishin kushtëzuar bashkërisht jetën e tij për plot njëzet e tre vite, derisa u rrit e u bë burrë, tash kishin bërë një marrëveshje. Njëri syresh, kryeqyteti, kishte lëshuar pe dhe djaloshin e ri, me gjoksin mbushur gjithë ëndrra, ia kishte lënë qytetit tjetër. Kësisoj u bë që pas një kohe Bujarit iu dha rasti të punësohet si pedagog në qytetin e dytë të vendit; në qytetin historik, të cilin e pëlqente shumë, por që nuk e kishte menduar kurrë të jetonte në të.

Bujari u rregullua shpejt e shpejt në qytetin e tij të ri. Shtëpia në të cilën banonte me qira ishte mu karshi shkollës së muzikës, nga e cila kishin dalë shumë artistë të njohur. Shpejt Bujarit i kishte rënë në sy një vajzë me flokë të gjatë e të zinj, që i derdheshin supeve. Nuk ndjente ndonjë pasion të madh për të, por e tërhiqte thjeshtësia dhe natyrshmëria e saj. Dukej krejt e pavetëdijshme ose e pa interesuar për bukurinë e saj dhe kjo e bënte edhe më tërheqëse këtë vajzë në sytë e profesorit të ri. E shihte pothuaj çdo ditë kur ajo dilte nga shkolla, pse mu në atë orë edhe Bujarit i takonte të kthehej nga shkolla e lartë ku jepte mësim. Por duhet thënë se ndonjëherë ai i shpejtonte hapat enkas për të mos humbur takimin me studenten e muzikës.

Lidhja e tyre filloi pas disa javësh, kur Bujari e kishte rregulluar më në fund që t'i njihte një mik i përbashkët. Sapo ajo shqiptoi emrin e saj: "Besa, më quajnë Besa" i tha, ai e pyeti menjëherë se çfarë mendonte për jetën dhe ajo i tha fare natyrshëm se synonte të bëhej një pianiste e madhe. Bujari mbeti ca i habitur me këtë përgjigje, që atij iu duk ca fëminore, por pastaj mendoi se tamam kjo mënyrë të foluri i shkonte shumë natyrës së saj. Me kohë, lidhja e tyre u thellua dhe një ditë vendosën të martohen, me kusht që ajo t'i vazhdonte studimet. Por shumë shpejt erdhën fëmijët. Më parë u lindi djali, që e quajtën Diamant, e pas dy a tri vitesh edhe vajza, që ia vunë emrin Dorina. Bujari ishte pothuaj gjithë kohën larg shtëpisë me studimet pasuniversitare, me specializime të njëpasnjëshme e seminare të shumta. Besa, e gjendur kësisoj fare e vetme me rritjen e fëmijëve dhe me punët e tjera të shtëpisë, vendosi ta ndërpresë shkollimin përkohësisht, për t'iu kthyer më vonë.

Por vitet kishin fluturuar dhe ajo ishte pajtuar me përkushtimin ndaj familjes dhe shtëpisë. Muzika mbeti si një mikeshë e humbur, si kujtim i një të kaluare të largët, ndonëse ishte ende fare e re për t'u ndarë prej saj. Dhe nuk mund të thuhej se ishte ndarë. Herë-herë i binte pianos pasditeve dhe Bujarit i dukej se në ato takime me muzikën, ajo çmallej me dashurinë e saj të vjetër, për të cilën ndjente nostalgji të madhe, por nuk thoshte asgjë.

Me kohë, edhe Bujari ishte përshtatur aq mirë në atë qytet sa që nuk ua vuri fare veshin disa ofertave për punë të reja në kryeqytet. Të dy, ai e Besa, edhe pse pa e folur asnjëherë në mes tyre, dukej sikur e kishin ndarë mendjen të jetonin përfundimisht brenda qytetit historik. Qyteti, përveçse për histori, ishte i përmendur edhe për bukurinë, kulturën dhe lashtësinë e tij. Flitej se së shpejti do të hynte nën mbrojtjen e organizatave botërore si qytet muze. Shtrihej rrëzë një vargu malesh, që i rrinin gjithë ditën mbi kokë, ndërsa mu përmes tij gjarpëronte lumi i rrëmbyeshëm, që e ndërronte shtratin sipas stinëve. Lumi e ndante qytetin mes për mes në dy pjesë. Në pjesën e vjetër, që ishte edhe qendra e tij, ishin mbledhur thuajse të gjitha monumentet dhe objektet e tjera të lashta e të bukura, të cilat tërhiqnin aq shumë jo vetëm vizitorët e huaj, por edhe vendasit. Ndërsa pjesa e re e qytetit ishte me rrugë të gjëra, anash të cilave ishin ndërtuar vila e pallate, shkolla e qendra të tjera sociale. Kjo ishte, si të thuash, pjesa moderne e tij. Banorët e qytetit ishin njerëz të qetë e të lidhur me punën. Shumica syresh i shfrytëzonin mirë mundësitë natyrore që u ofronte zona përreth, aq e bekuar nga natyra në të katër anët. Nga njëra dalje e tij, rruga të çonte përpjetë lumit dhe përfundonte në vise të bukura që njerëzve u shërbenin për të pushuar verës, a për të skijuar dimrit. Nga dalja tjetër, rruga shkonte poshtë trupit të lumit dhe ndeshte te një lum tjetër më i madh, i cili para shumë viteve ishte shndërruar në një liqe për të prodhuar energji. Pothuajse në çdo anë që shkoje, përjashta qytetit, kishte vendpushime, restorante dhe hotele të ndërtuar bukur. Sidomos verës, Bujarit nuk i bëhej fare të jetonte në zallamahinë e qytetit, të cilit ia kishte zënë frymën trafiku i rënduar, ndaj nuk linin rast pa shkuar herë në njërën e herë në tjetrën pikë turistike. Po dimrit, gjithsesi, mblidheshin në shtëpi. Prej gati një dekade e kishin ndërtuar edhe ata vilën e tyre mu aty në atë pjesën e lashtë të qytetit dhe me kohë çdo gjë në jetën e tyre familjare dukej se kishte marrë rrjedhën e vet. Njësoj sikur lumi që krijon shtratin. Sa herë dilte për ndonjë shëtitje mbrëmjeve skaj lumit ku shtrihej shëtitorja, që pastaj derdhej në sheshin kryesor ku ishte një shatërvan i mrekullueshëm, Bujarit i kujtohej ai lumi i vogël i fëmijërisë, të cilin e kishte lënë atje në vendin e lindjes. Ishte gati si përroskë, por ai e kishte pas mikun më të mirë. Ishte gjëja e vetme që i mungonte nga vendlindja e tij.

***

- Erdhëm, ja kemi për të bërë edhe atë copë rrugë atje tej dhe mbërritëm,- i tha djaloshi vajzës që mbante përdore.

- Ndërsa unë mendova se e kishim humbur rrugën, – tha ajo me shpoti.

- A dukem vërtetë si një njeri që ka harruar çdo gur në vendin e tij?- e pyeti djaloshi me vetullën të ngritur e duke nënqeshur paksa.

- Jo, jo, – qeshi vajza dhe ngriti sytë duke lejuar diellin t'ia mbulonte fytyrën,- por, kur të shikoja pak më parë, më dukeshe si fort i brengosur dhe jo i pranishëm, ndaj dhe mendova se mos e ke harruar vërtetë derën e shtëpisë tënde.

- Eh, deri tash, kot paskam menduar se më njeh mirë, por nuk qenke njohëse shpirtrash, ashtu siç thua. Në të vërtetë kisha humbur në kujtime, ndjeva se më paska marrë malli për këto rrugë. Dhe po thosha sa gjatë paskam pa ardhur. Eh, sa shumë kohë më marrin këto studimet dhe….dhe ti, – i tha duke ia kthyer një me një shpotinë.

- Sa i keq je, Diamant! Ndërsa unë, kot paskam shpresuar se të mungoj në çdo moment që nuk jemi bashkë…

- Edhe më mungon, budallaqe, ndaj edhe i thashë Dorinës se do të vija bashkë me ty në ditëlindjen e saj. Ajo u gëzua aq shumë sa më tha se nuk do ma hapte derën po qe se nuk të ishe edhe ti. Është ende si fëmijë.

Mimozës iu hap fytyra. Kishin kohë bashkë me Diamantin, por ishte hera e parë që po vizitonte familjen e tij, shtëpinë dhe qytetin ku ishte lindur e ishte rritur i dashuri i saj. Seç kishte një ndrojtje dhe zemra i rrihte shpejt sikurse ndodhej para provimit. Ishte në vitin e dytë të studimeve për psikologji dhe Diamantin e kishte njohur në bibliotekën e qytetit ku studionin bashkë. I kishte pëlqyer që në çastin e parë.

- Mmm…më duket se deri këtu po vijnë aromat e këndshme të kuzhinës së mamasë sime, – tha Diamanti me sytë paksa të picërruar nga kënaqësia. Pas pak çastesh Mimoza pa se ishin ndalur para një porte të madhe, të lyer në të gjelbër.

- Do t'i biesh ziles?,- i tha Diamantit.

- Po. Dua që Dorina të na e hapë derën.

Nuk kishin kaluar as dhjetë sekonda kur pas derës së hapur u shfaq koka e një vajze të këndshme, që po kërcente nga lumturia. Flokët e verdha e të dendura i binin shkujdesur nëpër fytyrë, ndërsa gëzimi i shihej qartë në sytë e mëdhenj e të zinj, që i qeshnin sikur buzët e bukura. Sakaq flokëverdha i kërceu të vëllait në qafë.

- Ngadalë moj, se më mbyte, – e nguci Diamanti duke ia kthyer përqafimin. – Kot që po i mbush të tetëmbëdhjetat, je ende një bebe e vërtetë, – i tha duke ia shkulur faqet.

- Për ju do të jem gjithmonë e vogël, kot që të rritem. Por, e di çfarë? Ka filluar të më pëlqejë tani që po plakem. Dua të mbetem gjithnjë e vogël. E vockël fare. Ha, ha... - pastaj, duke ia hedhur ëmbël sytë vajzës në krah të Diamantit, i tha të vëllait:- Po ti s'do më njohësh me të dashurën tënde? Shoh se kryeqyteti s'të paska mësuar gjë nga bontoni... Ha, ha, ha, ha –vazhdonte të qeshte me shpirt vajza.

- Po, - u shkund Diamanti.- Dorina kjo është Mimoza, është... e dashura ime, po. Nuk e paskam thënë këtë fjalë deri tani, më erdhi ca si e çuditshme.

- Epo do mësohesh akoma, kurrë nuk është vonë, – ia ktheu Dorina me shpoti dhe pastaj thuajse i kërceu Mimozës në qafë me aq dashuri sa ajo mbeti e mrekulluar nga gjithë kjo afri që ia shfaqi Dorina dhe nuk po dinte si të reagonte.

- Sa mirë që ke ardhur! Sa e këndshme që je! Po si të mashtroi ky vëllai im? – e ngucte Dorina Mimozën ndërsa po ecnin të tre oborrit të shtëpisë.

Oborri dukej shumë i bukur. Kishin vënë disa tavolina, ku ishin ulur shumë miq të Dorinës, ndërsa dëgjohej muzika e lehtë me të cilën po vallëzonte një çift më tej.

- Mama, mamaaaaa,- zuri të thërriste Dorina te dera e korridorit.- Ka ardhur Diamanti me Mimozën. Ngutu, dil.

- Mirëserdhët! – u tha Besa, e ëma e Diamantit, sapo u dha te dera. Mimozës i pëlqeu menjëherë kur e pa. Ishte një grua e bukur, edhe pse në moshë të mesme, ndoshta ca vite para të pesëdhjetave. Besa i përqafoi të dy dhe tha: - Sa më paska marrë malli biri im. Duhet të vish ca më shpesh në shtëpi, natyrisht bashkë me Mimozën.

- Po babai ku është? – pyeti Diamanti në vend të përgjigjes.

- Oh, ai gjithmonë me librat e tij... Ja po e thërras, është në kopshtin pas shtëpisë.

- Jo, lëre, do të shkojmë ta takojmë vetë,– tha Diamanti dhe pastaj përsëri fytyra iu hap teksa iu kthye së motrës: - Do ta shohësh dhuratën?

Dorina mu atëherë e pa se i vëllai po mbante në dorë një shportë të madhe, e cila ishte e mbuluar lehtë me një shall me lule.

- Shalli nuk është për ty, mos u gëzo kot. Mimoza e ka blerë për mamanë, por unë e përdora për ta fshehur dhuratën tënde nga sytë e tu... - i thoshte Diamanti dhe ikte me lëvizje të lehta e dinake derisa Dorina ta ndiqte që t'ia kapte shportën.

- Epo, atëherë unë po e marr shallin tim, njëkohësisht po ia ndërpres vuajtjet Dorinës,– tha mamaja duke u bashkangjitur në lojën dhe shakatë e fëmijëve të saj. - Të faleminderit, Mimoza, është shumë i bukur, – tha dhe e vuri shallin në qafë.

Mimozës i erdhi shumë mirë buzëqeshja e çiltër e Besës dhe e ndjeu menjëherë ngrohtësinë e njerëzve të afërt të Diamantit. Vërtetë nuk kishte parë aq shumë dashuri për një kohë të gjatë. Nëna e kishte lënë të vogël, ndërsa i ati, si ushtarak, ishte gjithmonë larg shtëpisë. E kishte rritur tezja dhe, pavarësisht dashurisë së pakufishme që ajo ia kishte dhënë, Mimoza gjithmonë e ndjente mungesën e prindërve, të vëllait ose të motrës. Ishte fëmijë e vetme dhe ëndërronte një familje të madhe.

- Një maceeeeee!- thirri Dorina si një fëmijë i llastuar.– Mama, më kanë sjellë një mace! Shiko sa e bukur që është! – fliste duke e nxjerr kotelen nga shporta.

- Ju faleminderit, është shumë e bukur! Ah, sa e këndshme, sa e mirë... Ju faleminderit shumë, të dyve. Më gëzuat pa masë! Askush deri më sot nuk më ka dhuruar një kafshë të gjallë, – fliste me sytë kah macja, të cilën po e mbante shtrënguar në gjoks duke e ledhatuar.

- Është e llastuar, sikur ti, – i tha Diamanti.- Kërkon gjithmonë të përkëdhelet dhe t'i plotësohen dëshirat.

- Dhe unë do ia plotësoj me kënaqësi, sepse e dua qysh tani. Njësoj sikur edhe ju m'i plotësoni mua. Ngaqë më doni fort, apo jo? Hajde, thuaj jo, po munde, thuaj jo…

- Të duam, të duam. Jemi fajtorë, e pranoj. Të gjithë njerëzit kanë ndonjë të metë,- qeshte tani edhe Diamanti.- Ja, edhe ne kemi një të metë të madhe, se të duam shumë ty.

Dorina ia tundi shuplakën, si një mama e mërzitur me fëmijën çamarrok, me demek se do ta rrihte nëse vazhdonte kështu. Pastaj tha për macen:

- Do ta quaj Midi! – duke u munduar t'i jepte solemnitet deklaratës së saj.

- Midi? Si modë fustanesh?- e përqeshte Diamanti për t'ia marrë hakun paq së motrës për shuplakat që ia kishte "dhënë".- E pastaj çfarë do të bësh, mos do të marrësh dhe një qen që ta quash Maksi?

- Midi, si shkronjat e para të emrave tuaj, çamarrok: Mi-moza dhe Di-amant,- tha duke i rrokëzuar emrat e tyre.- E kuptove tash?

Diamanti u tërhoq pa fjalë. Nuk mund ta fitonte luftën me këtë motër çamarroke. Por, edhe njëkohësisht u ndje i prekur.

- Keni vajzë të mrekullueshme, – i tha Mimoza Besës.

- Këta fëmijët e mi nuk do të rriten kurrë, – tha Besa.

- Për ju do të jenë gjithmonë të vegjël, natyrisht. Jeni nënë, prind. Dhe prindi kurrë nuk i përjeton fëmijët e tij si të rritur.

- Ashtu është. Tani do të jesh edhe ti njëra syresh, Mimoza. Do të të kem si bijën time.

Mimoza i buzëqeshi pa fjalë, por sytë e saj e falënderuan në heshtje.

- Hajde, hyni brenda, se mu dogjën ëmbëlsirat,– vazhdoi pastaj me atë zërin e saj të butë nëna. - Do të takoni edhe babin.

Derisa Dorina u kthye te miqtë e saj me miken e vogël në krah, Diamanti dhe Mimoza u futën brenda. Shtëpia dukej shumë komode që nga korridori. Kishte hapësirë dhe dhomat lidheshin në mënyrë shumë praktike. Ngado hynte dritë: nga dritaret e mëdha, po edhe nga muret, që i kishin disa pjesë nga tullat prej xhami. Muret ishin të lyera me ngjyra të ngrohta që shkonin mirë me orenditë të bëra kryesisht prej druri. Kaluan kah dhoma e ndejës, siç e quanin, për të dalë në një kuzhinë të madhe e moderne, apo soxhorno, siç kishin nisur t'i quanin tani vonë këto lloj kuzhinash, ku ishin menduar të gjitha mjediset: edhe pjesa e gatimit dhe e ngrënies, edhe këndi i çajit, edhe ai ndejës. Kuzhina, pastaj, kishte edhe një derë që të çonte te kopshti i prapmë.

Diamanti e hapi derën. Në fund të kopshtit, nën një verandë druri, ishte një burrë me kokën të ulur mbi librat e shumtë të shpërndarë mbi tavolinë. Ishte sikur një dhomë e hapur pune. Burri dukej diku te të pesëdhjetat dhe kishte pamjen e një intelektuali serioz. Një dorë e kishte mbërthyer fort në kokë, me gishtat që i depërtonin në flokët e dendur biond, ndërsa me tjetrën po shkruante. Dukej se ishte futur thellë në botën e tij, dhe fare i shkëputur nga mjedisi përreth. Nuk ndjeu gjë edhe kur Diamanti e Mimoza iu afruan fare pranë; dhe kur dëgjoi një zë që e thirri, e çoi kokën vrokthi në drejtim të të birit:

- Baba! Erdhëm të të takojmë këtu që mos të të ndërpresësh studimet e tua. Si je? – i tha Diamanti dhe u bë gati ta përqafojë.

- Oh, më falni nuk ju paskam ndier fare,- tha ende i përhumbur Bujari.- S'ju paskam ndier vërtetë. Mirëserdhët!- ia shtrëngoi dorën të birit, pastaj shikoi Mimozën, së cilës s'po dinte si t'i drejtohej. Ktheu shikimin pyetës kah i biri, sikur priste ndonjë sqarim ose përgjigje prej tij.

- Baba, kjo është Mimoza, kemi ca kohë që jemi bashkë. Dorina kishte dëshirë të vinim së bashku në ditëlindjen e saj. Edhe Mimoza kishte shumë dëshirë që t'ju njihte.

- Sa mirë keni bërë!- tha atëherë me një buzëqeshje galante Bujari dhe ia rrahu lehtë supet Mimozës.- Më vjen mirë që të njoha, - i tha me mirësjellje.- Ndjehu si në shtëpinë tënde.

- Ju faleminderit, jeni shumë të mirë, – ia ktheu Mimoza dhe shtoi:- Diamanti më ka folur shumë për ju…për të gjithë ju.

- Ashtu? Po ti mos i beso të gjitha fjalët që të thotë ky, – u përpoq të bënte pakëz humor Bujari, enkas për t'u çliruar nga një mëdyshje e papritur që ndjeu sapo mori vesh se i biri kishte një vajzë, të fejuar apo të dashur, kushedi. As vetë nuk po dinte se pse kjo mëdyshje. Mimoza buzëqeshi lehtë nga shakaja e Bujarit, por sakaq ndjeu se në mes të dy burrave diçka nuk shkonte mirë, nuk ndjehej në mes tyre ajo atmosferë e ngrohtë dhe krejt e shkujdesur që sapo kishte përjetuar në takimin e Diamantit me të ëmën. Gjithë ajo mirësjellje e përkujdesje në mes birit e babait se si iu duk, si një vazo e bukur por e krisur. Po, po, kjo ideja e një gjëje të bukur të krisur iu duk krahasimi më i gjetur për takimin në mes të Diamantit me të atin.

- Tani do të bëjmë mirë t'i bashkohemi festës, ndryshe Dorina do na e mbajë mend për të gjithë jetën, – tha Diamanti dhe e mori Mimozën përdore, duke ia ndërprerë kështu në mes meditimin e saj për vazon e krisur.- Ti baba vazhdo, do të shihemi më vonë,- iu kthye të atit dhe prapë i buzëqeshi lehtë sikur donte të rregullonte një marrëveshje të shkuar keq.

Derisa ata po zhdukeshin përsëri brenda derës së kuzhinës, Bujari ndjeu papritur një mall të thekshëm për ta përqafuar të birin. Po pse, pra, gjithë kjo ftohtësi në mes tyre? Gjithë e mbuluar me një tyl mirësjelljeje? Ndoshta ngaqë Diamanti është pjekur tani dhe nuk kishte më nevojë për të? Ishte rritur pothuajse pa e vërejtur, larg syve të tij, meqë atëherë kur ai po bënte hapat e parë në jetë, Bujari ishte gjithmonë larg tij, larg shtëpisë. Pastaj edhe nuk e kishte përkëdhelur si Dorinën. Mendonte se kjo farë sjelljeje, diçka e ftohtë, do ta bënte të birin më të fortë, më burrë, më të fuqishëm për t'i përballuar sfidat e jetës. Po, në të vërtetë dukej se kështu e kishte shtyrë me duart e tij larg vetes dhe ai kishte gjetur prehje tek e ëma. Ajo, po, e mbështeste në të gjitha gjërat. Po sa i mirë, sa i rritur i dukej! Një djalosh për ta admiruar.

Me këto mendime turbulluese në kokë, Bujari u ul sërish në karrigen e tij të mbuluar me një jastëk të butë, dhe nisi prapë nga formulat. Dukej se vetëm me ato ishte në ujdi. As i zemëroheshin e as i iknin; sapo merrte lapsin në dorë ato vinin varg e shtroheshin butë në letër. Bujari buzëqeshi lehtë dhe sikur u ndie diçka i lehtësuar me këtë miqësi të çuditshme me formulat e tija të mira.

Diamanti ishte në mes të studimeve për biokimi dhe kishte rezultate shumë të mira. Miqtë dhe shumëkush ia parashikonte një të ardhme të bukur në këtë fushë. Ishte djalë i zgjuar, i qetë dhe i matur, shumëkush nga kushërinjtë thoshte se përngjante me Bujarin në çdo anë. Por i ati nuk ngazëllehej; ai e shihte se i biri kishte maturinë, mirëkuptimin dhe zgjuarsinë e Besës, kishte marrë pra nga e ëma. Megjithëse i ishte kushtuar shkencës sikur i ati, e jo muzikës sikur ajo. Ndërsa e bija, Dorina, eh ajo ishte ndryshe. Po mbaronte të mesmen dhe dëshironte të studionte për piano. Ishte shumë e hapur dhe energjike, gjithmonë kishte diçka për të treguar, diçka për të bërë. Nuk i ndalej goja kurrë, pos kur ushtronte mbi tastierën e pianos. Atëherë zhytej në një botë tjetër, të sajën. Dukej se askush nuk mund të depërtonte deri te mendimet e saj. Kur e kundronte e ia shikonte profilin, Bujarit i kujtohej bashkëshortja e tij kur ishte e re dhe dëshira e saj e parealizuar për tu bërë pianiste e famshme. Dorina kishte marrë nga e ëma pasionin për muzikën, ndërsa fizikisht, por edhe me karakter, i përngjante shumë të atit. Kështu, pra, ndërsa i biri ishte krejtësisht e ëma, por studionte shkencën sikur i ati, kurse Dorina ishte sikur babai, por studionte artin si e ëma. Ishte një kombinim që i hutonte të gjithë ata që i njihnin si familje.

- Baba! – e trandi nga mendimet zëri i Dorinës që po vraponte kah ai. – E ke parë macen time të vogël? E di sa e mrekullueshme që është!

- Vërtetë qenka e mrekullueshme. Po kush do të kujdeset për të kur të shkosh për studime?

- Ju do të kujdeseni. Por edhe unë do vij shpesh, çdo vikend. Nuk më hiqni qafe lehtë, – qeshi dhe fluturoi duke humbur në kuzhinë. Pastaj nxori sërish vetëm kokën te dera dhe i tha ëmbël të atit: - Po ti do takohesh me miqtë e mi, apo jo?!

Bujari u kujtua se nuk ishte përshëndetur me të ardhurit. U ngrit dhe doli në oborrin që përngjante sikur ato livadhet e mëdha me panaire të verës, ashtu i mbushur gjithë djem e vajza të moshave të ndryshme. Të gjallë, si mosha që kishin; dikush tregonte ndonjë shaka, dikush vallëzonte, ndërsa dy a tre syresh kishin kërcyer në pishinën që ishte aty në anë të oborrit. Bujari u takua me të gjithë dhe piu me ta një gotë lëng. Befas Dorina ndali muzikën dhe tha:

- Dua të ngre një dolli me të gjithë ju që keni ardhur sot. Për ju, për familjen time. Kjo është ditëlindja ime më e bukur në jetë dhe ndihem shumë e lumtur që e ndaj me ju. Nuk kam për ta harruar kurrë! Ju faleminderit!

- Tani ke të drejtë të ikësh kur të duash nga shtëpia, nuk je më e mitur,- e nguci me zërin e tij shpotitës Diamanti, diku përtej tavolinave.

- Kudo që të iki, juve do t'ju kem me vete, mu këtu, – u përgjigj Dorina duke vënë dorën mbi zemër me një seriozitet solemn.

Të gjithë duartrokitën, ndërsa Besa e shikonte të bijën dhe ndjente se si po kalonte kaq shpejt nga çupëria në vajzëri. Në sy mund t'ia dalloje lotët e prindit, që e shihte fëmijën të ecte kah të papriturat e jetës, pa e ditur nëse ishte apo jo e përgatitur për to. Me buzëqeshjen e lehtë në buzë, shikonte të dy krijesat e saj, djalë e vajzë, të cilat ia kishte falur natyra për t'i përmbushur një mision në këtë jetë, për t'i dhënë kuptim jetës së saj; në këtë nuk kishte aspak dyshim.

Akrepat e orës po fluturonin rrugës së tyre dhe sakaq mbrëmja lëshoi vellon e saj. Miqtë e kishin kohë që kishin shkuar. Kur e kishin sistemuar të gjithë së bashku shtëpinë, Dorina u shtri gjerë e gjatë në kanape, e këputur.

-Dorina, mos u shtrij aty, shko të flesh lart në dhomën tënde!- i tha e ëma.- Mendon se je akoma dhjetë vjeçe të të bartim pastaj shkallëve?

- Po nuk dua që kjo ditë të mbarojë, dua të zgjasë ende.

- Hajde Dorina, do të të vë në gjumë sikur ishe e vogël,- i tha Bujari dhe e tërhoqi për krahu.

- Prit ta marr edhe Midin.

- Kush është Midi?

Ndërkohë që Dorina kishte marrë macen e saj si top bore në duar, Bujari e kuptoi se cila na qenkësh Midi. Shkuan lart bashkë dhe së pari e vendosën Midin në një jastëk të madh brenda një shporte prej kashte. Pastaj Dorina u ul te shtrati i saj. Befas, Bujari nxori diçka nga xhepi, një zinxhir të hollë floriri, dhe ia vuri në qafë.

- Ç'është kjo, baba?- u habit Dorina.

- Është medaljoni i nënës sime, Dorina. Gjyshes sate të ndjerë. Pata vendosur të ta dhuroj kur t'i mbushësh të tetëmbëdhjetë vjetët.

Dorina e mori medaljonin në dorë dhe pa se në zinxhirin e hollë varej një si kuti e vockël ku brenda duhej të kishte patjetër diçka; e hapi kutinë me kujdes sikurse të ishte e qelqtë. Brenda saj Bujari kishte vendosur një foto të vogël të Dorinës, kur ajo ishte foshnjë në krah të tij. Vajza ngriti sytë e përlotur dhe i tha të atit:

- Të faleminderit, baba, nuk do ta heq asnjëherë. Ti do të jesh zana ime e mirë.

- Ndërsa ti do të jesh manarja ime, sikur e ke ti Midin tani. Të dua sa diellin, sa hënën dhe yjet, – i tha Bujari dhe e puthi në ballë.- Ndoshta diellin e dua pak më shumë.

- Po pse? – e pyeti vajza kureshtare, teksa po shtrihej fare e përgjumur.

- Sepse është si zemra jote. Ti, sikurse dielli, ke ngrohtësi për tërë botën.

Si t'i kishte kuptuar fjalët e Bujarit, Midi u ngrit dhe kërceu te këmbët e Dorinës. Sikur deshi edhe ajo ta ndjente ngrohtësinë e saj. U bë kruspull dhe fjeti aty.

Ishte një nga ato ditët e bukura që gdhenden në kujtime për të mos u shlyer kurrë.

III

IKishin kaluar disa javë nga ditëlindja e Dorinës. Bujari dilte përditë në kopshtin pas shtëpisë dhe merrej me studimet e tij. Kishte vetëm edhe pak punë për të përfunduar kapitullin e fundit të librit të ri. Ky punim i pëlqente shumë ende pa u formësuar, ende pa u përfunduar. Sigurisht që do të bënte bujë në qarqet shkencore, meqë shtjellonte një ide të re, të bazuar në një zbulim të kohëve të fundit, rreth të cilit, ishte i sigurt se do të mbaheshin tryeza diskutimi, debate, seminare, emisione televizive me intervista e mundësi demonstrimi. Në fillim Bujari ishte nisur të bënte një koment për zbulimin e ri, por me kohë pa se çështjet që po ngrinte aty kishin të bënin me një nevojë të ekonomisë së vendit, që ishte tamam në moshën kur kërkonte të ngrihej në këmbë, pra të krijonte bazën e tij me industri e teknologji. Atëherë i shkreptiu se do të ishte më me vlerë të merrej gjerësisht me këtë temë, pra ta shihte në lidhje me nevojat dhe mundësitë e vendit të tij, për ta vënë në jetë. Këtë mendim ia kishin mbështetur edhe miq e kolegë, madje në një kafe pune me një përfaqësues të një fondacioni, i cili merrej me nxitjen e zhvillimeve teknologjike në vendet e vogla, kishin rënë në ujdi që, sapo ta përfundonte punimin, t'ia jepte së pari atij për ta parë. Përfaqësuesi i fondacionit i tha Bujarit se me temën që ai po hulumtonte po gjendeshin padashur në të njëjtën udhë, pasi edhe institucioni i tij ishte i interesuar të investonte për një projekt të tillë. Ky mendim i jepte edhe më shumë shtysë Bujarit për ta përfunduar sa më parë studimin e tij të ri.

Ishte kredhur në këto mendime, kur befas, përmbi fletoren e tij të punës filloi të lëvizte një hije dhe t'ia merrte përqendrimin. "Dreq, o punë!- tha,- si s'më lënë rehat edhe këto re, që ma marrin diellin".

Ngriti kokën i trazuar dhe, në vend të reve udhëtare, pa fqinjën që po ujiste lulet poshtë dritares së saj. Herë pas here gruaja e çikte me sup e kanatën dhe ajo lëvizte sa andej-këndej dhe e hidhte dritëhijen tamam mbi librat e Bujarit. Kjo kishte bërë që ekuacionet e tij të vallëzonin herë nën diell e herë nën hije.

Bujari vuri dorën strehë mbi vetulla, dhe i nguli sytë në dritare sikur donte ta gjente atje gjysmën e ekuacionit që i kishte fluturuar. Fqinja u hidhte ujë luleve dhe sikur fliste me to, pse herë i ravijëzohej një buzëqeshje e herë një ngrysje e lehtë mbi fytyrë. Flokët i kishte në ngjyrë gështenje të hapur dhe i mbante të mbledhura shkujdesur përreth qafës, bisht kali, siç thoshin vajzat në moshën e tij të rinisë. Mbante një bluzë të hollë që ia mbulonte lehtë trupin e bëshëm me forma të theksuara. Gjysmën e trupit e kishte hedhur përkëtej dritares dhe, ndërsa zgjatej poshtë parvazit për të lagur lulet, dukej e shkujdesur për gjoksin që i derdhej lirshëm nën bluzë. Bujari ngriu. Fqinja ishte e bukur si një nimfë. Kishte dy sy të mëdhenj përfund vetullave të theksuara harkore; buzë të plota, që dukeshin ende më të bukura kah puliteshin pas fjalëve të ndonjë kënge, të cilën po e këndonte ashtu mbytur, për vete. Drita që i binte në fytyrë i jepte pamjen e një krijese hyjnore; por megjithatë ajo ishte aty, si diamantet e shtrenjta në vitrinën e tejdukshme dhe delikate.

Bujari u kujtua se nuk ishte më në kohën e tij të rinisë për tu shastisur pas bukurive të grave, dhe atëherë kërkoi t'i shkundë vrullshëm këto përqasje romantike nga koka. I hoqi sytë nga dritarja dhe provoi t'i kthehet fletëve të tij gjithë shënime. Por ato i dukeshin aq të pakuptueshme tanimë. Diçka e shtrëngonte në gjoks, një ndjenjë pothuajse e harruar e kaploi të tërin. Forca që i buronte nga brenda e yshti ta ngrinte kokën përsëri dhe të shikonte kah fqinja, e cila dukej se vazhdonte e pa turbulluar punën e saj.

Për një çast fqinja i hodhi sytë përkëtej dhe shikimet e tyre u ndeshën diku në mesin e kopshtit plot lule, si dy zogj që bien padashur në të njëjtën pemë dhe nuk dinë si të bëjnë, të rrinë aty apo të rrahin krahët për të gjetur secili një tjetër degë të lirë.

- Përshëndetje,- i tha fqinja duke ia tundur dorën e duke i buzëqeshur lirshëm si fëmijë.- Çfarë po shkruani ashtu?- e pyeti me një zë intim e të ëmbël, thuajse po këndonte me fjalë.

- Ah, asgjë, asgjë,- u shkund Bujari si nga një përgjumje e shkurtër.- Ja me këto shkarravinat e mia,- shtoi ashtu kuturu, me një nënqeshje të ngrirë, gjithmonë duke u munduar të duket sa më i qetë e i patrazuar, megjithëse nën tavolinë e kishte shtrënguar lapsin me tërë fuqinë. Ndjeu se po e kaplonin ca djersë të ftohta. I dukej vetja si në faj.

- Ashtu?!- tha fqinja me një habi gjithë ojna.- Ndërsa mua mu duk se po merreni me ligjet e ekzistencës, ose po shkruani poezi.

- Poezi? Eh kjo do të ishte vërtetë interesante, – tha Bujari,- po ka kohë që nuk kam qenë aq i qetë për t'i lënë frymëzimit vend që të frymojë.

- Epo... ndoshta tani ka ardhur koha,- qeshi ëmbël fqinja, ndërsa Bujarit iu duk se dëgjoi gurgullimën e lumit të tij të dashur, që kalonte përskaj shtëpisë së tij atje në vendlindje. Iu duk sikur ishte ulur mbi atë gurin e madh e të bardhë skaj tij, si në kohërat e fëmijërisë, kur dëshironte të shndërrohej edhe vetë në lum. Kur ëndërronte të ishte i lirë e i pavarur si lumi, që i prekte të gjitha duart e botës, që i lante të gjithë trupat e bukur të zonjushave, që vizitonte dete e vende te mrekullueshme, që barte mesazhe të fshehta. Lumi ishte bërë atëherë miku i tij më i ngushtë, ishte bërë pothuajse vetë ai. Atij ia pështpëriste të gjitha sekretet dhe dëshirat më të thella…

- …sepse duhet të kryej edhe punë të tjera, mirupafshim!- Bujari u trand nga fjalët e fundit të fqinjës, e cila buzëqeshur ia bëri me dorë dhe u fut përbrenda.

Bujari mbeti ende ca çaste i hutuar me sytë të ngjitur në dritaren e mbyllur, pastaj uli kokën e mori frymë thellë.

Pak nga pak nisi të përqendrohej dhe çdo gjë dukej se po vinte në vendin e vet. Kur hija i kishte rënë gjithë kopshtit, Bujari u bë gati të mblidhte gjërat e tij e të futej brenda. Për një çast e kujtoi episodin me fqinjën e bukur dhe qeshi me veten:

" Eh, Bujar, Bujar, mendove se në zemrën tënde po fle ende një djalosh i turbulluar, mendove se ende ke fuqi të përballosh shqetësimet e dashurisë…. Eh, shkoi vapa me gushtin".

Brenda po e priste bashkëshortja e tij e mirë dhe kafeja e ngrohtë mbi tavolinë.

- Ka kohë që e kam bërë gati darkën, por nuk doja të të prishja qetësinë,- i tha gruaja me atë zërin e saj të butë gjithë mirëkuptim.- Kur pashë se po bëheshe gati për tu futur brenda, ta bëra edhe kafenë. Thashë se kushedi e do një para se të hash, që ta shkundësh lodhjen e punës.

- Mirë bëre, sot vërtetë jam lodhur shumë, po kam qenë i frytshëm,- tha Bujari, por menjëherë u trand nga deklarata e tij që mund të dukej me kuptim të dyfishtë. Dhe ndërroi fletë:– Më lër të pushoj pak, kam nevojë për një sy gjumë. Më zgjo pas një çerek ore.

- As kafenë nuk do ta pish?

- Nuk më shkon tashti,- tha Bujari duke u shtirur sikur të ishte tejet i lodhur.

- Mirë, shtrihu pak. Ndërkohë unë po e bëj gati tavolinën. Pas pak vjen edhe Dorina.

Bujari dhe Besa kishin një martesë diçka të veçantë. Gjërat brenda kësaj ndërtese të çuditshme shkonin aq të qeta, sa gati dukeshin të pazakonta, të panatyrshme. Asnjëri prej të dy bashkëshortëve nuk ia prishte qejfin tjetrit. Dukeshin sikur nuk kishin huqe e cene, si gjithë të martuarit e botës, sikur nuk ishin lodhur aspak e as ishin mërzitur fare me njëri-tjetrin në kaq vite bashkë. Nga kjo, miqtë i merrnin lakmi dhe nuk linin rast pa folur për marrëdhëniet e tyre ideale. Vërtetë nga jashtë martesa e tyre dukej si një kullë e fortë, e palëkundshme, të cilën sikur frikoheshin ta rrihnin erërat e forta.

- Natyra do të na vizitojë bashkë me burrin e saj së shpejti,- i tha Besa Bujarit, kur ky ishte zgjuar dhe po pinte kafenë.

- Natyra? Kush është Natyra? - pyeti ai.

- Natyra është fqinja jonë e re, me të cilën takohemi çdo ditë në rrugë,- i tha gruaja dhe vazhdoi me një entuziazëm të çiltër:- Është një grua shumë interesante, e gjallë dhe e hareshme, ka gjithmonë pamjen e një deti me valë, që fsheh sekretin e botës brenda barkut të tij.

U ndal pak , rrufiti kafen dhe vazhdoi:

- Burri i saj është shumë më i moshuar se ajo, madje ka qenë i martuar një herë dhe i ka vdekur gruaja e parë. Paska dhe dy fëmijë të martuar. Djali po i jetuaka jashtë, ndërsa e bija në kryeqytet. Me Natyrën janë takuar për së pari në një seminar shëndetësie, pse janë mjekë që të dy. Kanë edhe një klinikë private në periferi të qytetit. Kanë dy javë që janë shpërngulur në pallatin afër nesh.

Gruaja po fliste ende, po Bujari nuk e dëgjonte më. Ishte kredhur në mendime.

"Fqinja, ah ajo fqinja e mallkuar, na qenka mjeke. Dhe quhet Natyra? Sa emër i bukur, një emër që i përshtatet mirë asaj krijese me gjithë ato hire që natyra ia kishte falur aq bujarisht. Dhe, vetëm natyra mund t'i bëhet rivale", po mendonte.

-…po kërkojnë një ndihmëse për shtëpinë, meqë doktoreshë Natyra thotë se është e interesuar të përparojë në karrierë dhe jo të mbetet një shtëpiake çfarëdo…." – po vazhdonte gruaja.

- Natyrisht,- u ngut Bujari të thotë, - ashtu dhe duhet.

E shoqja heshti, uli sytë dhe ofshau.

"Ja,- tha me vete Bujari,- e bëri përsëri. E bën që unë të ndjehem me faj. Flet për doktoreshë Natyrën, thotë se ajo nuk dëshiruaka të mbetet shtëpiake, që të më lëndojë për veten e saj; mendon gjithnjë se kam qenë unë ai që e kam lënë pa diplomë. Më mirë ta kishte vazhduar atë dreq karriere të pianistes, do ta kisha përballuar jetën edhe pa atë sakrificën e famshme të saj...".

- Domethënë çifti i ri do na vizitojnë së shpejti,- tha Bujari me një ironi të fshehur, duke u munduar kështu edhe të ndërrojë ca temën e bisedës, edhe të bëjë pak humor, pas atij pezmatimi të beftë të Besës për punën e karrierës. Por e ndjeu sakaq se Besës nuk i pëlqeu edhe aq ironia e tij për "çiftin e ri".

- Po, besoj se së shpejti do t'i kemi për darkë, nëse ty nuk të pengon kjo,- iu përgjigj gruaja.- Por iu luta fqinjës të na paralajmërojnë gjithsesi, ngaqë nuk dua të na vijnë në ndonjë kohë të papërshtatshme për studimet e tua.

- Mirë fort, atëherë më lajmëro ndonjë ditë përpara,– tha Bujari dhe hapi gazetën.- Ky dreq studimi...

Bujari po këndellej. Fjalët e gruas po i vinin si lajmet e një spikeri nga një radio e largët. Ishte diçka si në meditime. Së shpejti do të takoheshin me fqinjën e bukur dhe ky mendim e bënte çuditërisht të dridhej i tëri. I jepte një tendosje të dhimbshme, po dhe të këndshme njëkohësisht.

- Po si qenka martuar me atë plak?– e pyeti sërish të shoqen, duke u munduar të dukej sa më i pa interesuar .

- Nuk e di, por si duket kjo ka ndodhur shumë shpejt. Nuk është edhe plak, sapo i ka mbushur të gjashtëdhjetat. Duket se fëmijët e tij nuk e kanë pranuar edhe sot e kësaj dite njerkën e re. Por as ajo nuk është shumë e prirë të lidhë miqësi me ta, thotë se i duken fare të largët.

"Natyrisht,- mendoi Bujari,- askush nuk e ka të lehtë ta pranojë si njerkë një femër aq të bukur e joshëse, intelektuale, të re e të freskët….".

- Po ai? Si duket ai? – pyeti duke i shtrënguar buzët me një farë përbuzjeje për burrin e fqinjës.

- Fare i zakonshëm, – ia ktheu Besa.– Është ca tullac dhe pakëz i plotë, mban një mjekër të prerë bukur, ka vetulla të trasha dhe të ngrysura, sy bojë qielli dhe është më i shkurtër se e shoqja, Natyra… Nuk përshtaten edhe aq si çift, por... – tha kështu dhe u zu në mendime, sikur po kërkonte të gjente fjalën e humbur. Dhe pastaj krejt papritur vazhdoi:

- Ah, po, se harrova. Të kam caktuar një takim për një vizitë mjekësore te doktoreshë Natyra. Do të shkojmë bashkë pas disa ditësh,- tha me një gëzim fëmijëror dhe humbi në kuzhinë.

- Po pse? – e pyeti Bujari duke bërtitur që ajo ta dëgjonte përmatanë.

Gruaja u shfaq përsëri në dhomë.

- Jam në merak për ty, Bujar. Dukesh i lodhur. Them se ke nevojë të bësh ca analiza.

- Epo mirë, po qe se kjo ta heq merakun, – i tha ai.

***

Bujari vazhdonte të dilte përditë në kopsht dhe çdo mëngjes ulej në ndenjësen e tij të rehatshme me mendimin se, së paku sot, do ta kryente një kapitull, e kështu do t'i mbahej fjalës që i kishte dhënë përfaqësuesit nga institucioni investitor për t'ia dorëzuar librin nga fundi i muajit. Tjetri, madje, kishte shkuar më tutje në bisedën me Bujarin: i kishte ofruar një fond për të përballuar nevojat e shtypshkrimit, të redaktimit dhe të oponencës. "Të gjithë në institutin tonë jemi të sigurt se punimi juaj është një hulumtim me vlerë, prandaj përgjegjësit e mi më dhanë dritën e gjelbër për fondet,- i kishte thënë ai Bujarit në një tjetër kafe pune.- Kësisoj, sipas rregullores, ju keni të drejtë ta merrni një pjesë të fondit që tani, ndërsa kusurin kur ta kryeni krejt punën". Bujarin e nxiste shumë ideja se tema e tij do të gjente aplikim të menjëhershëm në ekonominë e vendit, për këtë prej disa ditësh e niste mëngjesin me mendimin se atë ditë do të punonte më me ngulm dhe do ta mbaronte një pjesë të mirë të punës së mbetur. Fundja gjithçka e kishte në kokë, i duhej vetëm ta hidhte në letër.

Prej disa ditësh fqinja nuk ishte shfaqur në dritare. B kishte parë edhe nja dy herë të tjera pas asaj dite, fare shkurt, në rrugë; ishin përshëndetur me mirësjellje dhe përsëri ajo ia kishte bërë me dorë, siç bëjnë vajzat gjimnaziste kur ndahen me shokët e tyre. Bujari ishte munduar të dukej i sjellshëm dhe i përmbajtur në ato dy minuta prezence të saj, por sapo ajo kthente shpinën - eh çfarë kurmi!- seç ndjente një turbullim të pazakontë brenda tij. Të ishte ky vërtetë një trazim dashuror mashkulli? Por pas pak e mblidhte veten dhe pështpëriste gati me zë: "Bah….jo. Çfarë trazimi?". Mundohej ta bindte veten se e gjithë kjo ishte vetëm një lojë ndjenjash e asgjë tjetër. Një behje për një gjë të bukur, si për një lule, a për një fryt të pjekur. Hej, dreq, edhe krahasimet sikur nuk donin ta linin rahat. Dhe i jepte karar se nuk ishte më aq i ri sa të mendonte seriozisht për këto gjëra. Pastaj... ç'i duhej në këtë moshë të fuste ferrë në këmbë të shëndoshë, kur gjërat në jetën e tij ishin aq të qeta dhe kishin marrë rrjedhën e duhur në çdo anë. Kur kishte një grua... si Besa. Çuditërisht nuk gjente një krahasim për shoqen e tij të jetës, nuk dinte me çfarë ta përqaste.

Në të vërtetë pasioni për të shoqen tanimë nuk ishte më ai i pari, dhe gjithsesi dukej se të dy ishin pajtuar me këtë gjë, si ai dhe ajo. U mjaftonte qetësia, u mjaftonin fëmijët.

Dorina sidomos, që ishte aq e ëmbël dhe i bënte të ndjeheshin të lumtur. Jo, jo, ai nuk ishte më në atë moshë kur mund të mërgonte pas një ëndrre të lehtë dashurore. Mbërrinte kështu t'ia mbushte mendjen vetes se nuk kishte asgjë të vërtetë, se nuk kishte asnjë trazim për fqinjën e bukur. Atëherë ulte sytë mbi fletët e tij të bardha që prisnin të mbusheshin me formula.

Por ditët e fundit nuk ishte dhe aq i frytshëm në punën e tij. Bënte t'i ngulte sytë mbi temën, por pa dashur, në dy sekonda e ngrinte kokën dhe shikimi i shkonte bash te dritarja ku ishte shfaqur fqinja e bukur. I bëhej se shihte kurmin e derdhur të saj nën atë veshje të hollë të tejpashme dhe dorën e vogël që e përshëndeste. Kështu edhe atë mëngjes të shtunë. U nis për së mbari për punë. Hodhi sytë mbi librin e tij të ardhshëm dhe pa se kishte mbetur po aty ku kishte qenë atë ditë që u shfaq fqinja si vegim. Kjo e nervozoi; e nervozonte fakti se nuk po i bëhej të punonte. Gjithsesi, e mblodhi mendjen dhe iu shtrua me dhunë formulave të tij, që prisnin në kokën e trazuar për t'u hedhur aty mbi ato fletët e bardha.

E cingëriste mendimi se mos e kishte lënë veten të trandej në një punë jo fort të hijshme për të. Mos dukej krejt ndryshe tashti? Mos binte në sy se ishte kapluar nga ajo ndjenjë e vjetër, që e kishte braktisur me kohë, por që i ishte shfaqur çuditërisht rishtazi në qenien e tij? Bah! Dhe e turpëronte mendimi se ai mund të kishte rënë vërtetë në dashuri. Çka do të ndodhte, nëse këtë do ta vërenin familjarët e tij? Po miqtë?.. Çfarë do të ndodhte nëse do ta zbulonin studentët, që kishin për të një mendim aq të mirë, një respekt të skajshëm. Ai kishte qenë gjithmonë korrekt, edhe atëherë kur ndonjë studente djallushë ishte munduar ta ngucte e ta joshte me hiret e saj. Thjeshtë, kishte qenë përherë i paprekshëm nga lojërat dashurore. Dashuritë e tij kishin qenë shkenca dhe familja.

Por ditët e fundit i dukej se studimet, që deri dje i dhuronin qetësinë dhe plotësimin shpirtëror, i kishin kaluar në bezdi, në mërzi. Sillej si i hutuar nëpër shtëpi. Pjesëtarët e tjerë, gruaja dhe e bija, po edhe Diamanti me Mimozën, nisën ta vërenin ndryshimin, por secili mendonte se ishte i ngarkuar e i lodhur. Tamam për këtë, edhe e shoqja, Besa, ia kishte caktuar një vizitë mjekësore te kjo doktoresha e re, Natyra.

Besa, vazhdonte t'ia kujtonte se duheshin bërë analizat dhe vizita mjekësore, duke këmbëngulur përditë, saqë, po të mos ishte në pyetje vizita te Natyra, do t'ia numëronte se i ishte bërë e mërzitshme me atë përkujdesjen e saj, që ndonjëherë dukej si e shtirur. Ndjeu një faj të rëndë kur mendoi kështu për të shoqen. Gruaja e tij e mirë… Gati e kishte harruar fare këto ditë, nuk i kujtohej në ia kishte hedhur sytë si duhej. Ajo vazhdonte ta mirëkuptonte, të sillej me të gjithnjë njëlloj. O Zot, sa e padjallëzuar që ishte. Dhe ai sa po e nënçmonte këtë krijesë të mirë. Pse duhej t'ia përbuzte gjithë atë kujdes e mirëkuptim, pse duhej të ishte kaq mosmirënjohës për atë përkushtim e vëmendje që ajo tregonte për të. Dhe ajo vetë nuk kërkonte thuajse asgjë, dukej se ishte gjithmonë e kënaqur, e qetë, e plotësuar edhe pa i dhënë asgjë… Pse duhej të sillej aq ashpër ndaj kësaj krijese kaq të pastër, dreqi e marrtë! Pse nuk grindej kjo grua, pse nuk thoshte një fjalë, së paku të ngrinte zërin për diçka, të shprehte pakënaqësinë, të thoshte një herë "jo, s'bën, s'duhet"… Pse ishte aq e përkushtuar, xhanëm, për të tjerët, për atë vetë. Ndërsa për vete... sikur i kishte mbledhur të gjitha pasionet dhe emocionet e i kishte burgosur përjetësisht diku në fund të detit….

III

Një natë më parë Besa i kishte thënë Bujarit se fqinjët do të vinin atë të shtunë, prandaj ai e la më shpejt punën dhe u fut në shtëpi. Ishte pothuaj pasmesdite dhe mendoi se ata tashmë do të kishin ardhur. Ishte ashtu; nga ballkoni dëgjoheshin të qeshurat e tyre dhe të Besës që po u bënte muhabet. Bujari u fut nga kuzhina dhe pastaj në korridor, aty qëndroi pak kohë para pasqyrës. Ndonëse i dridheshin këmbët, iu duk vetja goxha i pashëm. U fut në dhomën e ndejës dhe menjëherë u gjend përpara fqinjëve. Burri ishte ashtu siç ia kishte përshkruar e shoqja: i shkurtër e me kokën thuajse pa flokë, me faqet pak të rëna e me një pamje prej babaxhani. Ndërsa Natyra, e shoqja, i kishte lëshuar flokët duke i lënë t'i derdheshin lazdrueshëm nëpër fytyrë. Kishte veshur një fustan me ngjyra të ndezura, nga i cili, poshtë, buronin këmbët e bukura të hedhura njëra përmbi tjetrën. Në një dorë mbante gotën, ndërsa me tjetrën prekte si pa dashje qafën e bardhë të zbuluar. Sikur kënaqej me lëkurën e saj të butë.

Burri i saj po tregonte një histori, duket nga jeta e tij, dhe herë pas here qesheshin bashkë me Besën, ndërsa Natyra i dëgjonte disi sikur me një nënqeshje të lehtë, jo aq e interesuar.

Bujari u afrua me një buzëqeshje të ngrirë në fytyrë. Përshëndeti, gjithmonë duke u munduar ta shmangte shikimin e Natyrës.

- Mirë se keni ardhur, – u tha, - shpresoj se nuk u vonova shumë, por kisha vetëm edhe pak për të përfunduar një kapitull nga studimi im. Më duhet ta mbaroj shpejt, këto ditë më duhet ta dorëzoj...- po shpjegohej gjithë edukatë, si një nxënës shkolle.

- Mirë se ju gjetëm, - i tha gjithë gjallëri e duke u ngritur në këmbë fqinji babaxhan.- Unë quhem Shpëtim.

Bujari pa para tij një fytyrë dashamirëse, me dy sy të zgjuar, që fshiheshin prapa qelqeve të syzeve. Tokën duart sikur të ishin të njohur të hershëm. Shpëtimi ia shtrëngoi dorën aq fort sa Bujari u kujtua se ishte burrë edhe ai, dhe se burrat kështu token. Kjo i bëri njëfarë përshtypje të mirë, megjithëse deri në atë çast e kishte menduar gjithë bezdi takimin me "plakushin". Pastaj Bujari u kthye nga Natyra. Ajo ia zgjati dorën pa lëvizur nga karrigia.

- Më vjen mirë që njihemi, - i tha gjithë delikatesë. Bujari ia zuri majat e gishtërinjve dhe ndërkohë mendoi se tamam kjo mënyrë elegante prezantimi i mungonte shumë grave të sotme.

Biseda po rridhte natyrshëm dhe për këtë Bujari i falënderohej heshtazi gruas së tij, që po bënte çmos për të mbajtur një atmosferë të çiltër e familjare me temat që rrokte dhe me mënyrën se si i trajtonte ato, duke u lënë gjithnjë rast më shumë miqve ta thoshin atë që mendonin. Shpëtimi e dëgjonte Besën pothuaj gojëhapur dhe si i mahnitur. Kjo nuk i pëlqente dhe aq Bujarit, por tekefundit mendoi se, babaxhani si babaxhan që është, habitet nga përrallat e plakushes së tij, ndërsa nuk e di se ka në krah një zanë si kjo që rri pa bëzajtur në karrige. Me këto që mendoi në heshtje iu duk se u hakmor mirë ndaj fqinjit të tij plak e babaxhan.

- Na tregoni edhe ju Bujar diçka për studimet tuaja, - i foli dikur Natyra me atë zërin e saj melodik, që atij iu duk se e dogji si me hekur te nxehtë.

- Ah, druhem mos bëhem i mërzitshëm,- tha gjithë ndrojtje Bujari.- Në to s'ka asgjë interesante, janë tamam si jeta e një burri pas të pesëdhjetave,- se si i erdhi ky krahasim dhe vazhdoi sikur po bënte një shaka, por vërejti vetullën e ngritur lehtas të fqinjës, që dukej e intriguar nga ajo që ai tha.

- Ja një arsye më shumë për të na treguar,- tha ajo,- sepse nga kjo që thatë del se do të kuptonim ca më shumë edhe për jetën tuaj. Por, më parë duhet t'ju them se unë nuk pajtohem me teorinë tuaj për... pesëdhjetëvjeçarët. Më lejoni t'i quaj kështu.

- Ashtu? E pse? – pyeti Bujari.

- Sepse unë jam e bindur që mosha mashkullore pas viteve të pesëdhjeta është sikur studimet tuaja, por ama e shikuar pozitivisht.

- Vërtetë, si ashtu? Kjo qenka shumë ngacmuese, – qeshi Bujari pa ia ndarë sytë fqinjës, po gjithmonë duke lënë me kuptuar se po vijon shakanë.

- Paj, si meshkujt, si studimet, pra të dy, janë të ngjashëm, pse përmbajnë gjëra të reja të ndërthurura me hulumtime nga përvoja të vjetra; përvoja të krijuara me pasion dhe maturi për një kohë të gjatë. Dhe plus gjëra të panjohura, që duhen studiuar e përjetuar pa humbur kohë e të futen në studimet e reja apo në... praktikat e reja. A më ndiqni? Sepse nuk premton koha. Si në shkencë, edhe në jetë, flas për këtë moshë, pra... pas të pesëdhjetave, duhet të jesh i shpejtë, pse nuk të fal e ardhmja. Në shkencë, dihet mirë, një zbulim i sotëm mund të vjetrohet papritur që të nesërmen; po edhe në jetë: ajo që Zoti ta ka dhuruar sot nesër mund të fluturojë e mund të migrojë për kushedi se ku. Dhe kjo pastaj sjell atë mundimin e madh, stresin për rastin e humbur... – tha Natyra duke i ngritur vetullat e bukura e duke ia ngulur një vështrim domethënës bashkëfolësit.

Bujari mbeti ca ngushtë nga gjithë kjo tiradë e fqinjës për shkencën dhe burrat, më mirë me thënë për rastet e humbura, prandaj deshi ta çojë bisedën në skaje të së zakonshmes.

- Por mendoj se kështu ndodh gjithnjë, - tha duke i zvarritur fjalët, që t'u lërë kohë edhe të tjerëve të mendojnë për këtë temë dhe të gjejnë pozicionin e tyre.- Gjithnjë në jetë ka raste të humbura. Si në shkencë, si në...

- Unë e kam fjalën për këtë moshë,- nguli këmbë Natyra, pa e lënë Bujarin ta përfundojë fjalën.- Rastet e humbura në rini nuk janë aq fatale sa në... më kuptoni, besoj. Prandaj po e krahasoj me shkencën, pse një rast i humbur në këtë moshën e të pesëdhjetave për mua është po aq fatal sa një zbulim shkencor i kyçur në sirtar. Ose në mendje. Besoj, – tha atëherë me shumë vetësiguri, kur pa se po ia dilte mbanë që ta mbyllte mirë idenë që kishte në kokë, - besoj se mu tash është koha që ju të veproni dhe studimet tuaja t'i shihni në praktikë, në vepër… T'i nxirrni nga sirtari. Jo vetëm si teori. Ju jeni shkencëtar dhe e dini se gjërat e mbetura në letër janë thjesht...,- ndaloi ca sikur dëshironte ta gjente fjalën e duhur, - ... janë, pra, thjesht dëshira të parealizuara, pasion i mefshtë… Ë?- pyeti duke e tundur lehtë kokën si një lozonjare tetëmbëdhjetëvjeçare dhe e shikoi drejt në sy.

Bujari ndjeu se po i djersiteshin duart ndaj i shtrëngoi fort pas trupit. I dukej se do të eksplodonte, se do të dilte jashtë kontrollit, do ta përqafonte, do ta shtrëngonte gjersa t'ia merrte frymën, i dukej se do të ndalej bota, do të shpërthenin të gjitha vullkanet dhe do të ekzistonte vetëm pasion, pasion... zjarr si në ferrin e tmerrshëm të dashurisë.

Por u kontrollua, ndonëse i dukej se mendimet po i vlonin. Provoi të kthjellonte trurin. Çfarë po i thoshte kjo grua, po i jepte shenjë? Po e ftonte në mëkat? E dashuronte vërtetë apo po e ngucte në një lojë të ndaluar dashurie që pastaj të argëtohej me turbullimin e tij? Me hutimin e tij, me vitet, moshën. Mos vallë ishte një përtallje e hollë kjo tiradë e çuditshme gjoja për shkencën, por që dukej sheshit se kishte në mes temën e... e të thuash dashurisë?.. Tundi kokën sikur për t'i flakur tej këto mendime që i jepnin dhimbje.

- E, profesor, nuk mendoni edhe ju kështu? Unë i them shpesh Shpëtimit se burrat më të moshuar janë gjithmonë më interesantë; apo jo i dashur? – iu drejtua ajo bashkëshortit, i cili buzëqeshi dukshëm i vënë në siklet. Ajo ia preku atij lehtë faqen, sikur fëmijës së vogël dhe pastaj u kthye me një zë të llastuar:

- Mua Shpëtimi shpesh më kritikon se i them gjërat drejtpërdrejt, por unë i them se jam mjeke dhe mendoj se detyra ime është t'ua jap diagnozat njerëzve aty për aty. Dhe të sakta, pa dredha. Ja, për shembull, ju, Bujar, dukeni një një mashkull që ka ndrydhur brenda vetes shumë emocione, shumë forca, dëshira dhe ndjenja të mëdha. Dukeni diçka si i drobitur, i fshikulluar nga lodhja, them, dhe keni nevojë për pak qetësi, mbase për ca joga, për pakëz ushtrime në palestër për ta çliruar trupin dhe shpirtin.

- Ju qenkeni psikologe e vërtetë, – i tha Besa me sinqeritet e dashamirësi.

- Ah,- tha ajo.- Burrat janë si fëmijët, të cilët po nuk i nguce nuk kujtohen as për të ngrënë.

Dhe iu kthye sërish Bujarit, duke e lënë Besën me fjalë në gojë:

- Ia qëllova, profesor, a është kështu si e thashë unë? Çfarë note do të më vini?

Në këto fjalë, ajo iu duk Bujarit si ato studentet djallushe, që i spërdridheshin me trupin të derdhur mbi tavolinën e tij të punës dhe e shihnin ngacmueshëm me sytë shkëndijues. Pickoi mishin e tij ashtu me duar të kryqëzuara nën sqetull dhe kështu u përmend paksa nga dhimbja që ndjeu.

- E mundur, por nuk e paskam menduar ndonjëherë në këtë mënyrë,- u mundua të buzëqeshte Bujari dhe hodhi sytë nga burri i saj, Shpëtimi, i cili nuk reagoi fare, përkundrazi rifilloi t'ia tregonte Besës atë historinë e mërzitshme nga vitet e tij studimore, me të cilën ajo po kënaqej si foshnje.

"Sa të plakur që janë…,- mendoi Bujari.- Nuk dinë fare të reagojnë në këto që thotë Natyra. Janë ende tek ura. Këtyre mund t'u flirtosh para syve pa marrë vesh asgjë"…

Pastaj, duke parë se të dy, Besa dhe Shpëtimi, po kënaqeshin me barsoletat e jetës së tij, ia nguli shikimin fqinjës së bukur, tashmë më me guxim dhe e vijoi diskutimin:

- Por, kur ta mendosh më mirë, edhe mund të jetë ashtu si thoni ju. Tekefundit juve jeni një grua e mençur dhe i shihni gjërat më mirë. Ndoshta më ndihmoni që edhe unë t'i shoh në atë mënyrë.

- Me kënaqësi, pse jo? – iu përgjigj ajo duke qeshur këndshëm.

- Si mjeke duhet ta keni ilaçin e duhur, ndoshta ndonjë zbulim të ri.

- Edhe në mos e paçim, e gjejmë… Me rëndësi që ju të jeni i kënaqur.

- Por, duhet të presim diagnozën kur të më vizitoni javën tjetër,- i tha ai duke e shikuar drejt në sy me ngulm.

- Patjetër, - ia ktheu Natyra,- e biseduam me gruan tuaj një ditë kur u takuam. Më tha se dëshiron t'ju bëjmë analizat.

- Oh, kjo më shumë brengoset, në fakt unë ndjehem mirë, jam në formë…

- Do ta shohim këtë, ë? - i tha tjetra me një buzëqeshje intime që i varej te cepi i buzës dhe që Bujarin po e bënte të çmendej.

- Do të mundohem që atë ditë t'i largoj pacientët e tjerë, që t'ju kushtohem e tëra. Po mendoj, dua t'ju kontrolloj me shumë kujdes. Kur dëshironi të vini?

- Caktojeni ju datën.

- Epo mirë. Do të merremi vesh ndërkohë. Fundja jemi fqinjë, tash e tutje do të kemi kontakte të shpeshta, shpresoj.

- Patjetër.

Pas kësaj bisede ajo u kthye kah dy bashkëbiseduesit e tjerë dhe filloi të qeshte me historinë e Shpëtimit, thuajse e kishte përjetuar që nga fillimi. Bujari kishte mbetur i gozhduar. Ndjehej në mëdyshje para Shpëtimit. Mos po e kuptonte keq këtë bisedë mënjanë që ai bëri para pak sekondash me gruan e tij; mos po ia merrte si një vardisje ndaj gruas së tij bukuroshe e të re? Mos po ngutej me habitjen e tij ndaj Natyrës? Apo nuk kishte asgjë nga këto dhe po i dukej kështu nga dëshira e zjarrtë për ta pasur këtë mrekulli prej gruaje në përqafimin e tij…

***

Dielli kishte kohë që kishte zënë fronin e tij në qiell. Frynte një puhizë e këndshme, që ta ngrohte shpirtin. Kjo mesditë kështu e butë, të ngjallte një farë gjendje euforike në shpirt, të bënte të ndjeheshe sikurse shpirtrat e dashuruar.

Dritaret e shtëpisë ishin të hapura të gjitha dhe nga brenda dëgjoheshin notat e Dorinës. Këtë herë po i binte pianos e po këndonte. Kënga e saj bashkohej me atë të zogjve jashtë, në oborrin e rrethuar me pisha e gjelbërim.

Nga kuzhina ndjehej aroma e këndshme e kafjallit, që po e gatuante Besa. Dorina e la këngën përgjysmë dhe fluturoi atje. Mbërtheu të ëmën nga prapa dhe e përqafoi fuqishëm.

- Largohu, moj dreq, se më more mendtë e u bëra gjithë pis me miell, – i tha e ëma me një seriozitet të përzier me buzëqeshje dhe pastaj ia bëri Dorinës hundën me pak miell.

- Na, pra! – dhe qeshi.

- Po bën petullat e mia të preferuara? Mmmmmmm nuk kam durim t'i gllabëroj të gjitha,- bërtiste nëpër kuzhinë Dorina dhe kërcente sa andej sa këndej.

- Je bërë më zi se Midi, madje edhe ajo e gjora është më e urtë se ti,- e shpotiti e ëma.

- Por, ama ec e thuaj se mund të mos e duash e? e? e? Me ato naze që ka, të bën ta hash fare; si shpirt është.

- Domethënë po të miklohesh mirë e bukur duhet të të duan të gjithë? – i tha e ëma duke qeshur.

- Po pra, të gjithë. Edhe unë dua të më duan të gjithë, ashtu siç e dua unë botën.

" Sa e ëmbël dhe e padjallëzuar që është" mendoi e ëma.

Ndonëse Dorina ishte tashmë e rritur, në shtëpi e mbanin si manare dhe ajo kënaqej me këtë. Kohë më parë, kur ishte adoleshente, rebelohej e kërkonte ta trajtonin si të rritur. Por, tani që vërtetë ishte rritur, kënaqej kur familjarët e trajtonin si macen e vogël dhe e mbronin nga çdo gjë.

Megjithatë, kishte çaste kur Dorina merrte një pamje serioze dhe kridhej në mendime të thella, dukej sikur barte hallet e të gjithë botës në shpinë. Kur e pyesnin, ajo vetëm mblidhte supet dhe qeshja ia mbushte fytyrën sikur rrezet e diellit.

"Ah, shpresoj që jeta ta trajtojë mirë Dorinën"- mendonte e ëma duke gatuar.- Ajo nuk është mësuar të përballet drejtpërdrejt me vështirësitë. Kam shpresë ta gjejë dikë që ta dashurojë shumë dhe t'i bëhet si shtyllë, si krah ku të mbështetet. Dashtë Zoti i madh e bëhet kështu. Vetëm pa dashuri Dorina të mos mbetet kurrë"- mendonte e ëma.

- E di se kam një gjë, që po më mundon shumë dhe tani jam në një dilemë të madhe? – e trandi të ëmën Dorina nga mendimet. Kur u kthye kah ajo, Besa pa një fytyrë serioze që sikur po mundohej të zgjidhte një gjë tepër të vështirë. Kishte kryqëzuar duart dhe me gishtërinjtë e njërës prej tyre rrihte krahun tjetër në shenjë brengosjeje.

- Jo, nuk e di, ma thuaj!- i tha e ëma dhe ndjeu një shtrëngim në zemër për brengën e së bijës.

Çfarë mund të ishte vallë ajo brengë?.. mos kishte gjetur ndonjë djalë, mos ishte dashuruar… mos, largqoftë, dikush e kishte kërcënuar me ndonjë gjë?..

- Çfarë të mundon?- e pyeti sërish.- Ke ndonjë problem? Ke dilemë për karrierën tënde, mos do t'i lësh studimet përgjysmë? Apo ke gjetur ndonjë djalë? Cili është, ma thuaj shpejt këtë dilemën tënde, se më plase!- tha nëna e brengosur me fytyrën e së bijës, e përgatitur se do dëgjonte diçka të tmerrshme. Pastaj mblodhi veten e tha më qetë:

- Dorina, ulu dhe më thuaj, çfarë dilemash ke, bija ime? Ti e di se me mua mund të bisedosh si me miken tënde më të mirë. Në mos asgjë tjetër, këtë mundësi ta kam ofruar gjithmonë. Hë, hajt se më plase….

- Po ja,- filloi të fliste ngadalë e bija dhe sikur hezitonte ta nxirrte fjalinë e duhur.- Ja, kam këtë problem të madh… më mirë të them dilemë të madhe…- dhe këtu papritmas mbushi zërin përplot me sherr fëmijëror dhe vazhdoi shpejt.- Nuk di a t'i ha këto petulla me reçel dredhëzash, me krem çokollate apo me mjaltë? – dhe u bë gati për të ikur njëkohësisht duke qeshur me të madhe.

- Moj e keqe, moj e mbrapshtë, ma luajte zemrën nga vendi. Ah moj dreqnushë, si nuk u rrite asnjëherë, – vazhdonte e ëma, e cila ishte zemëruar nga frika që i dha e bija, por njëkohësisht ishte çliruar nga tendosja. U ul në karrige të qetësohet, ndërsa e bija fshihej pas derës dhe nxirrte veç kokën për ta parë e qeshur.

- Pa eja, eja pak këtu të t'i shkul flokët. Kështu e frikëson ti nënën tënde?- e thërriste Besa Dorinën, ndërsa ajo nxirrte gjuhën dhe gajasej së qeshuri.

- S'do më mallkosh gjë, e mami? – e pyeti me buzë të varura duke aktruar fytyrën e një qenushi dhe pastaj ngadalë iu afrua si me dinakëri dhe e përqafoi. Besa bënte thuajse nuk donte ta përqafonte, por Dorina nuk i shqitej dhe i rrëshqiste nga duart si ngjalë.

- Jo nuk të mallkoj dot, por edhe sikur ta bëja, mallkimi im nuk do të të zinte, – i tha e ëma.

- Uh, mama, po gjithkund shkruhet se mallkimi i nënës të zë.

- Është mendim i gabuar, meqë nëna edhe po të mallkojë nuk e bën asnjëherë me zemër, e thotë vetëm me gojë.

- Epo mirë, shpëtova, – qeshi Dorina dhe u ul në tryezë. – Bëra pak shaka, mamushe, kisha përshtypjen se kohëve të fundit shtëpisë sonë i duhej pak hare.

- S'ka gjë, s'ka gjë, por ama pa një mallkim të vockël e të ëmbël s'do të shpëtosh kurrsesi. Këtë mallkim e kam mu nga ajo zemër që e frikësove tash në mëngjes,- i tha e ëma.

- E çfarë do më thuash, u bëfsha shtrigë!?

- Jo. Do të të them: u bëfsh nënë! Atëherë do të kuptosh gjithçka.

IV

Bujari po vishej me shpejtësi. Ndjente se duhej të dilte nga kjo shtëpi, nga ky kafaz. Dreq o punë, si nuk e kishte vërejtur deri më tani se ishte nën grila? Studimet, gruaja, fëmijët… bah, ndjehej sikur po i zihej fryma. Kaloi kah kuzhina, doli në korridor dhe filloi të nxirrte këpucët nga dollapi.

- S'do të hash? – e pyeti gruaja që po i afrohej me një salvetë kuzhine në dorë.

- Jo, sot do të bëj analizat e gjakut, nuk guxoj të ha përpara, – ia ktheu ftohtë ai.

- Do t'i bësh sot? Por mua s'më paske thënë gjë. Sikur do të shkonim pasdite në atë koncertin e muzikës klasike që po e pres për një kohë të gjatë, – i foli gruaja. - S'mund t'i lësh për nesër? Mund të shkojmë bashkë.

- Jo, nuk mund t'i lë. Pastaj koncerti është pasdite, jo tani.

- Po, por ndoshta pas analizave duhet të pushosh. Kështu mund t'i lësh për nesër, ndoshta…

- Je në vete? – ia preu fjalën i shoqi. – Ty të duket më i rëndësishëm një koncert me piano se sa shëndeti im? Tekefundit a nuk ishe ti ajo që insistove të vizitohem? – vazhdonte Bujari sikurse të ishte prekur në sedër.

- Jo, kurrsesi, koncerti nuk është më i rëndësishëm,– ia ktheu me zë të ulët Besa,- por unë mendoja se, meqë nuk i ke bërë analizat deri tani, mund të presin edhe një ditë ose dy. Ti më pate premtuar se do të vish në koncert.

- Po mirë, shko ti me dikë tjetër, merre Dorinën ose ndonjë shoqen tënde,- u ndal pak Bujari dhe vazhdoi me cinizëm:- Apo do më thuash tani se nuk ke as shoqe, se i ke humbur edhe ato për shkakun tim. Nejse, unë gjithsesi s'do të vija edhe ashtu. Muzika klasike, pianoja dhe pianistet më kanë dalë për hunde, – tha me nervozizëm dhe përplasi derën e iku.

- Ç'po ndodh, mama?- pyeti e brengosur Dorina, sapo doli i ati.

- Asgjë, bija ime, asgjë, mos u brengos. Babi yt ishte pak më i shqetësuar se zakonisht. Duket se po afron fundi i librit të tij dhe ka një lloj treme më të theksuar.

- Mirë, po ju nuk po flisnit për librin e babit, o mami,- tha Dorina dhe heshti. Shikoi të ëmën, por ajo i largoi sytë menjëherë nga e bija dhe shpejtoi hapin për nga kuzhina.

Bujari doli në rrugë dhe mori frymë thellë. Iu duk se mushkëritë do t'i plasnin nga sasia e ajrit që futi në to.

"Paskam qenë i burgosur në shpirt" mendoi me vete. Hipi në veturë, që kishte kohë pa u ndezur, dhe shkeli gazin. Sapo u largua nga rrethi shtëpisë, u ndje shumë mirë, sikur si një adoleshent që po arratisej nga sytë e prindërve. Lëshoi pak muzikë nga radioja dhe filloi të fërshëllente.

"Pastaj thonë se fatin e kemi të shkruar në yje,- fliste si me vete.- Se po na e dhuruakan me frymën e shenjtë… Eh, pallavra! Fatin e krijojmë vetë, e ndërtojmë me ose pa vetëdije, e besa po të jemi edhe pakëz të mençur,– mendoi duke qeshur me vete,- mundemi me kohë edhe ta ndryshojmë paksa. Sa nuk është bërë vonë. Kështu thotë doktoresha, e?".

Po i afrohej pjesës së qytetit ku mendonte se punonte doktoresha e tij e ëndrrave.

Kishte kohë që po e ëndërronte. I dilte ne gjumë, por edhe zgjuar. Tundi kokën thuajse donte ta flakte këtë iluzion. Por ajo skenë kthehej në mendjen e tij si shigjetë. Sa e sa herë e kishte imagjinuar, o perëndi . Mjaftonte të mbyllte sytë dhe imagjinata e tij fillonte e thurte atë pamje filmike:

Ata të dy vetëm për vetëm në një dhomë ambulante dhe fqinja e bukur me flokë të lëshuara e me uniformë të zbërthyer që e urdhëronte te zhvishej. Pastaj fillonte ta kontrollonte dhe bashkë me hekurin e ftohtë të stetoskopit, ndjente te nxehtit që ia jepnin duart e saj. Ajo ia përshkonte trupin me duar dhe ai në vend të asaj ndjenjës së ftohtë, kur të prekin duart e mjekut, ndjente afsh, vetëm afsh. Kalonte me duar te flokët e tij dhe i thoshte se është tmerrësisht e dashuruar në të qysh prej momentit të parë që ishin parë te kopshti. Bujari do ta mbërthente me të dy duart e tij të fuqishme dhe… ah s'mund ta mendonte më tej atë që do të ndodhte, përfytyrimi i skenës së imagjinuar i jepte dhimbje të ëmbla në çdo gjymtyrë.

Ndërkohë dukej se kishte mbërritur; fiku veturën dhe u mundua të qetësohej. Vendosi të priste i parkuar në një skaj, me që klinika iu paraqit para sysh, kur ky ende po e përjetonte skenën e tij të preferuar në ekranin e trurit të tij, për kushedi të satën herë. Klinika ishte një ndërtesë e bukur, që dukej se do të ishte rinovuar rishtazi. Ishte e lyer e tëra me te bardhë, ndërsa nëpër dritare shiheshin roletat e mbyllura. Bujari puliti sytë për të parë më mirë emrat e mjekëve te hyrja, por iu duk se pa vetëm atë të Shpëtimit.

- Çfarë tipi parahistorik!– mendoi.– Ka gruan mjeke - dhe çfarë gruaje se - dhe vë vetëm emrin e tij aty. Tamam torollak. Ah ky mentaliteti ynë ballkanas!- mendoi sërish me keqardhje.

Kaloi pothuajse një orë dhe doktoresha s'po dukej .Bujari u mundua të kujtojë se si i quante para disa kohësh tipat që prisnin me vetura të fshehura femrat e pëlqyera.

"Jo, jo unë s'jam maniak",- e ngushëlloi veten me zë.- S'jam si ata që u vardisen çdo femre që u shfaqet në shteg. Natyra ma ka dhënë rastin vetë e para.

Befas pranë klinikës u afrua një veturë dhe Bujari pa dy këmbë elegante e të njohura që po dilnin prej saj. Natyra zbriti dhe sakaq rregulloi kostumin qe i ishte rrudhur, pastaj u përkul edhe një herë në derën e veturës dhe foli me dikë aty brenda saj. Mu atëherë Bujari pa se Natyra kishte qenë ulur në ndenjësen pranë vozitësit, ndërsa vozitës ishte një burrë nja dyzetvjeçar. Ndjeu se xhelozia ia preu zemrën si me shpatë. U hamend a të paraqitej apo jo dhe ato pak sekonda i dhanë lodhje psikike sikur të kishte punuar një javë të tërë. U hodh jashtë pa menduar shumë dhe posa vetura tjetër vazhdoi rrugën, thirri emrin e doktoreshës. Për një moment iu duk zëri i panjohur, thuajse dikush ia kishte okupuar gojën dhe po fliste në emër të tij.

- Natyra, doktoreshë Natyra, – thirri pas saj.

Ajo ktheu kokën dhe u ndal; një herë u duk e habitur, por pastaj buzëqeshi.

- Ooo, çfarë befasie e këndshme,- tha.- Po ju? Fare nuk ju pashë se po vinit.

Bujari u zu ngushtë. Çka nëse e kishte parë nga vetura? Çfarë t'i thoshte tani? Pastaj filloi të gënjente:

- Isha duke kaluar këndej dhe pashë rastësisht këtë klinikë. U ndala të shoh nëse është e juaja, kur pastaj ju pashë si po zbrisnit nga vetura …- u ndal pak dhe shtoi:- në të cilën ishit me atë burrin...- Këtu Bujari e hëngri gjuhën dhe po të kishte mundësinë do të dëshironte ta lëshonte toka. Shpresonte se Natyra do t'i shpjegohej vetë për atë burrin e panjohur, se do t'i thoshte se e ka koleg pune, se e ka vëlla, kushëri, apo diçka që do t'ia qetësonte ndjenjën e xhelozisë, por ajo nuk e ndryshoi fare mimikën pos e buzëqeshur i tha:

- Po, sa mirë, shumë mirë keni bërë.

- ... dhe u binda se punoni këtu, ishte çështje minutash, mirë që u ndala, përndryshe nuk do të shiheshim... - shtoi dhe u ngut të ndërrojë temë.- Gjithsesi mirë që ju pashë, meqë dua të bëj analizat e gjakut. Ndoshta ju mund të më tregoni më mirë cilat t'i bëj e si t'i bëj... - e përfundoi fjalinë i rraskapitur sikur pas një beteje.

- Po, sigurisht. Urdhëroni brenda dhe do t'jua shkruaj të gjitha.

Bujari u nis pas saj me dy mendje. Thua ta kishte kuptuar ajo xhelozinë e tij? Pse nuk mundi ta kontrollonte veten, dreqi ta hajë! A thua ndjente ajo diçka sadopak dashuri ndaj tij, apo vetëm po argëtohej? A thua po i jepte ndonjë shenjë e ky budallai s'po e vërente... Apo ishte për të veç një numër, një i moshuar me të cilin luante pak derisa të humbte interesimin... Këto mendime po e çmendnin fare.

- Po gruaja juaj nuk erdhi? – e pyeti Natyra papritur.- Kemi kohë pa u parë me të.

- Jo,- tha shkurt ai,- i dhembte koka, pastaj dhe nuk e dija se do të vija këndej,- gënjeu.

- Aha, sa keq, shpresoj t'i kalojë shpejt,- tha me keqardhje doktoresha dhe vazhdoi: - Keni fat me gruan tuaj, Bujar, më duket një grua e mrekullueshme. E dashur, e urtë, gatuese e mirë, amvisë e përkryer. Më zgjon mallin e nënës sime. Ndjehesh ngrohtë afër grave të asaj moshe, apo jo?

Bujari u step. Gruaja e tij ishte plakur aq sa kësaj t'i zgjonte mallin e nënës? Dhe pastaj u frikësua akoma më tepër. Po unë? Mos i ngjaj edhe unë në babanë?

- Shumë pak e shoh nënën time, Bujar. Familja, puna, jeta dinamike nuk na lejon asgjë të këndshme. Jemi kthyer në robotë. Por, sadopak, mundohemi t'i gjejmë kanalet e duhura që t'i plotësojmë zbrazëtirat, kupton?

Bujari pohoi me kokë. Akoma kishte frikë se do t'i thoshte i moshuar.

- Ju dukeni shumë bukur, Bujar. Nuk i keni ndjere vitet fare,- i erdhi si bombë deklarata e Natyrës.

-Po më bëni qejfin,- tha turpshëm ai.

-Jo, jo, vërtetë, më besoni në fjalë. Merreni si diagnozë të saktë kur jua thotë vetë mjeku. Ju dukeni shumë bukur, plus nuk jeni marrë me punë fizike gjatë jetës suaj dhe keni mbetur i ri , si të thuash, i pa amortizuar.

Zakonisht Bujari në këto raste ia linte të gjitha meritat gruas së tij, por sot nuk iu dha.

- Ndoshta, por gruaja ime nuk mendon kështu,- i tha.- Madje ndonjëherë po më thërret "plaku im",- e provokoi ai doktoreshën me qëllim.

-Epo ju thërret me përkëdheli, jam e sigurt, - qeshi ajo.- Edhe unë ndonjëherë kështu i them burrit tim. Sepse nuk më duket ndonjë mëkat të jesh i moshuar; atë nuk e kemi vetë në dorë. Madje mua gjithmonë më kanë tërhequr meshkujt më të vjetër se vetja, e besoni? Kanë përvojën, maturinë, pjekurinë… dhe janë të rehatuar me gjendjen sociale, gjë që është shumë e rëndësishme. Gjëja e fundit që më bie ndërmend është të humb kohë me një mashkull të mbaruar, që akoma vrapon për të bërë dy para në xhep. Sot femra moderne nuk ka kohë t'i bëhet burrit nënë, ta mësojë, ta përkrahë, ta presë të mbushet mend. Burrat edhe ashtu piqen më vonë dhe po të jesh në lidhje me një më të moshuar se vetja, bëhet njëfarë balance. Përndryshe do të kesh afër vetes një adoleshent të përhershëm.

- E kuptoj,– u përgjigj Bujari.- Çudi sa mirë i shihni gjërat ju, Natyra. Keni ca teori interesante që ia kalojnë të gjitha ekuacioneve të mia.

- Vërtetë? Epo atëherë te themi se ju keni teoritë tuaja për kiminë në përgjithësi, ndërsa unë për kiminë e jetës.

- Bukur e gjetët, besa. Mund edhe t'i bashkojmë forcat e të bashkëpunojmë në studime. Ndoshta zbulojmë edhe teori të reja,- qeshi Bujari dhe filloi të ndjehet paksa më i ambientuar. Kjo grua e bënte të ndjehej me flatra .

- Pse jo, unë jam gjithmonë e hapur për hulumtime të reja, kam kureshtjen e pangopur për çdo gjë.

- Jeni vërtetë një grua interesante, doktoreshë, më duket se do të mund të bisedonim me orë të tëra bashkë, disi kemi një gjuhë të përbashkët.

- Po, vërtetë, edhe ju jeni shumë interesant, Bujar. Gruaja juaj është me fat që ju ka. Burrat si ju janë të rrallë sot, – nuk po ia kursente komplimentet Natyra, ndërsa Bujarit i vinin si balsam mbi plagë fjalët e ngrohta të saj. Ndjeu se u skuq dhe uli kokën. Ndjehej si një djalosh i dashuruar. Natyra e kishte kthyer në jetë, i kishte dhënë gjallërinë e humbur gjatë viteve dhe po i falënderohej me zemër.

Në atë moment trokiti dera dhe hyri një pacient tjetër me shumë pyetje. Doktoreshë Natyra i tha të ulej dhe të priste derisa t'ia shkruante Bujarit analizat.

Sa e bukur ishte ashtu kur shkruante! Si një hyjneshë që ka humbur nëpër mote. Kjo grua s'do të duhej të mundohej, s'do të duhej të lëvizte as gishtin më të vogël, e meritonte të ishte një princeshë në mes të mirash me atë zemër të ëmbël që kishte, me atë zë të këndshëm e joshës si sirenat e detit, me ato duar të buta... Ishte perëndeshë e bukurisë dhe e sharmit dhe mund ta bënte për vete çdo mashkull sa hap e mbyll sytë.

- Ja ku i keni, Bujar,- tha Natyra dhe ia dha letrat në dorë.- Jam e bindur se nuk keni gjë fare, thjesht jeni rraskapitur nga puna mendore. Ju duhet pak çlodhje dhe argëtim, diçka që ju tërheq shumë dhe jua heq vëmendjen nga puna. Duhet patjetër të gjeni një gjë për t'u argëtuar, në një mënyrë... si të them,- dhe shikoi nga pacienti i ulur në karrige.- Diçka të veçantë nga e përditshmja, më kuptoni?

- Po sikur ajo të jetë jashtë mundësive të mia? Të jetë diçka e ndaluar, e pamundur,- e pyeti guximshëm Bujari.

- Atëherë bëni çmos që ta keni. Luftoni për të, – ia tha ajo pa e ndërruar ngjyrën e fytyrës dhe shtoi:- Përndryshe besoj se jeni fizikisht mirë, besoj se akoma vashat e bukura rendin pas jush, e? Thoni gruas suaj të ju ruajë mirë…. – buzëqeshi me sharmë duke ngritur gishtin tregues në shenjë qortimi shpotitës dhe Bujarit iu drodhën këmbët.– Mos harroni të vini këtu kur t'i keni kryer analizat,- vazhdoi ajo,- Ju pres, ashtu siç e patëm lënë.- E shikoi drejt në sy dhe pastaj e përshëndeti.

Bujari doli nga klinika tërësisht i hutuar. Ende pa arritur mirë përjashta, filloi të ndjente nevojë të tmerrshme të ishte afër doktoreshës. "Po vdes nga dashuria e tundimi, o Zot," mendoi dhe u fut në veturë. Mbylli sytë dhe e lejoi iluzionin e njohur të bënte edhe një udhëtim para tij: nisi ta ëndërrojë Natyrën në krahët e tij...

E gjithë dita i kaloi pa asnjë qëllim. Shikonte vitrinat e shitoreve, por gjëja e vetme që i binte ndërmend ishte Natyra. "A do t'i pëlqente kjo Natyrës, a do t'i shkonte kjo Natyrës, sa bukur do t'i rrinte kjo Natyrës" – mendonte për çdo gjë që shihte të ekspozuar.

Në shtëpi arriti diku kah mbrëmja e vonë. Sapo doli nga vetura pa një figurë burri që po ecte drejt tij. Ishte Shpëtimi, burri i Natyrës.

- Mirëmbrëma, mik, - e përshëndeti fqinji.

- Mirëmbrëma, ia ktheu ftohtë Bujari.- Si jeni? Dolët sonte për një shëtitje?

- Në fakt isha në një shfaqje,– ia ktheu Shpëtimi.- Jam kënaqur shumë.

- Mirë për ju! Po gruaja juaj si është, nuk erdhi?

- Oh jo, Natyrës arti në përgjithësi i duket i pakuptimtë. E mërzisin shfaqjet, koncertet, operat, ekspozitat... - qeshi pak dhe vazhdoi:– Madje një herë më ka thënë se artin e kanë zbuluar njerëzit që nuk dinë çfarë të bëjnë me veten dhe nuk kanë aftësinë t'iu shërbejnë të tjerëve me një mënyrë më të zgjuar… E çuditshme, e? Eh mik, ç't'i bësh, ajo ka nevojë për më shumë gjallëri, është ende e re, pastaj edhe mjekët në përgjithësi nuk bëjnë shumë pas gjërave artistike, – tha disi sikur po i hapte zemrën Bujarit, por tjetri e shikoi pa emocione, ndërsa në kokë po bluante: "Edhe nuk ka faj ajo që ka nevojë për gjallëri afër një plakushi si ti, kush ka kohë sot për ca budallallëqe të shtirura që quhen art? Për ca megalomanë që lëshojnë mjekra të gjata e që mbajnë flokë të pakrehura dhe shtihen si ekscentrikë për t'u dukur si artistë?". Ndjeu se, gjithsesi, duhej të thoshte diçka:

- Epo mjekësia do përkushtim, kjo është e vërtetë. Arti s'të jep shumë bukë.

- Po vajza juaj a nuk është pianiste e ardhshme?- i tha Shpëtimi.

Bujari u ndie ngushtë, gati e kishte harruar këtë kur po bisedonte me komshiun.

- Po, po është. Mu për atë dhe po them. Kam brengë për të ardhmen e saj,- u përgjigj shpejt e shpejt, pa qenë i bindur se po thoshte vërtetë atë që mendonte për të ardhmen e Dorinës.

- Ndërsa unë mendoj se keni shumë fat. Është mrekulli të jetosh pranë artistëve.

- Faleminderit, – i tha Bujari. – Natën e mirë dhe mirupafshim.
- Mirupafshim,- ia ktheu fqinji dhe vazhdoi edhe atë pak rrugë gjer te dera e tij.

V

Në kryeqytet kishte rënë një mjegull e dendur. Vjeshta kishte filluar ardhjen me hapa të shpejta. I gjithë vendbanimi ishte vendosur në një luginë dhe po ta shihje nga larg në kësi lloj moti, të dukej si i fundosur i tëri në ujë. Viteve të fundit, në qytet ishin bërë shumë ndërtime pa plan, ndaj dhe e kishte humbur disi bukurinë e dikurshme. Ndërtesat e mëdha gri shtriheshin përskaj rrugëve me shumë gropa, që zakonisht rrinin të mbushura me ujë. Flitej se dikur qyteti kishte pasur një përroskë të këndshme, por që me rastin e ndërtimeve ishte mbuluar me beton, duke ua hequr kështu banorëve të drejtën për pak freski gjatë vapës së mundimshme të verës. Kësisoj kryeqyteti dukej si një njeri i lodhur, të cilit i kishin vënë shumë thasë të rëndë në shpinë. Dikush fajësonte për këtë politikanët, të tjerët fajësonin banorët e pandërgjegjshëm, të tjerë akoma ua vishnin fajin të ardhurve, jabanxhinjve, që blinin ndonjë copë tokë me paratë e fituara në mërgim dhe nisnin menjëherë të ndërtonin shtëpitë e tyre ngjitur njëra me tjetrën. Gjithsesi, cilido që ta kishte fajin, qyteti po ngulfatej nga kaosi që mbretëronte në të, pavarësisht se me shpirt mundohej tu përngjante metropoleve europiane. Megjithatë, aty vazhdonin të shpërnguleshin shumë banorë të zonave të tjera; kjo vinte ngase ai, si kryeqytet që ishte, u ofronte më shumë mundësi punësimi dhe lehtësira të tjera, si në mjekësi a në shkollimin e fëmijëve, dhe ngaqë, s'do mend, aty jeta ishte më e gjallë dhe kultura lëvrinte më shumë.

Diamanti po ecte krah për krahu me Mimozën. Kishin dalë për një shëtitje nëpër platenë e gjerë në mjediset e Universitetit. Një pjesë të rrugës asnjëri prej tyre nuk po fliste. Dukej thuajse secili kishte një plan që po mundohej t'ia thoshte tjetrit.

- Je shumë i heshtur sonte, – foli dikur Mimoza
- Ke të drejtë, e pata humbur krejt, madje mu duk se më zgjove nga një botë tjetër.
- Po mendoje gjë?
- Po, ashtu...
- Lidhur me çfarë, mund të ma thuash?
- Eh, lidhur me shumëçka. Me familjen time, me ty, me studimet.
- Ke ndonjë çështje konkrete për të cilën do të doje të bisedonim?
- Një? Kam shumë, por duket se askush nuk është pa to sot.

Mimoza i buzëqeshi dhe ia shtrëngoi krahun.

- Tani më ke mua, Diamant. Së bashku do t'i zgjidhim më lehtë.

Edhe djaloshi e shikoi me dashuri vajzën dhe e tërhoqi afër vetes.

- Po, vërtetë. Tani të kam ty. Shpresoj mos të të humbas kurrë…- e tha sikur me një frikë në zërin e tij.
- E pse të më humbasësh? Unë s'po shkoj askund. Pastaj ti ke edhe familjen tënde, Diamant. Jam e bindur se me babanë mund t'i zgjidhësh problemet që mund të kesh. Unë si femër e kam ndjerë shumë mungesën e nënës, ndërsa me babanë nuk mund të flisja shumëçka që më mundonte. Por për ty gjërat janë ndryshe. Ti i ke të dy.
- Mimoza, unë me babin nuk jam shumë i lidhur, kemi njëfarë distance në mes.
- Ashtu? Po pse?
- Nuk e di. Është krijuar me vite të tëra.

- Dëshiron të flasim për këtë sonte? Nëse nuk ndjen se duhet të ma thuash, nuk zemërohem,- i tha Mimoza me mirëkuptim në sytë e saj.

- Deri sonte nuk kam folur për këtë me askënd. Mami ka provuar të ma hapë bisedën, por kam ndërruar temë, nuk kam dashur ta bëj të ndjehet keq.

- Por babai yt duket njeri i mirë.

- Nuk është njeri i keq, kurrsesi. Por me mua është i ftohtë, Mimoza, ka qenë gjithnjë kështu dhe nuk e di pse; qysh nga fëmijëria e hershme më ka shtyrë larg vetes gjithmonë. Kur tregohesha i dobët në ndonjë gjë, nuk më merrte kurrë në mbrojtje, ndodhte edhe më nënçmonte.

-Më duket e pabesueshme.

-Unë isha shumë i vogël dhe nuk e kuptoja pse e bënte. Unë e doja babanë, e doja shumë. Por ai ishte gjithmonë kaq i largët, nuk linte vend e mundësi pa ma potencuar superioritetin e tij. Ndjehesha keq, gjithmonë i frikësuar nëse do të dukem i denjë në sytë e tij për një gjë, a për një tjetër…

- E kam vështirë për ta kuptuar, më beso. Po mirë, më vonë u përmirësua situata?

- Jo. Madje u bë më keq. Tani më shikonte disi sikur një rival. Me pjekjen time nisa të ndjej për të një mllef, që sa vinte e grumbullohej. Nuk më linte të qetë. Këtë e kanë vërejtur edhe mami, edhe Dorina. Madje, ajo si motërz e vogël, njëherë krejt naive e pyeti babanë para të gjithëve: "Babi, a e do ti Diamantin?". Ne të gjithë mbetëm pa fjalë, ndërsa babi u zu shumë ngushtë.

- Çfarë iu përgjigj? – e pyeti Mimoza me kërshëri.

- I tha: "E dua, si jo". Por ishte si një dëshmi e ftohtë, pa jetë, sikur sa për të mbyllur atë muhabet.

- Ti mendon se ai vërtetë nuk të do?

- Jo, nuk them se jo. Por mënyra si e ka treguar dashurinë për mua ka qenë shumë e rëndë, shumë. Sot e kësaj dite nuk kam shpjegim për sjelljen e tij ndaj meje. Po mendoj, Mimoza, njerëzit ëndërrojnë të kenë një djalë, birin e tyre, apo jo?

- Sigurisht që po.

- Epo ky e kishte, por sillej thuajse e kishte barrë, thuajse nuk mund ta shihte me sy.

- Por kjo duhet të ketë shpjegim, Diamant. Pse nuk e ke biseduar me të?

- Nuk e di. Një kohë i jam frikësuar, meqë gjithmonë ishte i gatshëm për të më qortuar. Më vonë, ai mllefi i grumbulluar u shndërrua në një lloj urrejtjeje dhe…

- Urrejtje për babanë tënd?

- Me njëfarë mënyrë po. Por pastaj sikur u shuan ndjenjat dhe m'u bë çdo gjë njësoj. E di se mamaja është munduar të jetë gjithmonë një urë mes nesh. E shkreta, as ajo nuk e kuptonte pse kjo sjellje. Thoshte: "Po të mos i dhuroja djalë, ndoshta do ta thoshte ndonjëherë se nuk e ka. Por e ka. E ka të vyer, çfarë do tani?". Njerëzit kanë fëmijë që iu sjellin shumë probleme në shtëpi dhe përsëri gjejnë mirëkuptim për ta, i përkrahin… sepse janë prindër.

- E kuptoj.

- Pastaj babai hyri në një farë moshe dhe dukej se kishte nevojë të afroheshim. Por ishte vonë. Me gjithë mundin tim, gjërat nuk mund të ngjiteshin menjëherë.

- Kushedi pse është sjell ashtu, Diamant. Babai yt është njeri i ngritur dhe habitem që ka pasur qasje të tillë.

- Nuk ka lidhje këtu ngritja intelektuale. Mund të jesh bari dhe të jesh i drejtë me fëmijët e tu. Por, kjo me babanë ishte e pashpjegueshme.

- Po me Dorinën si vihej?

- Krejtësisht ndryshe. Atë gjithmonë e ka mbajtur pranë, e ka privilegjuar, si të thuash.

- Të pengonte ty kjo?

- Jo, jo ma çfarë thua… Përkundrazi, isha i lumtur që së paku me të ishte i afërt, i dashur. Por, vetë Dorina nuk ishte e lumtur kur e shihte që ishte i ftohtë me mua. Mami si mami, vuante, mundohej ta shpjegonte këtë me shumë gjëra, thjesht arsyetohej për të ma lehtësuar lëndimin.

- Jam shumë e befasuar, – tha Mimoza,- por mundohu ta kuptosh, Diamant. Kanë qenë kohëra të tjera dhe...

- Ndoshta…

- Mundohu të mos e paragjykosh. Koha do ta tregojë arsyen e duhur.

- Po, por deri atëherë po kalon shumë ujë, Mimoza, shumë ujë nën urë.

- Lërja kohës çdo gjë. Unë besoj se babai yt deri tani e ka ndjerë gabimin e vet.

- E mundur. Ka provuar disa herë të më flasë për këtë gjë, por unë i kam bërë bisht.

- Po pse?

- Nuk e di. Ndoshta brenda vetes sime kam dëshirën që ta mundoj ashtu si më ka munduar ai mua. Kam dëshirë të vuajë, ashtu si kam vuajtur unë. Por, në fakt, unë e dua aq sa mund të duhet prindi.

- Mundohu ta falësh, Diamant. Jam e sigurt se arsyet e tij kanë qenë pasojë e ndonjë gjëje në jetën e tij.

- E kam tejkaluar tashmë. Por, distanca ka mbetur.

Mimozës i erdhi shumë keq, por nuk jepej në fytyrë. U mendua pak dhe sa për ta ndërruar bisedën i tha:

- E di çfarë? Sot pashë një shpallje ku kërkoheshin vullnetarë për në Afrikë.

- Mos më thuaj! Mos deshe të shkosh pahiri?

- Po pse jo?– qeshi ajo sikur fëmijë.– E di sa shumë kam dëshirë ta bëj këtë, Diamant? Do u ndihmonim të varfërve, të sëmurëve, natyrisht në mënyrë të organizuar.

- Po studimet?

- Janë vetëm gjashtë muaj ose një vit në pyetje. Ose do t'i ndërpresim, ose do t'i vazhdojmë atje, në kuadër të qëndrimit.

- Ti je plot ide të çmendura!

- Mirë, ashtu jam, por do ta mendosh? Më premto se do ta mendosh.

- Mirë. Por, jo tani Mimoza, jo tani. Kam provime të rëndësishme para diplomimit. Flasim sërish për këtë.

- Në rregull, pajtohem,- i tha Mimoza duke e shikuar fytyrën e djaloshit, i cili dukej se ende nuk ishte shkëputur nga mbresat e bisedës së mëhershme rreth babait të tij. Ajo u bë sikur nuk po e vërente këtë dhe pas pak tha:

- Diamant, a shkojmë këtë fundjavë te shtëpia jote për një vizitë së bashku?

- Çfarë pate? Pse duhet të shkojmë?

- Dua ta shoh Dorinën dhe mamanë tënde. Jam përmalluar për to.

- Këtë e pata mangët. Njëherë ato e tash ti.

- Mamaja jote është shumë e ngrohtë, është mu ajo që më nevojitet. Ndërsa Dorina, eh, Dorina të ndreq ditën.

- Mos e harro Midin!

Të dy qeshën me zemër. Mimoza u gëzua se në fytyrën e Diamantit po kthehej disponimi i mirë dhe qetësia.

- Do të shkojmë, pra, si thua?

- Mirë, mirë, shkojmë. Ke nisur qysh tash t'i mësosh pikat e mia të dobëta për t'i arritur qëllimet.

***

Derisa po parkonte veturën, Bujari ishte gjithë nerva. Gruaja i kishte treguar se sot do të vinte Diamanti me atë të dashurën e tij dhe gjëja e fundit që i duhej tani, ishte tollovia nëpër shtëpi.

"Pse nuk qëndrojnë pranë mësimeve të tyre, xhanëm? Mendojnë se kështu kryhet fakulteti, me dashuriçka?"- pështpëriste me vete.

Për një moment i shkoi në mendje se dashuritë më shumë i kanë hije atyre, që janë të rinj, se një njeriu të martuar e të moshuar; por, si iu kujtua aventura e tij me Natyrën, u ngut ta flakte këtë mendim: " Së paku unë i kam kryer obligimet e mia në jetë. Kam të drejtë në pak argëtim dhe kënaqësi. Pastaj... po ta kisha dashurinë që më nevojitej, nuk do ta kërkoja tjetërkah, apo jo? Nuk kam unë faj këtu, jo, jo"- arsyetohej sidomos për t'iu kundërvënë brejtjes së ndërgjegjes.

Doli nga vetura dhe filloi të bartte kutitë e sapo blera me kompjuterin e ri. Deri sot nuk i kishte interesuar fare teknologjia e re , por me ta kuptuar se kështu mund të bisedonte lirshëm e fshehtas me Natyrën përmes internetit, e kishte porositur në vend.

- Ua, babi ka blerë kompjuter, – bërtiti Dorina, e cila u gjend atëbotë në oborr. – Të kam thënë qysh moti se të duhet, o babi, por nuk më dëgjoje.

- Po pra, fitove, a sheh? Kam dëgjuar këshillat e tua dhe e bleva, – ia ktheu Bujari, pa e shikuar në sy.

- Sa mirë, sa mirë; megjithëse ajo makina jote e shkrimit sot do të bëhet xheloze në rivalen e saj të re e të bukur. Ha, ha, ha, – qeshte Dorina duke mos i shkuar fare ndërmend se kishte bërë krahasimin më të duhur, që përkonte me rastin e Bujarit.

- Le të bëhet, – i tha i ati. – Me që është plakur e nuk më hyn më në punë.

- E tani bëre të më dhimbset, – tha Dorina. – Unë edhe kur blej diçka në shitore, për shembull ndonjë bluzë, më duket se ajo tjetra, që nuk e marr, mërzitet dhe qan.

- Ah, nuk i ha unë këto, – tha Bujari duke marrë frymë me vështirësi nga të barturit e kutive që po i fuste brenda. - Këto janë teoritë e tua për të zhvatur sa më shumë para nga unë. Gjoja po qanë dhe... hajt blije!

Dorina filloi të qeshte me zë dhe hareja e saj e mbushi shtëpinë me gjallëri.

- Ka ardhur kush?- e pyeti Bujari me zë të ulët pasi lëshoi kutitë në tokë.

- Diamanti me Mimozën, do të rrinë për fundjavë në shtëpi.

- Epo mirë, – tha shkurt Bujari.

"Pra im bir na paska ardhur bashkë me atë vajzën, së cilës duket se i ka kërkuar dorën. S'e marr vesh, a janë të dashur, apo të fejuar? He, si erdhën kohërat,- mendonte Bujari.- Të fut biri i botës një unazë në gisht dhe u krye muhabeti. Ndoshta edhe më mirë për mua, më hiqen qafe më shpejt. Mos deshën që t'iu bëj edhe dasmën? Sa për mua, le të shkojnë e të jetojnë në tavan me pëllumbat… me që na qenkan aq të dashuruar. Pastaj ajo Mimoza, pih, nuk është ndonjë femër për të qenë. Fare e thjeshtë, as e bukur, shumë e brishtë dhe e mbyllur në vetvete. Ç'të ketë parë Diamanti në të? Nuk e di ç'i ka pëlqyer. Është si gjethja në erë. Këta të rinjtë e sotëm s'kanë fare haber se ç'është femra e bukur. Sidoqoftë shpresoj që sa më parë të martohen e të ikin që këndej. Nuk më duhet të ndihem gjysh qysh tani. Shpresoj të shkojnë diku jashtë shtetit, perspektiva është atje" e gënjeu edhe veten në mendje, thuajse po mendonte për të mirën e tyre.

Besa, si i kryente të gjitha punët e shtëpisë, dilte çdo pasdite për të bërë dy hapa në shëtitoren e qytetit. Kohët e fundit kishte nisur t'i respektonte më shumë këshillat e mjekut të saj, që ia përsëriste gjithmonë se, meqë vuante nga tensioni i lartë, i bënte mirë të ecte. Po ecja i bënte mirë për gjithçka, edhe për të dalë nga bota e mbyllur e shtëpisë, që sikur e hante brenda atyre mureve të mbyllura. E kishte ftuar edhe Bujarin disa herë t'i bënte shoqëri, por ai rrëshqiste me dinakëri, duke e pasur gati gjithnjë një arsye për t'i bërë bisht. Pse të dilte me të sikur një i moshuar? E çfarë do të flisnin rrugës? Për nipat? Për mbesat? Ma çfarë… Ndjehej shumë i ri për t'iu bashkangjitur shëtitores së pleqve, ashtu e quanin. Në fakt, ai ndjente elanin dhe pasionin për t'u martuar sërish, për të filluar një jetë të re. Sapo e shihte gruan që po vishej, dilte në kopsht dhe ulte kokën mbi fletoret e tij. Ajo vinte, e shihte ashtu të mbytur në studimet dhe, si ofshante dëshpërueshëm, shkonte. Shpesh ia linte kafenë e ngrohtë mbi tavolinë dhe pastaj dilte. Ndonjëherë e përcillte Dorina, ndonjëherë fliste në telefon me ndonjë shoqe dhe vendoste të dilte me të. Kur kthehej në mbrëmje, i kushtohej darkës dhe kështu të shoqin e linte prapë të qetë.

Bujarit nuk i kujtohej kur kishte reshtur së dashuri gruan e tij. Para apo pas Natyrës. Fqinja paraqiste një dimension të ri, një matës kohe tashmë, ishte bërë si një kufi midis dy kohësh. Ndoshta shfaqja e saj në jetën e tij vetëm kishte bërë që ai të shihte se emocionet ndaj gruas moti kishin vdekur. Sidoqoftë, ata ishin bërë të huaj për njëri-tjetrin; këtë e ndjenin të dy, ndonëse asnjëri nuk po thoshte asgjë tani për tani.

- Sonte kah po ktheheshim pashë zotëri Shpëtimin,- tha Diamanti gjatë darkës, duke iu drejtuar më shumë të atit, që po rrinte në tavolinë bashkë me ta. Pastaj shtoi:- Duket njeri i edukuar, i mirësjellshëm; madje na ftoi mua e Mimozën për një darkë në shtëpinë e tij. "Si të dëshironi ju,- na tha.- O dalim në restorant, o hamë në shtëpi".

-Është vërtetë njeri i mirë dhe i edukuar,- ia priti Besa.- I qetë, i matur. I pëlqen të udhëtojë, të shohë filma të mirë, e do muzikën klasike dhe artin në përgjithësi. Dhe duket se ka kulturë profesionale, pse ligjëron në disa universitete të huaja. Thonë se ka edhe një goxha pasuri, ka disa apartamente brenda e jashtë qytetit. Dhe ana më e mirë: i pëlqen të ndihmojë njerëzit në nevojë. Vërtetë shumë pak kanë mbetur njerëz të tillë sot. Ia vlen të marrësh shembull nga të tillë njerëz, bir. Edukata dhe kultura, nuk thonë kot më të vjetrit, e zbukurojnë çdo njeri.

Bujari po dëgjonte syhapur, po i bënte shumë përshtypje se si Besa e njohkësh kaq mirë këtë "Zotni Shpëtimin". Mendoi gjithë smirë e xhelozi për fqinjin e tij... "edhe i edukuar, edhe profesionist i mbaruar, edhe xhentëlmen i dorës së parë... bah".

- Vërtetë, xhaxha Shpëtimi është i mrekullueshëm. Një ditë më tha se i dëgjon me endje sonatat e mia nga ballkoni. Por, unë akoma mendoj se babi im është më i miri në botë,- cicëroi Dorina dhe sakaq u ngrit nga karrigia dhe iu var të atit në qafë.

- Babi im, babi im, babi im! – e përqeshi Diamanti,- Thuajse është vetëm i yti. Kush po ta lë mënjanë "babin tënd"?.. as bëmë ndonjë krahasim këtu....ne veç përmendëm një njeri të mirë dhe kaq.

Dorina ia nxori gjuhën duke e imituar me grimasa. Mimoza buzëqeshi. E pëlqente dhe e donte Dorinën me zemër sikur motrën e saj.

- Kush është ky farë zotëri Shpëtimi? A bën ta di edhe unë?- tha Bujari.- Hiqmu, moj dreq, se ma këpute qafën,- iu ngërdhesh me të butë Dorinës, që vazhdonte të ndjehej mirë në prehër të të atit. Ajo u step pak, por nuk u dha.

- Shpëtimi është burri i doktoreshës Natyra, mor babi,- i tha pastaj dhe u largua disi me qejfprishur nga prehri i tij. - Nuk ia paske ditur emrin?

- E paskam harruar. Por, tekefundit, nuk më duket ndonjë person aq i rëndësishëm, sa t'ia mbaj mend emrin. Gjithsesi, mbase them kështu ngaqë nuk e njoh aq mirë, sa e njohka jot ëmë,- shtoi me një zë që dukej sheshit se nuk i kishte pëlqyer aspak portretizimi që i kishte bërë Besa këtij "zotni Shpëtimit".

-Unë thashë vetëm disa gjëra që ai person i ka,- tha si e zënë në faj Besa. Dhe shikoi nga të bijtë si për të marrë mendimin e tyre, se a kishte thënë ndonjë gjë që nuk ishte ashtu. Bujari u bë më cinik:

-Atëherë pse nuk ia kërkon fotografinë e tij, të madhe sa të presidentit, e t'ia varim këtu në mur. Do na udhëhiqte më mirë me virtytet e tija të larta.

Besa e gjeti të udhës të shkonte në kuzhinë. Si t'i përgjigjej? Madje i erdhi edhe turp para Mimozës për ato fjalë gjithë mungesë etike që tha i shoqi.

Situatën, si gjithnjë, mundi ta shpëtojë Dorina:

- Babush, po mua pse ma di emrin?

-Ti je e rëndësishme,- i tha Bujari, që ishte ende furioz nga ato që sapo kishte thënë vetë për komshiun e tij.

- Po sa e rëndësishme jam?- Por, si e pa të atin të përskuqur nga furia që i ziente përbrenda, e ktheu fletën:- A më do ende më së shumti në botë? Sa botën e maaaaaaaaaadhe?

- E kush tha se bota është e madhe? Mund të jetë fare e vogël, nëse ti do,- iu përgjigj Bujari pa e ditur as vetë nëse po vijonte të ngulte thumba për fqinjin apo po i përgjigjej me humor së bijës.

Dorina vari buzët. Bujari e vuri re vuajtjen e së bijës dhe i buzëqeshi ëmbël, ashtu siç donte ajo. Vërtetë Dorinën e kishte dashur gjithmonë më së shumti, ishte e vogla e tij, engjëlli i tij. Duhet ta kishte vërejtur kohëve të fundit mungesën e përkëdheljeve që ia kishte munguar yllit të tij.

- Mirë, mirë, të dua sa botën e madhe, sa hënën dhe diellin,– i tha Bujari fjalinë me të cilën gjithmonë ia uronte natën e mirë. Dorinës sakaq iu hap fytyra si qielli pas shiut.

- Mirë, mua më mjafton të më duash sa birin tënd, – tha papritur Diamanti, që deshi edhe ai të hidhte ca ujë në situatën e nxehtë që qe krijuar, por e mbylli menjëherë, madje e kafshoi edhe gjuhën për atë që tha. Nuk ishte rasti. Në vend që ta shuante, kishte mundur ta ndizte më shumë zjarrin. Të gjithë heshtën pas kësaj. Mimoza ngriti sytë dhe i pa të dy me keqardhje, po gjithsesi Diamantit ia pasoi një vërejtje po me sy.

Fjalët e të birit ranë sikur një kovë uji të ftohtë mbi kokën e Bujarit. Foli me gjysmë zëri, më shumë për vete:

- Natyrisht se të dua, të gjithëve ju dua.

VI

Bujarin s'po e zinte vendi vend. Salla ishte e mbushur përplot dhe ai mezi po priste që të ndaleshin dritat dhe të fillonte shfaqja. Jo se ishte shumë i interesuar për dramën që do të shihnin, por nuk dëshironte që të vërehej aq haptas shqetësimi që e kishte të vulosur në fytyrë. E shoqja kishte bërë çmos për t'ia mbushur mendjen të shkonin në premierën e kësaj drame, për të cilën kishte kohë që po flitej në publik. Natyrisht që në fillim e kishte refuzuar, ishte munduar të sajojë njëqind shkaqe e arsye për të mos shkuar. Kohët e fundit, sidomos, i dukej se disi gruaja ia ulte atë pamjen e tij intelektuale, pavarësisht se ajo mundohej ta mbante hapin me kohën. Vishej hijshëm, sillej me maturi dhe etikë me kolegët e tij që i takonin, jepte mendime të kursyera e me vend. Gjithsesi Bujarit nuk i bëhej mirë me Besën përkrahu. Të kishte një grua me pamje si Natyra, eh, do të ishte ndryshe…

Ndërkohë gjërat me doktoreshën e re kishin marrë një farë kahu interesant. Kompjuteri kishte bërë punën e tij: kishin vënë kontaktin me internet dhe shpesh bisedonin deri mbrëmjeve vonë. Dukej se kjo puna e internetit ishte një shpikje shumë e zgjuar për këto punë, si e bërë apostafat për të. Madje për çdo çift dashnorësh që ishin të shtrënguar të mos takoheshin dot lirshëm. Ca për shkak të njerëzve që kishin pranë, bie fjala vajzat e reja që nuk ishin të lira nga prindërit për të takuar të zgjedhurin e vet. Ose për ata që ndodhen larg me banim. Bujari kishte mësuar nga Natyra, se internetin tash shumëkush po e përdornin shumë e më shumë për të gjetur gjysmën e tyre, pra dashurinë e pazbuluar, që mund të rrinte fjetur në një anë shumë të largët të planetit. "Ose që mund të ndodhen fare pranë, nga njëri pallat në tjetrin",- kishte shtuar ajo, duke e lënë me qëllim fjalinë disi të pambaruar. Atëherë Bujari e kishte shtuar me mendje: "Si ne, do të thuash, që na ndajnë vetëm disa metra kopsht e dy a tre mure, por nuk mund t'i zgjasim duart të prekemi". Me dy fjalë, interneti po bënte një punë të mirë për t'i njohur e për t'i mbajtur disi pranë, të paktën në ndjenja dhe në emocione.

- Pasnesër do të shkojmë në teatër me Shpëtimin, – i kishte shkruar dy net më parë Natyra.

- Vërtetë? E ke fjalën për atë premierën e shumëpërfolur?

- Po. Shpëtimi dëshiron të shkojmë dhe po ia bëj qejfin; duhet ndonjëherë. Përndryshe, ti e di, teatri më duket humbje kohe.

- Ke të drejtë. Në këtë kohë moderne duket gati jashtë mode.

- As ti nuk e do teatrin, sikur unë?

- Dikur po. Por kam ndryshuar sqimë. Tani më pëlqejnë gjërat e kohës, gjërat reale. Nuk më kënaqin përrallat me mbret.

- Sa mirë, Bujar. Ne përshtatemi në shumë gjëra. Sikur të ishim vëlla e motër.

Bujari u ngrys dhe nuk i shkroi asgjë në atë çast. Pas pak Natyra shtoi përsëri:

- Nuk të pëlqeu ideja vëlla-motër?

- Jo dhe aq.

- E mora me mend, – shkroi në çast ajo. – Të provokova pak, mos m'u zemëro.

- Me ty nuk të zemërohem kurrë. Je shumë e dashur,- i shkroi me guxim Bujari dhe priti të shohë reagimin nga ana tjetër, a do t'i zemërohej apo do ta mirëpriste këtë kompliment Natyra. Kur një burrë i thotë një gruaje "shumë e dashur" çfarë do të mbetej më shumë për t'i thënë se e donte. Pas pak i uruan "natën" njëri-tjetrit. Natyra ia kishte mësuar se disa mendime a ndjenja mund të shpreheshin me simbole a figura në gjuhën e mesengjerit. Kështu, për t'i uruar "natën e mirë" dikujt që e do shumë, mund t'i përcjellësh një ikonë, një figurinë pra, që i shpreh ndjenjat e tua më mirë se sa fjalët e thata. Bujari u kujtua për këtë kur pa në dritaren e tij të mesengjerit një ikonë që s'e kishte parë më përpara: një fytyrë e bukur gruaje që afronte dorën tek buzët e saj dhe, kur e largonte dorën, prej buzëve shpërndaheshin ca zemra të vogla të kuqe si gonxhe trëndafili ende të paçelura mirë. Mbeti i mahnitur nga figura, po më shumë u hutua nga mesazhi që mendoi se Natyra po i jepte me këtë rast. U drodh i tëri dhe u ndje i mikluar nga ndjenjat e dashurisë. "S'ka dert mosha,- i tha vetes,- dashuria fle ende në mua njëlloj si një herë e një kohë. Derisa kjo grua e re më do"...

Me ta marrë vesh se edhe fqinjët po shkonin në teatër, Bujari po atë natë i tha gruas se është penduar që s'po vete edhe ai, se me gjithë angazhimin që ka me studimet e tij, e ka marrë malli për ndonjë shfaqje dhe se një freski do t'i bënte mirë pas lodhjeve studimore. Besës i erdhi shumë mirë. Meqë, siç tha, kishte menduar ta anulonte shkuarjen edhe pse mezi e kishte pritur ditën e premierës.

Mbrëmjen që po shkonin në shfaqje, Bujari u përgatit goxha gjatë. Veshi kostumin solemn, duke i dhënë kësisoj pamjes rëndësi më shumë se çdo herë tjetër.

- Dukesh shumë bukur sonte, Bujar, – i tha Besa kur po zbrisnin shkallët

- Faleminderit, – ia ktheu shkurt ai, duke mos u lodhur t'ia kthente komplimentin e t'ia bënte qejfin edhe asaj. Besa, edhe ajo dukej shumë bukur atë natë, pavarësisht se ishte veshur me një kostum më korrekt se sa duhej për moshën e saj. Kishte pamjen e një zonje të hijshme e gjithë nur.

Deri në teatër shkuan më këmbë, Bujari tha se nuk ishte rasti për të përdorur makinën. Edhe Besa ashtu mendonte, madje nuk ishte aspak larg, bëheshin a s'bëheshin njëzet minuta më këmbë. Kur arritën, salla ishte e mbushur përgjysmë dhe ata shumë shpejt zunë vendet e tyre. Bujari, sa u ulën, nisi të kërkonte me sy fqinjën, por si duket ata ende nuk kishin ardhur. Dikur i nguli sytë te dera për të mos e lëshuar momentin kur do të hynin.

- Oh, Bujar, shiko, qenkan Shpëtimi me Natyrën; ja aty në rreshtin e dytë para nesh, – i tha befas gruaja.

- Ku? – i shpëtoi papritur pyetja atij dhe pastaj bëri sikur i pa interesuar. – Nuk po i shoh, por nuk ka gjë. I kemi boll para syve në shtëpi.

- I paskan vendet të mira. Unë mezi arrita t'i siguroj këto ku jemi,– tha Besa me keqardhje.

- Njëlloj do ta përjetojmë,- tha Bujari dhe mori një qëndrim të drejtë, gjoja për të parë skenën më mirë, por sytë i kishte drejtuar kah flokët e Natyrës, që i derdheshin bukur supeve. "Sa i lumtur dhe krenar duhet të ndjehet tash burri i saj! Të kesh një grua të tillë përkrah, të bën të rrish më tepër në publik se në shtëpi",- mendonte Bujari.

Dhe ja ku edhe Natyra e ktheu kokën. Një herë shikoi rrotull pa ndonjë interesim të veçantë dhe pastaj shikimi iu ndal te Bujari. I buzëqeshi dhe e përshëndeti duke mbyllur paksa sytë, ndërsa atij i kërceu zemra nga vendi si e çmendur.

Akti i parë kaloi shpejt, meqë Bujari ishte koncentruar tërë kohën në figurën e kokës së bukuroshes dy rreshta para tij. Nuk ia kishte idenë çfarë luhej në dramë, nuk kishte asnjë interesim për të.

Gjatë pauzës doli për një kafe në bufenë e teatrit. Gruaja mbeti e ulur brenda sallës. Derisa po kthehej brenda, Bujari pa çiftin e fqinjëve që po rrinte në korridor para hyrjes. Shpëtimi po fliste diçka, ndërsa e shoqja e kishte ndezur një cigare dhe derisa e dëgjonte, rrihte dyshemenë me takën e njërës prej këpucëve të saja elegante. Dukej shumë bukur, si modele. "Janë sikur bukuroshja dhe bisha",- mendoi Bujari me vete. Pastaj iu afrua me buzëqeshje.

- Po kënaqeni me shfaqjen? – iu drejtua më shumë Shpëtimit, me që e dinte se po të haste në shikimin e Natyrës, do të skuqej deri në vesh

- E bukur është. Edhe aktorët vërtetë janë shumë të përgatitur. Më kanë mahnitur,- ia ktheu fqinji.

- Po, po ashtu është. Më falni mua, po kthehem brenda, kam lënë time shoqe vetëm. Shihemi më vonë përsëri,- shtoi Bujari, pa e menduar mirë nëse fjalët e fundit i tha rastësisht, apo enkas për Natyrën.

- Sigurisht, – tha Shpëtimi me atë dashamirësinë e tij, që Bujarit i dukej si një gjë e lagësht e shtirur, e neveritshme.

Pas disa minutash, të gjithë ishin kthyer në sallë dhe filloi akti i dytë. Bujari ishte shumë i shqetësuar, nuk po mundej as të rrinte i qetë në karrigen e tij.

- Je mirë? – e pyeti gruaja, e cila e kishte vërejtur se po lëvizte më tepër nga që duhej.

- Kam pak ngrohtë, disi më duket se nuk ka ajër të mjaftueshëm, – iu përgjigj ai.

- Dëshiron të dalim jashtë? – e pyeti ajo sërish.

- Jo, njëherë jo.

Nuk kaloi shumë kohë dhe ai pa figurën e Natyrës që po ngrihej nga karrigia e saj. Kaloi skaj disa njerëzve duke u përkulur, shikoi kah Bujari dhe doli jashtë. Shpëtimi mbeti duke shikuar shfaqjen. Bujari ktheu kokën kah e shoqja. Dukej se ajo nuk e kishte vërejtur Natyrën tek po dilte.

- Megjithatë po dal pak jashtë të marr një ajër. Ti qëndro, mos e humb shfaqjen, mirë?- tha ai.

- Jo, po vij me ty, – iu përgjigj gruaja duke pëshpëritur.- Mbase nuk je mirë?

- Mos u brengos, nuk kam gjë, janë këto xixat e mia në kokë, – ia ktheu ai duke buzëqeshur dhe ia shtrëngoi dorën lehtë mbi shuplakë duke i thënë:- Rri dhe shikoje shfaqjen, ke kohë që e ke pritur. Kështu pastaj ma tregon edhe mua pjesën që po humb. Unë do të jem fare mirë.

Doli ngadalë dhe sakaq e pa veten jashtë sallës. Ofshau sikur të kishte hequr një barrë të madhe. U vu të shikonte një ekspozitë pikturash që e kishin vendosur nëpër korridorin e gjerë, derisa ia zuri syri fqinjën e bukur, që po e shikonte edhe ajo një pikturë. Bujari iu afrua nga prapa dhe i tha:

- Po të ishe ti modeli i autorit, piktura do ia kalonte Mona Lizës.

Pavarësisht se zëri i Bujarit i erdhi i papritur, Natyra nuk bëri asnjë lëvizje. Duket se ajo e kishte pritur. Kishte qenë e bindur se ai do të vinte aty, mu atëherë dhe mu pas shpinës së saj. Ajo kishte një vetëbesim që impononte. Pastaj iu përgjigj pa e kthyer kokën:

-Po më bën lajka, Bujar. Gratë asokohe kanë qenë më femërore se ne sot. Më sensuale. Ne ngjajmë sikur meshkuj.

- Ti je sinonim i femrës sensuale dhe intelektuale, Natyra. Yt shoq është burrë me fat, – i tha Bujari dhe u çudit edhe vetë me guximin që mori për t'i bërë komplimente gruas që e admironte.

- Faleminderit, – tha ajo me një buzëqeshje gjithë flirt dhe pastaj vazhdoi me zë të ulët: - Dëshiron të pimë ndonjë gjë bashkë? Më zihej fryma atje brenda. Ndërsa shfaqja më duket tejet e mërzitshme.

-Jashtëzakonisht, – ia aprovoi mendimin Bujari dhe e ndoqi pas deri te banaku i bufesë.

- Të pëlqen kur bisedojmë mbrëmjeve në internet? – e pyeti befas Natyra.

- Më pëlqen shumë, ndonëse kompjuteri dhe interneti për mua janë zbulime të reja, deri vonë isha akoma me makinën e shkrimit, – i tha me sinqeritet Bujari.

- Kam ndikuar mirë në ty, ë? – e pyeti Natyra duke qeshur.

- Bukur shumë, besa. M'i ke mbushur shumë vende bosh të ditëve të mia. Edhe pse më shumë shkruhemi mbrëmjeve vonë. Kushedi sa gjëra të tjera do t'i kesh mësuar Shpëtimit. Të them të drejtën, – iu afrua pak sikur po i fliste për ndonjë sekret, – ia kam pakëz zili tët shoqi.

- Ashtu?– ngriti vetullën Natyra dhe vazhdoi me një nënqeshje cinike: – Ah, Shpëtimi, ai është nga ata që nuk ndryshojnë shpejt. U qëndron besnik klisheve klasike, – e tha fjalinë e fundit duke e theksuar me cinizëm gjithë përbuzje të veçantë. Pastaj sërish iu kthye Bujarit:- E di se Shpëtimi të çmon shumë ty dhe punën tënde?

Bujari u gjet shumë ngushtë. Heshti pak e pastaj tha:

- Faleminderit, më vjen shumë mirë.

- Ka shumë respekt edhe për gruan tënde. Thotë se është një nga ato zonjat e rralla që njeriu nuk e has shpesh në ditët e sotme.– I tha këto duke e shikuar me sytë e saj provokues.

- Duket se i kemi bashkëshortët të bërë për njëri-tjetrin, – tha Bujari dhe të dy u shkrehën në gaz. Befas Natyra mori një pamje serioze dhe i tha:

- Ashtu siç jemi ne? Apo jo?

Bujarit iu duk se zemra po i dilte vendit. Shikoi pak në dysheme dhe pastaj ngriti kokën dhe tha sikur triumfalisht:

- Po, Natyra, mu siç jemi ne. Sinqerisht të them, më vjen keq që nuk jemi takuar më herët.

- Do ta braktisje gruan për mua?- i tha befas ajo pa u turpëruar fare nga pyetja që i bëri, dhe u qesh për ta mbuluar me një tyl shakaje sfidën që ia lëshoi në prehër tjetrit.

- Është pyetje e vështirë,- tha Bujari.- Por një gjë ta them me siguri, se kam ëndërruar gjithnjë për një grua sikur ti, sidomos nga momenti prej që jemi njohur bashkë.

- Ti do të thuash se ëndërron për mua? – e pyeti ajo sërish duke e shikuar me ngulm në sy.

- Pse dëshiron ta dish? – tha edhe Bujari tani dukshëm i shqetësuar nga emocionet.

- Paj, më intrigon ta di nëse jam pjesë e fantazive të një burri që nuk është i imi.

- Je e sigurt se e dëshiron të vërtetën?

- Më josh pa masë.

Bujari u mendua. Ky ishte njëri prej atyre momenteve që njeriut ia ndryshon kahun e jetës. Mund t'i thoshte jo dhe ta gënjente. Por do të ndaleshin shpresat e tij për ta pasur dhe ndoshta interesimi i saj do të binte. Mund t'i tregonte të vërtetën, t'i thoshte shqeto se e mendonte në çdo çast dhe vuante për të, kështu do të dilte haptas një herë e përgjithmonë me dashurinë e tij, me pasionin që po e kallte përbrenda. Tha me vete: " Në djall të vejë! Mjaft jam shtrënguar deri tani, dua pakëz nga jeta". Natyra ishte vërtetë grua e martuar, por nuk mund të përmbahej dot. E dëshironte. Dukej se edhe ajo nuk ishte indiferente ndaj tij.

- Hë, e ke vështirë ta thuash?- e nguci sërish Natyra, mu sikur ai të ishte një fëmijë i frikësuar,përpara mësueses së aftë për ta zhvoshk nxënësin e saj gojëkyçur.

- Jo, por nuk di si ta them.

- Thuaje ashtu si është.

- Mirë. Po ta them, pra,– mori frymë thellë Bujari dhe, duke mos guxuar ta shikonte në sy, i tha: - Natyra, ti je në të gjitha fantazitë e mia, jam me ty prej mëngjesit deri në mbrëmje. Ndoshta. ndoshta po marr liri të tepruar, por unë… mua më vlojnë shumë ndjenja për ty.

- Po flet sikur kjo të ishte diçka e keqe.

- Jo, nuk është. Por e kam parasysh se je e martuar.

- Dhe? Të pengon ty kjo? Unë e Shpëtimi vështirë se mund të quhemi të martuar. Pyetja është si ndihesh ti ndaj gruas sate.

Në sytë e Bujarit u ndezën shkëndija të shumta shprese. Ishte shumë më afër dashurisë së tij, sesa që e kishte menduar.

- Edhe unë me gruan jemi njësoj sikur ju. Si dy të huaj nën një kulm.

Natyra nuk e komentoi asgjë, por i tha:

- Ndoshta është koha të kthehemi brenda. Nuk kam më fuqi ta përballoj këtë bisedë.

- Mirë, po kthehemi, – tha edhe Bujari. Kur po ecnin drejt korridorit i pëshpëriti ngadalë afër veshit: - Do të bisedojmë sërish përmes internetit?

Natyra u ndal dhe u kthye nga ai. E shikoi drejt në sy dhe i tha:

-Bujar, unë jetoj për ato çaste,- dhe u zhduk brenda sallës. Ai mbeti i shtangur duke shikuar një pikturë, e cila nuk i paraqiste asgjë. Priste të ndjente më shumë shqetësime nga kjo bisedë, por çuditërisht, po ndjehej shumë natyrshëm dhe egoja e tij mashkullore i ishte plotësuar si kurrë më parë.

Pas këtij takimi gjërat kishin ecur shumë më lehtë e më rrjedhshëm. Bujarit i ishte kthyer humori i mirë, madje shpesh e dëgjonin te fërshëllente nëpër shtëpi. Me gruan

mundohej të qëndronte sa më larg dhe i shmangej rasteve kur u duhej të paraqiteshin bashkë. Ishte i bindur se asaj nuk i kishte rënë në sy asgjë nga flirtet e tij me Natyrën. Madje aq i sigurt ishte për këtë, sa në një farë mënyre ndjente një lloj përbuzjeje për naivitetin e së shoqes. Por, mendonte, tekefundit, nuk ishte më problemi i tij. Le të bënte çfarë të donte. Çfarë faji kishte një burrë, kur gruaja nuk i ofronte ngrohtësinë e duhur? E çfarë duhej të bënte ai? Të priste përjetësisht se gjërat do të ndryshojnë? Mos po priste ajo vallë se ky duhej të bënte diçka? Ky ishte burrë, dreqi e marrtë, burrë! Gruaja duhet t'i dijë e t'i bëjë më mirë disa gjëra.

Kështu mendonte edhe një ditë derisa po hapte derën e shtëpisë. Vëmendjen ia tërhoqi një zhurmë që dukej sikur një vaj i mbytur. Kush po qante? Mos i kishte ndodhur fëmijëve ndonjë gjë? Hoqi këpucët dhe hyri me shpejtësi në dhomë. Gruaja ishte ulur në divan dhe po i rridhnin lotët.

- Çfarë ke, çfarë ka ndodhur, pse po qan? – e pyeti Bujari me një frymë.

- Asgjë, asgjë…

- Mos ka ndodhur diçka me fëmijët, ku është Dorina?

- Jo, jo fëmijët janë mirë,– i tha gruaja duke u munduar të tregohej e qetë.

- Po çfarë ka ndodhur, pra? Ç'janë këta lot në pikë të ditës? – e pyeti me vrazhdësi ai.

- Bujar, kohët e fundit nuk po ndjehem mirë. Kam shumë shtrëngime e dhimbje në gjoks. Kam frikë se…se…- nuk mund t'i lidhte fjalët gruaja nga lotët që i rridhnin pandërprerë.

- Se, çka? Hajde, mos u bëj fëmijë. Pastaj... kush është mirë sot? Gjithkush e ka një hall,- i tha i shoqi, megjithëse ndjente një nevojë të çuditshme t'ia theksonte se, në fakt, ai po ndjehej si djalosh.

- Frikohem mos po vdes. Po e ndjej se do të ndodhë diçka e keqe. Kam një parandjenjë që po më ndjek.

- O, sa shpirtin e ëmbël e ke, moj grua, – i tha Bujari duke qeshur derisa ajo po qante.- Po hajde, se nuk vdes njeriu aq lehtë sa mendon ti. Një Zot e di se sa do të jetosh,– tha kështu dhe iu duk se mos ishte shprehur me një cinizëm të theksuar, mos po dukej se po fliste për një gjë që, si për inat, nuk do të ndodhte ndryshe. Pastaj u step dhe fytyra i mori pamje serioze. U kredh në mendime, nisi të kujtojë kohën kur i thoshin njëri-tjetrit se vdekja jote le të më marrë mua, e përbetime të tjera si këto.

- Nuk frikohem për jetën time, – foli dikur gruaja duke i fshirë lotët. Fytyra i ishte skuqur, ndërsa buzët i ishin mavijosur goxha shumë.

- E për cilën jetë frikësohesh, për timen? – e pyeti ai me një shaka të pakripë.

- Jo, Bujar. Dua të them se nuk mërzitem nëse vdes. Bota nuk ndalet nëse unë shkoj.

- Po çfarë, pra?

-Mërzitem kur mendoj se ç'do të ndodhë me fëmijët, nëse unë vdes, si do ta përballojnë ata pastaj vdekjen time. Nuk dua që të pikëllohen qysh tani, pse janë fare të rinj. Njeriu që rritet me prindër të shëndoshë, është më i fortë edhe mendërisht edhe fizikisht. Ka vetëbesim dhe forcë. Madje, mu për këtë, po mundohem që mos t'u tregoj fëmijëve edhe kur po ndjehem keq. Nuk dua që ata të rrinë zemërngrirë për shëndetin tim. Dua ta shijojnë jetën, nuk dua t'u bëhem brengë.

-Ti po flet thuajse ke marrë dënimin me vdekje. Sikur kjo punë mori fund. Nuk ke asgjë, moj, fare. Një tension të lartë, që ma ka gjysma e botës, dhe menjëherë flet për vdekjen.

- Ti thua se fëmijët do ta kalonin lehtë humbjen time?

- Nuk them asgjë. Mos m'i shtrembëro fjalët, se nuk kam nerva për këto kalamallëqe tashti. Po them se nuk ka nevojë t'i futësh fëmijët në këtë punë.

- Por unë jam nënë…

- Pse veç ti je nënë? Nuk paska nëna të tjera në këtë botë, aman.

- Pse i merr fjalët për ters, Bujar, unë po flisja…

- Hajde, se na lodhe, nuk ke gjë fare. Harroje këtë muhabet. Fshiji lotët, se nuk të kanë hije në këtë moshë.

- Por shtypjen e gjakut e kisha…

- Ia nise prapë me shtypjen, ti?- e shikoi i shoqi tani me një padurim të shprehur.

Gruaja heshti dhe uli krahët, u nis drejt kuzhinës për të bërë kafetë.

"Dreq, o punë, e kisha mangët të merrem edhe me ankesat e saj tani", mendoi Bujari. Mendja i shkoi te bukuroshja e tij gjithë shëndet e freski, me atë trup aq të hijshëm. Përjetoi shpejt e shpejt nëpër mend atë vegimin që e kishte sajuar ashtu, sikur ndodhej vetëm për vetëm me Natyrën e tij, dhe, për të qenë i patrazuar në përjetimet e tij të bukura, ndezi televizorin. I dukej sikur një dorë e padukshme e fatit e kishte marrë përsipër që t'ia rregullonte jetën mirë e bukur, ashtu siç duhej. Me këto mendime në kokë, e kishte zënë një gjumë i lehtë. Gruaja u afrua dhe e pa. Në faqet e saj ishin akoma gjurmët e lotëve dhe sytë i kishte të ënjtur. Me duart që po i dridheshin, mbante kafetë, ndonëse këmbët nuk e mbanin nga shëndeti i përkeqësuar. E shikoi gjatë të shoqin, i cili po flinte me një buzëqeshje të ravijëzuar lehtë në buzë. Në fytyrën e shtrembëruar nga dhimbja, gruas sërish i shkëlqyen sytë nga lotët që po afronin për të vërshuar. Ajo e ndjente çdo ditë e më shumë, se lisi i jetës së tyre të përbashkët, të cilin e kishte përkujdesur me aq shumë mund, dashuri dhe kujdes për ta pasur si mbështetje, kishte kohë që nuk ishte më. Madje ai lis nuk kishte vënë rrënjë asnjëherë.

***

"Kushedi a do të zbulohet ndonjë ditë në tërësi universi?- mendonte Bujari një mbrëmje, i shtrirë në shtrat, me duart e vëna nën kokë. Shikonte kah dritarja yjet sikur djalosh i dashuruar. Nata, ndonëse jo e ngrohtë, ishte shumë e kthjellët.- Ku është ky fundi i universit, xhanëm, a thua çka ka pas tij?" – mendonte akoma i humbur tërësisht në misteret e largëta prej miliona vite dritë.

"Tring , tring"- u dëgjua toni nga kompjuteri, që po e lajmëronte se dikush e thërriste në bisedë.

"Uh, dreq o punë! – mezi u kthjell Bujari. – Paskam qenë i hutuar. M'u duk se isha në një botë krejt tjetër".

U afrua para ekranit dhe pa dritën që po tregonte emrin e Natyrës. Kishte vënë një pseudonim interesant që e trazonte: "Irena".

- Eeej, Irena, çfarë po bën?– iu lajmërua Bujari

- Ja, po prisja mos po dukesh, por pastaj e vërejta që nuk je aty. Të dërgova një zile. Mos të tremba?

- Më ke kthjellur më shumë se ç'mund ta paramendosh. Por, më thuaj…

- Çfarë…

- Prej nga kjo Irena? Të pëlqen ky emër?

- Është një personazh i dashur. Më pati bërë shumë përshtypje.

- Vërtetë? Sa interesant. Po në cilin libër?

- Librin nuk e kam lexuar, por e kam parë filmin. Një rrugë e dy punë. Sa më kujtohet, quhej "Saga e Forsajtëve".

- Ah, po. Në fakt, unë e kam lexuar. Është i mrekullueshëm. Po, po, tash më kujtohet Irena, eh, kush mund ta harrojë Irenën. Mishëron femrën e bukur, gracioze dhe në të cilën… shumë lehtë mund të dashurohesh.

- Dhe të cilën e dëshiron çdokush për vete, – e plotësoi Natyra.

- Po. Të pëlqen të identifikohesh me të, a?

- E cila femër jo?

Biseda vazhdoi deri natën vonë. Bujari e Natyra kishin filluar ta njihnin aq mirë njëri-tjetrin, sa që iu dukej se kishin qenë në jetën e secilit gjithmonë. Se ishin një trup, një shpirt. Nuk kishte qenë nevoja t'i tregonin shumë hollësira për veten, pse secili e kishte krijuar portretin e tjetrit përmes rrëfimeve, dialogëve, pasthirrmave, pajtimeve me idetë dhe mendimet e tjetrit. Mu aty kishin kuptuar se çfarë mendimesh e ndjenjash flinin në shpirtin e secilit, çfarë i pëlqente apo jo secilit, dhe, si për çudi, shpesh herë kopjoheshin në mendime, pra shkruanin të njëjtën gjë në të njëjtën kohë. Secili nga kompjuteri i tij. Nga kjo përputhje e mendimeve dhe e ndjenjave, edhe të fateve mbase, kishin arritur t'i besonin njëri-tjetrit edhe fshehtësitë vetjake e ato familjare, me grindjet, ëndrrat, gëzimet e dëshpërimet që kishin. Natyra i ankohej Bujarit se si fëmijët e burrit të saj e trazonin. Se si vinin, e merrnin babanë e tyre dhe shkonin bashkë te varri i së ëmës.

"Ç'duhet kjo?" i shkruante. Ajo grua kishte kohë që kishte vdekur, tri vite të plota, aman, dhe i shoqi duhej ta harronte më në fund, tash mund të merrej më mirë me gjërat e gjalla. Ndonjëherë, Natyra i tregonte se kur vinin mbesat e nipat, disi i dukej se Shpëtimi kërkonte prej saj të vihej si gjyshe ndaj tyre. Neveritëse, bah! I thoshte se me të shoqin nuk diskutonin shumë, pos formalisht për gjëra të rëndoma, dhe Natyra akuzonte po ashtu fëmijët e tij për këtë ftohtësi në mes tyre.

"E kanë shtirë të atin kundër meje! I kanë dalë ngjarë së ëmës, duhet të ketë qenë person jo i mirë" qahej bukuroshja e tij. Edhe pse Natyra nuk ia thoshte troç, nga gjithë bisedat e saj Bujari kishte arritur ta kuptonte se ajo nuk flinte bashkë me të shoqin, madje as në një dhomë. Ai nuk e kuptonte, nuk arrinte t'ia përmbushte nevojat e saj. Ajo ishte shpirt i lirë. Po dhe në krevat kushedi si i kishin punët.

" Po pse rri me të?", – i kishte shkruar një mbrëmje tjetër Bujari.

" Më jep sigurinë e duhur",- i ishte përgjigjur ajo.

" Sigurinë për çka, ti je femër e pavarur".

" Sigurinë për shumëçka, po kjo nuk domethënë që e dua".

Ndërsa Bujari, i cili kishte gjërat e tij të parealizuara në jetë, i thoshte se si në shtëpinë e tij kishte gjithçka, por mungonte gjallëria, se bënte një jetë vërtetë pa telashe, por të mefshtë e pa lëng, se nuk grindeshin kurrë por edhe kjo i dukej false, dhe i ankohej se i lipsej shumë një jetë e gjallë, që t'ia lodhte e t'ia çlodhte gjymtyrët. Një jetë me ca përplasje mendimesh, me zhvoshkje ndjenjash, që ta flakte ndryshkun jashtë.

Dhe ishte tamam pas këtij rrëfimi të tij, kur Natyra befasisht kishte marrë guximin dhe i kishte shkruar:

" Do të doja të kisha takuar më herët me ty, Bujar"

Ai kishte ngelur si i paralizuar para asaj fjalie të thjeshtë në ekranin e kompjuterit dhe pasi ishte mëkëmbur ca, i ishte përgjigjur:

" Edhe unë do të doja të të kisha takuar më herët, qëkur ishe çamarroke, të isha në shkollë me ty që të merrja nga ato hiret e tua. Do të doja të kisha lindur më herët për ty".

" Nuk do të ishte nevoja,- kishte shkruar ajo, që e kishte kuptuar menjëherë se Bujari aludonte për punë të diferencës që kishin në moshë.- Sa i përket moshës, ti do më përshtateshe për mrekulli. Qëkur isha e vogël, e mendoja burrin më të madh se veten, disa herë më të madh. Shokët e shkollës, edhe ata të viteve më të larta, më dukeshin shumë fëmijë.

- Si kështu?- shkroi Bujari që s'po dinte se si të reagonte ndaj kësaj që i kishte thënë Natyra. Por programi kompjuterik nuk priste, duhej të shkruaje shpejt mendimin tënd, ashtu si të ishte, pse, po të vonoheshe edhe për pak sekonda, tjetri matanë mbetej në mëdyshje.

-Po,- shkroi Natyra dhe shtoi: Ka kohë që dua të ta them një gjë, Bujar, mu beto se s'do më zemërohesh…".

" Të zemërohem me ty? E kush ka zemër të hidhërohet në ty? Thuaje, pra.

" Do të doja ta kisha një fëmijë me ty, po të ishte vajzë mund ta quanim Irena".

" Me mua? Pse me mua, ti je e martuar",- Bujarit i rrëzoheshin gishtërinjtë nëpër tastierë dhe fjalët i dilnin gjysma-gjysma o të ngjitura varg me njëra-tjetrën. Sikur pështjellimet e tij në kokë.

" Nuk e di, ashtu. Më duket se ti je shpirti im binjak. Më duket se bash në ty kam hasur atë, që e kam pritur gjithnjë".

"Hëm,– ishte përgjigjur Bujari.- Tani që e di këtë, vuajtja ime bëhet më e madhe. Tmerrohem mos mbetesh përherë dëshira ime e parealizuar dhe e kërkuar. Për mua je femra e vetme…".

"Por jo e paarritshme", – i kishte thënë ajo dhe në çast i kishte postuar një nga ato figurinat, që këtë herë ishte një gonxhe trëndafili, e cila i hapte e i mbyllte petalet duke vazhduar rrugën nëpër ekranin e kompjuterit derisa zhdukej aty pas. Bujari ishte mësuar tashmë që në këto figurina të lexonte një mesazh të qartë, që donte të shprehte gjithnjë më shumë se sa thonë fjalët. E ndali gonxhen e trëndafilit në ekran dhe u bë gati t'i hedhë dorën për ta marrë e ta vinte mu aty në xhepin e vogël të xhaketës, siç e kishin zakon të binin djelmoshat në rininë e tij. Por trëndafili elektronik iku sakaq e u zhduk në tejsirën e eterit. "Si dashuria,- mendoi Bujari.- Kështu zhduken shumë dashuri. Pastaj falënderoi Zotin që ndodhej vetëm për vetëm në studion e tij, pse kështu e kishte të mundur t'i jepte liri vetes që të hidhej në flatrat e afshit të zjarrtë të dashurisë.

Nga ana tjetër dialogu vijonte përsëri:

"Çfarë pësove, Bujar? Nuk të punon mirë tastiera? Po më vonohen një shekull fjalët e tua".

"Jo tastiera, por gishtat",- tha ai.

Atëbotë Natyra hodhi në ekran një qenush të vogël prej pelushi, që tundej e shkundej dhe gajasej së qeshuri e sikur thoshte: "Ha, ha, ha, sa bela me këtë dashuri". Dhe, ndërsa Bujari ndiqte këtë lodrim zbavitës e domethënës, në ekran u shfaq fraza tjetër:

"A e di, Bujar? Në ty kam gjetur jo vetëm babanë e fëmijës tim, por edhe...".

"Edhe çfarë?" u ngut t'ia presë përmes fjalët Bujari.

"Nuk e di nëse ti beson në Zot, si profesor që je, por unë kam shumë besë në Të. Gjithsesi, deri dje i qahesha Atij se më ka parë me sy të shtrembër, se nuk ma ka plotësuar dëshirën për të gjetur gjysmën time që më shkon për zemër. Por me sot kam nisur t'i falem e të kuptoj më mirë se Zoti është vërtetë aq i lartë e i madh".

"Po, po" shkruante Bujari veç për t'i treguar Natyrës se po e ndiqte në ekran.

"Deri dje, pra, më dukej se më kishte mënjanuar, por me sot po kuptoj se Zoti, duke më lidhur së pari me një njeri që nuk është gjysma ime e vërtetë, më ka treguar se kështu tashti unë mund ta kërkoj e ta gjej më mirë atë që kam dashur dhe e kam ëndërruar ndoshta që në djep

"Po ti?" i shkroi Bujari me gishtat që tani vërtetë nuk po mundej t'i komandonte aq lehtë.

"Hiç, mendoj se tash e kam gjetur.

Atëherë Bujari, i mrekulluar nga ato që po i thoshte Natyra, i mori frenat në dorë dhe e cyti atë:

“Si mendon se do të bësh, pra?”.

“Po mendoj të ta grabis zemrën, kaq”.

“Oho,- shkroi Bujari.- Duhet të grabisësh aty ku ka dy zemra”.

“Pse?”.

“Se kështu, së paku ia le njërën”.

“Jo,- tha Natyra,- të grabisësh, po mendoj se do të thotë t’ia marrësh zemrën krejt. Mos të ketë më zemër që ta dashurojë dikënd tjetër, por veç mua.”.

“Oh, Natyra, po të kuptoj krejt, por po të lajmëroj se, nëse po mendon ta grabisësh zemrën time, nuk do gjesh asgjë. Unë jam sosur nga shpirti. Kam mbetur vetëm trup”.

“Po mendon gabim,- iu përgjigj ajo.- Ndonjëherë nuk e njohim veten, por të tjerët na njohin më mirë. Unë e di sa shpirt e zemër ke ti”.

Bujari u trand krejt. Si ta quante vallë këtë që po i ndodhte me këtë grua të re e të bukur. Do të ishte kjo vërtetë dashuri? Apo filmat dhe dramat kishin nisur të krijoheshin e të shfaqeshin sot në një tjetër mënyrë? Atëherë, kur iu duk se më në fund ishte sosur tema e bisedës për sot, mori edhe guximin t’i bëjë një të papritur mikes së tij përtej ekranit:

“Gjithë këto mrekulli i bën ky kompjuteri, por një gjë nuk e di nëse e bën apo jo”.

“Çfarë?”.

“Nëse dëshiron për shembull, ta puthësh një mik a ... një mike në ekran, a mundesh dot?”.

“Provoje,- i tha ajo shkurt, sikur ta kishte paramenduar me kohë një pyetje të tillë.- Kur njeriu e do një gjë me zemër, mundet ta arrijë.

“Po provoj, por më mungon imazhi”,- tha Bujari dhe atëherë ndjeu se shumë përpara kishte shkuar sot në ndjenjat e tij me fqinjën e bukur.

Pas asaj dite ishin takuar disa herë me Natyrën. Ndjehej se, pas asaj bisedës në kompjuter, ishin bërë më të afërt se kurrë. Nuk qenkësh dhe aq virtuale kjo dashuria në internet, kishte menduar Bujari. Madje i bëhej se ato fjalë magjike i kishin këmbyer jo në ekranin e tejdukshëm të kompjuterit, po nën dritën e zbehtë të një parku a në qoshen e një rruge duke ia ndjerë dihatjen e ngrohtë gruas që e kishte pranë. Dukej se, dita kur do të bashkoheshin plotësisht po afrohej. Kishte një kimi mes tyre në ato bisedat aq të ngrohta, që e bënte Bujarin t’i dridheshin këmbët afër saj.

Takimet i bënin fshehtas, të rastësishme, megjithëse e shoqja nuk i kërkonte kurrë që të shpjegohej për daljet e tij të befta e të shpeshta. Ajo sigurisht që nuk kishte nuhatur asgjë nga flirtet e tij me Natyrën, prandaj ai e kishte lehtë të rrëshqiste jashtë shtëpisë sa herë që të donte.

-Do ma bësh atë vizitën mjekësore që patëm biseduar? – i tha një ditë Natyrës kur ishin takuar përsëri. Njëkohësisht ngriti vetullën dhe vari buzëqeshjen në cep të buzës në mënyrë provokuese.

- Kur të duash,- iu përgjigj ajo.- Burri im nuk punon më në klinikë, ka vendosur të pensionohet. Po thotë se ka nevojë të pushojë, se ka kontribuar mjaft në shkencë deri tani e të tjera dokrra si këto. Nuk janë të gjithë si ti, Bujar, të dhënë pas shkencës dhe studimeve sikur me elanin fillestar . Ti je… ti je krejtësisht ndryshe nga ai. Edhe në jetë. Je i gjallë e virtuoz. Ai i mjeri edhe është plakur goxha shumë, më shumë se vitet që ka.

Bujari ndjeu një krenari mashkullore. Por, ndryshe nga ç’e priste, Natyra ia plasi vajit papritur. U skajuan pak dhe gjetën një cep betoni për tu ulur.

- Çfarë ka ndodhur, Natyra? Nuk mund të të shoh me lot në sy, më dhemb.

- Ai… ai… më duket se më tradhton, Bujar. Duket se vërtetë ka një tjetër, jam gati e sigurt… - fshiu sytë ajo dhe ngriti kokën.– Ai më tradhton, Bujar, burri im… për atë po flas.

- Je e sigurt?

- Po. Kisha kohë që dyshoja, por tani jam fare e sigurt.

- Po si e kuptove?

- Çdo grua e kupton kur burri i dashuron një tjetër. Është, si të thuash, një nuhatje e femrës. Intuitë.

- Interesante,- tha Bujari dhe mendoi me vete: " Shiko, shiko sa e zgjuar. Ajo budallaqja ime as që merr erë nga këto gjëra, mund ta tradhtosh para syve kur të duash".

- Unë e vëreja se ai prej kohësh e kishte humbur interesimin për mua, por mendoja ngaqë ishte i plakur. Pastaj nisi të më shikonte me përçmim, ndonjëherë edhe me njëfarë dhembshurie, por gjithsesi një dhembshuri përçmuese. Ka kohë që…- ngurroi për një çast ta thotë atë që kishte në mendje.- Ka kohë që…as nuk flemë bashkë,- e tha më në fund.

- Por kjo nuk do të thotë se ai të tradhton! – Bujari po ndjente një gëzim të madh në zemër që po i lehtësoheshin gjasat për ta pasur Natyrën. Sidomos kur tashti që mësoi se ata nuk flinin bashkë. Tekefundit, kështu ajo ishte më e gatshme për të. Ajo kishte edhe nevojë.

- Por, a je fare e sigurt për këtë që thua?- e pyeti Natyrën duke i shkundur mendimet që e kishin zënë në kokë.

- Po. Një ditë më tha se po shkonte në bibliotekën e qytetit.

- E pastaj? Pleqtë edhe ashtu s'kanë punë më të mençur, se sa të lexojnë.

- Po ama një mikja ime më mori të nesërmen në telefon dhe më pyeti se kush ishte ajo gruaja me të cilën e kishte parë burrin tim në një park. Ajo kishte supozuar se ishte ndonjë kushërirë e tij, ose e imja, meqë, siç më tha, dukeshin shumë të afërt me njëri-tjetrin, bisedonin shkujdesur.

-Po nuk të tha se cila kishte qenë ajo grua?

- Jo, nuk e njihte. Madje gruaja kishte pasur një shall me lule mbi kokë, ndaj shoqja ime nuk ia kishte parë dot fytyrën.

- Dhe?

- Asaj i thashë se mund të ketë qenë ndonjë kushërira jonë ose e tij... por ia thashë vetëm për t'ia shqitur dyshimin, pse jam e sigurt se nuk është ashtu. Unë nuk kam askënd përveç nënës sime. As ai nuk ka ndonjë grua të moshuar në fis e të afërt.

- Mos u ngut, mund të ketë qenë ndonjë kolege nga fakulteti ku ka ligjëruar, ndonjë studente... Mos nxirr përfundime të shpejtuara. .

- Nuk do të kisha nxjerrë, por ngjarja është përsëritur disa herë.

- Ku e di?

- E di. Jam e sigurt. Mos më pyet më tej.

- Çfarë mendon të bësh? Mos më thuaj se të dhemb tradhtia e tij. Ti edhe kështu nuk e do, apo jo?

- Po, por, megjithatë tradhti është. Ndoshta ky është dënimi im që po shihem me ty.

- Je në vete? Kjo që po bëjmë ne nuk është tradhti. Ne dashurohemi. Është dhuratë e vetë natyrës që jemi takuar. Ti vetë e ke thënë se neve na pati tradhtuar fati deri tani. Por dashuria triumfon gjithmonë. As mos e mendo, more vesh? Nuk është tradhti kjo e jona. Por, më thuaj, çfarë mendon të bësh?

- Nuk e di. Atij nuk i kam thënë asgjë.

- Maskarai! Ka në dorë një thesar si ti dhe nuk ia di vlerën.

Natyra ngriti kokën dhe e shikoi në sy. Bujari e zuri për dore dhe e tërhoqi ngadalë drejt vetes. Afruan buzët në heshtje. Për ato pak çaste Bujarit iu duk se ishte në parajsë. Ia ndjeu frymën e lehtë, shijen joshëse të buzëve të njoma, gjoksin që po i rrihte si një zog i vogël mu aty ngjitur me këmishën e tij. I kishte mbyllur sytë dhe ia ledhatonte lehtë buzët me buzët e tij. Ah sa e kishte kërkuar këtë çast magjik. Si nuk e paskësh ditur se sa e ëmbël qenkësh dashuria. Papritur, Natyra kërceu përpjetë, si ta kishte pickuar gjarpri.

- Jo, jo… çfarë po bëjmë kështu… nuk guxoj… unë…. të lutem Bujar, më kupto.

-Unë të dua, Natyra, jam i çmendur pas teje, ti e di, ka kohë që të ëndërroj…- ia kapi dorën Bujari duke mos dashur ta linte të ikë. Pastaj ia shkoi duart në supe, përreth qafës së bardhë si farfuri.

- Të lutem, Bujar,- i tha ajo.- Më lër, një herë tjetër, sot jam tejet e trazuar. Nuk kam mendje për asgjë. Tani... tani duhet të marr një vendim. Ndoshta... ndoshta do të duhet të ndahem me të, nuk di...

-Të ndahesh?, - i tha i befasuar Bujari.- Të ndahesh për fare? Po çdo të bësh pastaj?

Ajo e shikoi ngultas në sy, duke u munduar t'i buzëqeshë ëmbël si një djallushë, siç ia kishte bërë edhe herë të tjera.

-Nuk e di, Bujar. Nuk e di vërtetë se ç'do të bëj. Vetëm e ndjej se duhet të largohem prej tij përgjithmonë.

- Po mirë, bëje pra, çfarë të ndalon?- e pyeti ai.

- Ufa…

-Çfarë të pengon, Natyra?

- Paratë, Bujar.

- Ti dëshiron të rrish me të vetëm ngaqë ka para? – i tha Bujari i tendosur kokë e këmbë.

- Çfarë thua, Bujar? Jo, jo. Por më duhen para për avokatin, për ndarjen. Pastaj kishim edhe një kontratë paramartesore, ku harxhet e shkurorëzimit do t'i bartte ai që do ta kërkonte shkurorëzimin. Kupton? Siç e sheh, ai dëshironte të më lidhte aq shumë për vete, sa më ka mbyllur dyert në çdo anë. Madje nuk kam asgjë anash, meqë punonim bashkë, fitimet i kishim të përbashkëta, por ai i vinte në bankë në emër të tij.

- Po ti nuk ke të drejtë në to?

- Kam, Bujar, por kush do të më ndihmojë mua të shkretës në këto punë? Shpëtimi me ta marrë veshë se dua të ndahem, do të bëjë çmos të më shkatërrojë. Ndoshta po të kisha ca para tani e të kryeja të gjitha punët më parë, pa e ditur ai, do të ishte më mirë. Pastaj, natyrisht do të kërkoja të drejtën në pjesën time dhe do t'ia ktheja atij që do të m'i huazonte. Por, nuk kam kujt t'i drejtohem, nuk kam…- foli Natyra me një zë që i dridhej nën vaj dhe u mbështet lehtë në gjoksin e Bujarit.

Bujari u zu ngushtë. Kishin kursimet në bankë, por deri tani nuk i kishin prekur. Megjithatë, pasi mendoi shkurt, i tha:

- Prit pak. Unë do të t'i gjej paratë, mos u mërzit fare. Ti vetëm mundohu të kuptosh sa të duhen, mirë?

Natyra e shikoi me fytyrën e fëmijës së përlotur, që ka kuptuar se megjithatë do t'ia blejnë kukullën e dëshiruar dhe iu tulat pas gjoksit.

-Vërtetë, Bujar? Vërtetë do më ndihmosh?

-Natyrisht, marroqe. E si mendove ti? Të të shoh tek vuan dhe të qëndroj duarkryq?

Atëherë Bujari mendoi se ishte rasti ta puthte prapë dashnoren e tij të re. Ajo, si ia la buzët që t'ia shijonte një çikë, u largua me takt:

-Oh, Bujar, nuk di si të të falënderohem. Një ditë do të t'i kthej të gjitha, patjetër.

-Mos mendo tani për këtë. Ke gjëra të tjera për të cilat duhet të përgatitesh, – i tha ai me një ton sikur po sajonin ndonjë komplot të fshehtë dhe pastaj shtoi:

-Do t'i bësh me dije ndonjë gjë sadopak Shpëtimit?

-Jo, tani për tani asgjë. Duhet të kem durim. Nuk do t'i them asgjë derisa ta përfundoj planin tim.

VII

Një hije e ndiqte hap pas hapi në një rrugicë të ngushtë. Bujari vraponte, por hapat i kishte shumë të rëndë, i dukej thuajse po vraponte mbrapsht. Frika që ndjente ishte e padurueshme. Befas u ndal dhe ktheu kokën. Hija u ndal gjithashtu dhe e shikonte me neveri dhe përbuzje. Ai u mat t'i thoshte diçka, por dhëmbët nuk i hapeshin. Çdo muskul i trupit i ishte paralizuar. Dikur hija iu afrua, e zuri përkrahësh dhe filloi ta shkundte.

"Kush je ti, pse më ndjek?", – e pyeti Bujari. Ndjente një dhimbje të thekshme në nofulla.

"Mendo më mirë kush mund të jem. Unë jam ai që do të të vras.

"Po pse, çfarë të kam bërë?".

" Do të të vras për atë që do të bësh"- i tha hija dhe e shkundi aq shumë sa Bujari ra në një farë humnere dhe, derisa po binte, shihte vrasësin që po e shikonte nga lart.

"Më thuaj kush je, dreqi ta marrë?".

" Jam ti, – qeshte hija.- Zgjohu, nëse nuk do që të vdesësh; zgjohu, zgjohu...".

- Zgjohu, Bujar, zgjohu!- e shkundi Besa ngadalë.

Bujari kërceu frikshëm dhe hapi sytë.

- Oh, mirë që më zgjove, pata një makth të tmerrshëm. Ajo shkundja jote në ëndërr më doli thuajse… më mirë harroje.

- Po shihje ëndërr të frikshme?

- Ishe ti që më thoshe zgjohu, apo? Tani vërtetë nuk e di. Ende jam nën mbresat e makthit dhe ëndrrës.

- Bujar, të zgjova ngase nuk jam mirë,– i tha gruaja.

- Çfarë? Unë sapo kalova një tmerr ndërsa ti tani me thua se nuk je mirë?

Gruaja e pa e habitur dhe trishtimi ia mbuloi fytyrën. Megjithatë, u përmbajt dhe i tha qetë:

- Ka një orë që po endem nëpër shtëpi. Mora edhe tabletat, por nuk po më bëjnë punë sonte. Më duket se duhet të shkojmë te mjeku.

- Te mjeku në mes të natës? Ç'na gjeti! Nuk mund të presësh deri në mëngjes, së paku? Shiko se mos e ke nga stresi; e di edhe vetë se para ca ditësh më the se ke frikë mos do të vdesësh. Je bërë ca neurotike, si të thuash, vesvese.

- Nuk është ashtu, Bujar. Kam vërtetë shumë shtrëngime në gjoks dhe tension të lartë të gjakut. Po frikësohem. Më fal, nuk desha të ta prish gjumin, por ndjehem keq, shumë keq.

- Mirë, po shkojmë atëherë, bëhu gati! – i tha gjithë hundë e buzë Bujari, dhe u ngrit për t'u veshur.

Rrugës nuk e folën asnjë fjalë. Gruaja kishte mbështetur kokën për xhami dhe ishte krejtësisht e zverdhur. Bujari ishte akoma i bindur se ajo nuk kishte gjë, pos frikës së paarsyeshme, ndonjë lloj neuroze apo hipohondrie. Jashtë po bënte kohë e keqe, fryente një erë me një fishkëllimë të trishtueshme, ndërsa më vonë filluan pikat e para të shiut.

Arritën tek ambulanca e qytetit dhe u paraqitën te mjeku kujdestar, i cili i pranoi menjëherë. Ishte një burrë i ri, serioz në pamje, por megjithatë shumë i dashur sjellshëm. I vuri stetoskopin dhe nisi ta kontrollonte gruan.

-Është vetëm paksa e frikësuar,– i foli mjekut Bujari,- përndryshe është shëndosh si molla. I ka ndodhur edhe herë të tjera, është pak frikacake.

Mjeku nuk ia vuri shumë veshin fjalëve të tij dhe vazhdoi kontrollin me kujdes. Bujari u ndje pakëz ngushtë, por qëndrimi i mjekut e bëri të mos fliste më. Rrinte i mbështetur për muri dhe e lëvizte këmbën me nervozizëm.

Më në fund mjeku e kreu vizitën dhe i bëri gruas një injeksion. Pastaj i tha:

- Ju keni një zgjerim të vogël në një anë të zemrës, besoj se është krijuar me vite nga tensioni i lartë. A i keni bërë ndonjëherë analizat? – e pyeti gruan, ndërsa ajo mohoi me kokë.

- Tani për tani ky injeksion do jua zbresë shtypjen e gjakut dhe do t'ju qetësojë. Por nuk ka veprim terapeutik. Juve ju duhet një trajtim pak i gjatë, lipset të bëni një jetë të qetë, pa strese. Nëse keni mundësi, mund të shkoni ndonjë ca ditë diku në mal. Është shumë e këshillueshme të ecni. Merrni pasdite dikë me vete dhe dilni, bëni një shëtitje. Jam i bindur se burri juaj do t'ju përcjellë me shumë kënaqësi, apo jo? – mjeku shikoi kah Bujari me vetulla të ngritura e me buzën pak në të qeshur, fare miqësisht.

- Posi, posi…- tha me gjysmë zëri Bujari dhe mendoi se këta mjekët e sotëm duan të na mësojnë edhe se si të sillemi me gratë tona. Mos po duan edhe të na ...

- Pas ndonjë kohe, kur situata juaj të qetësohet, do të vini sërish për kontroll dhe do ia nisim ca analizave. Mirë? Si thoni?- e pyeti tani sërish mjeku gruan Besën, e cila ende dukej paksa e shqetësuar.

- Do të përpiqem, doktor.

Bujari e shikonte të shoqen pa fije emocioni. Domethënë na qenka edhe e sëmurë tash, nuk e kishte boll t'ia duronte plakjen dhe monotoninë.

- Shkojmë,- i tha së shoqes me një zë të mbytur, kur pa se mjeku e mbaroi vizitën.

Ndërkohë jashtë shiu ishte lëshuar sikur litarë. Ishte shumë vonë, nja dy orë pas mesnate. U futën në veturë dhe përsëri nuk po flisnin asnjë fjalë. Bujari bënte çmos t'ia bënte me dije se ia kishte prishur terezinë në mes të natës për hiç gjë, dhe gruaja po e ndjente atë faj, bashkë me shëndetin e trazuar.

Pasi kishin bërë ca rrugë, befas vetura u ndal. Bujari provoi edhe disa herë ta ndizte, por kot.

- Në djall!- shau i mërzitur.- Janë lagur kandelat, vetëm këtë e kisha mangut.As frenat nuk punojnë mirë, por mendova ta shtyj disi deri në shtëpi. Duhet të dalim jashtë. Do ta bëjmë rrugën më këmbë. Bah! Edhe kjo na duhej!

Besa rrinte e heshtur sikur të kishte bërë fajin më të madh në botë që ishte sëmurë në mes të natës. Iu përlotën sytë dhe heshtazi hapi derën e veturës dhe doli jashtë në shi.

- S'kemi ç'të bëjmë, duhet të ecim, – i tha Bujari pa e shikuar fare në sy. E skajoi disi veturën në anë të rrugës dhe e mbylli. Gruaja e pa që po shkruante diçka mbi një copë letër, por nuk kishte fuqi ta pyeste më tepër.

Ai nisi të ecte me shpejtësi, ndërsa ajo mezi arrinte pas tij. Nuk ia dha dorën, nuk e pyeti a ishte më mirë. As nuk e ktheu kokën një herë prapa. Donte ta bënte me faj, le të plaste. Ç'kishte që sëmurej në mes të natës?

Më në fund, të bërë ujë, mbërritën në shtëpi. Dorina po i priste zgjuar. Në fytyrë i shihej brengosja.

- Ku ishit, çfarë ka ndodhur? Mama, je mirë?

- Mirë, më mirë, moj bijë.

- Ulu mama, po çfarë ndjeve. Ku ishit? U tmerrova.

- Te mjeku, bijë. Mos u brengos, ishte një dobësi momenti duket.

- Çfarë të tha mjeku… prit të të bëj një limonadë, – bëri të vraponte në kuzhinë Dorina, por u ndal në prag dhe shtoi:

- Pse jeni lagur kështu?

- Na la vetura në rrugë, nesër duhet sjellë disi në shtëpi. Besoj se do t'i teren kandelat dhe do të ndizet. E skajova disi, nuk shihej mirë, - i shpjegoi pa qejf Bujari.

- Dhe ju erdhët më këmbë? Pa ombrellë? Nuk mund të thërrisnit një taksi? – foli gjithë habi Dorina. Shikoi kah e ëma, e cila po rrinte e heshtur.

- Nuk jemi shkrirë fare, e sheh? – iu përgjigj i ati me një pyetje cinike në vend të përgjigjes..

- Mami im e mirë, sa shumë qenke munduar. E sëmurë, pastaj më këmbë e në shi..., mirë që ishe me babin.

Bashkëshortët u shikuan sy më sy dhe heshtën.

- Do të bëjmë mirë që të flemë tani,- tha prerazi Bujari dhe u ngjit shkallëve.

***

Kishin kaluar disa orë dhe Bujari ende po sillej në shtrat. Kishte nisur të agonte.

"Duket thuajse kanë kaluar njëqind vjet nga takimi i parë me Natyrën, nga gjithë kjo ngjarje,- mendoi, - e jo vetëm disa muaj. Thuajse jam tjetër njeri, thuajse diçka brenda meje u ngjall, u ringjall, më duket se paskam qenë i vdekur shpirtërisht deri, deri… atë çast në kopsht".

"Megjithëse e dhimbshme ndarja nga episodet e deritanishme të jetës,- vazhdonte Bujari të mendonte, mirë që më ka ndodhur, ndihem më i gjallë, më i freskët, më i matur, më ndryshe, më... më mashkull, dreqi e marrtë! Koha ishte të ndryshojnë gjërat. Gjithmonë duket se kemi kohë, se do të vijnë ditë të tjera, se të do bëjmë këtë ose atë dhe e shohim jetën si nëpërmjet një farë xhami të mjegullt të dritares. Presim një farë caku, një farë qëllimi. Presim e presim përderisa jeta na tërheq, sikur e heq zvarrë lumi i rrëmbyer degën e shkëputur, dhe nuk arrijmë t'i shijojmë gjërat që na kalojnë përreth, krejt pranë, e i lëmë të na ikin shpesh pa i vërejtur. Dhe pastaj bum! Ndodh diçka, një rastësi… Oh, ku ka rastësi sot!.. Një shikim, një prekje padashur, një çast i vetëm dhe ndryshon jeta. E ky moment na gjen aq të papërgatitur. Oh, Bujar, Bujar,- mori frymë thellë,- duket se brenda një trupi të lodhur, ke burgosur një djalosh të frikësuar, që i fliste dikur lumit".

Ktheu sytë kah gruaja aty në skaj të krevatit, e cila po flinte. Kishin një jetë të tërë së bashku dhe Bujari e kaloi nëpër mendje gjithë kohën me të, mendoi vetëflijimin e kësaj gruaje, braktisjen e një karriere të shkëlqyer të pianistes dhe përkushtimin e saj të plotë ndaj familjes, ndaj tij dhe dy fëmijëve.

Besa, megjithëse në gjumë, nuk ishte fare e qetë. Herë-herë fliste përçart dhe rënkonte trishtueshëm. Trupi i saj ishte deformuar me kohë nga lindjet, nga mosha dhe nga tretmanët mjekësore që i merrte nga shkaku i menopauzës. Bujari kujtoi trupin e hedhur të Natyrës dhe padashur e krahasoi me atë të gruas së vet. Kushedi se si do të jetë në... shtrat,- mendoi vagëllimthi atë çast për dashnoren e tij ende thuaja platonike.

"Dhe pastaj thonë se gruaja është si vera, sa më e vjetër aq më e mirë!!! Bah, çfarë dokrrash! Duket se këtë fjalë e ka zbuluar ndonjë grua e shëmtuar, ose ndonjë burrë që s'ka ditur se ç'janë gratë",- tha me vete dhe i pëlqeu shumë që e tha edhe ai një postulat për gjininë e bukur të kësaj bote.

Të tridhjetë vitet që kishin kaluar bashkë ngjasonin me një liqen të qetë, të patrazuar, pothuajse si një idil nga pikturat e varura në muret e shitoreve. Gjithë ato vite, që Bujari ia kishte dhuruar shkencës dhe studimeve të tij, gruaja i kishte harxhuar për t'i krijuar atij një fole të qetë, një kënd ku kthehej si zogu i lodhur pas shtegtimeve dhe gjente aty prehjen e duhur.

Dhe përnjëherë gjithë këtë pikturë thuajse e mori dikush në dorë dhe ia shqeu e theu para syve copë- copë. Ajo. Fqinja e mallkuar e mrekullueshme.

Si do t'ia bënte… Natyra s'po i hiqej mendsh. Tashmë e dinte se edhe ajo nuk ishte indiferente ndaj tij dhe pothuaj ishte lidhur me të.

Zot, kur e përfytyronte atë përqafimin e saj…atë puthjen e shpejtë në cep të buzës aty në park…

Ndonëse dritarja ishte e hapur, në dhomë bënte vapë e padurueshme. Bujari po vërtitej ende në shtrat i shqetësuar dhe shihte orën që shënonte katër pas mesnatës.

VIII

Besa u zgjua e trembur. Mezi merrte frymë, dhoma i dukej e panjohur. Ndjehej si në vakum, krejtësisht e çorientuar. Shikoi shpejt Bujarin, që po flinte qetë afër saj dhe iu duk i huaj, i panjohur. Zemra i rrihte aq shpejt e fuqishëm sa që e mbajti me dorë si zogun e frikësuar.

"O Zot, çfarë nate!" mendoi dhe u përpoq të qetësonte veten. Dalëngadalë gjërat në dhomë po merrnin format e tyre nën dritën e agut më të hershëm.

Pastaj iu kujtua ëndrra qe kishte parë. Dikush ia kishte ngulur një thikë në zemër, por ajo nuk kishte vdekur. E shihte veten tek përpëlitej nën dhimbjet më të tmerrshme, por nuk vdiste. Vetëm vuante pa skaj.

"Paska qenë ëndërr e tmerrshme,- mendoi,- shpresoj të mos jetë ndonjë paralajmërim për të keq".

U ngrit nga shtrati ngadalë dhe po ashtu ngadalë shkoi në banjë. Lau fytyrën dhe i ngriti sytë drejt pasqyrës. Sakaq imazhi i saj iu duk krejtësisht i huaj, i shëmtuar, i plakur, i verdhë dyllë. Disa rrudha dukeshin më kthjellët në atë verdhësi, sikur t'i kishe prerë me thikë.

" Nuk po e njoh dot as veten,- tha dhe i largoi sytë me shpejtësi nga pasqyra sikur të kishte parë aty fantazmën.- Personazhet që i shikoja dikur si të vjetër, si dikush që do të bëhemi ne, unë, dikur në të ardhmen e largët, sot shoh se janë te vetja ime, se nesër është sot. Pamjet e ardhmërisë që i shihnim nga e kaluara, bëhen të qarta para vetes sonë dhe neve na mbetet të ballafaqohemi me to si në duelin më të frikshëm. O, Zot!".

Gruaja u shikua edhe një herë në pasqyrë. Iu duk vetja si një pikturë e vjetruar, e dalë mode. Sikurse dikush e kishte harruar të varur në murin e ndonjë muzeu të vjetër dhe askush nuk ia hidhte sytë gjatë ditës. Ndërsa natën… natën mbetej krejtësisht e vetmuar. Pavetëdijshëm preku vendin ku e kishte shpuar thika në ëndërr. Dhimbja i dukej sikur ishte ende aty. Një dhimbje e thellë. Jo ajo e therjes, por një dhimbje e vuajtjes së përjetshme si në ferr.

Sapo doli nga banja, e pa Dorinën me pizhame në korridor.

- Mami, u zgjove? Si po ndihesh sot? E di që s'kam fjetur pastaj edhe dy orë të tëra? Më bëre të brengosem shumë sonte.

- Jo, jam shumë më mirë sot. Dorina, nuk dua të brengosesh për mua sa herë nuk jam mirë, moj zemër. Ne tani e kemi një farë moshe dhe natyrisht që ankohemi nga ndonjë gjë.

- Po, por shkuat te mjeku në mes të natës. Mendova mos është ndonjë gjë më e madhe.

- Jo, jo ishte tensioni i lartë. Shtypja ime e gjakut, pra. Nuk kam pasur kujdes në të kohëve të fundit. Prej sot do t'i kushtohem diçka më shumë.

- Oh, mami, kur i je kushtuar vetes ti? Ti gjithmonë je kujdesur për ne, ndërsa veten e ke lënë pas dore. Por shih si ia bëjmë: Unë e di një spital ku do të shkojmë së bashku për analizat, e? Kam ca miq të mirë aty.

- Spital? Ti? – e pyeti nëna me habi. – Po prej nga i njeh këta njerëz e këto spitale që thua?

- Ua mami, të tregoj ndonjëherë tjetër, pse tani po ngutem, mirë? Më premton se do shkojmë bashkë për analizat?

- Të premtoj.

- Mrekulli! Tani ika në kuzhinë, duhet të dal pas pak, – foli shpejt vajza dhe u humbi poshtë shkallëve.

Mëngjesi ishte akoma me shi. Dukej ditë e zymtë, njëra nga ato ditë që nuk të jep vullnet për asgjë.

- Mirëmëngjeeeeeeesi,- u dëgjua sërish zëri i Dorinës që po kumbonte korridoreve te shtëpisë. – Zgjohuni, o njerëz, është dita e re, tring , tring!- bënte shaka.

- Ç'ke me mëngjes që po bërtet ?- i tha Bujari që po zbriste shkallët duke rrudhur fytyrën nga zhurma.

- Kaloi dita, ndërsa të gjithë po flini; hajde, hajde, dua t'ju jap te gjithëve një të puthur para se të dal. Ndaj ju zgjova.

- Po pse? Ke ndonjë lajm të gëzuar?

- Jo, por duhet te shkoj në provim dhe me nga një të puthur, më duket se ju marr të gjithëve me vete, ja këtu në zemër.

- Oh, ç'na qenke poetike sot, – i tha Bujari përgjumshëm dhe e puthi ne faqe.- Hajde, ik tash se do të bëhem gati, do dal edhe unë

- Ku do shkosh, babi?

- Kam ca punë të rëndësishme.

- Më të rëndësishme se unë?

- Po pse e krahason çdo gjë me ty? Sa fëmijë që je, moj vajzë.

- Mirë, babi, mos u zemëro. Desha ta zgjas muhabetin edhe pak me ty, ngase... nuk e di, më kishte marrë malli të bisedojmë.

- Po ne do të shihemi pasdite. Shko e jep provimin njëherë.

- Ke të drejtë, – tha Dorina dhe e shikoi me buzëqeshje mirëkuptuese. – Mirupafshim, pra.

- Mirupafshim, shejtane.

***

Bujari, sapo doli nga banka, u skajua në një cep dhe numëroi edhe një herë paratë që i nxori nga libreza e kursimeve të familjes... Ishin tamam sa kishte menduar. Kishte më se një dekadë që kursenin për shkollimin e fëmijëve apo për ndonjë ditë të vështirë. Gruaja e tij kishte arritur që çdo muaj të ndante nga një shumë e ta dërgonte në fondin e tyre të kursimeve. Ato para kishin një histori, një jetë të tërë. Ndonjëherë i kishin shfrytëzuar ndonjë pjesë për pushimet verore, por bënte seç bënte gruaja dhe ia dilte t'i grumbullonte sërish në numrin e duhur. Ishte nikoqire e mirë, duhej ta pranonte këtë.

Por Besa nuk do ta vërente fare mungesën e atyre parave për një kohë, së paku derisa Natyra t'ia kthente. Po nëse do t'i duhej ndonjë gjë Diamantit? Nëse dilte ndonjë dasmë e paparashikuar? Si do t'ia bënte?

Mendoi pak dhe u kujtua. Do t'i thoshte se iu kanë dashur për librin e tij. Jo, këtë nuk do ta besonte, meqë librin e tij do ta sponsorizonte ai fondacioni; këtë e dinin të gjithë tanimë. Mirë, pra, do t'i thoshte se iu kanë dashur ndonjë shoku të tij. Por cilit? "Tekefundit,- mendoi,- vetë kam punuar për këto para, të miat janë! Derisa unë jam shkolluar e kam lodhur kokën me shkencë, ajo ka qenë në dhomë të ngrohtë. Të miat janë, bëj ç'të dua me to! Qysh sot do t'ia dërgoj Natyrës, edhe pse duhet t'i pres ata dreq gazetarë për atë intervistën rreth librit. Duhet t'i gënjej e tu them se sot s'jam gati. Do të mendoj në shtëpi si ta gjej një motiv të mirë për këtë, - vazhdonte të fliste me vete Bujari, derisa papritur i cingëroi telefoni në xhep dhe kërceu përpjetë i trembur. Ja, mendoi me buzëqeshje, edhe një marifet tjetër i Natyrës. Ia arriti të më bindë të mbaj celular, ndonëse e kisha zët më parë. Apo, më mirë të them, më bindi dashuria për të.

Kishte kohë që e kishte blerë telefonin celular dhe mezi mësohej me të. Bujari nuk ishte ndonjë tip që përqafonte shpejt teknologjinë e re. Ishte mësuar me vite të punonte në qetësi dhe ndodhte që gruaja e tij dhe fëmijët e hiqnin edhe kabllon e telefonit shtëpiak, për të mos e penguar cingërima e tij qoftë edhe nga korridori. Por, tani telefoni po i dukej më i vlefshëm se kurrë. Ishte si një mik, si një shok, që ia mbante ndryrë sekretet e tij, mesazhet që ia dërgonte Natyra dhe ato që vetë ai ia dërgonte asaj. Edhe pse me Natyrën gjërat ishin nxehur shumë, përsëri asnjëri syresh nuk e kishte pranuar hapur se kishin nisur tanimë një lidhje. Se kishin një dashuri. Bujari këtë ia linte turpërimit të Natyrës, ndërsa edhe vetë ngurronte t'ia pranonte vetes se ai tashmë kishte një partnere tjetër. Dëshironte ta kishte sa më parë, ta afronte në trupin e tij, të bashkoheshin fizikisht ashtu sikurse ishin shpirtërisht në një, por nuk mësohej dot me idenë se kishte një të dashur, kishte një aferë dashurie..

- Alo, ka kush andej? – dëgjoi zërin nga celulari dhe i ra ndërmend se kishte kohë që e kishte hapur.

- Po. Cili ju duhet?

- Ju jeni Bujar Spahiu? – pyeti zëri

- Po. Po ju kush jeni?

- Jemi nga policia rrugore. Keni lënë veturën në një vend shumë të keq. Po pengoni qarkullimin. Nëse nuk e merrni deri në mbrëmje, do të detyrohemi ta tërheqim me automjetin-bartës të policisë dhe atëherë, përveç dënimit, do të paguani edhe taksën e qëndrimit të automjetit.

- Po këtë numër ku e morët?

- Kishit lënë një copë letër të futur te dritarja, nuk ju kujtohet?

Bujari u drodh. Tani iu kujtua që e kishte shkruar atë natë me shi, duke menduar se makina e vendosur ashtu keq e keq mund t'i pengonte dikujt natën dhe e kishte futur në një cep të dritares, që të mund ta telefononin po t'u duhej. Nuk u drodh pse kishte bërë këtë, por ngaqë në vend të numrit të shtëpisë, kishte lënë padashur atë të celularit. Sigurisht gruaja nuk e kishte vërejtur, ajo as që e dinte se ky kishte celular, cingërimën ia kishte lënë vetëm në dridhje.

- Mirë, do të mundohem të vij menjëherë, kam vetëm edhe një punë për ta kryer rrugës.

- Ngutuni, ju lutem. Nuk pret puna.

"Dreq o punë,- mendoi Bujari.- E bëjnë kiamet, thuajse nuk mund ta shtyjnë pak". Pastaj u kujtua se veturën duhej ta çonte edhe tek automekaniku, pse frenat nuk punonin mirë. "Po shkoj njëherë deri në klinikë te Natyra e t'ia dorëzoj këto para. Pastaj po vazhdoj te vetura"- i dha karar.

Zuri një taksi dhe për gjysmë ore arriti para klinikës. Një veturë tjetër e parkuar e shtangu për ca sekonda. Ishte po ajo vetura e njëjtë, nga e cila kishte dalë Natyra atë ditë kur po e priste fshehtas, por tani nuk ishte askush brenda. Ndjeu se xhelozia po ia prishte mendjen. Të kishte kush brenda në klinikë? Çka nëse i zinte në ndonjë pozicion intim? Kush është ai?.. Oh nuk mund ta duroj këtë, duhet t'i shoh me sytë e mi!

U fut brenda fytyrëprishur nga dhembja. Nëpër korridore nuk priste askush, asnjë pacient. Iu duk e çuditshme kjo gjë, mos ishte sot ndonjë festë? Jooo, banka punonte. Eci deri në fund të korridorit dhe trokiti në derë. Priti pak sekonda dhe tamam kur po bëhej gati të hynte, u paraqit Natyra, më e bukur se kurrë. Për ca momente u ndodhën aq afër sa ia ndjeu parfumin. Iu drodhën këmbët.

- Mendova… mendova se nuk je vetëm.

- Në klinikë nuk mund të jesh asnjëherë vetëm, pacientët të vërsulen në çdo moment, ndonjëherë të bezdisin me ankesat e tyre dhe mendojnë se ua ke për borxh të merresh me ta. Ja, dje njëri me shqelmoi derën.

- I poshtri, – shfryu Bujari me pezëm.

- Po. Dhe e përzura, nuk e kontrollova fare, ndonëse priste aty gati për një orë. Çfarë mendoi ai, se për atë pagese gati simbolike unë do bëhem skllave e tij? Eh,- shfrente ajo,- po ne mjekët a kemi shpirt, a kemi zemër, a kemi kërkesa, nevoja, kush duhet të mendojë për ne?

- Unë mendoj për ty... .

Natyra e shikoi ëmbël, si një kotele.

- Të kam sjellë paratë, Natyra. Janë të gjitha kursimet e mia. Bëj çfarë ke për të bërë dhe filloja procedurës për ndarjen. Mos humb më asnjë sekondë.

- Por... duhet kohë derisa të t'i kthej...

- Nuk ka gjë, do të pres.

- Oh, Bujar, je i mrekullueshëm.

Natyra u kthye nga dritarja dhe iu duk se po fshihte lotët. Ndenji ca ashtu, ndërsa Bujari i ulur në shtratin e të sëmurëve, u koncentrua në siluetën pas saj. Dalëngadalë mori një pozicion gjysmë të shtrirë. E fiku celularin, nuk donte ta shqetësonte cingërima e tij së paku këtë kohë që ishte me të adhuruarën e zemrës.

Natyra edhe e kthyer kah dritarja, dukej shumë joshëse. Uniforma e saj dypjesëshe ishte mbështetur për linjat e saj sikur të ishin përqafuar, ishte shkrirë me to. Trupi i dukej sikur ta kishte skalitur ndonjë skulptor dhe ai po i pushonte aty sytë duke e shikuar. Filloi ta kaplonte një ngrohtësi në tërë trupin dhe ndjente një shtrëngim të padurueshëm në bark. Bëri të kthjellej, por truri kishte kohë që nuk po e dëgjonte, duart i djersinin, ndërsa shpirtin e kishte krejtësisht të trazuar. Ndjehej i paralizuar sikur ta kishin lidhur për shtrati, ndërsa ai ndonëse mundohej, s'mund të bënte asnjë lëvizje. Ky kombinim i dëshirës së zjarrtë dhe pamundësisë, filloi t'ia humbte arsyen.

Natyra ngriti edhe një herë dorën, duket se fshinte akoma sytë e përlotur. Nuk ia shihte dot fytyrën.

"Do vish afër meje? – e pyeti Bujari ngadalë. - Kam nevojë për ty, të lutem mu afro", – i lutej me gjysmë zëri. Ajo akoma s'po e kthente kokën.

Bujari ishte shumë i shqetësuar. Ndjente të rrahurat e shpejtuara të zemrës pa e prekur me dorë. Mendja i ishte turbulluar.

Befas ajo hoqi kopsën e flokëve dhe lëshoi flokët e gjatë. Ai e pa si i hipnotizuar. Ajo u kthye ngadalë dhe po i afrohej pa fjalë. Në sytë e saj shiheshin gjurmët e lotëve të përziera me një seriozitet, pasion dhe vendosmëri. Arriti deri te cepi i shtratit dhe e u ul skaj tij. Bujari mendoi se do ngulfatej, mezi merrte frymë nga tundimi. Natyra filloi të zbërthente pullat e bluzës duke mos ia shkëputur sytë. Ngadalë hoqi pjesën a sipërme të uniformës dhe sakaq flokët iu derdhën mbi lëkurën e butë të trupit. Ishte sikur një hyjneshë…

Pastaj u përkul dhe e puthi. Bujarit i dukej se iu ndal fryma, se kishte vdekur. E shikonte si i paralizuar. Flokët e saj i ishin shpërndarë edhe nëpër trupin e tij. Ngriti duart dhe e preku, e përqafoi fuqishëm, thuajse nuk donte ta linte t'i ikte më kurrë. Ia ledhatonte shpinën, kraharorin. Pastaj kapi me dy duar kokën e saj dhe e afroi te e vetja. Ndjeu duart e saj që po hynin nën këmishën e tij dhe po ia zbërthenin kopsat. Bujari e kishte humbur ndjenjën për kohë, hapësirë. Asgjë më nuk ndjente pos trupit të Natyrës që po fërkohej me të tijin. Asgjë më nuk kishte rëndësi. Mund të vdiste, mund të jetonte… ishte një shpirt që sapo kishte hyrë në dyert e parajsës dhe lumturia i dukej e përjetshme.

Me sy gjysmë të mbyllur shikonte Natyrën, e cila përdridhej si ngjalë në gjoksin e tij. Kishte një trup të përkryer… ishte… o perëndi… më duket se po vdes nga lumturia…

Dy shpirtra u bënë një diku në hapësirë.

***

Për ca minuta Bujari duket se e kishte humbur vetëdijen. Ishte fare i dërrmuar dhe nuk mundej as t'i hapte sytë, as të lëvizte. Kishte mbetur i humbur si në ekstazë.

- Ke ndërmend të ngrihesh apo do flesh aty? – befas ndjeu zërin e butë të Natyrës.

Nuk dinte sa kohë kishte kaluar, sa kohë kishte qëndruar aty i shtrirë. Mund të kishin kaluar shumë orë, nuk i kujtohej asgjë, sikurse sapo kishte dalë nga një trans i fuqishëm.

Ktheu kokën ngadalë dhe e pa Natyrën të veshur si zakonisht dhe të kthyer kah dritarja. Po shikonte diku jashtë.

"Sa kohë paskam mbetur i shtrirë? Kur qenka veshur kjo? Nuk më kujtohet asgjë"-, befas ndjeu se e kishte dorën e tij brenda këmishës së shkopsitur dhe e hoqi menjëherë. Si kishte humbur kështu? Si i dehur, si i përgjumur... Mundohej të sillte ndonjë gjë nëpër mend, por, pos trupit të Natyrës që bashkohej me të tijin dhe një ekstaze marramendëse, asgjë më nuk i kujtohej.

Shikoi kah Natyra, por ajo nuk po lëvizte; qëndronte po aty pranë dritares. Nuk ia shihte dot fytyrën.

"Të ketë qenë kjo gjë vetëm ëndërr?", mendoi dhe u tremb." Duket thuajse Natyra s'ka lëvizur fare nga ai vend qysh para se... Jo, jo nuk është e mundur, ai e kishte ndjerë, ai e kishte prekur, ai, ai... kishte bërë dashuri me të... apo? Apo jo? Mund të betohej se akoma ia ndjente erën e lëkurës së saj, ndonëse shqisat i kishte akoma të bllokuara. Akoma i ndjente buzët e saj në të tijat,- dhe preku pavetëdijshëm buzët. Mos ishte vetëm iluzion kjo? Bujari u përpoq me të gjitha forcat të përqendrohej, të kthjellohej, por përveç imazhit të Natyrës së përkulur sipër tij, më nuk i kujtohej asgjë tjetër.

E shikoi Natyrën mos po gjente ndonjë përgjigje në fytyrën e saj, por ajo po shikonte akoma diku larg, përtej dritares. Edhe flokët i kishte të mbledhur sërish.

" Po çmendem", mendoi Bujari.

Njëherë u mat ta pyeste, por ndaloi. Si do t'i thoshte, si do ta pyeste?. A mund të ketë një pyetje për këto gjëra? Po nëse nuk ka ndodhur fare? Po sikur të ngrihej, t'i afrohej nga mbrapa e ta përqafonte? Jo, mund ta trembte dhe mund të reagonte keq. Natyra do të mendonte se ai është i çmendur, se është ndonjë psikopat, se është një posesiv, maniak seksual e të tjera si këto. Atëherë mund edhe të ftohej nga ai e të ikte, të ikte përgjithmonë, mos ta shihte më kurrë. Jo, jo një gjë e tillë ishte e papërballueshme. Dreq o punë! mendonte Bujari". Por kjo ka ndodhur, ka ndodhur, s'ka si të jetë ndryshe, si mund të përjetojë njeriu gjithë këtë ndjenjë vetëm si vegim? Ka ndodhur, ka ndodhur! Pastaj kur unë jam përfjetur pak, ajo është ngritur, është veshur, ka mbledhur flokët dhe ka shkuar te dritarja. Ka ndodhur...

- Jam i sigurt që ka ndodhur,- e dëgjoi zërin e tij të lodhur e plot dyshime, që po i dilte nga buzët pa i urdhëruar.

- Çfarë ka ndodhur? – dëgjoi një zë burri që hyri në derë. Bujari kërceu në këmbë. I dukej se sapo u zgjua nga një ëndërr. Në derë po qëndronte Shpëtimi me fytyrë të ngrysur si mos më keq. Dukej gati i tmerruar. Në atë çast Bujarit iu kujtua se Natyra as nuk e kishte mbyllur derën me çelës. O sa turp nëse i kishte parë, çfarë do të bëhej tani? pyetej Bujari.

- Duket ka ndodhur një grindje në rrugë, ka kohë që po zihen mes vete, – tha Natyra duke mos ia shkoqitur sytë dritares dhe pa e kthyer fare fytyrën për këndej.

"Grindje? Tërë kohën ajo paska përcjellë një grindje? Po sytë e përlotur, po ndjenjat?, luftonte ende me meditimet e tij Bujari.

- Po them çfarë ka ndodhur me Bujarin, e kontrollove apo jo?- ia priti ftohtë Shpëtimi dhe pa pritur përgjigjen e saj shtoi:

- Bujar, duhet të flasim, kam diçka për të të thënë.

Bujari ndjeu se po e lëshonte toka. Shpëtimi e paskësh kuptuar tradhtinë. Mundet edhe t'i kishte parë me sy. Tani do të merrej vesh gjithçka, do të bëhej skandal. Gruaja, fëmijët, studentët. Bujari zuri veshët me duar, iu duk se po dëgjonte gjithë qytetin duke pëshpëritur për të.Tani Shpëtimi do t'ia përplaste të gjitha në fytyrë, ndoshta do të provonte ta ofendonte, natyrisht që do ta përbuzte.

Do t'i duronte të gjitha, do t'ia tregonte të vërtetën, do të provonte të merreshin vesh me fjalë. Bujari po mblidhte mendimet. Pastaj u përpoq të merrte pamje indiferente dhe i tha:

- Fol, Shpëtim, çfarë deshe të më thuash?

- Bujar, eja të dalim jashtë më mirë.

- Mund të bisedojmë edhe këtu.

- Më dëgjo, eja, kam nevojë për ajër dhe… mund të kesh nevojë edhe ti.

Eci pas tij. Arritën jashtë në oborr dhe Shpëtimi i tha të ulen në një bankë druri.

-Bujar, nuk po gjej ndonjë mënyrë të lehtë për të ta thënë.

- Çfarë është? Thuaje më!- tashmë e kishte humbur durimin.

- Dorina, Bujar!

Bujarit iu mjegullua të parit. Prit, prit, çfarë hynte tash Dorina në këtë mes, çfarë po i thoshte Shpëtimi, pse Dorina… - ndjeu se zemra po i tkurrej.

- Ç'ka Dorina, Shpëtim, ku është, çfarë hyn ajo tani këtu?- pyeste pa u ndalur sikurse donte të parandalonte atë që ia ndjente zemra se ka për ta dëgjuar.

- Ulu njëherë, Bujar.

- Nuk dua të ulem. Thuaje më! Ku është Dorina, të pyeta!

- Bujar, bëhu i fortë! Dorina… Dorina është në spital…

- Pse? Çfarë ka ndodhur, është e sëmurë? Mos e ka sulmuar kush, si është tani, është më mirë? Më thuaj se është më mirë, të lutem, – dëgjoi zërin e vet të përvajshëm që po i lutej Shpëtimit, ndërkohë që po e shkundte nga krahët.

- Ajo… ajo është në morg.

Bujari e shikonte tejpërtej.

- Si në morg? Çfarë bën ajo aty? Pse në morg? Pse në morg, o Shpëtim?- vazhdonte ta tundte akoma nga krahët derisa burri s'po bënte asnjë lëvizje për t'u mbrojtur.- Çfarë kërkon ajo në morg… jo, prit,…. s'ka pse shkon Dorina në morg…. ndoshta ka shkuar sepse dikush ka vdekur…..- fliste shkëputur dhe u ngrit e zuri të ecte sa andej-këndej si i humbur.

Shpëtimi mezi po i përmbante lotët .

-Dorina, Dorina ka vdekur, Bujar. Sot, pasdite. Ka pasur një aksident.

- Jooooooo! – ulëriti Bujari dhe e kapi për gryke. Mos më thuaj se ka vdekur, more vesh? More vesh, ore i poshtër? Vajza ime nuk mund të vdesë, nuk bën të vdesë, nuk ka vdekur, e kuptove? Pse më thua kështu, pse më mundon? Je në vete… - Bujari vazhdonte ta grushtonte Shpëtimin, përderisa ai po e mbante me të dyja duart, ndërsa faqeve i rridhnin lotët si përrua.

- Zot, ku je, mos, mos më braktis… Jo foshnjën time…jo…jo... merrmë mua, ma merr shpirtin, të lutem… jo foshnjën time… jo Dorinën… mos ma kthe shpinën, perëndi, mos më le të jetoj, të lutem… jam në ëndërr, më thoni se jam në ëndërr… jo kjo s'po ndodh tani… nuk është e vërtetë... ja, do të zgjohem tani… jo, më thuaj se nuk është e vërtetë…- fliste Bujari i përgjunjur në tokë dhe ktheu kokën kah Shpëtimi, me shpresë mos po zinte ndonjë shenjë se e tëra kishte qenë e pavërtetë, se do t'i thoshte çdo gjë është në rregull. Por Shpëtimi ishte bërë dyllë. Dhe tmerri që ia kishte kapluar fytyrën, e bëri Bujarin të përballej me të vërtetën e tmerrshme.

Ndjeu se po i merrej fryma dhe humbi ndjenjat. Iu duk sikur po binte përsëri në humnerë. Po tretej në një errësirë të pakufishme dhe binte…binte…

" Do të të vras,- i thoshte hija… - do të të vras duke të vrarë atë që është më e çmueshmja për ty"…

"Po kush je ti", e pyeste Bujari me dhimbje …

" Jam ti, ta kam thënë…

" Unë nuk jam më, ti tashmë më ke vrarë…"

" Ti ke vrarë. Ti je vrasës. Vrasës"...

IX

U përmend. Sytë iu ndeshën me tavanin. Kuptoi se ishte në shtëpinë e tij. Shikoi orën në mur, ishte mbrëmje. "O Zot, gjithë ky ankth!" mendoi me vete.

Tani do të vinte Dorina si një flutur, do ta përqafonte dhe do të shkonte te pianoja e saj. Ja, prit, më duket po dëgjohen notat e saj… jo… jo, duket si këngë… si ninullë, apo si vaj? Duket se dikush po vajton… Po pse?

Bujari u ngrit. Në kokë iu kthyen ngjarjet e ditës, banka, paratë, Natyra. Nuk ndjente asnjë emocion për këto. Por, çka ishte edhe diçka, diçka e keqe, diçka që po i gërryente zemrën dhe po ia shponte lukthin si me thikë.

Dorina, ku është Dorina… Çfarë i kishin thënë për Dorinën?..- vazhdoi të ecte deri në dhomën tjetër.

Pastaj u shtang. Dhoma e qetë e ndejës kishte pamje të tmerrshme.

Gruaja e tij qante dhe e mbanin për krahësh motrat e saj, tezet e Dorinës. Dikush u kujtua t'ia jepte një injeksion. Herë humbej, herë kthehej. Dukej sikur ishte dikush tjetër, si e çmendur.

Në dhomë kishte shumë njerëz të veshur me rroba në ngjyra të errëta dhe me fytyra të ngrysura. Pse kishin ardhur? Çfarë po kërkonin këta njerëz këtu? Dorina tash do vinte dhe çdo gjë do të kthehej si kishte qenë.

Të gjithë e shikonin sikur kishin parë fantazmën. Ja, paska ardhur edhe Shpëtimi, shokët e shoqet e fakultetit, – mendonte Bujari si nëpër mjegull.- Por, pse kanë ardhur këta njerëz, pse? – vazhdonte të pyetej me vete duke refuzuar ta pranonte të vërtetën. Me një çast ia zuri syri Diamantin. Ishte ulur në një karrige dhe qante i heshtur. Mimoza me sy të skuqur i jepte kurajë. Kur e pa babanë, u ngrit, e përqafoi dhe u shkreh në vaj. Po pse po qante kështu djali i tij?

Ecte si nëpër mjegull dhe kërkonte me sy Dorinën. Pse s'po e shihte? Ku ka bredhur? Tash do të vinte, tash… ja edhe pak… heshtni, njerëz… shkoni në shtëpi… prit, pse s'po duket më Dorina?

Grumbulli i njerëzve u hap dhe Bujari ngriu. Zgurdulloi sytë si i çmendur, ndërsa ndjeu se zemrën po ia shqyenin hijenat më të tmerrshme në botë. Para syve iu shfaq imazhi i Dorinës së vdekur, të cilën e kishin vënë në mes të dhomës.

Nuk po ndjente më asgjë. As zëra, as dhimbje. As shihte njerëz, asgjë. U përkul afër bijës së tij. Ajo dukej si e fjetur. Flokët e butë i kishin rënë anash, ndërsa në buzë kishte një buzëqeshje si një trëndafil të bardhë. Dukej se tani do t'i hapte sytë. Do bërtiste dhe do thoshte: Aaaaaaaaaaaaaaaaa- ha, ju zura, bëra shaka, ju frikësova, a- ha!

Fytyra i kishte marrë një ngjyrë të panatyrshme, ndërsa shiheshin ca gjurmë të gjakderdhjeve të brendshme anash faqeve.

Bujari ia përkëdheli flokët dhe u struk afër saj. U bë kruspull. E përqafonte, ia puthte duart. Por, ajo... ajo nuk lëvizte. Ishte aty, por nuk fliste, nuk bënte nga ato shakatë e përhershme me të. Kishte fluturuar.

Dhe pastaj ndjeu se nga gryka i doli një oshtimë, një bërtitmë, çjerrje, ulërimë… si një kafshë e plagosur për vdekje.

Humbi ndjenjat përsëri.

Dikush po hidhte ujë mbi të dhe ai hapi sytë. Ku jam? Jo, nuk dua të zgjohem.

- Të lutem, përmblidhu, Bujar, duhet të jesh i fortë. Kanë ardhur edhe policia… - zëri i Shpëtimit i dukej sikur vinte nga largësia.

U ngrit në këmbë duke u mbajtur për të deri te një kolltuk. Karshi tij rrinin dy policë, të vrenjtur në fytyrë. Njëra ishte femër, një vajzë e re, pak më e madhe se Dorina. Kishte sy të përlotur. Nga dhoma tjetër ndjehej vaji i pikëlluar që të këpuste shpirtin.

-Zotëri, pranoni ngushëllimet tona, humbja juaj është shumë e madhe,- i tha policja.- Vërtetë është e vështirë, por na duhet të marrim ca shënime, duam t'ju tregojmë si ka ndodhur, dhe t'ju bëjmë ca pyetje.

Bujari rrinte para tyre si i ngrirë, pa kuptuar mirë se çfarë duhej të bënte për ta.

- Zotëri,- nisi t'i thotë polici,- bija juaj ka pësuar aksident për shkak të frenave të prishura të veturës suaj. Ajo kishte shkuar ta marrë veturën, që e kishit parkuar gabimisht në rrugë. Pas thirrjes së parë që ju kanë bërë policia rrugore në celular, ju nuk e keni kryer obligimin, ndaj kanë gjetur numrin tuaj shtëpiak në librin telefonik. Është lajmëruar Dorina dhe ka pranuar thirrjen tonë të fundit për tërheqjen e veturës. Ka kërkuar të presim edhe për pak kohë. Ju kanë thirrur në celular, por ju e kishit fikur. Pastaj bija juaj, si duket ka dashur t'ju kursejë,dhe është nisur vetë për ta tërhequr veturën, por si duket nuk ka pasur dijeni se frenat janë të prishura. E ëma nuk ka qëlluar në shtëpi për ta paralajmëruar, pasi, siç thotë edhe ajo, Dorina kur kishte dalë në mëngjes për të shkuar në provim dhe kishte njoftuar se do të kthehej në mbrëmje. Si duket është kthyer më herët dhe...

- Pasi e ka lëvizur veturën, - e vijoi policja bisedën e kolegut të saj,- disa qindra metra më tutje ka ndodhur tragjedia. Një nënë me të bijën për dore po shkonin rrugës dhe papritur fëmija e ka lëshuar dorën e së ëmës e është derdhur në rrugë, mu përpara veturës suaj. Dorina ka dashur të frenojë menjëherë, por frenat nuk kanë mbajtur dhe ajo... si e ka kuptuar se frenat kanë defekt, me shpejtësi vetëtime ka devijuar djathtas; vetura është shmangur nga rruga dhe ka përfunduar në rrëpirë, disa metra poshtë. Vajza juaj e shpëtoi një fëmijë nga vdekja e sigurt, por mjerisht iku vetë. Fëmija ka pësuar një traumë, tani ndodhet në spital, por ka shpëtuar jetën, ndërsa...

Bujari po e dëgjonte i vdekur përbrenda.

- Pas hetimeve të para konstatuam se e gjithë kjo tragjedi nuk është shkaktuar nga vozitja e pandërgjegjshme, por nga frenat e prishura të veturës suaj. Më së pari menduam se, meqë Dorina ishte vozitëse fillestare, kishte bërë ndonjë gabim. Por jo, ajo e kishte çuar veturën shumë mirë, por e kishin tradhtuar frenat. Tanimë, nga vetura s'ka mbetur asgjë.

"Frenat!..,- Bujarit iu kujtua nata kur shkuan me Besën në spital…,- Po, po, frenat"... ….paskam harruar… edhe veturën e kam harruar….".

- Frenat e kanë vrarë!- tha befas duke u çjerrë si bishë: - Unë paskam faj, o perëndi çfarë paskam bërë!.. Unë… po t'i kisha rregulluar frenat, kjo nuk do të ngjante… po ta kisha tërhequr veturën me kohë… nuk do të ngjante… unë jam vrasës, më burgosni, më vrisni… - u shkreh në vaj.

- Ju lutem, qetësohuni. Nuk është faji juaj. Ka qenë e shkruar të ndodhë kështu. Disa gjëra përputhen nganjëherë aq keq në jetë. Pastaj tragjeditë rrugore ndodhin çdo ditë. Por, pasi ra fjala, ku ishit ju në atë kohë, pse nuk erdhët ta merrnit vetë veturën?

- Po, vërtetë, ku ishe ti Bujar? – dëgjoi zërin e Besës, e cila rrinte mbështetur në skaj të derës. Fytyra e saj dukej e çnjerëzuar.- Të gjithë të kanë kërkuar për punë të makinës. Ku ishe ti?

- Unë… unë… po vrisja bijën time.

***

Në varrim kishin ardhur me qindra njerëz për ta përshëndetur për herë të fundit artisten e re, vajzën, shoqen. Dikush mbajti një fjalim rasti, të tjerët qanin, dikush hidhte një lule mbi arkivolin e saj.

Bujari i ndiqte fare i përhumbur. Në mes të gjithë asaj turme, sytë i zunë një grua që po qante me ngashërim. Nuk e njihte, nuk i bëhej ta kishte parë kurrë. Ia kishte shtrënguar dorën fort së bijës, ndërsa sytë e përlotur nuk po i ndante nga arkivoli i Dorinës.

Bujari e ndali për pak çaste shikimin mbi të dyja, dhe mendoi se nuk i njihte, nuk i kishte parë kurrë në rrethin e tyre, as për të mirë e as për të keq, siç thuhet; pastaj u mbështet në gruan e tij, e cila ia kishte vënë krahun në rrugën e fundit të bijës së tyre. Besa, edhe pse e përhumbur dhe gati pa ndjenja, mundi t'i thotë të shoqit se ajo fëmijë që e mbante e ëma për dore kishte qenë para veturës së tyre kur e ngiste Dorina; ajo ishte pra fëmija që e kishte shpëtuar bija e tyre nga vdekja e sigurt. Një of! i thellë u doli të dyve njëherësh nga gjoksi, nga shpirti. Ishin prindër, dëshmitarë të momentit të kobshëm kur bija e tyre po e linte këtë botë, ashtu siç kishin qenë po ata që e sollën në jetë.

Në shtëpi kishte rënë zija. Njerëzit hynin e dilnin, ngushëllonin, sillnin diçka, cigare a kafe, sipas zakonit. Secili komentonte në mënyrën e vet dhe thoshte se kjo vdekje kishte qenë shumë e rëndë dhe tronditëse.

- Ka qenë si engjëll,- thoshte një shoqe e Dorinës. Nuk i duronte vuajtjet e njerëzve. Bënte çmos të ndihmonte aty ky mundte.

- Është e vërtetë. Madje jo vetëm vuajtjet e njerëzve, por të çdo gjallese. Unë mbaj mend si një herë rrugës kah shkonim në një ditëlindje, Dorina e pa një mace që e kishte lënduar këmbën dhe që ishte strukur në një qoshe. U ndal, e mori dhe e dërgoi në veterinari. Kot e lutëm mos të na humbte kohë. Ajo na tha: " Shkoni ju, unë vij më vonë"- shtoi një vajzë tjetër që kishte fytyrën e skuqur dhe sytë e ënjtur nga të qarët.

Bujari po i dëgjonte i përhumbur. I dukej se po flisnin për dikë tjetër, jo për bijën e tij. Ndoshta kjo ishte ëndërr, ndoshta nuk po ndodhte me të vërtetë. Po atëherë pse po e ndjej gjithë këtë dhimbje?, mendonte. Pastaj u dëgjua zëri i mbytur i një gruaje dhe, kur e pa më mirë përmes mjegullës së lotëve, Bujari vërejti në të gruan që kishte parë gjatë rrugës për nga varrimi. Vajza e vogël gati po fshihej pas saj.

- Dorina shpëtoi vajzën time nga vdekja e sigurt,- po thoshte gruaja përmes ngashërimit.- Jam e bindur që e ka ditur se vetë po shkonte drejt humnerës. E gjitha ndodhi vetëm për disa sekonda. Vajza ime pesëvjeçare ma lëshoi dorën dhe vrapoi në rrugë. Më lëshoi toka. Po shihja me sytë e mi vdekjen e bijës sime. E kam fëmijë të vetëm, – tha gruaja dhe këtu zëri iu mbyt nga vaji. Pastaj fshiu sytë dhe vazhdoi:- Dorina ma dha prapë bijën time, por vetë... ah vetë. Dorina do të jetë gjithmonë engjëlli ynë mbrojtës, do t'i jemi mirënjohës përjetësisht.

Bujari i shikonte i përhumbur. Fytyra e gruas i dukej si e një fëmije të frikësuar, të mbledhur kruspull. Kishte humbur ndjenjën për kohën, për masën. Dhe pastaj ra në një përhumbje të thellë, sërish:

Dhoma ishte plot me njerëz të huaj, që ia përkëdhelnin flokët dhe i buzëqeshnin dhimbshëm. Dikush ia rrihte krahët, dikush i falte ndonjë bonbone a ëmbëlsirë, por ai nuk e kuptonte çfarë kishte ndodhur, pse kishin ardhur këta njerëz? Ai donte vetëm një përkëdhelje, atë të nënës së tij, që nuk po dukej.

- Eja Bujar, - i kishte thënë i ati, – tani duhet të përshëndetesh me nënën për herë të fundit. Mos qaj, ti tani je burrë!

"Ku po shkonte nëna tani? Po udhëtonte larg te tezja përsëri? Pse po shkonte vetëm, pse nuk po e merrte edhe atë me vete?"- mendonte djaloshi dhjetëvjeçar.

- Do të kthehet nëna pastaj? – e kishte pyetur të atin, por nuk kishte marrë përgjigje.

Në dhomën e madhe, siç e quanin, e kishte marrë tezja .

- Eja, djali im.

Nëna ishte shtrirë në mes të dhomës. Bujari mendonte se kishte fjetur. Pse nuk po zgjohej më? Ai donte t'i ulej në prehër si gjithmonë…

Ishte e bukur, shumë e bukur. Por dukej se kishte shumë ftohtë.

Pastaj erdhën ca burra dhe e morën nënën. Gratë filluan të qanin, nisën të vajtonin. Të gjithë dolën jashtë, pos Bujarit. Atë e kishin harruar dhe ai,… ai kishte mbetur vetëm.

- A thua nëna nuk më do më? Kam qenë djalë i keq dhe ajo nuk do të më shohë më?

Bujari vrapoi në oborr.

- Zgjohu nënë, do të jem i mirë, zgjohu! Asnjëherë më nuk do të lahem në lum… zgjohu, nënë…nuk do të vij i lagur, as i ndyrë… më fal…- i rrokulliseshin lotët faqeve të njoma.

Ca plaka e larguan dhe ai mes trupave të tyre të shtrembëruar, shihte tek e braktiste përgjithmonë e ëma, ajo që i kishte dhënë frymën .

"A do më braktisin kështu të gjithë ata që i dua?- kishte menduar ato çaste djaloshi i përlotur.- Do të mbes i vetmuar, i harruar nga të gjithë. Mu kthe, nënë, nuk do bëj më gabime, nuk do bëj… mos më lër… mos më lër…

……

- Baba! Çohu, kemi nevojë të flasim,- dëgjoi një zë të largët.

Bujari u trand. Cili baba? Ku është babai... - iu duk se pa fytyrën e të atit para sysh.

- Baba, kthjellu! Duhet të përmbledhësh mendjen dhe forcat, na duhesh tani më shumë se kurrë.

Zgurdulloi sytë sikur donte të shihte nëpër atë mjegull të dendur. Diamanti i kishte kapur dorën.

- Baba, duhet të flasim për ceremonitë mortore. Jemi mbledhur në dhomën tjetër. Edhe nëna po të pret.

Bujari u ngrit dhe eci pas tij si i hipnotizuar. Rreth tavolinës ishin mbledhur disa familjarë më të afërt, pastaj Besa, Shpëtimi dhe Diamanti me Mimozën. U ul i heshtur.

- Bujar, - foli gruaja, - duhet të tërheqësh nga banka kursimet tona, na nevojiten për përgatitjet e tjera pas varrimit, për drekën e për pllakën përkujtimore dhe njëkohësisht t'ia kthejmë Shpëtimit paratë që na i huazoi rreth varrimit. Nuk kishim kohë t'i nxirrnim nga banka. Eh, kemi kursyer për shkollimin e saj dhe tani na duhet t'i përdorim për… për….- u ndal sikur do të çirrej me të madhe, por pastaj u përmblodh dhe vazhdoi: për vdekjen e saj. Nesër shko dhe nxirri.

Bujari u shkund sikur dikush t'ia kishte futur një shuplakë të fortë.

"Paratë….Zot, paratë… i kishte Natyra… si t'ia bënte… o çfarë kishte bërë!... "- dhe pastaj u kujtua: " Po Natyra ku ishte gjithë këtë kohë? As kishte ardhur, as ishte kujtuar, as e kishte ngushëlluar. Si është e mundur? Si ia kishte bërë këtë kur i duhej më së shumti? Do të shkoj tash menjëherë tek ajo. Duhet të m'i kthejë paratë, paratë e Dorinës, o Zot!!!.".

- Ti, Diamant, do të presësh ngushëlluesit, ndërsa unë do të merrem me të gjitha përgatitjet e tjera, - i tha Besa të birit dhe pastaj filloi të merrej vesh me familjarët e tjerë rreth obligimeve.

Bujari e ngriu shikimin drejt saj. Iu duk krejtësisht tjetër. Fytyra i kishte marrë një pamje të shtrembëruar në dhimbje, por të fortë. E veshur e tëra në të zeza, kishte bërë që vijat e fytyrës së saj të dukeshin më të theksuara se zakonisht. Dukej e përmbledhur, e matur dhe e fuqishme. Për herë të parë ai u ndje i vogël afër saj, fare i vogël.

***

Kaherë kishin ikur të gjithë. Bujari e kishte humbur orientimin me kohën. Ndoshta kishin kaluar ca orë, ndoshta ca ditë... e çfarë rëndësie kishte më koha për të. Asgjë nuk kishte më rëndësi për të, pas ikjes së Dorinës. U ngrit dhe, vjedhurazi, pa u vërejtur nga askush, doli në rrugë. Ecte me hapa të pasigurt dhe nuk vërente askënd. Vetëm hije, hije…

"Duhet të arrij sa më shpejt. Duhet të marr paratë. Nuk bën ta kuptojë askush çfarë kam bërë. Tani do t'i kem, ja edhe pak, edhe pak….".

Iu duk një shekull derisa arriti. Po këmbët, në vend që ta çonin në klinikë, e kishin drejtuar te shtëpia e Shpëtimit. U ndal dhe po hezitonte të trokiste, vallë do të ishte në shtëpi vetëm Natyra apo edhe Shpëtimi? Nga dera nuk dëgjohej asgjë. Ishte fare i mpirë dhe nuk kishte fuqi as të mendonte e as të arsyetonte. Mori frymë thellë dhe, instinktivisht, i ra ziles. Qetësi. I ra edhe një herë pak më gjatë.

Në derë u duk Shpëtimi.

- Bujar! – u habit komshiu dhe pastaj menjëherë vazhdoi:- Urdhëro, mik, eja brenda. Më fal, u vonova në derë. Kisha dremitur pak dhe...

- S'ka gjë.,- tha i dërrmuar Bujari.

- Eja, mirë bëre që erdhe; do pimë nga një kafe, ke nevojë të heqësh pak nga ajo atmosferë.

- Je vetëm?- e pyeti Bujari menjëherë.

- Po, natyrisht, pse pyet?

- Jooo, veç ashtu, kot…

U futën brenda.

Apartamenti ishte shumë i bukur. Çdo gjë ishte e rregulluar me shije. Mbi oxhak radhiteshin fotografitë e anëtarëve të familjes, fëmijët me uniforma shkolle, familja e lumtur në det, në borë duke skijuar, ndërsa në vendin kryesor ishte fotoja e një gruaje shumë të pashme, me flokë të derdhura valë-valë, e cila mbante një foshnje në dorë. Askund nuk dukej portreti i Natyrës.

- Dëshiron një gotë të vogël raki njëherë? E kam të shtëpisë.

- Po mirë, - uli krahët Bujari .

- Si jeni kah shtëpia, u forcuat paksa?

- Është vështirë… por, të falënderoj që je gjetur me të gjitha. Edhe me paratë.

- As mos e thuaj! Ku kishit kohë për bankat ju! Asgjë nuk është, fare mos u ngut me to.

- Jo, jo do të t'i kthej këto ditë, të faleminderit. Nuk di si do t'ia dalim me dhimbjen…

- Do t'ia dilni, Bujar, e di se do t'ia dilni. Je me fat, ke afër vetes njerëz të fortë, njerëz që të duan. Tani i duheni njëri-tjetrit më shumë se kurrë. Dorina është ende mes jush dhe do jetojë në kujtimet tuaja, – u përlot edhe ai.- Më duket se ende e shoh, ia dëgjoj të qeshurat, pianon… Bujar, jeni me fat që keni pasur mes jush një engjëll të tillë për aq kohë sa e lejoi perëndia.

- Po, perëndia na e dha e na e mori. E luta të ma merrte shpirtin, por ai më mori gjënë më të shtrenjtë,- tha me dhimbje Bujari.- Asgjë më nuk do të jetë si ka qenë, Shpëtim. Me Dorinën ka vdekur edhe pjesa ime e hareshme.

- Mos thuaj ashtu, të gjithë njerëzit pësojnë humbje. Edhe unë kam humbur gruan, dashurinë time të jetës, – ktheu shikimin për një copë herë kah fotografia. – E kam dashur më shumë se veten time, kemi jetuar një jetë të mrekullueshme, edhe pse në atë kohë isha gati i varfër, student. Erdhën fëmijët, telashet, studimet… ajo ishte gjithmonë aty për ne, na e paraqiste folenë e ngrohtë. Pastaj mu kur u stabilizuam, fëmijët gjetën rrugët e tyre, u pasuruam me mund e djersë, krijuam të gjitha kushtet për një jetë të lumtur. Mu atëherë …- Shpëtimi u kredh në mendime,- për një moment, thjesht përfundoi gjithçka. E humbëm. Çdo plan, çdo bisedë, çdo dëshirë vdiq në atë moment.

- Ishte e sëmurë?

- E tradhtoi zemra. Për një sekondë jeta e saj mori fund, ndërsa tonat ndryshuan.

- Po si e tejkaluat dhimbjen?

- Dhimbja nuk kalon kurrë e gjitha, Bujar. Në fillim është si një grumbull gacash të ndezura flakë, që të djegin shpirtin. Pastaj me kohë, një nga një gacat shuhen, por në fund njëra mbetet e ndezur përgjithmonë. Kjo është.

- Shpresoj edhe neve koha të na ndihmojë,- tha Bujari duke iu dridhur buza.

- Koha e mpak dhimbjen, ashtu që mësohemi të jetojmë me të. Ndaj dhe na duket më e përballueshme pastaj, – ia ktheu Shpëtimi dhe shtoi:- Kanë kaluar vite nga vdekja e gruas sime, por mua më duket gjithmonë se është gjallë. Ka ca lidhje të forta në jetë, që kur njëri vdes, a shuhet, hija e tij gjithmonë mbetet. Është disi sikur dikush shkon përgjithmonë, për të mbetur përgjithmonë. Janë lidhje të thella, të pakuptueshme, të pathyeshme. Pastaj njeriu e gjen një farë qetësie dhe mundohet t'i japë jetës një formë sërish nga e para. Dhe nis të kuptojë se, vërtetë çdo gjë shkon e rrëshqet si rëra nëpër gishtërinj, por diçka mbetet. Ndjen se vërtetë gjithmonë dikush mungon, por njëkohësisht është këtu tërë kohën në jetën e tij, e kupton?

Bujari dëgjonte i trazuar, kokulur dhe i heshtur.

- Kur njeriu humb dikë që e do aq shumë, mbetet rob i asaj dite kur i njeriu i dashur ka ikur përgjithmonë. Diçka, si të thuash, është zhdukur, për të qenë gjithmonë prezent. Mundohesh të krijosh një jetë paralele, diçka që i përngjan asaj të parës. Por është e kotë. Mund të jesh i lumtur edhe në vetminë tënde pastaj. Por vetëm në atë që nuk dhemb më dhe e cila i përkëdhel kujtimet si vesa e brishtë,- përfundoi Shpëtimi.

- Ju e keni provuar këtë jetën paralele. Më duket se pastaj keni gjetur një qetësi me Natyrën… desha të them me gruan tuaj.

Shpëtimi nënqeshi, ndërsa e përzier në seriozitetin e fytyrës kjo buzëqeshje u duk si një ngërdheshje.

- Eh, Natyra – u mendua paksa sikur me nënqeshje dhe vazhdoi:- Ajo ishte vetëm një moment dobësie, Bujar. Por, të paktën, mirë që nuk kemi pasur as kurorë, asgjë bashkë. U takuam diku dhe natyra e saj,- u ndal sikur u habit me kuptimin e dyfishtë të fjalës, – pra, natyra e saj e hareshme më konvenonte në ato momente, kur ndihesha aq i vetmuar prej botës. Më bëri të harroj dhimbjen që kisha, më rinoi pak me vitet e saj. Vendosëm të jetojmë bashkë për ca kohë. Ishte argëtuese për aq sa zgjati, e pranoj, por gjërat pastaj filluan të bëheshin të mërzitshme, nuk e kishin peshën e duhur..

- Argëtuese për aq sa zgjati? Pse flisni në kohën e kaluar? – pyeti Bujari dhe u tremb për atë që mund të dëgjonte.

- Natyra dhe unë jemi ndarë qe dy muaj, Bujar. Ajo nuk jeton më këtu, nuk e ke ditur?

Bujarit iu duk se iu shemb tavani mbi kokë.

- Jo,- tha me zë të shuar.

- Normal që nuk e ke ditur, po pse të pyes unë… eh ti ke dhimbje tani, ndërsa unë po të lodh me këto budallallëqet e mia.

- Jo, jo të lutem vazhdo, – tha Bujari dhe pastaj bëri sikur nuk ishte kureshtar. – Dua ta largoj pak mendjen nga pikëllimi.

- Natyra ishte një mashtruese e thekur, Bujar. Doli se nuk ishte as e diplomuar. Kishte arritur të më bindë dhe tash më vjen turp nga kjo gjë, vërtetë po. E humba gruan time, por për pak sa nuk humba dhe fëmijët për shkak të saj. Ajo kështu kishte bërë shumë herë. Takohej me burra intelektualë e të pasur dhe shfrytëzonte bukurinë dhe dhelpëritë , por edhe zgjuarsinë e saj për t'u marrë paratë. Herë shtirej sikur ishte e sëmurë, ndonjëherë paraqitej thuajse ishte e varfër, ndonjë dashnori i kërkonte të holla kinse i duheshin për avokatin për divorcin...

Bujarin e lëshoi toka. Mezi po merrte frymë.

-… dhe shumë burra…dua të them edhe unë… gjunjëzoheshin para djallëzive të saj. Shumica ia kanë dhënë të gjitha paratë. Duket se unë jam i vetmi që kam shpëtuar nga kjo punë. Më ishte mbushur mendja me kohë se nuk mund të kishim një jetë bashkë dhe e ndava. Shpresoj të mos ketë rënë ndonjë tjetër në grackën e saj. Ajo… ajo ka një dashnor dhe bëjnë plane bashkë. Rrezikojnë të përfundojnë në burg një ditë, sepse kanë mashtruar shumë njerëz .Tani janë arratisur diku, nuk e di se ku, dhe vërtetë nuk më intereson më. S'dua t'ia shoh kurrë sytë.

- Por, por… ju e patë atë ditë, në ordinancë…

- Po. Atë ditë ishim marrë vesh që të takohemi aty, për t'ia paguar paratë për divorcin tonë formal. Më thjesht, e kam paguar të më lërë rehat. Kështu kishim rënë dakord. I dhashë një dorë para që të shkulej nga unë. I thashë në telefon se nuk dua ta shoh më në shtëpi. Kurse ordinancën e kemi mbyllur, është në shitje.

Bujarit iu kujtua se atë ditë nuk kishte asnjë pacient. Vetëm... vetëm makina e atij tipit aty në rrugë.

-… ishte vendi i vetëm ku pranova të takohem me të. Solla paratë që më kishte kërkuar si shantazh, si kusht për të mos më bezdisur më. Rrugës dëgjova vajtimin e gruas sate dhe u ndala të shoh çfarë kishte ndodhur. Kur kuptova, hyra dhe ndeja disa orë për t'i qetësuar. Çfarë nuk bëmë për të të gjetur, Bujar… Eh, çfarë nuk bëmë.

-Pastaj më vonë u kujtova se Natyra më priste në ordinancë dhe kur erdha aty të pashë të shtrirë. Mendova se Natyra mund të të ketë premtuar atë kontrollin sa për të të marrë paratë e mjekimit dhe, meqë e dija çfarë të kishte ndodhur, nuk kisha zemër të të tregoja aty për aty se ajo ishte një mashtruese. Tekefundit çfarë rëndësie kishte… Pastaj ti e di, e tëra është histori.

- Ti më thua se ajo është arratisur, se ka dashnor tjetër, se është mashtruese, se nuk e di ku gjendet?..

- Pikërisht atë po të them. Falë Zotit, nuk e di. Dhe s'dua ta di më kurrë.

Bujarit iu morën mendtë. Pastaj ndjeu se diçka po i ngjitej gurmazit, një lëmsh i madh e ngufaste. Piu pak ujë dhe u ngrit në këmbë, por ato e tradhtuan. U shemb përdhe si i vdekur.

- ... vrasës… ti je një vrasës… ke vrarë bijën tënde, familjen, ke vrarë nderin… je një hiç... ti do të duhej të vdisje… ti… ti… afrohu…- fliste hija nga larg

- Më mbyt, të lutem më mbyt…

- Jo… je i dënuar të jetosh…i poshtër…do të jetosh me mua…me veten tënde…ky është dënimi yt…afrohu…afrohu…zgjohu... zgjohu...

- Zgjohu Bujar, zgjohu!- e dëgjonte zërin e Shpëtimit që vinte si nga larg dhe nisi t'i kthjellohej pamja ngadalë. Shikoi Shpëtimin që po ia lagte faqet me ujë dhe po përpiqej ta ndihmonte të përmendej.

- Oh Bujar, më trembe. Për një moment humbe ndjenjat dhe një kohë ishe si në agoni. Flisje përçart dhe dukej sikur digjeshe nga të nxehtit. Si në ferr.

- Nëse ka ferr në këtë botë, ai gjendet në zemrën e njeriut të pikëlluar, Shpëtim,- u përgjigj Bujari me vështirësi dhe i shkrehur në vaj vazhdoi: -Të njeriut të pikëlluar, të dëshpëruar e të tradhtuar.

X

Bujari doli në rrugë. Iu morën mendtë përsëri dhe u mbajt në një shtyllë telefoni. Shpëtimi i kishte ofruar ta përcillte, por ai nuk kishte pranuar. "Kam nevojë të jem vetëm" i kishte thënë.

"… është mashtruese, ka një dashnor… nuk është as mjeke… është e arratisur… ka marrë shumë njerëz në qafë… iu ka marrë para..."- i silleshin ndërmend fjalët që ia kishte thënë Shpëtimi.

"E kishte mashtruar. Ajo ishte tallur me naivitetin e budallallëkun e tij, me dashurinë e tij prej adoleshenti. Ajo, ajo nuk e kishte dashur, ndoshta e kishte përbuzur, përqeshur. Ndoshta kishin bërë shaka në llogari të tij, netëve kur ishte shtrirë afër dashnorit të saj.

Befas iu kujtua ngjarja në ordinancë, përjetimi i tij dashuror. "Të ketë ndodhur vërtetë? Ende nuk e di a ka ndodhur. Ndoshta nuk ka ndodhur asgjë, mbase ajo nuk ka lëvizur fare nga dritarja, ndërsa unë, ah unë…- u neverit nga vetvetja.- Unë e doja, e adhuroja, isha në gjendje ta shkatërroj familjen, punën, reputacionin tim. Unë, unë…isha i çmendur pas saj, isha në trans në kohën kur… kur… kur bija ime kishte dhënë frymën e fundit dhe unë nuk i isha pranë".

Iu duk se i iu ngritën flokët përpjetë. Jeta e tij ishte shkatërruar. Dhimbja ishte më e madhe se vullneti për ta tejkaluar.

" Do të vras veten,- mendoi.- Do të vdes, nuk mund ta përballoj më as dhimbjen, as turpin, as humbjen… qysh sonte… Oh, Dorinë e dashur, le të vdes e të më varrosin pranë teje, bija ime, nëse do të ma falësh. Nëse do e pranosh babin tënd të jetë i denjë, që së paku në vdekje të të përqafoj" qante në rrugë dhe nuk mërzitej nga shikimet e kalimtarëve të rastit.

" Para se të vdes duhet t'ia pranoj gruas sime të gjitha! Duhet, këtë ia kam borxh. Duhet ta kap edhe një copë të vogël të dinjitetit që më ka mbetur, dhe t'ia pranoj të gjitha, për aferën, për paratë. T'i gjunjëzohem e t'i kërkoj të më falë. Mos të vdes me gjithë këtë barrë faji, të filloj të jetoj në atë botë se unë i vdekur jam qysh tani mbi tokë. Më jep forcë, o Zot, t'ia pranoj dhe pastaj të mbyll sytë përgjithmonë".

Kujtoi me lot gruan e tij. Si nuk e kishte parë vlerën e saj gjithë këto vite? Si e kishte shikuar gjithmonë, por nuk e kishte parë? Si e kishte ndier, por nuk e kishte dëgjuar? Si e kishte aq afër e nuk e kishte ndjerë? Si kishte mundur mos ta dashuronte atë krijesë të mirë e besnike, apo më mirë e thënë, si kishte mundur ajo ta dashuronte Bujarin?! Si e kishte duruar gjithë këto vite, a thua...

"Më ka dashur. Më ka dashur ndaj dhe më ka duruar".

Bujarit iu kujtua nata kur e kishte dërguar Besën te mjeku. I erdhi ta grushtojë veten, t'i nxjerrë flokët një nga një. Sa i vrazhdë kishte qenë me të, ndërsa ajo nuk kishte thënë një fjalë. E kishte ndjekur e sëmurë nëpër shi dhe ai nuk i kishte vënë as krahun. Ishte dënuar, përjetësisht i dënuar!

E pastaj frenat… po frenat!! Po t'i kishte rregulluar ato të mallkuara frena nuk do të kishte ndodhur kjo hata me Dorinën; po të mos kishte shkuar te Natyra, do ta kishte çuar veturën te automekaniku. Pastaj edhe po të harronte, do të vdiste ai në vend të saj… po pra, të vdiste… o sa do të dëshironte të kishte vdekur e t'i mungonte Dorinës, në vend të gjithë kësaj dhimbjeje e gjithë këtij malli që ai po ndjente për të.

Tani ajo do t'i binte pianos… mu në këtë kohë…

Bujari kalkulonte të gjitha mundësitë, të gjitha rrugët që i kishte pasur për të parandaluar gjëmën, vetëm nëse…vetëm nëse… vetëm nëse do të kishte vepruar ndryshe. Vetëm nëse… Por, tani ishte vonë.

Do të vdiste. Patjetër duhej të vdiste. Duhej të paguante për gjithë këtë krim që kishte bërë. Hapi derën e shtëpisë dhe hyri brenda.

Nga dera e dhomës së pritjes, dëgjoheshin ca tinguj të mbytur pianoje.

"O Zot, të jetë Dorina? Të jetë ngjallur? E gjithë kjo të ketë qenë vetëm ëndërr? Ëndërr e keqe? Po, po ajo është ngjallur, s'ka qenë e vdekur kurrë…".

Ja tani ai do të hynte, ajo do ta linte pianon dhe do t'i kërcente në qafë. E qeshura e saj do të kumbonte korridoreve dhe do ta ngrohte shtëpinë. Do t'i jepte shpirt përsëri.

U afrua te dera dhe vuri veshin. Nuk ishin halucinacione, tingujt ndjeheshin qartë. U ndal dhe u mbështet për muri. U përqendrua fort dhe mundohej ta bindte veten se aty brenda ishte vetë Dorina. Mos ishte fantazmë? Oh, le të ishte. Le të ishte, veç të kishte fytyrën e Dorinës, sytë e saj, të qeshurën e saj... "Thonë se shpirtrat e njerëzve të vdekur ditët e para shëtisin rreth shtëpive ku kanë jetuar", mendonte. Kishte nënqeshur kur e kishte dëgjuar këtë. Por tash, tash donte ta besonte, me mish e me shpirt donte të ishte ashtu.

Pastaj mori zemër dhe hapi derën ngadalë. Përpara pianos ishte ulur gruaja e tij.

- Besa! – bërtiti Bujari dukshëm i tronditur.

Gruaja u kthye kah ai dhe ndërpreu muzikën.

- Më thirre "Besa"?- i tha ajo me pamjen e fytyrës së njeriut të rraskapitur nga jeta.

- Po. Pse çuditesh?

- Kam harruar që kur më ke thirrur për të fundit herë në emër. Ndoshta e kam harruar edhe vetë emrin tim… ndoshta kam harruar edhe pse po jetoj…

- Por nuk ke harruar arsyen pse ke jetua, Besa, mos fol kështu.

- Jo, nuk kam harruar, por ajo arsye tash ka vdekur.

- Por, jemi ne, Besa.

- A dëgjove, Bujar? Të thashë: Ka vdekur!.

Ndjeu se po i thahej fyti. Dukej se gruaja tha të vërtetën. Dukshëm edhe ai kishte vdekur për të. Kur ta dëgjonte edhe tradhtinë e tij dhe humbjen e parave, ndoshta do ta përzinte nga shtëpia. Pastaj le të vdiste në rrugë si qen, nuk e meritonte më mirë. Por, a e meritonte kjo grua vallë tani edhe një grusht të tillë që do t'ia jepte jeta? Jo me vdekjen e tij, por me rrëfimin e së vërtetës? Bujari u trand nga ky mendim dhe pështpëriti nëpër buzë me një nënqeshje cinike të vajtueshme: "Eh, Bujar, Bujar! Ti as i vdekur nuk vlen më të të përmendet emri. Nuk vlen fare më. Je një hiç".

- Çfarë bën mbi piano, Besa, është e dhimbshme tani për ne…

- Dua te loz Bujar, sepse jam e bindur se Ajo është këtu dhe ndoshta dëshiron t'i prekë tastierat e nuk mundet. Dua të loz për të, do ta bëj çdo ditë. Oh foshnja ime, bija ime!

Besa nisi të qajë me ngashërim, por njëkohësisht duke i rënë tastierave përsëri. Lozte pianon duke qarë dhe Bujarit iu duk se po i shqyhej zemra nga skena që po përjetonte.

Vendosi që të priste derisa ajo të qetësohej dhe shkoi në dhomën tjetër. Ndërkohë do ta mendonte planin e vetëvrasjes. Mendoi të hipte në tavanin e shtëpisë dhe të varej... Jo, kështu do të tmerronte njerëzit e shtëpisë, nuk donte t'u shkaktonte të tjera skena të tmerrshme. Mendoi se vdekjen mund ta thërriste duke marrë një numër të madh tabletash qetësuese dhe të zhytej në gjumë të përjetshëm; a të merrte diçka helmuese nga laboratori i tij në fakultet… U kujtua për vitet e rinisë, sa larg i dukeshin studimet e tij, ajo ishte një botë tjetër tani, nuk donte ta ndynte kujtimin për Bujarin e atëhershëm. Duhej ta linte ashtu si ka qenë, të pastër.

"Ndoshta mund të hidhem nga ndonjë ndërtesë e lartë... Të mbytem në lumë...".

Pastaj papritmas u kujtua. Posa gruaja ta përzinte, do të udhëtonte deri te shtëpia e tij e fëmijërisë. Do të shkonte në breg të lumit, do të ulej në atë gurin e madh, do t'ia rrëfente të gjithë historinë e jetës së tij, që nga dita që u nda prej tij, dhe pastaj… pastaj do të hidhej dhe do bëhej një me të, një me lumin. Mu ashtu siç e kishte ëndërruar. Do të bëhej lum i pikëlluar që vazhdon furishëm me dëshirën për t'u tretur ne det, për të mos ekzistuar, për tu bërë *asgjë*.

Ndjehej shumë i trazuar. Mendoi me ironi se ndoshta vdekja e tij do ta kthente qetësinë në këtë shtëpi. Atë qetësinë që ia krijonin për të studiuar, qetësinë për të punuar. Edhe atëherë kur qetësia nuk i duhej të tjerëve, edhe kur fëmijët ishin të vegjël dhe kërkonin lojë. Por, ata ia mundësonin. E sot, kur Bujari kishte kthyer trazimin, njerëzit e tij kishin nevojë për qetësi. Dhe ai do t'ua jepte sepse e meritonin. Do t'ua kthente. Me vdekjen e tij.

Pas një kohe, Besa doli nga dhoma e pianos dhe u ul. Në fytyrë i shiheshin shenjat e një gruaje të pjekur e të rrahur nga jeta. Bujari e shikoi me kujdes. Nuk mund t'i binte në fije me çfarë i përngjante Besa.

"Në grua të bukur! – u kujtua,- në grua të bukur, të cilën kam qenë i verbër për ta parë".

Vërtetë, Besa, me gjithë dhimbjen e madhe, kishte marrë një pamje të hijshme që vinte në shprehje bashkë me qëndrimin dinjitoz.

"Mbase kështu ka qenë gjithmonë gruaja ime. Por unë kurrë s'kam pasur kohë dhe dëshirë për ta kuptuar. A thua sa herë ka pasur nevojë për ndihmën time, për mendimin tim, për mirëkuptimin, të cilin unë e kam kursyer marrëzisht, duke qëndruar në fronin e njeriut të paprekshëm?

- Doje të bisedonim diçka? – i tha Besa papritur.

Bujari u kujtua. Erdhi momenti. Forcohu Bujar, është koha të përballesh me demonët e tu!

- Besa… - filloi, - ndoshta nuk është momenti i duhur, por duhet të flasim rreth shumë gjërave.

- Çfarë ka ndodhur? Ku është Diamanti?

- Jo asgjë, mos u tremb, të lutem. Diamanti është mirë. Fjala është për mua. Kam bërë… kam bërë ca gabime të tmerrshme dhe më duhet t'i them para teje. Shpresoj të më falësh. Së paku atëherë kur të jesh e gatshme për këtë.

- Fol Bujar! Nuk kam durim më, – i tha gruaja me gjysmë zëri.

- Dua t'ia nis nga fillimi. E di se kam qenë shumë i vrazhdë dhe jam sjellë keq me ju… me ty… tani e shoh këtë, kam qenë i lig….

- Mos e mundo veten tani, ngrihu,- i tha gruaja edhe ajo e prekur.- Kemi kohë për ta biseduar.

- Jo, të lutem më lër ta mbaroj. Më duhet të rrëfehem. Dua të shkoj me shpirt të çliruar në… në…

- Ku po shkon? – ia tha trembshëm gruaja.

- Më lër ta mbaroj. Frenat e prishura janë faji im. Unë i dija, por atë ditë e lashë veturën. Po të kisha shkuar për ta marrë, kjo s'do të kishte ndodhur… Pastaj u vonova, nuk i dhashë rëndësi. Nuk më shkoi mendja se Dorina do të shkonte atje. Ajo doli në mëngjes për provimin, nuk ma merrte mendja se do të kthehej shpejt.

- Provimi nuk ishte mbajtur,- tha Besa.- Prandaj Dorina u kthye shpejt në shtëpi.

- Edhe po të mos dilte, nuk do të më shkonte ndërmend se ajo mund të vepronte ashtu. Unë madje, nuk e kisha regjistruar ende në kokën time se ajo kishte marrë patentën.

- Ajo, ajo donte që t'i të gëzoheshe se ta ka hequr një brengë.

- Ndërsa unë i mora jetën,- shpërtheu në vaj Bujari.

- Jo Bujar, mos mendo kështu… Lere, do të bisedojmë tjetër herë.

- Jo! Tani do të bisedojmë. Është koha kur duhet të t'i them të gjitha. Shih Besa, paratë në bankë… kursimet tona… nuk janë më.

- Si nuk janë, çfarë don të më thuash, ku janë?

- Ia kam dhënë… ia kam dhënë të gjitha Natyrës.

- Cilës Natyrë, çfarë don të më thuash?

- Natyrës, ish-gruas së Shpëtimit.

- Por, ajo ka kohë që nuk jeton më këndej. Unë vërtetë, nuk të paskam thënë se ajo ka ikur nga Shpëtimi. Po ti si e takove, pse ia dhe?- dhe pastaj uli kokën me një pamje zhgënjimi dhe shtoi:

- Ti don të më thuash se ti… se ti ke pasur punë me të?

Bujari uli kokën dhe mezi ngopej frymë.

- Ka pasur punë aq sa për t'u mashtruar për një pjesë të vogël të parave, - u dëgjua nga dera zëri i Shpëtimit që ishte futur dhe po afrohej ngadalë, sikur po inkuadrohej në një bisedë krejtësisht normale. Nuk e kishin parë, as e kishin ndjerë që ishte futur në shtëpi, ndaj u befasuan kur e panë aty. Ai zuri vetë një kolltuk, pa pritur t'i thonë të ulet, dhe u rehatua.

- Ia tregove Besës muhabetin? – e pyeti Bujarin ndërsa ky kishte mbetur pa gojë nga habia. Dhe pa pritur përgjigjen vazhdoi:

- Besa, Bujari kishte menduar të ta bëjë një befasi të mirë, e kishte menduar qysh përpara se të ndodhte tragjedia në shtëpinë tuaj. E kemi biseduar bashkë dhe unë pranova ta ndihmoj. Plani ishte që Dorinës t'i paguhej shkollimi në një universitet të lartë të Francës dhe asaj t'i vinte thirrja si befasi. Njëkohësisht Diamantit t'i organizonim një ceremoni të bukur martesore dhe ndonjë udhëtim për muaj mjalti, si dhuratë martese nga familja. Ndërsa për ju të dy, e kishte menduar një befasi tjetër për përvjetorin e martesës dhe natyrisht disa para anash për pleqëri,- fliste Shpëtimi sikurse sipas një skenari të gatshëm dhe shtoi:

- Bujari donte të t'i bënte të gjitha si shpërblim për mundin tuaj të sa viteve që keni pasur për të dhe posa të kryhej libri dhe buja pas tij, dëshironte t'ju kushtohej në tërësi.

- Por... ti? Pse je angazhuar ti? – pyeti Besa me një zë të pasigurt.

- Sepse unë jam pensionist me kohë të lirë dhe më plaste barku duke mos bërë asgjë. Një ditë biseduam me Bujarin dhe ai më tregoi për këtë plan. Unë u ofrova ta ndihmoj, meqë ti Besa e din se kam të njohur në universitetin e Francës, kam ligjëruar atje. Pastaj dhe më jepte kënaqësi t'i ndihmoja Bujarit. Ne merremi vesh aq mirë… ne burrat kemi një gjuhë, apo jo? – provoi të bënte pak shaka dhe dukej se po ia arrinte. Besa vuri lehtë buzën në gaz, sa për të mos ia prishur Shpëtimit, por përsëri fytyra i mori një hije mosbesimi.

Bujari ishte shtangur. S'po thoshte dot një fjalë.

- Por, atëherë… pse ia dha paratë Natyrës? – tha Besa duke shikuar nga Bujari. Zëri i saj mori tonin e frikësuar dhe vazhdoi: - Ajo ka ikur. Mos vallë i ka marrë edhe paratë tona me vete?

- Ja se si shkuan punët. Unë e Bujari e patëm lënë të takohemi tek ordinanca e vjetër, por Natyra kishte ardhur aty para meje për të mbledhur gjërat e saj. Kishte parë Bujarin që po më priste. Meqë ky nuk e dinte si qëndron puna mes nesh të dy, e kishte lutur edhe Natyrën që t'i ndihmonte rreth befasisë që dëshironte për ty, pra një udhëtim edhe për ju të dy, ja e thashë. Pastaj Besa, ti e din, Natyra me ta kuptuar se Bujari ka me vete para, ia kërkon dhe i pranon në emrin tim dhe i thotë Bujarit të shkojë, se është punë e kryer, pra se paratë do m'i dorëzonte mua. Madje ia kishte bërë edhe një vizitë mjekësore.

Bujari u skuq. Ende nuk e dinte mirë çka kishte ndodhur atë ditë në ordinancë. T'i kishte parë Shpëtimi gjatë?.. Ndoshta s'kishte ndodhur fare, por prapë se prapë, për t'i parë i kishte parë… – dhe pastaj befas u vetëdijesua për të vërtetën që e kishte para sysh: Po Shpëtimi pse po e ndihmonte tani? E dinte? Sigurisht se e dinte, ndaj dhe e kishte sajuar këtë histori. Por, pse, pse?..

- Po çfarë ndodhi pastaj? – pyeti Besa.

- Asgjë. Deshi fati ta arrij aty para se Natyra të ikte. Duke e njohur mirë, e dita se mund të ketë ndodhur ndonjë gjë, pra se mund t'ia ketë marrë të hollat bashkëshortit tënd. E detyrova të m'i paguante një nga një, ndryshe do ta dërgoja në polici. Më tha se së paku donte t'ia jap paratë e vizitës, që ia kishte bërë Bujarit. Ishte qesharake, por ia dhashë. Janë simbolike, sa për të mos thënë se i mbetët borxh. Pastaj erdha ne restorant, por Bujari kishte ikur. E lashë që paratë t'ia kthej të nesërmen. Por… e nesërmja solli fatkeqësinë dhe nuk kisha kohë për t'i thënë gjë, s'kishte më rëndësi asgjë. Paratë mbetën tek unë, një pjesë t'i dhashë atë ditë për varrim, kurse të tjerat i kam unë. Ja, kjo ishte e gjitha. Në vend të Bujarit, ta tregova unë.

- Paskam menduar se na i ke huazuar,- tha Besa.

- Atë ditë nuk kishte kohë për shpjegime, Besa. Bujari ishte mjaft i humbur, ndaj doja të kryhen punët pa fjalë.

Bujari po mendonte se me sa lehtësi Shpëtimi e thërriste emrin e gruas së tij: "Besa… Besa"… ndërsa ky, burri i saj, kishte pasur kohë që e kishte menduar vetëm si "gruaja". Kjo i ndihmonte, e bënte ta linte më me lehtësi në prapavijë, ndërsa në fakt, ajo kishte qenë aq e pranishme për të gjithë. Edhe për atë.

- Po si nuk ia tregove Bujarit pastaj se i ke marrë paratë? Në fakt kur ka ndodhur kjo me Natyrën?

- Një ditë para fatkeqësisë. Të nesërmen, siç e din, askush nuk mund ta gjente Bujarin derisa m'u kujtua se mund të jetë te vendi ynë, ku bënim planet e organizimeve për ju dhe pastaj dilnim për ndonjë kafe. E gjeta në oborrin e ordinancës.

- Po ti Bujar, pse nuk e thërrisje Shpëtimin, pse rrije vetëm?

- E gjeta tek provonte kot të zinte dy gram bateri në celular për të më thirrur, nuk i punonte…- vazhdonte Shpëtimi pa e lënë Bujarin të përgjigjej dhe pastaj, sikur deshi ta përfundonte këtë mori pyetjesh, nxori një zarf nga xhepi dhe tha:

- Ja ku i keni paratë, aty janë të gjitha pos hakut për vizitën. Më vjen keq që nuk doli si menduam, Bujar. Por kush e priste.

Besa u ngrit pa fjalë.

- Do ziej kafenë tani. Mirë që paskemi shpëtuar. Të faleminderit, Shpëtim, çfarë do të bënim pa ty.- Pastaj e pyeti: - A do të rrish për darkë me ne? Kemi nevojë për shoqëri.

- Me gjithë qejf, Besa. Kur rri me ju, më duket se jam edhe më afër Dorinës.

Besa buzëqeshi në shenjë falënderimi dhe iku në kuzhinë.

Burrat mbetën vetëm dhe pasoi një heshtje e gjatë. Ndiheshin ca tinguj enësh nga kuzhina dhe asgjë tjetër. Bujari tërë kohën e mbante kokën ulur, ndërsa Shpëtimi ofshante herë pas here, sikur dëshironte të pushonte nga një lodhje e madhe, nga një sfidë tepër e vështirë, të cilën posa e kishte kaluar me sukses. Por lodhja kishte mbetur.

Dikur Bujari ngriti kokën ngadalë dhe e shikoi në sy.

- Ti… ti e dije?

- Po. – i tha shkurt Shpëtimi.- Kam dyshuar, por sot kur pashë reaksionin tënd në shtëpinë time, u binda në tërësi. E lidha me bisedën që bëmë në shtëpinë tuaj për paratë dhe mu ndez një alarm: ordinanca... biseda... paratë... vizita tek unë… Pasi dole nga shtëpia ime, u vesha dhe për një copë rrugë të kam përcjell.

- Po si e dije numrin e parave?

- Nuk e dija saktësisht, por u nisa nga ajo sa i kishte thënë Besa me një rast Natyrës, duke menduar se po fliste me një shoqe të mirë. Kanë biseduar një herë për planet tuaja të familjes dhe për mundësitë që i kishit të kufizuara për shkak të një shume jo aq të madhe kursimesh. Ajo atëherë provoi me mua, duke më thënë që t'ia jepja një sasi të konsiderueshme parash, për t'ia huajtur Besës. Unë iu përgjigja se komshinjtë, po të kenë nevojë, duhet t'i kërkojnë vetë. Nuk mund t'i besoja një gruaje si ajo. Bujar, duhet ta dish të vërtetën: mu ky shkak e ka shtyrë Natyrën pastaj të fillojë me joshjet e saj ndaj teje. Më vjen keq, por kështu është.

- Po pse nuk më thoshe gjë për të?

- Në fillim nuk e mendoja se mund të lindte ndonjë idil në mes teje me Natyrën. Figura jote... Kur e kuptova, gjërat kishin ecur shumë mes jush.

- Po pse nuk më tregove, pse nuk më parandalove… sikur ta kishe bërë, do të veproja ndryshe.

- Si mund ta parandaloja dikë që kishte aferë me gruan time? Mendon se e kisha krejt njësoj të shihja çfarë po ndodh mes jush? Por, cilido dhe cilado ka të drejtë të dojë një tjetër, po qe se do. Nuk jemi më si qëmoti. Nëse kjo do të ndodhte, mua më mbetej të mendoja rrugën time.

Bujari uli kokën i turpëruar deri në palcë. Ndonjëherë njeriu i jep vetes më shumë të drejtë se sa që duhet dhe ai u bë i vetëdijshëm se po e keqpërdorte tolerancën e tjetrit.

- Jam treguar shumë naiv dhe i papjekur, - tha.- Më fal, ke arsye.

- Pastaj unë kam provuar të t'i vë disa gjëra para syve, Bujar. Të kujtohet nata kur u takuam në rrugë? Të thosha se ke një familje të mirë, se është kënaqësi të jesh mes artistëve, se njerëzit e tu të duan… Por ti nuk shihje gjë, pos Natyrës. Pastaj kishte edhe një arsye tjetër: nuk doja të lëndohet familja jote, njerëzit e tu nuk e meritonin një gjë të tillë. Shpresoja se do të ishte ndonjë flirt i parëndësishëm i yti, që të ka ardhur bashkë me krizën e moshës dhe do të kalonte pa u vërejtur. Por ti… ti e kalove kufirin, Bujar, kalove çdo gjë, i tejkalove kufijtë e vlerave të tua, që i ke kultivuar me vite.

- Po… po pse më ndihmon tani?… Ti… ti do të duhej të hakmerreshe.

- Jo. Natyra nuk ia vlente, ndërsa familja juaj, po. Çdo njeri ka të drejtë të gabojë. Fatkeqësisht pasojat ndonjëherë mund të jenë shumë të rënda. Madje, tragjedia njerëzore nuk është gjithmonë në ngjarjet dhe vuajtjet njerëzore, por në rastet që i humbim. Për arsye se kemi dështuar për t'ia qëlluar çfarë është e drejtë. Vetë Zoti e di se kam provuar edhe Natyrën ta vë në rrugë të mbarë edhe pasi pata kuptuar për bëmat e saj. Kam biseduar gjatë me të. I tregova se i kam kuptuar të gjitha. I premtova para për të kryer studimet, për të hapur ordinancën. I bëra me dije se nuk jemi për njëri-tjetrin, se qëllimet e saj për të më shfrytëzuar financiarisht kanë dështuar, por thashë se doja ta ndihmoja nga dëshira për ta kthyer në rrugë të drejtë një njeri. Ta ndryshoj për të mirë. Por kot, Bujar, dështova. Ndonjëherë e keqja është e pazbutshme, ani pse për mësues ka dashamirësinë.

Bujari po fshinte nga sytë sa herë që ndonjë lot lodhej nga pesha e tepërt dhe rrokullisej teposhtë faqeve.

- Po pse nuk më le sot t'ia pranoj Besës? Pse më ndërpreve? Pse e thure gjithë atë gënjeshtër? Duhej t'ia thosha të vërtetën…

- E vërteta e vetme është se Natyra ishte gënjeshtare e mashtruese, dhe jo ti. Ajo ishte buqetë me lule, në petalet e të cilave strukej gënjeshtra, e keqja, e liga. Ti ishe vetëm një njeri, i cili për ca kohë humbi nëpër aromat e saj. Fundja ishe një njeri me ndjenja, të pëlqente bukura, s'është aspak keq. Por ajo nuk ia vlente, të thashë. Ca gjëra duhen mbetur pa thënë, ca gjëra duhet të mbesin nëpër të çarat e hapësirës.

Bujari tashmë po qante. Si nuk e kishte parë gjithë këtë mirësi rreth vetes. Sa shumë kishte qenë i bekuar, ndërsa ai kishte puthur ligësinë në buzë dhe pastaj kishte helmuar dhe të tjerët.

- Më fal, Shpëtim, kam gabuar rëndë. Edhe ndaj familjes time, edhe ndaj teje am tradhtuar. Nuk ju kam vlerësuar, as respektuar, as… dashur sa duhet. Kam qenë i verbër. Të faleminderit për të gjitha. Të kam borxh tërë jetën. Pavarësisht se kjo jetë a zgjat edhe një ditë a shumë vjet...

Shpëtimi e pa në sy. Dukej se e kuptoi mendimin e mikut.

- Borxhin e vetëm ma ke që të mos jesh frikacak ndaj jetës, Bujar. Të mos ikësh nga përgjegjësitë. Tani kjo nuk i duhet askujt rreth teje, as ty. Duhet të përballesh me sfidat e jetës . Po nuk e bëre, dije se ke dështuar në tërësi.

- Do ma falësh ndonjëherë, Shpëtim? A thua do ma falni ndonjëherë të gjithë? – pyeti me sy të përvajshëm e me zë të ulët Bujari.

- Ke rrugë të gjatë për të bërë, tek brendia jote Bujar, tek shpirti yt, zemra jote, vetëdija jote. Shumë beteja duhet t'i kalosh duke i fituar. Pastaj, në fund, është me rëndësi t'ia falësh një herë vetes tënde, Bujar. Fale atëherë kur ta mendosh se e ke arritur këtë. Pastaj do të jetë më lehtë.

Nga kuzhina u ndjenë këmbët e Besës që po sillte kafetë.

XI

Kishte vetëm pak ditë që ishte kryer ceremonia mortore e përvjetorit të parë të vdekjes së Dorinës. Një vit kishte kaluar me hapa të rënda dhe Bujari ende nuk e kishte pranuar tërësisht si të vërtetë shuarjen e saj, humbjen e përjetshme. Çdo herë e zinte veten të mendonte se do të ndodhte ndonjë mrekulli, se Dorina do të ringjallej, paçka se kjo nuk i kishte ndodhur kurrë askujt tjetër. Ndonjëherë mendonte çfarë do t'i tregonte së pari kur të takoheshin, si do të reagonte po ta shihte se është kthyer.

Një kohë të gjatë e shihte çdo natë në ëndërr. Ajo vdiste, por gjithmonë në mënyra të ndryshme. Pastaj ëndrrat u modifikuan. Ajo vdiste, kthehej, por të gjithë e dinin se prapë do të vdiste. Frika nga dhimbja që do ta ndjente kur ajo do të vdiste sërish, e bënte Bujarin të zgjohej gjithmonë në ankth dhe duke qarë me zë.

Gjatë gjithë vitit kishte ndërruar jeta e të gjithëve. Diamanti kishte filluar të bashkëjetonte me Mimozën dhe lajmërohej rrallë. Por edhe atëherë, fliste më me ëndje me të ëmën, ndonëse përpiqej që me babanë ta mbante respektin. Besa ishte mbyllur pak a shumë në kutinë e kujtimeve dhe shpesh shfletonte albumet e fotografive me sy të përlotur. Pas dreke dilte nga pak për ndonjë shëtitje, ndërsa në mbrëmje mbyllej te pianoja dhe luante pjesët e preferuara të Dorinës. Dita-ditës sonatat rridhnin bukur e më bukur dhe duart e Besës lëshoheshin pa frikë mbi tastierat e saj, të cilat i kishte lënë anash për shumë kohë. Kur dilte, merrte shallin e zi, mbulonte kokën, dhe shkonte në shëtitjet e saj të zakonshme për rreth dy orë. Nuk e ftonte më Bujarin si kaherë, ndonëse ky e priste një ftesë të tillë. Ndodhte shpesh që kur ajo dilte, Bujarit i mbusheshin sytë me lot dhe qëndronte një kohë të gjatë pa lëvizur. Analizat e saj mjekësore kishin mbetur të pabëra ndonjëherë dhe ajo më nuk i kushtonte shëndetit të saj asnjë rëndësi. Shpesh e shihte të zverdhur, por çdo insistim i tij për vizitë te mjeku haste në vesh të shurdhër.

Bujari provoi edhe një kohë të merrej me studimet e tij, por e pa se ishte e pamundur, asgjë më nuk kishte kuptimin e duhur. Teoria e tij, e cila pretendonte të bëhej e famshme dhe të ndryshonte edhe ca koncepcione të larta shkencore, sot i dukej si një shkrim i pavlerë, si një shkarravinë që nuk po thoshte asgjë. Ndoshta nga fakti se nuk shpjegonte se si mund të ktheheshin të vdekurit sërish mbi tokë. Ishte i dërrmuar. Jetonte pa asnjë qëllim.

- Të duhet pak ndihmë, – i tha një ditë Shpëtimi.- Mendoj se është koha të vizitosh një mikun tim.

- Çfarë ndihme? Cilin mik duhet të takoj?

- Bujar, ti po e mbyt veten me torturat më të mëdha. Ke bërë një përzierje të dhimbjes, të barrës së fajit, brejtjes së ndërgjegjes e pikëllimit dhe je duke e pirë si helm çdo ditë nga pak. Nuk mund të vazhdosh kështu. I duhesh familjes, por edhe vetes tënde. Mos u bëj aq egoist.

- Egoist? Je në vete? Unë po shqyhem, ndërsa ti thua egoist?

- Natyrisht. Ti po merresh vetëm me dhembjen tënde.

- Dhe çfarë ndihme mendon se më duhet?

Shpëtimi nxori një kartëvizitë dhe ia zgjati.

- Urdhëro, mik. Merre!

Bujari e shikoi. Ishte emri i një psikiatri dhe shënimet e tij.

- Ti… ti më mendon të çmendur?

- Jo, kurrsesi. Bujar, ti ke nivelin e duhur për ta ditur se psikiatri nuk i duhet vetëm të çmendurve. Ti ke nevojë për ndihmë profesionale që të dalësh nga kjo situatë. E di si thonë? "Psikoterapia vepron si kirurgji e trurit".

- Punë e madhe. Nuk dua. Më duhet ta përjetoj këtë dhimbje, më duhet ta dënoj veten.

- Përsëri po tregohesh egoist. "Unë, unë, unë". Sa shumë "unë"! Harroje këtë një herë. Mendo për të tjerët, kupton? Mendo edhe për dhimbjen e të tjerëve.

- Si qenkam egoist? Më trego pra!

- Mendoje për shembull çfarë do të bëje po të ikte Besa ose Diamanti nga ti. Çfarë do të mendoje në fillim? "Oh, jam i vetmuar, më lanë, unë nuk vlej asgjë, si do t'ia bëj vetëm, do të vdes". Apo jo?

- Po.

- E pra, ky është egoizëm. Do të duhej të mendoje ndryshe. Si do të ndjehej vetë Besa që po ikte? Çfarë ke bërë ti që ajo nuk ndjehet mirë në shtëpinë e saj? Mos ndjehet a thua më e lumtur pa ty? Nëse po, atëherë pse? Sa je në gjendje të bësh ti tani për lumturinë e saj, të Diamantit?

Bujari u mendua. Ideja se mund ta braktisnin e bëri të rrëqethej i tëri. Pastaj i hyri një dyshim në zemër.

- Ti di gjë e s'po më tregon? – e pyeti me frikë

- Jo, jo. Oh, Bujar, sa i papërmirësueshëm që je. Mos e bëj përsëri. Koncentrohu në atë që po flasim, mos ia kthe kahen bisedës.

- Por unë… unë nuk di të mendoj ndryshe.

- Po pra, nuk di. Ndaj dhe të propozova që të shkosh tek ai që di. Domethënë tek ai që do të të mësojë t'i shohësh gjërat ndryshe. Hë pra , mendoje një herë, mirë? Mos e hidh anash as si letër, as si ide.

- Do ta mendoj. Nuk mund të premtoj asgjë.

Po atë pasdite, teksa ishte ulur në karrigen e kopshtit pas shtëpisë, u thellua në mendime. Sytë i shkuan te dritarja e fqinjës. Iu bë se e pa tek po ujiste lulet me atë buzëqeshjen e saj ledhatare. "Por… prit…."- i tha vetes.- "Pse nuk më ngacmon më fare ajo buzëqeshje? Pse nuk më duket joshëse, madje më duket djallëzore. A thua çfarë do të bëhej deri tani sikur Natyra nuk do të kishte qenë një mashtruese, por vërtetë e dashura e tij? Do të ikte me të? Do të arratisej si i marrë? Ishte vallë në gjendje ta linte familjen për të?..

Natyra ishte zhdukur pa asnjë gjurmë. Kishte dëgjuar prej Shpëtimit se jetonte diku jashtë vendit me atë dashnorin e saj. Madje, rrengun e Bujarit ia kishte bërë edhe një personi tjetër, por sërish kishte shpëtuar pa therkë në këmbë.

"Ndoshta dhe secili prej tyre e ka merituar një fat të tillë, mu sikurse unë,- mendoi atëherë Bujari.- Ajo sigurisht i ka studiuar mirë tipat labilë si ne dhe pastaj ka vepruar"

-Bujar! Bujar! Eja brenda,– e trandi zëri i Besës, që vinte nga dhoma.

Bujari u bë i vetëdijshëm atë moment se edhe sonata ishte ndalur. U ngrit dhe hyri brenda.

Posa hapi gojën të pyeste çfarë ka ndodhur, sytë i zunë një vajzushë që po qëndronte para derës së hapur të shtëpisë. Ishte veshur me rroba të vjetra dhe dukej se kishte kohë pa u larë. Flokët i binin fytyrës e i ishin ngjitur nëpër faqe, ndërsa pas tyre fshiheshin dy sy të kaltër lutës. Në duar mbante dy shporta: një me lule e një me mollë. Kishte diku nëntë ose dhjetë vjet. Kur u paraqit Bujari, i ngriti sytë me turp dhe i uli menjëherë. Dukej si e frikësuar. Derisa po bëhej gati të thoshte gjë, Bujari pa Besën që po vinte me një grusht monedhash në dorë.

- Po kjo? – e pyeti ai të shoqen.

- Është shitëse lulesh. Dua të blej ca që t'i ndihmoj, më dhimbset. Shih sa e vogël është. I thashë se do t'ia dhuroj ca para, por më tha se nuk kërkon lëmoshë. Është shumë krenare. Nuk po gjeja monedhat, ndaj të thirra, por pastaj më ra ndërmend se kisha ca në çantën time.

- Si e ke emrin? – e pyeti vajzën Bujari.

- Jeta, – u përgjigj vajza me gjysmë zëri.

- Ku jeton ti? Ku i ke prindërit?

Vajza u zu ngushtë. Vari kokën edhe më shumë, ndërsa po shtrëngonte grushtet me gjithë fuqinë.

- Nëna… nëna më ka vdekur kur kam lindur unë. Ndërsa babai im… nuk është mirë, është i sëmurë nga veshkat. Jetojmë me një barakë në lagjen e varfër të qytetit.

- Ku i bie kjo lagje?Paska një lagje që quhet kështu?- pyeti Bujari më shumë duke u kthyer nga Besa.

- Po,- iu përgjigje Besa në vend të vajzës.- Është përtej parkut të qytetit. Kam kaluar andej shumë herë gjatë shëtitjeve të mia.

Bujari uli kokën. “Po të kisha dalë ndonjë herë me gruan time do ta dija”, mendoi. Pastaj u kthye kah Jeta:

- Po mollët e lulet ku i merr? – e pyeti atë.

- Në oborr kemi disa drurë molle. Tani në vjeshtë arrij të shes ndonjë. Lule nuk ka shumë, ato i kam shitur verës.

- Po si të lejon babai të shesësh kështu? Ti je e vogël, duhet të jesh në shkollë.

- Ai nuk e di, por unë e kam lënë shkollën para dy muajve. Nuk kishim para për librat. Tani duhet të grumbulloj para për operacionin e babait. Ai… ai është i shtrirë tërë kohën.

- Ku, në spital?

- Jo, ne nuk kemi para për spital.

- Pse edhe për spital u dashkan para? – pyeti Bujari me trishtim

- Bujar, e ku ka sot ndihmë pa para. Mos u sëmursh! Por, në anën tjetër edhe mjekët nuk kanë faj me ato paga të vogla që marrin. Nuk kanë vullnet për punë, – foli Besa gati më shumë për vete.

- Punë e madhe pagat e vogla. Mjeku është mjek. Për çfarë e kanë betimin e Hipokratit, që të bëhen hipokritë? – tha Bujari me nervozizëm, por ku e pa fytyrën e frikësuar të vogëlushes e uli tonin dhe e pyeti atë krejt butë:

- Po ti si ia bën, çfarë hani?

- Përgatis ndonjë gjë. Aq sa kemi.

Bujarit iu ndrydh zemra. Para vetes kishte një krijesë të vogël, të brishtë, që e kishte njohur jetën me të gjitha vrazhdësitë e saj ende pa frymuar mirë. Befas sikur u kthjell:

- Jeta, a bën ta vizitoj unë babanë tënd ndonjë ditë?

Vajza nuk u përgjigj dhe ballin e saj të vogël e përshkuan djersët.

- Do ta kundërshtonte babai yt këtë gjë? – e pyeti tani edhe Besa.

- Jo, por…- sikur mundohej të thoshte diçka por nuk mundej.– Ju… ju nuk mund ta vizitoni shtëpinë tonë, nuk keni as ku të uleni… më vjen turp… ne nuk kemi asgjë….

Bujari e Besa u shikuan sy më sy për një çast. Pastaj Besa ia vuri vogëlushes të gjitha monedhat në grusht dhe i tha:

- Mirë, me jep ca lule dhe pastaj na trego saktë ku e ke shtëpinë.

- Por këto para janë shumë, ndërsa lulet e mia nuk vlejnë aq. Më mirë bli ca mollë.

- Jo, jo, dua pikërisht lule. Kam nevojë për lulet, prandaj po i blej. Ndërsa mollët do t’i shesësh më lehtë.

- Mirë atëherë,- tha vajza dhe nxori prej shportës lulet që ishin vyshkur kaherë.

***

Kishte kohë që vogëlushja kishte ikur. Dy bashkëshortët po qëndronin para televizorit të ndezur, secili i kredhur në mendimet e veta. Asnjëri nuk guxonte të thoshte atë që mendonte.

Dikur Bujari ngriti sytë dhe shikoi Besën. Dukej se ishte plakur këtë vit, por qëndrimi i saj impononte, ndërsa afërsia e saj i jepte ngrohtësi, ndihej i sigurt.

“Sa shumë kam ndryshuar!” mendoi dhe pastaj iu drejtua Besës:

- Edhe ti po mendon ende në Jetën?

Besa u hutua një herë nga pyetja dhe pastaj tha:

- …jetën?… aha po, po Jetën …Vërtetë po, s’më hiqet nga mendja.

- Sa gjynah! Ajo është aq e vogël dhe mban gjithë atë barrë në shpinën e saj të dobët.

- Po,- ia ktheu Besa,- dhe isha duke menduar se ajo vajzë nuk e ka provuar kurrë dashurinë e nënës, ndërsa jeta e ka grushtuar përsëri. A thua pse na thonë se jeta është kaq e bukur kur ajo na jep aq dhembje?

Ofshau Bujari:

- Dhe kur e pashë… më përngjau aq shumë në Dorinën kur ishte e vogël… m'u duk thuajse u kthye ashtu e bërë pis nga loja… O perëndi sa më mungon!

Besës iu drodh mjekra. Pastaj mori frymë thellë dhe tha:

- Vërtetë i përngjante. Ndoshta na duket ashtu nga malli që ndjejmë për bijën tonë. E di çfarë m'u kujtua pastaj kur shkoi?

- Çfarë?

- Të kujtohet para dhjetë viteve kur u shtriva në spital për operacionin. Dorina kishte diku shtatë a tetë vjet. Bisedova me të një mbrëmje më herët, e parapërgatita se do të shkoja për ca ditë. I thashë se do të mendoj tërë kohën për të e për Diamantin. Se do të kthehem më mirë dhe më e shëndetshme. E mbajta në prehër dhe i flisja. Ajo më shikonte me ca sy të frikësuar dhe pastaj më pyeti:

"Po valixhen pse e ke bërë gati, të duhen aq shumë gjëra?".

Po, i thashë, çdonjëri që udhëton diku, merr me vete gjërat që i duhen. Por të premtoj se do kthehem shumë shpejt.

" Më shpejt se kthehet babi nga studimet e tij jashtë?" më pyeti.

Më shpejt, i thashë dhe pastaj e vura në gjumë. Por, të nesërmen kur arrita në spital, hapa valixhen dhe mbeta e shtangur. Mbi rrobat e mia ishin sandalet e bardha të Dorinës. I kishte vënë aty sigurisht natën. Pata qarë gjatë.

Besa fërkoi ballin dhe vazhdoi:

-Kur u ktheva, Dorina më doli përpara dhe mua më ra ndërmend t'ia shikoj rrobat që i ishin bërë pis. Ajo më përqafonte, ndërsa unë po i shikoja fanellën nën xhaketë. E di se kam menduar: Perëndi, më jep forcë t'i rris këta fëmijë, derisa të bëhen të zotët e vetes… pastaj, edhe po të vdes, nuk ka rëndësi. Por….- i mbeti fjala në fyt...- por ajo shkoi e para… iku – u ndal pak sërish:- Më beso, një natë më herët kam pasur parandjenja për këtë tragjedi që na ndodhi. Pashë ëndërr se dikush më nguli thikën në zemër. Por nuk e dija se do mbesja pa foshnjën time.- Fshiu sytë dhe pastaj vazhdoi:

- E pata pyetur pse i kishte vënë sandalet e saj në valixhe. Më tha: "Mendova se kështu do më marrësh me vete, por edhe nëse jo, do me ndjesh më afër". Më vonë ma dha një letër, të cilën e kishte shkruar me ndihmën e Diamantit gjatë qëndrimit tim në spital, ku kishte përshkruar ndjenjat e saj. E kam ruajtur akoma.

- Do të doja ta shihja, por frikohem se njëherë nuk kam fuqi ta përballoj.

- Do ta lexojmë bashkë ndonjë ditë tjetër. Sa shumë ngjarje më kujtohen tani me Dorinën. Sa e çuditshme është kur njeriu humb dikë, të gjitha gjërat që të duken të përditshme, në atë rast marrin dimension tjetër. Bëhen kujtime, histori, ngjarje të rëndësishme. Ja, para disa ditësh më ka rënë ndërmend një gjë tjetër, Bujar.

- Në lidhje me çka?

- Mu kujtua një ngjarje tjetër. Vetëm disa muaj para se të ndodhte tragjedia. Ti ishe i preokupuar me studimet...

"I preokupuar me tradhtinë që ta kam bërë ty, juve të gjithëve" mendoi atëbotë Bujari dhe iu ngushtua shpirti.

- … ajo po i binte pianos. Hyra ta ftoj që të pimë nga një kafe, por u habita sepse dhoma dukej shumë e errët. E pyeta pse qëndron në errësirë dhe shkova të hap perdet. Nuk mu përgjigj fare. Por pas pak më tha:

"A e di, mama, që thonë se ka ca njerëz që jetojnë nën tokë?".

"Jo, i them, po ti pse mendon në kësi gjëra dhe krijesa të frikshme?".

"Jo, mama,- më tha,- ata janë njerëz të mirë, por janë shumë të brishtë dhe vdesin nën rrezet e diellit. Nuk e durojnë dritën. Ndaj kur ne flemë, ata dalin dhe kryejnë punët e tyre mbi tokë, të thuash janë si shpirtra. Ndërsa me agun e parë i kthehen jetës në errësirë".

Hapa perdet me fuqi.

“ Dhe ti dëshiron të solidarizohesh tani me miqtë e tu nën tokë?” i thashë.

“ Desha ta di si ndjehen,- më tha dhe pastaj vazhdoi:- Në fakt unë e di si ndjehen”.

Nuk e mora seriozisht dhe i thashë:

“ Hajde, mjaft me përrallat, po ec e pimë kafenë së bashku”

- Po pastaj? E përmendi më këtë? Mua s’ma paska thënë kurrë. A thua pse ta ketë sajuar këtë? - fliste si për vete Bujari mjaft i hutuar.

- Ndaj dhe të thashë, se m’u kujtua para ca ditësh përsëri kjo. E di çfarë erdha në përfundim? Se ajo më ka folur për veten e saj.

Bujari e pa me habi.

- Po, po. Për veten, Bujar. Donte të më thoshte se ajo ishte shumë e brishtë për këtë botë të vrazhdë. Mu sikurse njerëzit e errësirës me dritën e fortë të diellit.

- Je e sigurt për këtë?

- Më se e sigurt. Dorina ka pasur shpirt artistik dhe në këtë mënyrë ka shpjeguar gjërat që e kanë munduar. Thuajse ia ka parandier zemra se së shpejti do të shkojë… nën... nën….

Besa filloi të qante pa zë.

I shoqi ishte shumë i prekur dhe vazhdonte ta ndjente thellë e më thellë thikën e brejtjes së ndërgjegjes. Ai nuk kishte ditur asgjë për Dorinën e tij, as për telashet, as për hallet, as për gëzimet, as për brengat. Kishte qenë shumë i preokupuar me gjërat e tjera, një herë shkenca, pastaj... pastaj ai flirt i mallkuar. Ndërsa ajo, ah ajo… e mira, nuk kishte dashur ta mundojë me asgjë, e kishte kursyer.

Bujari po shikonte se si Besës i binin lotët pikë-pikë me një pjesë të dyshemesë. Papritmas ndjeu zërin ngashërues të saj:

- Atë ditë që ka vdekur, kanë vrapuar njerëz që ta nxjerrin nga vetura. Ka qenë edhe për disa minuta e gjallë. Dikush është kujtuar ta pyesë kush ishte, që ta lajmërojë familjen. Dhe e di çfarë ka ndodhur? Dorina ka hapur sytë me mundim dhe ka thënë: “Unë jam hëna dhe dielli i babit tim”. Dhe pastaj i ka mbyllur sytë përgjithmonë.

Bujarit i ra tavani mbi kokë. Ajo kishte folur për të me frymën e fundit, ndërsa ky shtrihej si një maskara nëpër ordinancat e ndyra dhe ia dhuronte paratë e shkollimit të saj një mashtrueseje të bukur”.

Ngriti kokën me mundimin e njeriut që po i shqyhej shpirti, por u trondit nga pamja që pa në fytyrën e Besës. Ajo po e shikonte pa asnjë emocion. Seç kishte një hije përçmimi a hakmarrjeje në të. Dukej sikur kënaqej me vuajtjen dhe torturën e tij, thuajse e kishte pritur këtë moment me shekuj.

- Po pse, pse s’ma keni treguar këtë deri tash? Pseee? – bërtiti Bujari si bisha e plagosur dhe kapi flokët me dorë.

- Nuk ishte koha e duhur që të vuash.

Bujari humbi ndjenjat dhe u shemb në dysheme.

XII

“Ha, ha, u ktheve përsëri vrasës,- thoshte hija që e ndiqte. Të kam thënë, do vrasësh pjesën më të mirë të vetes tënde, të kam thënë….

“ Por unë…unë nuk e kam mbytur... ti... ti ke vrarë çdo gjë në mua… më mbyt krejt tani”.

“ Jo, ti nuk e meriton vdekjen… duhet të vuash… të vuash… pleh”.

“ Do të vuaj tërë jetën, vetëm ma kthe Dorinën, më jep një shans ta shoh…oh, nëna ime…”.

“ Unë jam ti, jam vrasës dhe jo engjëll… jam ti, ti, ti... .

Hija e kapi për krahu dhe Bujari u frikësua shumë. Ndjeu një dhimbje të madhe dhe pa se ia kishte ngulur thonjtë në mish. Por nuk i dilte gjak… vetëm dhimbje, dhimbje…

“Ma lësho krahun”, bërtiste Bujari, por ndjeu se thonjtë iu ngulën edhe më thellë diku afër zemrës.

Hapi sytë ngadalë. Akoma po ndjente dhembje në krah kur pa se dikush po ia jepte një injeksion në të. Gjërat dukeshin të mjegullta, por arriti të shihte fytyrat e njerëzve rreth tij. Ishin Diamanti, Besa, Shpëtimi dhe një burrë tjetër, që po ia jepte barin qetësues.

- Çfarë… çfarë ka ndodhur? - pyeti me mundim.

- Qetësohu, Bujar, ke pësuar thyerje nervore. Do të kalojë shpejt. Ky është miku im mjek, psikiatri që ta pata preferuar, të kujtohet?- dëgjoi si nga larg zërin e Shpëtimit.

Shikoi mjekun që nuk ishte fare në të bardha. Kishte mjekër të mirëmbajtur bukur gjithë thinja dhe po i buzëqeshte nën syzet e vëna më poshtë syve. Bujari u mundua t’ia kthente buzëqeshjen, por nuk kishte forcë.

- Dua…dua të vdes… doktor, me lejo të vdes…

- Të gjithë do të vdesim, – i tha mjeku me ngrohtësi,- po jo tani ama. Tani duhet të shëroheni një herë. Pastaj shohim,- ia mbylli syrin me shaka.

Besa po shikonte jashtë dritares, por mund t’ia dallonte sytë e përlotur nga profili i saj. Diamanti e shikonte dhimbshëm të atin dhe ia fërkonte ballin.

Ai përsëri po zhytej në gjumë të thellë sikur në një det të pafund.

Kur u zgjua përsëri, ndjehej më mirë. Ishte vetëm në dhomë. U ngrit ngadalë dhe shkoi në dhomën tjetër. Në tavolinën e kuzhinës po drekonin të gjithë.

- Baba! U zgjove! Je më mirë?- vrapoi Diamanti dhe e zuri përkrahësh.

- Po, po ... më mirë jam. Mos u shqetëso, s’më gjen gjë mua.

- Eja ulu edhe ti ha ndonjë gjë, forcohesh.

Bujari u ul. E kishte kokën të rëndë. Besa ia solli pjatën e tij.

- Je më mirë?- e pyeti pak ftohtë.

- Po, - i tha ai pa e shikuar dhe filloi të hante.

- Bujar, tani po bisedonim me doktor Lumin, duhet t’ia fillosh një psikoterapie sa më shpejt,– i tha Shpëtimi.

- Ju… ju quheni Lum? – pyeti Bujari.

- Po. Lum Burimi. Disa hutohen e më thonë Burim Lumi, gjë që duket më e logjikshme, apo jo?- pyeti me humor dhe të gjithë qeshën.

- Interesante vërtetë. Më pëlqeu shumë emri juaj. Pra, ju mendoni se kam nevojë për psikoterapi? Po flisni për seanca, ku duhet të shtrihem e t’ju flas për veten?

- Po. Mos e merrni aq kiamet këtë gjë, Bujar. Njerëzit në Perëndim shkojnë te psikiatri edhe për ta pyetur sa kafe të pinë në ditë. Eh, sa mirë do të ishte kështu! Do të ndërtoja një pallat me gjithë ato para,- përsëri bënte shaka mjeku enkas për të krijuar një atmosferë qetësuese.

- Po çfarë do të bisedojmë?

- Çfarë të mendoni ju se duhet të më tregoni. Do t'ia nisim qysh javën tjetër. Mos u shqetësoni fare. Asnjë thyerje nuk zgjat përgjithmonë. Jam i bindur se vetë do vini në shumë përgjigje që i keni kërkuar.

- Me ndihmën tuaj, ama.

- Unë vetëm do t'ua tregoj drejtimin e duhur. Ju do t'i gjeni vetë përgjigjet rrugës.

- Do më jepni barëra?

- Nëse do të keni nevojë, po. Pse pyesni?

- Paj disi nuk kam marrë barëra shpesh.

- Barërat janë për t'u ndihmuar njerëzve. Në rastin tuaj, ndoshta duhet të merrni ndonjë dozë më të vogël, por që do ta zgjasë më shumë trajtimin. Ju keni nevojë për barëra, madje është dashur të vini më herët. Nuk është puna se te çrregullimet shpirtërore janë fajtore vetëm mendimet e këqija. Ato vijnë pikërisht nga çrregullimi i bilancit kimik në trurin tuaj. Barërat ndihmojnë mjaft edhe në kombinim me seancat që do të bëjmë, mendoj se do ta arrijmë qëllimin e duhur. Pas ca kohësh do të ndjeheni i rilindur, me forca të reja.

- Mirë. Pajtohem, – tha Bujari, – por një gjë më vjen ende çudi.

- Çfarë, ashtu?

- Kjo që quheni Lum.

- Aha. Po pse ashtu?

- Paj. Lumi është si një emër i shenjtë për mua. Kur isha i vogël ia tregoja të gjitha sekretet e mia lumit që rridhte skaj shtëpisë. E kisha mikun më të mirë… dhe tani… tani ja përsëri duhet të bisedoj me Lumin.

- E sheh? Asgjë nuk është e rastit në këtë botë, – i tha mjeku.- Ndonjë herë fati i fut duart e tij në jetën tonë dhe na i rregullon gjërat ashtu sikur ne nuk e kemi menduar. Do të isha i lumtur nëse arrij të bëhem miku juaj ashtu sikurse e keni pasur lumin e vërtetë.

- Ashtu shpresoj dhe unë,- tha Bujari.– Tani kam nevojë për miq, çështja është se a i kam merituar?

- Nuk keni nevojë vetëm ta meritoni ndihmën, ju keni të drejtë në të, – i tha mjeku.

- Ti ke një grua të mrekullueshme, çfarë të duhen miqtë e tjerë? – i tha Shpëtimi, - Kur kujtoj gruan time të ndjerë, e di se edhe po të jetoja dy jetë të tjera, do ta kisha vështirë të gjeja një mike të tillë. Je me fat, mik.

Bujari ndjeu të nxehtit që po i shkonte faqeve. Nuk guxonte ta shikonte as Besën, as Shpëtimin.

- Do të vij qysh prej javës tjetër në ordinancë, – i tha mjekut.- Më caktoni orën.

- Shumë mirë, ju pres të hënën në ora dhjetë. Deri atëherë, pushoni.

***

Bujari ishte shtrirë sërish kur Besa i solli çajin e ngrohtë.

- Pije, është kamomil me mjaltë, – i tha.

- Faleminderit. Do të dalësh sot pasdite?

- Jo, sot jo.

- Por mjeku të ka thënë të ecësh. I ke bërë analizat që të pati thënë? – e pyeti me ndrojtje.- Duhet ta ruash shëndetin.

Iu duk se në fytyrën e Besës pa një vello mllefi e mërie bashkë. Kujtoi sërish natën kur e kishte bërë të zvarritej pas tij e sëmurë nëpër shi. Ishte më se i sigurt se as ajo nuk e kishte harruar. Madje i dukej se tamam nga kujtimi i keq i asaj nate, ajo po e dënonte veten duke mos shkuar më te mjeku. Gruaja qëndroi pak pa folur, e pastaj tha:

- Me rëndësi është shëndeti yt njëherë. Unë mund të dal edhe ditëve të tjera.

- Po Diamanti është këtu?

- Doli me Mimozën deri në bibliotekë, të duhet gjë?

- Po. Dua ta lus diçka.

- Mirë, atëherë prit sa të kthehet.

Bujari u ndje keq. Gruaja s'po tregonte as kureshtjen më të vogël për atë që kishte për t'i thënë Diamantit. Megjithatë, përpiu krenarinë dhe tha:

- Mund të të lus edhe ty, ndoshta më ndihmon.

- Nëse mundem, pse jo, më thuaj ku qëndron puna.

- Dua të shkoj te shtëpia e Jetës, e vogëlushes së varfër. Dua ta vizitoj atë dhe babanë e saj të sëmurë. Më duhet vetura e Diamantit, meqë e jona… - u ndal pak e pastaj shtoi:- … Pastaj nuk jam ende i fortë të ngas veturën.

- Mirë, por forcohu një herë, pastaj shohim.

- Jo, dua të shkoj qysh nesër. Por s'jam i fortë të shkoj vetëm, ndaj doja të vinit me mua.

- U bë, pra, shkojmë nesër, pasnesër, kurdo që të ndjehesh i fortë.

***

Pas dy ditëve ishin gati. Ishte pasdite kur u nisën. Shiu nuk ishte ndalur prej mëngjesit. Dukej thuajse dita fare nuk kishte ndryshuar fazat e saj: ishte e zymtë gjithë kohën.

Besa kishte marrë me vete një shportë të madhe me ushqime dhe dy valixhe me rroba. Kur u afruan te lagjja e të varfërve, siç e quanin njerëzit e qytetit, vetura e Diamantit filloi të toroshitej si karrocë nga gropat e shumta në rrugë, shumica e tyre plot baltë e ujë. Rrugës dukeshin shtëpi të vjetra, gati të rrënuara. U ndalën aty ku i kishte udhëzuar Jeta dhe trokitën në derën e një shtëpie të vogël prej balte. Nuk u përgjigj askush dhe i Diamanti trokiti më fort.

- Ndoshta nuk na dëgjojnë ose janë në gjumë, – tha Besa.

- Po e hap pak derën,– tha Bujari dhe e shtyu ngadalë dërrasën e vjetër që zëvendësonte derën e hyrjes.

Dhoma e errët dhe gjithë erë myku nisi të ndriçohej nga pak. Ishte një mjedis tejet i varfër: në një skaj ishte një shporet nga llamarina e vjetruar, ndërsa tutje ca enë. Në skajin tjetër ishte një shtrat dhe mysafirët panë të shtrirë një njeri me sy të mbyllur. Jeta dukej se nuk kishte qëlluar aty. Të gjithë shikuan njëri-tjetrin pa ditur çfarë hapi të ndërmerrnin më tutje. Nuk e kishin menduar fare si do të rridhte ngjarja. Pastaj Diamanti sikur u kthjell:

- Zotëri! – e thirri të sëmurin, - po flini?

- Kush jeni ju? – provoi të bërtiste burri dhe hapi sytë, që i ishin fundosur në ca gropëza gjithë ngjyrë të zezë rreth tyre. Fytyrën e kishte të verdhë dyllë, ndërsa buzët të mavijosura.

- Ne jemi miqtë e Jetës, vajzës suaj.

- Ah,- buzëqeshi hidhur i sëmuri. – Jeta paska miq? Paskam menduar se na ka harruar edhe vetë Zoti.

- Jo, jo... do të bëheni më mirë, mos u brengosni. Po ku është ajo?

- Ka dalë për të shitur ndonjë gjë, sigurisht. Madje mendon se unë nuk e di për çfarë del. E gjora bija ime, mendon se me ato para mund të më sigurojë transplantimin e veshkës. Ka filluar edhe të kursejë, çdo ditë më tregon një kuti me monedhat e saj.

Besës iu mbushën sytë me lot.

- Ajo nuk dëshiron t'ju humbasë, ju do për së tepërmi,- i tha.

- Po. Nuk mund ta paramendoni sa me faj ndjehem që jam i sëmurë. Në vend që të bëj babanë për të, ajo po bën prindin për mua. E në këto kushte që kemi… më dhimbset fëmijëria e saj. Do të doja të vdisja, që të mos më ketë më barrë.

- Jo, jo kurrsesi, asaj do t'i mungonit shumë pastaj. Duhet të luftoni shkaku i saj.

- Zonjë, sot askush nuk të hap derën po nuk pate para. Jetojmë në ferrin e kësaj bote.

Besa pohoi me kokë. Dhe pastaj tha:

- Ju jeni i ri. Gjithsesi do t'ia dilni. Së paku për shkak të Jetës. Ajo ka nevojë për ju.

Befas u dëgjua një vaj i heshtur, por gjithë ngashërim. Të gjithë kthyen kokën dhe panë vogëlushen që kishte hyrë pa u vërejtur. Kishte zënë fytyrën me duar dhe po qante.

- Oh, bukuroshe, ç'të bëra unë kështu,- iu afrua Besa dhe e mori pranë vetes - Mos qaj, babi do bëhet më mirë, ta jap fjalën… Eja, mos qaj tani… shih çfarë të kam sjellë,- dhe Besa filloi të nxirrte gjësendet. Pas pak filloi të pastronte nëpër dhomë, ndërsa Bujari u ul në skaj të shtratit.

- Si është puna juaj? Çfarë ju thonë mjekët?- e pyeti ai babanë e Jetës.

- Veshkat e mia nuk punojnë, jam i varur nga dializa. Dy herë në javë vijnë ata të spitalit, më marrin në veturë, më dërgojnë në spital dhe pas dializës më sjellin prapë këtu. Iu dhimbsem edhe atyre, por nuk kanë çfarë të bëjnë. I vetmi shpëtim për mua është transplantimi i veshkës, por për këtë duhen para. Pastaj duhet gjetur një dhurues me grup të njëjtë gjaku dhe duhet udhëtuar jashtë vendit për ta bërë transplantimin, sepse këtu te ne ende...

- Çfarë grupi ke?- e pyeti Bujari pa e lënë ta kryejë fjalën.

I sëmuri i tregoi. Kishte grupin e njëjtë si të Bujarit e Diamantit.

- Sigurisht duhen përshtatur edhe gjëra të tjera,- i tha.

- Po, sigurisht,- tha babai i Jetës.

- Do e lejosh Jetën të na vizitojë në shtëpinë tonë?- e pyeti Besa të sëmurin.

- Gjithsesi, ju faleminderit. Ajo ka nevojë për ngrohtësinë e njerëzve.

Ndenjën edhe pak dhe pastaj u përshëndetën me premtimin se do t'i vizitojnë së shpejti.

...

Rrugës të gjithë ishin të heshtur. Gjendja e mjerueshme e këtyre njerëzve i kishte prekur thellë.

Bujari tërë kohën po mendonte si ta ndihmonte këtë njeri dhe bijën e tij.

- Do ta pyes Shpëtimin në mund të bëjë gjë,- tha dikur.

- Po baba, sigurisht se ai mund të gjejë ndonjë zgjidhje. Sa e lezetshme ajo vajza, më kujtonte Dorinën.

- E kam ftuar të na vijë nesër për drekë,– tha Besa.

... ..

Me të arritur, Bujari ia mësyu derës së Shpëtimit.

- Mik, dua të të kërkoj një nder,- i tha.

- Fol, Bujar.

Bujari i tregoi për Jetën e vogël, se si ajo ishte aq e varfër e se si i ngjante Dorinës, sa ua nxori mallin e saj; i tregoi për gjendjen e babait të vogëlushes, për varfërinë e skajshme të tij, për sëmundjen e tij...

Shpëtimi e kishte dëgjuar me shumë vëmendje.

- Do të bëj ç'është e mundur, Bujar, qysh nesër do të interesohem. Por, këto gjëra vërtetë kushtojnë shumë.

- Do ta bëjmë një zgjidhje, Shpëtim…Unë… unë jam në gjendje ta shes edhe shtëpinë e të kaloj në ndonjë apartament më të vogël. Dua ta ndihmoj këtë familje të mjerë, dua ta bëj këtë. Nuk e di pse, por e kam ndjerë këtë gjë qysh në momentin e parë.

- Më vjen mirë për ty, Bujar. Kjo që mendon të bësh nuk është një gjë e vogël, nuk e bëjnë të gjithë. Unë jam mjek dhe e di se ç'do të thotë. Do të mundohem shumë, më së shumti për shkakun tënd.

- Ti ke bërë për mua shumë edhe deri tani.

- Mirë. Do bëj çfarë të mundem, do të nis qysh nesër. Por tani më lër, sepse kam kohën e shëtisë.

- Edhe ti?

- Ka kohë qe dal për të ecur pasditeve.

- Bën mirë. Atëherë mirupafshim.

Kur u kthye në shtëpi gruaja kishte dalë. Diamanti po lexonte një libër dhe, posa e pa, u ngrit në këmbë.

- Baba, duhet të pushosh më shumë. E di se çfarë të ndodhi dje? Çdo gjë hap pas hapi. Mos i merr gjërat me vrull.

- Ke të drejtë, Diamant. Kur e mendoj vitin e shkuar më duket se nga një lum i qetë që shkonte rrjedhës së vet të sigurt, papritmas u derdhëm në një ujëvarë të paparashikuar e të frikshme, e cila na hodhi sa andej-këndej kthesave të frikshme e të panjohura. Duhet kohë ta marrim veten.

- Po, baba. Por shpresoj vërtetë t'ia dalim. Baba, - tha përsëri - kur të forcohesh pak, kam diçka për ta biseduar me ty. Nuk është urgjente, por kam nevojë për mendimin tënd.

- Thuaje, bir!

- Jo, ka kohë…nuk është asgjë e rëndësishme. Tani për tani ke nevojë për rehabilitim, të gjithë kemi.

- E vërtetë. Po nëna jote doli?

- Po, – dhe pastaj sikur u kujtua diçka dhe tha:- U gëzova që e vuri përsëri shallin e saj të njohur me lule. Ishte koha ta hiqte shallin e zi. E pashë se hamendej, por e vuri. Tani dukej përsëri mami im.

- Shallin me lule? – pyeti i përhumbur Bujari.

- Po. Atë që e vinte gjithmonë para zisë. Ia pati dhuruar Mimoza në ditëlindjen e Dorinës.

Bujarit iu duk thuajse e shpoi diçka në bark. Pse i ngjallte një farë ndjenje jo të mirë ky shall me lule? Ia kujtonte ndonjë gjë? Doli në kopsht prapa shtëpisë dhe u ul në vendin e tij. " Shalli me lule… shalli me lule"...

Befas u kujtua ç'i kishte thënë Natyra atë mbrëmje kur po i tregonte se e tradhtonte burri:

"Po, ama një mikja ime më mori të nesërmen në telefon dhe më pyeti kush ishte ajo gruaja me të cilën e kishte parë në një park… Ajo kishte supozuar se ishte ndonjë e afërme e imja… me që siç tha, dukeshin shumë të afërt dhe gruaja kishte pasur një shall me lule mbi kokë, ndaj nuk ia kishte parë fytyrën…".

Bujari u ngrit vrik përpjetë dhe filloi të shëtiste nëpër kopsht.

“Është pothuajse tullac dhe pakëz i plotë, mban një mjekër të prerë bukur, ka vetulla të trasha dhe të ngrysura që strehojnë dy sy të kaltër, është pak më i shkurtër se Natyra…”,- i kujtoheshin edhe fjalët e Besës në fillim të njohjes me çiftin fqinj. Nga e njihte ajo aq mirë Shpëtimin? Si nuk e ka vërejtur ky këtë? Hë!.. Shiko, shiko. Dhe ai mendonte se është naive, budallaqe…

Ti ke një grua të mrekullueshme, çfarë të duhen miqtë e tjerë?- iu kujtuan tani fjalët e Shpëtimit.

“ Maskarai”.- shau me vete.

“Është vërtetë njeri i mirë dhe i gjithanshëm, duket se ka edhe një pasuri të madhe. I pëlqen të udhëtojë, të shohë filma të mirë, e do muzikën klasike dhe artin në përgjithësi, i pëlqen të ndihmojë njerëzit në nevojë dhe ligjëron në disa universitete botërore. Ka disa apartamente brenda e jashtë qytetit, është shumë i kulturuar dhe i matur. Vërtetë shumë pak kanë mbetur njerëz të tillë sot; Diamant duhet të marrësh gjithmonë shembull nga të tillë njerëz, bir; edukata dhe kultura janë thesar për çdo njeri”- përsëri kujtohej se ç’i thoshte ato ditë Besa Diamantit, dhe se si ai vetë ishte bërë aq xheloz duke parë se ajo po i jepte aq shumë vlera këtij zotit Shpëtim.

“O Zot, si nuk e paskam kuptuar më herët. Ata të dy dalin çdo pasdite bashkë. Shëtisin, kushedi ku shkojnë… ndoshta në ndonjë apartament të tij. Kjo e shpjegon edhe gatishmërinë e Shpëtimit të na ndihmojë në çdo situatë… Hë, maskarai!!! Ndërsa unë e mendoja burrë të ndershëm. Më paska mashtruar. Më kanë mashtruar të dy… të gjithë po më mashtrojnë… e kam merituar, e kam merituar….” dhe pastaj përsëri u kthjell:

“Po Natyra? A thua Besa e dinte edhe për Natyrën? Gjithë ai qëndrim i saj armiqësor e ai mllef i brendshëm ndaj tij duhej ta kishte një përgjigje. Zot! Shpëtimi e Besa. Kush e kishte menduar!..

“Do ta përcjell nesër kur të dalë për shëtitje. Do ta ndjek, që ta vërtetoj përfundimisht. Sonte nuk do t’i them asgjë” tha me vete dhe hyri brenda.

- Po shkon të shtrihesh, baba?
- Po, Diamant. Mos më zgjoni për darkë.

XIII

Kah ora njëmbëdhjetë cingëroi zilja e derës. Besa fluturoi ta hapte. Kishte një disponim të mirë, dukej tërësisht fare e kthjelltë, sikur një njeri që kishte gjetur sërish arsyen për të jetuar.

Para saj ishte Jeta, vogëlushja e varfër, me një pamje të turpëruar. Ishte munduar të pastrohej, ishte krehur mirë, veshur në një fustan që ia kishte dërguar Besa, kur ishin atë ditë tek ata për vizitë.

- Mirë se na erdhe, – i tha Besa dhe e përqafoi. Vajza ngurronte një herë, por pastaj hapi duart dhe ia hodhi në qafë.
- Mirë se ju gjej,- tha e qeshur.
- Sot na ka ardhur mysafirja më e dashur. Bujar, hajde ta përshëndesësh.

Bujari u afrua dhe ia shtriu dorën. Posa mori doçkat e saja të buta në shuplakën e tij, ndjeu se po i vinte vaji, por u përmbajt.

- Eja vogëlushe,- i tha,- do kalosh sot ditën me ne?

Jeta pohoi me kokë

- Sa mirë! Së pari do të ta tregoj shtëpinë dhe kopshtin. Pastaj do të vijë edhe xhaxhi Diamanti me nusen e tij të ardhshme dhe do hamë së bashku. Mirë?

- Mirë,- tha vajza.

Bujari e mori për dore ta shëtiste, ndërsa Besa u përlot nga gëzimi kur i shihte bashkë.

" Sa shumë jetë sjellë një krijesë kaq e vogël", mendoi.

Jetës i pëlqeu shumë shtëpia. Dalëngadalë filloi të lëshohej, dukej e qetë, thuajse kishte i harruar të gjitha brengat. Sa herë qeshte me zërin e saj melodik dukej sikur po fluturonin notat e muzikës. Shtëpisë po i kthehej gëzimi me hapa të vogla.

Pas pak ia mbërritën edhe Diamanti me Mimozën. Ai e mori menjëherë Jetën në grykë.

- Ma jep pak mua,- i tha në çast Mimoza.

- Jo, s'ta jap.

- Po kjo ishte me mua, – tha Bujari.- Pse doni të ma grabisni?

- Dhe tash do të vijë me mua, sepse është koha që ne të dyja të bëjmë diçka bashkë,- tha Besa duke e marrë Jetën përdore.

Jeta i dha dorën dhe hynë brenda.

- Do të ta tregoj pianon, të pëlqen? – e pyeti Besa kur u gjendën brenda në dhomë.

- Nuk e di, nuk kam parë kurrë prej së afërmi një piano.

- Po televizor keni?

- Po, por nuk punon prej kohësh.

- Mirë.

Besa u ul pranë pianos dhe e mori në prehër. Ia mori duart Jetës dhe ia vuri mbi tastierë, ndërsa duart e saj i mbështeti mbi ato të vogëlushes. Nga pianoja nisën të dalin notat dhe muzika filloi të mbushte dhomën, ndërsa Jeta ishte mahnitur aq shumë me instrumentin, sa që nuk bënte asnjë lëvizje. Vetëm përcillte gishtat e saj, që po krijonin melodinë, e cila i përngjante nga pak në ninullat e gjyshes. Gjyshja i kishte vdekur tri vite më parë.

- Si thua, është bukur? – e pyeti Besa.

Vogëlushja pohoi me kokë. Sytë po i qeshnin dhe vetëm një shikim mbi fytyrën e saj e bënte ditën më të bukur. Derisa vazhdonin, Besa ndjente ngrohtësinë e saj fëmijërore që ia mbushi shpirtin dhe dëshironte ta mbante aty përgjithmonë.

Te dera e dhomës kishin qëndruar edhe të tjerët dhe po kënaqeshin me pamjen e mrekullueshme mes një nëne, që po digjej nga malli për të bijën, dhe të një vashe që ëndërronte dashurinë e nënës. Ishte një pamje gati hyjnore.

- Xhaxhi Diamant, unë luajta në piano, – i tha Diamantit gjithë gëzim vogëlushja.

- Ta dish, je një talente e rrallë. Unë jam fansi yt i përjetshëm,- i buzëqeshi Diamanti me gishtin e ngritur tregues. Pastaj e mori përdore. - Do hamë tani?

Vajza u ngrys.

- Ç'ke? Nuk ke uri?

- Jo, por… mendoj në babin tim. Sot nuk i kam gatuar asgjë. Ai sigurisht është i uritur. Të gjithë u shikuan mes vete.

- Kur të të kthejmë në shtëpi, do t'i dërgojmë edhe babit tënd për të ngrënë nga të gjitha ato që kam përgatitur për ne,- i tha Besa. – Madje do t'i dërgojmë më tepër që të ketë për disa ditë,- shtoi pastaj.

Fytyra e vajzës u hap si qielli pas shiut. U ul në karrige dhe filloi drekën më të këndshme që do e kishte provuar në jetë.

….

Derisa Diamanti po ia shpjegonte Jetës një film për fëmijë, Besa po lante enët dhe ishte gjithë mendime për vogëlushen:

“ Ta dërgoj në dhomën e Dorinës? Është herët? T’ia fal ndonjë rrobë të saj kur ka qenë e vogël?”. Çfarë do të thonë të tjerët?”. Ishte pak e tendosur kur ndjeu se i ra një gotë nga dora e u thye copë-copë.

- Mama, je mirë? – vrapoi Diamanti i brengosur.

- Po, bir, mirë jam, – buzëqeshi Besa.- E kam nga gëzimi që na ka ardhur Jeta.

Pastaj mori vogëlushen për dore dhe tha:

- Të na falni pak, se tash kemi ca biseda sekrete me Jetën, – dhe i shkeli syrin vajzës.- Do të vish edhe ti, Mimoza? Vetëm vajzat lejohen.

Mimoza e shikoi me plot mirëkuptim. Pastaj sikur e kuptoi dhe tha:

- Shkoni ju të dyja më mirë. Unë do bëj kafetë.

Besa mori vogëlushen dhe u ngjitën lart.

- Dëshiron të bësh banjë?- e pyeti.

- Po… por nuk di si…

- Mirë, unë do të të ndihmoj, e? Hajde sa bukur kanë për t’u bërë flokët.

Besa e mbushi vaskën plot me ujë e shkumë dhe ia vuri brenda ca lodra plastike të Dorinës. Edhe pse e rritur, Dorina ruante pjesën e saj fëmijërore brenda shpirtit dhe i pëlqente të mbante lodra në gjithë shtëpinë.

“ Po kur të martohesh çfarë do bësh me këto lodra pastaj,- e pyeste e ëma.- Mendon se burri do të t’i durojë çapkënllëqet e tua?”.

“Atëherë do ta kem burrin lodër” – qeshte Dorina dhe sakaq kapte arushin e saj prej pelushi dhe vallëzonte me të sikur për inat të s’ëmës.

Besa ishte në mendime dhe pavetëdijshëm po buzëqeshte me të bijën sikur të ishte aty para saj.

- Po ju a keni vajzë ? – sakaq e tronditi zëri i Jetës.

- Vajzë? Po… kam… kam pasur…

- Ku është?

Besa i tregoi qiellin nga dritarja.

- Atje lart, në qiell.

- Por çfarë bën ajo atje tani?

- Na shikon neve dhe qeshet. Ajo ka qenë shumë e hareshme. Tani është në një vend më të bukur se ky këtu.

- Bashkë me nënën time?

Besa e shikoi me dhimbsuni.

- Po, shpirt, bashkë me nënën tënde. Të mungon shumë nëna?

Vajza pohoi me kokë.

- Edhe ti asaj i mungon shumë, sigurisht. Por, derisa ta keni njëra-tjetrën në zemër, do të jeni afër. Ja, sikur e mbaj unë Dorinën time,- ia mori dorën dhe e vuri te zemra e saj.– Ti je pjesë e nënës tënde sikurse është ajo pjesë e jotja tani, me që jeton brenda zemrës tënde, e kupton?- u mundua t’ia shpjegonte më mirë vogëlushes, e cila po e shikonte në sy thuajse dëshironte ta gjente një shpjegim të mirëfilltë për humbjen e nënës.

- Po- dhe vajza instinktivisht preku zemrën.

- E sheh? Aty është. Aty do të jetë përgjithmonë.

Jeta ishte një vajzë shumë e zgjuar dhe e pjekur për moshën e saj. Edhe babai i saj kishte qenë mësues i historisë, por ishte dashur ta linte punën për shkak të sëmundjes. Një herë kishin jetuar më mirë, me që gjyshja punonte qilima. Por pas vdekjes së saj, gjërat ishin rënduar, njësoj si sëmundja e babait.

Jeta ia tregoi Besës të gjitha këto pothuajse me një frymë. Pastaj sikur u lehtësua nga një barrë e rëndë dhe u shndërrua menjëherë në një fëmijë pa brenga:

- Do m'i krehësh flokët?

- Posiiii. Kam për të të bërë si kukull, si artiste filmash.

Besa e lau Jetën mirë e mirë, siç e lante Dorinën kur ishte e vogël, dhe përsëri humbi në kujtime:

"Më mirë më lan babi, se ti. Ti gjithmonë më fut sapunin në sy. Babi më fërkon vetëm deri te fyti,- ankohej Dorina e vogël, – ndërsa ti ma bën fytyrën me sapun….".

" Por babi nuk të fërkon mirë… më shumë argëtoheni, sesa që të heq baltën" – i thoshte e ëma.

" Ndaj dhe po të them se më lan më mirë... Ti... ti ma gërryen lëkurën…".

Besa buzëqeshi dhimbshëm me kujtimet e saj.

" Ah, bija ime….ku je tash!".

Ofshau thellë dhe pastaj filloi ta krihte Jetën. Ia thau flokët mirë, ia mblodhi dhe i vuri ca kopsa me ngjyra. Vajza dukej e lumtur dhe shikohej në pasqyrë. Nuk bënte asnjë lëvizje nga frika mos po prishte ndonjë gjë.

- Më duket se kam shkuar te floktarja, – i tha Besës.

- Tamam. Je bërë për të dalë në televizor.

Besa e mori dhe shkuan në dhomën e Dorinës. Vajza u ul te shtrati i saj, që kishte mbetur i paprekur nga dita kur e përcollën.

- Sa e bukur kjo dhomë, – tha Jeta. – Xhaxhi Bujari paska harruar të ma tregonte.

- Sigurisht ka harruar, – ia ktheu Besa dhe nxori nga dollapi një valixhe të madhe ngjyrë rozë. E vuri mbi shtrat dhe e hapi. Brenda kishte plot rroba të bukura të Dorinës nga mosha e saj e vogël.

" Do t'i ruaj për vajzën time", – e kishte zakon të thoshte e bija.

Besa u kthye kah Jeta:

- Do ta provosh ndonjë plaçkë?

Vajza e shikoi me ndrojtje.

- Mos u brengos, çdo gjë është në rregull.

Vogëlushja zgjodhi disa, por në fund vendosi të vishte një fustan të kuq me vija të bardha.

Dukej e mrekullueshme.

Kur zbritën shkallëve, të tjerët mbetën pa gojë. Bujarit iu tha fyti aq sa filloi të kollitej.

- E njihni këtë gocë? – pyeti Besa duke e mbajtur për dore.

- Uaaa, po ti qenke mis bota, – i tha Diamanti. – E di se je bërë bukuroshe e vërtetë?- i hapi duart për ta pritur t'i kërcente në qafë.

Vajza u skuq, por qeshej nga lumturia. Vrapoi si flutur dhe i përqafoi të gjithë me radhë.

Kur Besa mori kafenë që ia solli Mimoza, ndjeu se Bujari erdhi ngadalë dhe u ul afër saj.

- Besa…- i tha gati duke pëshpëritur…- je e sigurt për këtë gjë? Mendon se është koha?

- Po, koha është. Jam e sigurt se edhe Dorinës do t'i pëlqente kjo gjë. M'u duk se ndjeva shpirtin e saj në dhomë, kah i drejtonte duart e mia për t'ia dhënë rrobat e saj Jetës. Ti e di sa zemërgjerë ka qenë…

- Po. Epo mirë, atëherë.

Mbrëmja po afronte me shpejtësi. Vajza duhej të kthehej në shtëpinë e saj. Atëherë menduan ta përcjellin. Bujari mbeti në shtëpi, ndërsa të tjerët hipën në veturën e Diamantit. Besa kishte marrë shumë ushqime, ca batanije, çarçafë të pastër e gjëra të tjera të nevojshme. I biri u ndal rrugës në një barnatore dhe mori ca ilaçe për babanë e Jetës, për të cilat ia kishte treguar ai në vizitën e parë.

Kur arritën në kasollen e errët, Besës iu shtrëngua zemra. Babai i Jetës u mundua të lëvizte pak, por ishte shumë i dobët. E kishte pasur ditën e dializës.

- Si je sot, mik?- e pyeti Diamanti dhe ia vuri edhe një jastëk nën kokë.

- Mirë, mirë… po ju si kaluat? Jeta, u kënaqe ti sot?

- Oh, babi, sa shumë jam kënaqur! Kemi shëtitur, pastaj kam lozur, teta Besa më ka larë në vaskën plot me lodra. Pastaj kemi ngrënë shumë gjëra të mira, ja, ja edhe ty t'i kemi sjellë… pastaj teta Besa më ka dhuruar rroba të bukura….- vazhdonte vajza të fliste pa u ndalur.

- Oh, oh ndalu pak,– qeshi babai me gëzimin e së bijës.- Do m'i tregosh pastaj të gjitha një nga një, mirë? Tani do të flasim me miqtë e tu.

- Babai ka nisur të interesohet për rastin tuaj, zotëri…- Diamanti u ndal sepse u kujtua se s'po ia dinte emrin të sëmurit.

- Arben, më thirr Arben,- tha tjetri.

- Në rregull, Arben…, pra, babai po bën çmos për t'ju ndihmuar. Këto ditë do t'i përgjigjet miku i tij, i cili ka marrë përsipër të interesohet për ju.

- Ju faleminderit, ju faleminderit shumë, ju po bëni shumë për mua,– tha Arbeni dhe sytë i morën shkëlqim nën pikat e lotëve.- Kam menduar se në këtë botë nuk ka më njerëz të mirë…

- Edhe ju duhet të luftoni, patjetër do bëheni më mirë,- i tha Besa, e cila tashmë kishte sistemuar gjërat që i kishte sjellë.

- Ne duhet të ikim tani, eja të përqafosh tetën, – iu kthye Jetës, të cilën Mimoza po e mbante për dore.

- Do të vish prapë? Do shihemi përsëri?- e pyeti vajza me sy që të këpusnin shpirtin.

- Të jesh e sigurt se po. Ti je pjesë e jona tani.

- Më mban edhe mua aty? – e pyeti sërish Jeta duke ia prekur fustanin tek vendi i zemrës

- Përgjithmonë aty do jesh tash e tutje,- i tha Besa.– Tani mirupafshim, do të shihemi së shpejti.

Vajza e shtrëngoi fort dhe Besa ndjeu edhe rrahjet e forta të zemrës së vogël që i rrihte si zogut.

Mimoza e Diamanti po e prisnin jashtë tashmë.

-Mirupafshim edhe një herë,- tha Besa dhe kur po prekte rrezen e drunjtë për ta hapur, papritmas ndjeu zërin e Arbenit:

- Zonjë…

- Urdhëro, Arben,- u kthye dhe u afrua te shtrati i drunjtë.– Të duhet gjë? Ma thuaj lirisht.

- Desha t'ju them një gjë. Ju sot gëzuat një zemër fëmije dhe kjo është dhurata më e bukur që më keni bërë. Të jeni e sigurt se do të shpërbleheni së shpejti për këtë.

Besa buzëqeshi.

- Veç ju të bëheni më mirë. Të gjitha pastaj rregullohen.

- Ju gëzuat një fëmijë dhe juve do t'ju gëzojë jeta së shpejti. Jam i sigurt,- tha prapë Arbeni.

Besa heshti. Pastaj mori frymë thellë dhe tha:

- Ju faleminderit. Kisha vërtetë nevojë për një fjalë të mirë. Mirupafshim.

Rruga kaloi shpejt. Besa ndjehej keq që e kishte lënë Jetën dhe Arbenin e sëmurë, por njëkohësisht i lehtësohej shpirti se kishte bërë diçka mirë për ta, dëshironte me gjithë shpirt të vazhdonte kjo lidhje Të dy palët kishin nevojë për njëri-tjetrin në mënyra të ndryshme. Kur po dilnin nga vetura, ajo e vërejti se Mimoza e Diamanti po shikoheshin sikur kishin diçka për t'i thënë.

-Çfarë? Ka diçka që doni të ma thoni? – i pyeti

Mimoza heshti.

- Po mama, por mos u brengos. Nuk është kushedi çka. Po hyjmë një herë brenda sepse dua të jemi të gjithë, – iu përgjigj Diamanti.

Bujari po i priste gjysmë i shtrirë në kanape. Mendimet i kishte të përziera. Sa e bukur ishte Jeta, sa fëmijë i mbarë, sa shumë ia kujtonte bijën e tij. Duhej të bënte çmos për ta kthyer në shkollë sa më parë. Pastaj mendimet i fluturonin në tjetër anë: Të kishte gabuar në dyshimin e tij mbi Shpëtimin e Besën? Po si nuk e kishte vërejtur ky simpatinë e tyre të ndërsjellë? Që kur do të jenë nisur bashkë? Ndoshta edhe qysh në kohën kur ky flirtonte me Natyrën, ndoshta ai e ka larguar me qëllim atë? Jo, jo… ajo ia kishte marrë edhe paratë, jo… Si pra? Shpëtimi e kishte nxjerrë nga shumë situata, si mund t'ia bënte këtë gjë… ndoshta i hakmerrej se ky kishte flirtuar me gruan e tij të re? Sidoqoftë, sido që të kishte rrjedhur kjo simpati, marrëdhënia e tyre dukej se ishte fakt tanimë. Çfarë do të bënte ai tani, çfarë do të bënte?

- Erdhëm, baba - dëgjoi zërin e të birit që u fut bashkë me të tjerët në shtëpi.

- U kthyet? E takuat babanë e Jetës?

- Po. Ma tha edhe emrin, quhej Arben. Ishte i ri me moshë, sonte e vërejta ende më mirë, meqë mami ia dërgoi edhe një llambë më të fortë. Ishte i ri, por sëmundja e kishte plakur.

- Sigurisht. Eh, i shkreti…

- Je mirë baba sonte?

- Mirë jam, pse pyet?

- Më dukesh paksa i humbur në mendime.

Diamanti e Mimoza u shikuan përsëri.

- Baba, dje të thashë se kisha diçka për ta biseduar, por se çështja pret.

- Po, më kujtohet. Si është puna?

- Sonte mora një telefonatë se puna megjithatë u përshpejtua. Ndoshta nuk është momenti i duhur, por duhet ta bisedojmë. Prita sa ta përcjellim Jetën.

- Tregoju më Diamant, kështu po i tremb duke e zgjatur!- i tha Mimoza, ndërsa Besa pohoi me kokë.

- Baba, mama unë… unë dhe Mimoza do të nisemi pas disa ditëve për në Afrikë. Jemi paraqitur si vullnetarë në një mision humanitar të shoqatës botërore të Mjekëve pa kufi. Do të shërbejmë vullnetarisht dhe njëkohësisht do t'i vazhdojmë edhe studimet. Në të vërtetë, më mirë e thënë, unë do ta përgatis temën e diplomës nga përvoja që do të kem atje.

Besa e Bujari u shtangën.

- Në Afrikë? Je në vete, bir? Aq larg? Po ne, si do t'ia bëjmë ne pa ty, pa ju? – e pyeti Bujari gati i tmerruar.

- Baba, ti ke mamanë dhe unë nuk po shkoj në një planet tjetër. Është disa orë me aeroplan. Do të lajmërohem shpesh dhe do të vij dy herë në vit.

- Po si u bë kjo punë? Nuk na paske thënë gjë…

- Ka kohë që e kemi menduar, – foli Mimoza, – por nuk mund t'ju linim, me që ishit shumë të pikëlluar për Dorinën, edhe zotëri Bujari nuk ndjehej mirë. Kështu vendosëm ta shtyjmë për një kohë të pacaktuar…

- Por mbrëmë na lajmëruan se ishte afati i fundit t'i bashkëngjitkemi grupit me të cilin dëshirojmë të jemi,- e plotësoi Diamanti

- Por pse në Afrikë? Ku do të shkoni atje?.. ku do të qëndroni?.. Mendo pak për mua, Diamant! Për nënën tënde, ka shtypjen e lartë… Dëshiron të ndjehet më keq se kaq?- i tha Bujari me një dëshpërim të mbushur gjithë frikë.

- Baba, nuk është tërë Afrika xhungël ose shkretëtirë. Ne do të qëndrojmë fillimisht me një hotel e pastaj do na sistemojnë nëpër fjetoret e tyre. Do të qëndrojmë në qytet, por herë pas here do të udhëtojmë për të ndihmuar të varfrit, të sëmurët e të paaftët kudo ku të jenë. Njëkohësisht do të bëjmë studimet dhe pas një viti, ose pak më shumë, do kthehemi këndej… - pastaj uli kokën dhe të gjithë heshtën.

Befas e ngriti përsëri dhe iu drejtua së ëmës, e cila më shumë kishte heshtur.

-Mami, më fal nëse nuk kam menduar sa duhet në ju. Por edhe unë jam shumë i dëshpëruar për humbjen e motrës sime të vogël, ndaj kisha nevojë të largohem ca. Nuk dua t'ju lëndoj, por kjo është një punë që duhet ta bëjmë, duhet ta bëjmë si unë dhe Mimoza. E ndjejmë... Më falni nëse të hidhërova me këtë. Nuk do të shkoj nëse kjo ju bën të ndiheni edhe më keq se kaq. Nuk do të shkoj, do ju qëndroj pranë… nuk mund ta përballoj faktin se ju kam lënë të lënduar… harrojeni fare këtë muhabet… më fal mama… më fal edhe ti baba.

Bujari kishte varur kokën dhe nuk fliste fare. Mimoza e shikoi Diamantin në shenjë mirëkuptimi.

- Diamant, – foli Besa. – Unë jam e lumtur kur ti të jesh i lumtur, e di këtë?

I biri pohoi me kokë, i mbytur nga lotët që i kishin ardhur në grykë.

- Prandaj më dëgjo mirë. Ti merre Mimozën dhe shkoni ku jeni nisur. Ne do të jemi fare mirë. Fare mirë, kuptove? Prindi është i lumtur atëherë kur fëmija i tij ngrihet në këmbët e veta, kur bëhet zot i vetes… kur bëhet njeri. Unë dhe babi yt do të ndjehemi të lumtur, të plotësuar atëherë kur ju, fëmijët tanë, gjeni rrugën tuaj. Kur e dimë se ju kemi vënë në rrugë të mbarë. Atëherë kur do të krijoni familjen dhe çerdhen atje ku ndjeheni mirë. Ndërsa unë, ne, do të lumturohemi me gëzimin tuaj.

Bujari ngriti kokën dhe e shikoi Besën gjatë. Ku kishte qenë deri tani kjo grua e fortë, të cilën ai nuk e kishte parë? Si kishte mundur ta anashkalonte dhe të bredhte rrugëve si një adoleshent i papjekur pas simpatisë së parë? Tani ishte vonë. Ajo ishte ftohur prej tij, ndoshta dhe do ta braktiste shpejt… si Diamanti… si Dorina… si nëna e tij e re….

- Po ti ç'thua, baba? – e pyeti të atin Diamanti.

- Unë… unë… jam i lumtur për ju, por... dijeni se do të më mungoni pa masë,- tha Bujari dhe uli kokën

- Ju faleminderit,- i përqafoi të dy prindërit Diamanti dhe pastaj përqafoi edhe Mimozën.

- Ju jeni prindërit më të mirë në botë. Do t'ju kem tërë kohën në mendje dhe në zemër,- tha tejet i mallëngjyer gjithsesi.

Pas kësaj i përqafoi edhe Mimoza. Për herë të parë u ndjenë të afërt si një familje dhe të gjithëve u erdhi shumë mirë nga kjo ndjenjë. Kishin nevojë më shumë se kurrë për njëri-tjetrin.

XIV

Diamanti po e vinte edhe valixhen e fundit në veturë, ndërsa Mimoza po përqafohej me Besën. Bujari i kishte përcjellë tërë kohën nga dritarja, në të cilën përplaseshin pamëshirshëm pikat e shiut.

"Iku edhe Diamanti. Fëmijët kur dalin një herë nga shtëpia, mësohen shumë lehtë pa prindërit. Është aq i dhimbshëm fakti se nuk iu duhemi më, së paku jo sa na duhen ata neve…"- mendonte. Pastaj u largua ngadalë nga xhami dhe zbriti poshtë.

- Baba! – iu afrua i biri, – po vija për të të përshëndetur.
- Po, bir…
- Një herë do të shkojmë në kryeqytet, sa për të rregulluar gjërat e nevojshme, transferimin e dokumenteve të fakultetit e gjëra të tjera si këto. Organizata në të cilën veprojmë, pothuajse i ka kryer të gjitha punët, por na kanë mbetur edhe krejt pak. Pastaj do të nisemi me aeroplan.
- Të vijmë edhe ne të të përcjellim në aeroport? – pyetën të dy prindërit gati njëherazi.
- Jo, më mirë jo. Ju e dini sa i urrej lamtumirat. Dua t'ju mbaj në kujtesë këtu, në oborrin e shtëpisë.

Bujari pohoi me fytyrë të shtrembëruar nga pikëllimi. I biri e pa dhe vazhdoi:

- Baba, kjo është e përkohshme, do të kthehem shpejt. Është diçka që duhet ta bëj, e kupton? Kam nevojë të bëj diçka për dikë tjetër, kam nevojë të ndihmoj, kam nevojë ta lehtësoj dhimbjen.
- E kuptoj, bir.

Pastaj Bujari mori kokën e të birit dhe ia ngriti me dy duart.

- Jam krenar për ty, e di këtë? Mbaje mend! Tani kokën lart dhe shko!- i tha dhe e puthi në ballë.
- Rrugë të mbarë, qofshi të bekuar, – u tha Besa.

Vetura kishte kohë që ishte larguar, por Bujari po shikonte ende pikën ku e kishte parë për herën e fundit. Brenda vetes ndjente një zbrazëti të madhe, i dukej sikur diçka u shkëput nga ai përgjithmonë.

" A është e mundur, vallë, të kem harruar ndonjë herë se kam një djalë të tillë të mirë, kur nuk i kam parë mirësitë që kisha përreth, por mendoja për ca dashuriçka të zbrazëta; a është e mundur të kem qenë aq larg vetes, o perëndi!!! A thua biri im ta ketë vërejtur këtë gjë në mua dhe sot shkon, kur më duhet më së shumti? Pse vallë ne prindërit mendojmë se fëmijët tanë nuk i vërejnë mbrapshtitë tona, pse mendojmë se mund t'i mashtrojmë, ndërkohë që ata na shohin shumë mirë dhe na falin. Na falin sepse na kanë prindër. Vetëm nga ky fakt. Kur jemi të rinj ankohemi se prindërit tanë bëjnë gabime, thërrasim se ne do të bëhemi krejtësisht të tjerë. Pastaj vjen koha kur në veten tonë shohim sjelljet e njohura, që dikur na dukeshin aq të papranueshme. Dhe nuk duken më fare të frikshme fytyrat e kaluara… sepse tani ata jemi vetë ne. Bëjmë të njëjtat gabime. Eh, nuk është e vërtetë se vetëm prindi i do fëmijët pa kushte! Janë edhe ata që na duan të tillë, jemi tek ata për t'u paraqitur fytyrën e botës… dhe pastaj… pastaj shohim se ne kemi mësuar prej tyre po ashtu", – mendonte i vrarë në shpirt.

Ngadalë hyri brenda. Dëgjoi tingujt e pianos që vinin nga dhoma tjetër.

"Të paktën kjo ka miken e saj të mirë,- mendoi,- mua nuk më ndihmon më dot askush".

Pianoja vazhdonte rrëfimin, derisa Bujari u shtri mbi kanape duke e dëgjuar me ëndje çdo notë të saj.

Kushedi sa kohë kishte kaluar, kur nëpër sytë gjysmë të mbyllur, pa se gruaja po bëhej gati për të dalë.

"Paskam fjetur", tha me vete.

Hapi sytë dhe pa batanijen, që ia kishte hedhur përsipër Besa derisa ai po flinte. Ia kishte hequr edhe syzet e ia kishte vënë mbi tavolinë.

- Sa është ora? – pyeti
- U zgjove? – i tha Besa.- Është afër orës gjashtë. Nuk desha të të zgjoj, mora çelësat me vete.
- Po del?
- Dua të eci pak. Sot kam pasur një ditë mjaft të tendosur.

Bujari e pa si po e vinte shallin e saj me lule mbi kokë. Pastaj i tha shkurt:

- Mirë. Shëtitje të këndshme.

Që të dy e ndjenin situatën e ftohur mes tyre, por sikur ishin pajtuar me të. Çdonjëri dëshironte të ishte ndryshe, por asnjëri nuk bënte gjë. Dukej se ishte vonë për gjithçka. Ishin lodhur, nuk ekzistonte më vullneti i duhur. Në kohën kur duheshin kultivuar marrëdhëniet e tyre, ai kishte rrënuar çdo gjë. Fëmijët nuk ishin më, nuk kishte asgjë për ta plotësuar atë zbrazëtirën e krijuar me vite dhe për të cilën asnjëri nuk e kishte menduar se do të vinte me hapa aq të shpejtë. Ndoshta Besa e kishte menduar. Ndoshta ajo e kishte duruar mu për këtë arsye. Por ky i kishte kaluar kufijtë dhe ajo më nuk kishte interesim për të luftuar. Jo më. Kishte gjetur mënyrat e veta për ta plotësuar jetën, aq sa ajo mund të plotësohej.

Dera u mbyll. Shtëpinë e kaploi një heshtje e shurdhët. Sa shumë i mungonin njerëzit rreth tij. Po e mbyste kjo qetësi, kjo zymtësi që përkonte me brendinë e tij në shpirt.

Besa doli. Befas u kujtua se duhej ta ndiqte, duhej ta vërtetonte se a kishte një aferë me Shpëtimin. Duhej!.. ndryshe do të çmendej.

Po, sa mori këtë vendim, u ndje i tmerruar nga e vërteta që mund ta kuptonte së shpejti.

"Ndoshta është më mirë të mos bëj gjë, ndoshta është më mirë të mos kuptoj edhe në qoftë e vërtetë. Tekefundit a nuk e kam merituar?". Por një brengë e fortë aty përbrenda s'e linte të gjykonte më gjatë. Tha prapë i vendosur si më parë:

"Jo, jo. Do ta përcjell. Në qoftë e vërtetë më duhet ta kuptoj. Nuk mund të jetoj më në këtë mënyrë. Mirë të bëhet diçka".

Mori mantelin dhe doli.

Rrugës kishte fare pak njerëz. Muzgu ishte afër dhe ndjehej freskia pas shiut që sa kishte pushuar. Errësira po lëshonte velin e saj. Bujarit iu kujtua rrëfimi i Dorinës, që ia kishte treguar Besa.

"Tani dalin mbi tokë njerëzit e errësirës",– mendoi, - njerëzit e brishtë e të frikësuar. Sikur unë. Sikur Besa. Sikur gjysma e botës".

Kaloi nja gjysmë ore rrugë, por nuk ia kishte zënë syri gruan askund. Pastaj u kujtua se ajo shkonte shëtitores që çonte kah parku i qytetit. Shpejtoi hapin dhe brenda njëzet minutave shkeli nëpër kalldrëmin e bukur të rrugës, të rrethuar me pisha të vogla anash.

" Sa shumë kohë që s'kam kaluar këndej"- mendoi

Ecte me jakat e ngritura të mantelit duke shikuar në të dy drejtimet e rrugës. Njerëz në moshë të pjekur, të rinj të dashuruar, çifte që pushonin bankave të njëpasnjëshme dhe restoranteve të vogla përskaj.

"Dhe unë kam menduar se duhet të jesh plak për të ardhur këtu, mendoi. Sa bukur të shohësh bashkëshortë përkrahu tek bisedojnë rrugës gjërat e tyre, qajnë hallet e bashkojnë brengat, ndajnë gëzimet... ".

Në çast u ndal si i paralizuar. Në njërën prej degëve të rrugës që çonte brenda parkut dhe përfundonte në një restorant, pa një grua me shallin në kokë. Ishte Besa, po, po.

Po ecte ngadalë, në njërën dorë mbante çantën që e merrte gjithnjë me vete, ndërsa tjetrën e kishte futur në xhep. Nuk ishte vetëm. Skaj saj po ecte Shpëtimi. Po, po e njohu, ishte ai.

Në çast i flakëriu në mendje: "E vërtetë është… e vërtetë! Më kanë mashtruar, ma kanë punuar pas shpinës. Më kanë ngulur thikën. Nuk kam më besim në askënd".

Pastaj e zuri paniku.

"Çfarë të bëj? Të bëhem sikur nuk i pashë dhe të shkoj në shtëpi e të vazhdoj këtë jetë të dyfishtë? Apo të pres një rast më të volitshëm e t'ia them se e di që... Jo, jo nuk mundem, nuk mundem ta mbaj në bark këtë, duhet t'ua them, duhet t'ua përplas të dyve në sy. Po çfarë nëse pas kësaj ajo më braktis? Çfarë nëse shkon me Shpëtimin? Sa kishte të drejtë tani t'i kërkonte sqarime? Sa kishte të drejtë t'ia ndalonte për ta jetuar jetën e saj. Ndoshta më mirë të heshtte, ndryshe ajo do ta shfrytëzonte këtë rast dhe do të ikte. Ndërsa ai... çdo të bënte pastaj fillikat. Pa Besën. Po a e donte vërtetë gruan e tij sa t'i vinte keq që ajo po e braktiste, apo ishte egoja që nuk mund ta duronte tani këtë?".

Bujari u tmerrua nga hamendjet që i vlonin në kokë. Po, ai e donte Besën. E donte me pasionin e një burri të penduar e të rrëmbyer nga vorbulla e emocioneve të thella. E donte sikur të ishte dashuruar sërish në të, sikur vdekja ta kishte bërë të shihte më mirë brenda saj. E donte për vlerat që kishte, për forcën e saj, për mënyrën si luftonte me sfidat e jetës dhe si i përqafonte ato pastaj; e donte për vetë atë, sikur mund ta dojë burri një grua, për gjithçka që ajo mund të paraqiste për një mashkull: femrën, gruan, motrën, nënën... të gjitha ishin në një: ishin Besa. Ajo kishte ngrohtësinë, afërsinë, pasionin, mençurinë, kishte edhe bukurinë. Ishin një oqean i tërë i pafund vlerat a saj njerëzore. E sot, sot ai e kishte larguar me dy duart e tij. Bujari lëvizi kokën instinktivisht për të flakur këto mendime që e sakatonin në shpirt. Dhe tani ajo ishte në prehër të dikujt, që duket se ia kishte parë vlerat para burrit të saj, mikut të jetës. Eh, miku i jetës.

Ndërkohë Besa dhe Shpëtimi ishin ulur në një tavolinë, e cila ishte pak më në skaj se të tjerat. Restoranti ishte krejt i lirë, ata ishin të vetmit mysafirë, duket ishte herët për klientët e mbrëmjes. Kohët e fundit të gjithë pronarët e lokaleve ankoheshin për shkak të numrit të vogël të klientëve. Vendin e kishte kapluar një krizë ekonomike dhe shumë nga njerëzit ishin të preokupuar si të mbijetojnë, se sa për të ndjekur kënaqësitë. Rrallëkush i lejonte vetes shpenzime të mëdha. Bujari i shikoi edhe një herë të dy. I erdhi të thotë "dy dashnorët", por zemra nuk ia pranonte të mendonte se gruaja e tij, Besa e tij, ishte e tjetërkujt.

Kamerieri po u sillte tash pijet dhe shkëmbeu fare lirshëm me ta disa fjalë.

"Duket se i njeh që moti, duket se janë mysafirë të përhershëm këtu" – mendoi gjithë inat e xhelozi Bujari tek rrinte aty në këmbë me mendimet e vagëlluara në kokë.

U ul në një bankë dhe po i përcillte nga larg. I hipi një xhelozi e tmerrshme. Xhelozia si për lodrën që të vidhet nga dora. Por jo, megjithatë kjo ishte një ndjenjë tjetër. Ishte një xhelozi plot dashuri e pasion, ishte një xhelozi e njeriut të frikësuar që sheh me sy të trishtuar si po i tretet gjëja më e çmuar që ka pasur në këtë botë, si po i ikën sikur rëra nëpër gishtërinjtë dhe ai nuk ka fuqi ta ndalojë.

Ndjeu një sëmbim në zemër. E shtrëngoi fort me dorë, mori frymë thellë dhe tha me vete:

"Po shkoj, nuk kam çfarë të humb.E vërteta e vetme është se unë nuk mund të jetoj më në një gënjeshtër".

U nis me hapa të pasigurta drejt tyre. Sa më shumë u afrohej, zërat e tyre i bëheshin më të qartë, ndonëse flisnin me zë të ulët. Besa po i tregonte diçka Shpëtimit, kushedi, ndoshta për Diamantin, se si iku sot larg për shumë kohë, a po i fliste ndoshta për Dorinën. Ndërsa ai e dëgjonte me kujdes, e shikonte në sy. Ishte aty për të. Ashtu sikur Bujari nuk kishte qenë kurrë.

Ndjeu gjakun që po i ngjitej me vrull përpjetë. U mundua ta përmblidhte veten, ndonëse me dëshirë do të bërtiste deri në qiell.

- Mirëmbrëma,- u tha me tu afruar.

- Oh, Bujar, na befasove, – i tha pa të keq Shpëtimi.– Sa mirë paske bërë. Por nga na dole, nuk të pamë fare?

- Ishit shumë të preokupuar me bisedën tuaj,- tha Bujari me ironi dhe shtoi:- Ndërsa ju pashë rastësisht. Dola edhe unë për një ajër të freskët. Kisha nevojë.

- Eja ulu, – i tha Besa. Për çudinë e Bujarit ajo reagoi fare e qetë dhe kjo gjë po ia shtonte akoma më tepër nervozizmin. Për çudi, asnjëri prej të dyve nuk po ndjehej keq, ashtu siç kishte pritur ai.

- Nëse mendoni se nuk ju pengoj, – u përgjigj dikur përsëri me ironi, ndërsa Besa e Shpëtimi u shikuan mes vete.

Bujari vuri buzën në gaz jo natyrshëm dhe gjoja për t'ua sqaruar fjalinë e tij të fundit, shtoi:

- Dukej se kishit mjaft për të biseduar, jua ndërpreva muhabetin.

- Ç'është ajo fjalë, Bujar. Mua më vjen aq mirë që ke dalë. Tani sa po më tregonte Besa për Diamantin. Më vjen mirë që ka gjetur rrugën e tij, – foli Shpëtimi, duke u munduar të tregohet i lirshëm pas dy thumbave që kishte lëshuar në adresë të tyre Bujari.

- Ju bëtë fjalët bashkë për të dalë? – i pyeti sërish, duke injoruar fjalinë e fundit të Shpëtimit.– Apo u takuat rastësisht?

- Shpëtimi del për kondicion, ndërsa unë me rekomandimet e mjekut. Takohemi shpesh këtu dhe pimë ndonjë kafe bashkë. Pse? – e pyeti Besa me indiferencë.

- Kot, veç pyes... nuk ma paske përmendur ndonjëherë se po del me fqinjin tonë.

Shpëtimi e pa në sy me Besën, por nuk foli. Në fytyrën e tij vërehej keqardhje për sjelljen e Bujarit.

- Apo jo? – e provokoi sërish Bujari

Tensioni ndjehej në ajër. Shpëtimi vërejti cinizmin në fjalët e Bujarit, por u përmbajt.

- Nuk ka rënë fjala, Bujar.

- Mund të ma thoshe dhe do të kishim dalë të tre, - tha Bujari sikur donte të rregullonte diçka nga ato që prishi. –dhe pastaj përsëri nuk u përmbajt dot:- në qoftë se nuk ju prishja punë.

Ra heshtja si një gur i rëndë. Askush, as ai që e nisi, as ata që po e dëgjonin, nuk qenë në gjendje të thoshin diçka, as vetëm diçka, sa ta thyenin paksa atë pllakë të rëndë që ra mu aty në mes. Ishte një nga ato heshtje që s'ke si e prish, as ke si e ujdis.

... ...

"Bujar! Çfarë po flet kështu? – i tha Besa,- mjaft me këto, bisedojmë në shtëpi, po deshe"…

"Jo, Besa, lëre, ai ka nevojë të sqarohet" - tha Shpëtimi.

"Oho, pa shih, pa shih, faleminderit komshi,- tha sërish me cinizëm Bujari…- Ma dhe të drejtën e fjalës, komshi. Bukur fort!" .

"Bujar, mjaft, e teprove!" – i tha gruaja dhe e pa me sy kërcënues, aq kërcënueshëm si nuk e kishte parë kurrë.

Ishte e kotë. Pezmi që po ndjente ishte aq i rëndë, sa ia kishte mjegulluar krejt mendjen.

"Unë e paskam tepruar? Unë? Ti vjen dhe argëtohesh me burrin e botës dhe unë ia paskam tepruar? Si ke fytyrë!".

"Bujar, të lutem përmbahu, jemi në vend publik. Mos u sill kështu, mos nxjerr përfundime të gabuara, të lutem. Gjërat nuk janë ashtu si të duken. Besa dhe unë jemi miq të mirë dhe asgjë më tepër", – tha Shpëtimi.

"E tash u qetësova krejtësisht. Sa i mirë je... ha-ha-ha,- qeshi me mllef Bujari.– Miku im i mirë, Shpëtim-shpëtimtari!!! Njeriu që të nxjerr nga balta për të ta futur thikën pas shpine. Sa i mirë je, sa i mirë! Dhe unë të besova natyrshëm. Se isha budalla, se mendova se ishe mik i mirë, derisa ti po ma vidhje familjen para syve, i bëre të gjithë të të shihnin si shpirtmirë, ndërsa unë isha ai i keqi, i poshtri, i ulëti... ti ishe shembulli, ideali, fisniku, a dreqi i mallkuar. Lozje pa pikë turpi rolin e filantropit, gjersa me vidhje gruan para syve"...

Bujarit i mbeti fjala në fyt. Shpëtimi kishte ngritur kokën dhe e shikonte drejt e në sy, duke e bërë ta mendonte mirë atë që ishte bërë gati të thoshte. U ndje si i zënë në kurth me karremin e krijuar prej fjalëve të veta. I vinte inat se nuk kishte aftësinë për të qenë i qetë, e shihte se po sillej si budalla, si njeri i pamatur... gati nuk e njihte vetveten. Por shikimi i Shpëtimit e gozhdoi. Dukej sikur Bujari i kishte zbrazur të gjitha ç'kishte brenda në bark dhe ai po i përgjigjej tani, ja kështu:

"Unë të kam vjedhur gruan ty? Unë? Je i sigurt për këtë? Ti... ti që... ".

Bujari u drithërua dhe mendoi në çast: "T'i ketë thënë gjë Besës për Natyrën? Ia kishte thënë, sigurisht. Çfarë kanë folur kaq kohë këtu në park? Edhe për paratë, për të gjitha i ka treguar... Ndoshta ishte tashti koha për t'u sqaruar. Të thoshte para Besës gjithçka, le ta braktisnin të gjithë.

"Çka unë?.. thuaje... thu-a-je..."- dukej sikur po i thoshte Shpëtimit me ato buzët të shtrënguara nga inati, nga mllefi.

"Jo. Asgjë, asgjë,- ia kthente Shpëtimi po në inat.

"Thuaje, dreqi e marrtë... nëse nuk e ke thënë deri tani. Do të t'i kthej të gjitha... paratë, nderet... të gjitha... të gjitha".

"Cilat para?" – pyeti Besa shumë e nevrikosur.

"Pyete mikun tënd, nëse nuk ta ka thënë deri më tash, ai na ka blerë të gjithëve".

Tjetri, Shpëtimi, i uli sytë dhe e zbuti vështrimin, si duket i erdhi prapë keq për të.

"Jo, Bujar, unë nuk kam blerë asgjë, por ti doje te shisje çdo gjë tënden të çmuar me çmim të lirë. Doje të jepje thesarin për plehra"...

"Çfarë po flisni?"- tha prapë Besa.

"Sonte më ke lënduar pa masë... e ke tepruar, Bujar, por unë nuk dua ta vazhdoj më, nuk dua të them gjëra për të cilat mund të pendohem më pas..."- tha Shpëtimi me zë të ulët.

... ...

...Vazhdonin të heshtnin, megjithëse secili nga të tre dukej se kishte diçka për të thënë, por që secili nga të tre e mbante ndryrë pas buzëve të mbyllura e të shtrënguara mirë atë që kishte për të thënë. Fjalët aty brenda pas buzëve të tyre ishin si ca zogj nervozë që i mbanin me zor si pas dritareve të një burgu të thurur me hekura. Dhe Bujari endej në atë vorbullën e tij të vegimeve, dhe ndërsa i dridheshin lehtas buzët nevrike, pyeste veten nëse i kishte thënë apo jo atë fjalë aq të rënda; a ishte bërë apo jo tani disa sekonda më parë ajo bisedë aq e rëndë në mes atyre të treve?

Kamerieri, që e kishte vënë re ardhjen e Bujarit në tavolinë, u afrua dhe e pyeti me mirësjellje:

- Doni të pini gjë, zotëri?

- Jo, faleminderit. Po shkoj.

Kamerieri i shikoi dy të tjerët thuajse priste ndonjë sqarim. Pastaj, kur pa se situata nuk ishte aq e këndshme, u përkul prapë me mirësjellje dhe u largua pa thënë gjë.

- Tani u bë mjaft, po shkojmë,- tha Besa dhe bëri të ngrihej.

- Jo, jo kurrsesi, ju mos e prishni qejfin se po shkoj unë. Ia kalofshi bukur!,- tha Bujari dhe u ngrit e iku me një "natën e mirë" të ftohtë akull, duke lënë të habitur si Shpëtimin edhe Besën.

U largua me vrull para se të tjerët të arrinin të ngriheshin nga karriget. Hodhi hapat shpejt dhe u nis për në shtëpi. Nuk donte kurrsesi ta arrinin, as Besa e as Shpëtimi. Tani donte të ishte vetëm, vetëm... Rrugës luftonte me lotët që i ishin mbledhur në fyt. Ikte si i marrë pa asnjë cak. Duke kaluar sërish kah parku, u ul në një bankë pa mundur të ndalonte vajin.

Kjo nuk kishte kuptim më, nuk kishte. "Pse nuk e kam parë gjithë këtë gjë me kohë, pse? Ndoshta nuk kam dashur ta shoh. Ndërsa ai maskarai kishte vepruar. Po, po. Kjo ishte mënyra e tij për t'u hakmarrë! Ndoshta e kishin bërë plan të dy! Për t'u hakmarrë të dy njëherazi, me të njëjtin mjet. Duhet të jem i fortë tani, duhet!".

U ngrit ngadalë dhe nisi ecë marramendshëm, sikur i goditur nga një hekur në kokë.

"Çfarë do të ndodhte tani? Kthim mbrapa nuk ka. Do të kthehej më Besa në shtëpi pas këtij skandali që u bë? Po dale, çfarë skandali? A u bë ndonjë skandal, a u tha ndonjë gjë, apo jo? Ende nuk ishte i qartë, se të gjitha ato që i përjetoi në dialogë, ishin thënë apo jo. Si në ordinancë me Natyrën... që nuk e dinte ende nëse kishte ndodhur gjë... Nuk i ndante dot fjalët e thëna nga ato të menduarat, por të pathëna. Dreq, o punë, si u bëra kështu për të më qarë hallin. Jam shumë konfuz. Po lajthis fare. Po, edhe në se të gjitha nuk ishin thënë, diçka... diçka kishte ndodhur ama. Sepse si Besa edhe Shpëtimi kishin mbetur të ngrirë nga qëndrimi i tij. Të paktën ajo e kishte kuptuar se ku i dhembte atij, e kishte ndjerë në ajër xhelozinë e tij. E qartë, pas gjithë kësaj, ajo zor se do të kthehej në shtëpi. Zor. Dhe nëse kthehej, si mund të vazhdonin jetën bashkë, si mund të rrinte në këmbë ajo kasollja e tyre e dashurisë me gjithë këto dëme të pariparueshme që kishte marrë. Nëse jo, nëse Besa nuk do të jetonte më në një çati me të, si do ia dilte vetëm, si?!!".

Hyri në shtëpi sikur hajn. Shkoi në një cep të kanapesë dhe u struk, u bë kruspull aty. Nuk kishte ndezur as dritat, as televizorin, donte të dëgjonte edhe tingullin më të vogël që do të vinte nga jashtë. Ngjarja që sapo kishte ndodhur i dukej sikur nuk ishte e tij, por e dikujt tjetër

Orët po kalonin dhe Besa nuk po kthehej në shtëpi. Bujari ndjeu se lotët ia lagnin faqet.

Papritmas, diku para mesnatës u hap dera e hyrjes. Dëgjoi hapat e gruas së tij që po hynte brenda. Ato u ndalën për pak dhe ai e kuptoi se ajo po varte mantelin. Pastaj ndjeu se hyri në dhomë, se kaloi skaj tij pa asnjë fjalë dhe u ngjit shkallëve.

Vuri mirë veshin, nga dhoma lart nisi të dëgjonte zhurmën e dollapëve që hapeshin e mbylleshin kanatesh.

"Po bie të flejë,- mendoi.- Po pse po i hap dollapët? Të shkoj lart? Të rri këtu? Po çfarë nëse edhe ajo vuan?". Ç'punë kam tani me të? Ajo... ajo e paska vendosur rrugën e saj, më paska ndërruar me një tjetër. Pse e bëri? Ishte keq me mua?. Po, vërtetë, edhe shumë i mirë nuk kam qenë me të, por ama e kam dashur, e kam dashur me shpirt. Më pëlqeu menjëherë sa e pashë atëherë, kur ajo ishte ende studente dhe unë i porsa diplomuar. Eh ajo kohë, kohë e rinisë... Është e vërtetë, nuk jam treguar shumë i vëmendshëm me të, s'ia kam shprehur asnjëherë hapur se sa e kam dashur, por këtu brenda, ama, këtu brenda... Unë kështu jam, nuk i them kurrë gjërat që kam në shpirt, kush më do duhet të më kuptojë. Nuk di ta them me fjalë atë që mendoj, atë që dua, kështu edhe nuk... - ngeci, deshi të thotë se përbrenda në zemër nuk vinte kurrë njeri tjetër mbi të, mbi Besën, por u kujtua se ato fluturimet me Natyrën, ama, dëshmonin të kundërtën dhe ja se si tash, nuk mundi as me vetë të thotë se, mbi Besën nuk kishte vënë asnjë grua tjetër.

Zhurmat e dollapëve dhe ecejaket atje lart u dëgjuan gjatë, rreth një orë. Pastaj hapat filluan të uleshin shkallëve. Bujari picërroi sytë në terr dhe pa siluetën e Besës që po zbriste me një valixhe në duar. Një mendim i thershëm i vegoi në mendje. Pse kjo me valixhe?

- Besa!- dëgjoi zërin e tij që i doli nga fyti gati pa e urdhëruar.

Gruaja u ndal. Bujari u ngrit dhe ndezi dritën.

- Ku je nisur kështu?
- Në hotel. Sonte do të fle në hotel. Prej nesër do të kërkoj ndonjë banesë me qira.
- Po ikën? Kaq e paskemi pasur?
- Mendoj se nuk kemi më gjëra të përbashkëta. Koha është të jetojmë ndarë sa nuk është bërë vonë.
- Ke vendosur kështu?- i tha ai.- Si nuk paskemi gjëra të përbashkëta? Po martesa jonë, po fëmijët, po gjithë këto vite që i shkuam bashkë? Po dashuria që kemi pasur?
- Dashuria? Cila? Si na qenka kjo dashuria, pra, hë, më thuaj!- e lëshoi me forcë valixhen për dysheme Besa dhe iu drejtua:- Për ty qenka dashuri ta nënçmosh gruan tënde me vite, ta konsiderosh injorante, budallaqe e naive? Qenka dashuri të mos i gjendesh afër kur ka nevojë më së shumti për ty? Si na qenka dashuri, kur e sheh tjetrin të vuajë e ti të mos ndjesh asgjë? Mendon se nuk e kam parë atë shikimin tënd cinik kah më shihje të torturohesha e sëmurë? Dhe ty të dhimbsej të ngriheshe për të më çuar në urgjencë! Ta bëje të paktën nga mëshira… Po të ishe njeri, do ta bëje… Qenka dashuri që vetëm të marrësh, të marrësh, të marrësh dhe të mos japësh asgjë… asgjë, dreqi e marrtë!!! Me rëndësi që vetëm ti të ndjehesh mirë. E ne të përshtatemi pas teje. Kur do ti - të qeshim, kur do ti- të qajmë, kur do ti- të heshtim, të gjitha kur ti do. Dhe veç të gjitha këtyre, ta fyesh e të mos besosh në tjetrin, sikur ajo të jetë jo gruaja jote, por një mace rrugaçe? Ë, kështu na qenka dashuria? Tani mjaft më. Nuk më duhet ajo dashuria jote, për të cilën ke mënyrën më mizore për ta shprehur. Nuk ta dua, e kupton? Nuk më duhet dashuria pa respekt.
- Besa, nuk mund të shkosh kështu! Kemi ende për të biseduar. Duhet të më tregosh pse e bëre këtë zgjedhje?
- Për cilën zgjedhje po flet? Për zgjedhjen që bëre ti? Ti e bëre zgjedhjen.
- Për kë? Për kë kam bërë zgjedhje? Çfarë të ka thënë Shpëtimi?
- Bujar, lere Shpëtimin të qetë. I ke rënë në qafë më kot.

- Ti don të më thuash se nuk ke pasur asgjë me të? Shiko, Besa, se ai ka shfrytëzuar disa situata. I ka shfrytëzuar mirë, nuk them, është treguar i shkathët, por puna e tij nuk më pëlqen aspak. Dhe ti... si u vure kështu me të?

- Mos u bëj cinik. Natyrisht se s'kam pasur asgjë me të. Ai është një mik, një njeri i mirë, me të cilin kam hapur zemrën atëherë kur ti bridhje poshtë e lartë me… Ai të ka mbrojtur gjithmonë, përherë gjente arsyetime për veprimet e tua të... të pahijshme, gjithmonë ma bënte më të lehtë për t'i përballuar lajthitjet e tua. Po të ishe pak njeri e të kishe pak dinjitet, duhet t'i kërkoje ndjesë për këtë që i bëre sonte. Ta dish që nuk e meritonte, nuk e meritoja as unë.

- Ti po e mbron tani atë? Të qenka bërë më i afërt se bashkëshorti yt? Mos ke menduar të jetosh me të tani e tutje? Duket sheshit që simpatizoheni, në mos po... në mos po...- vazhdonte Bujari, ndonëse bëhej gjithnjë e më i vetëdijshëm se po prekte fundin e gjërave.

- Simpatizohemi? Do të ta them troç? Mirë, atëherë dëgjoje. Simpatizohemi. Shpëtimi dhe unë kemi pasur vërtetë simpati të ndërsjella për njëri-tjetrin, sepse ndajmë gjuhë të përbashkët, shije të përbashkëta, mendime dhe pikëpamje të jetës. Dhe po, është e vërtetë, një herë më ka thënë se do të kishim qenë vërtetë për njëri-tjetrin. Edhe unë ndjeva se ai do të kishte qenë vërtetë për mua. Dhe e mendoja veten se ai do të kishte qenë njeriu me të cilin unë do të ikja... të ikja prej teje.

- E shikon? Mirë e kam kuptuar. Pse nuk e bëtë, pra? Pse? – pyeti Bujari tanimë me sy të zgurdulluar nga xhelozia dhe urrejtja bashkë.

- Sepse ka diçka më të madhe se ndjenjat dhe dëshirat në këtë jetë. Janë vlerat njerëzore, Bujar. Ato, të cilat ti i pate humbur rrugëve të tua të kryqëzuara në shumë drejtime pa krye. Janë vlerat njerëzore, e kupton? Ato që na bëjnë të quhemi njerëz, të ndihemi njerëz. Janë familja, krenaria, dinjiteti, nderi, dashuria e besnikëria. Janë edhe shumë të tjera. Si ti, si unë kemi marrë të dy nga jeta e njëri-tjetrit, edhe i kemi dhënë, po, por nuk bën që në rastin e parë kur takojmë një tjetër që na pëlqen apo që na josh më shumë, ta braktisim, t'i biem shkelma një jete të tërë që kemi krijuar me një njeri. Unë e ndjeja këtë dhe është bash kjo që më ka mbajtur e më mban të mos shkas në gabime, të mos miklohem nga vezullime të çastit. Bujar! Janë ato që të bëjnë të tundësh kokën dhe të thuash: "Jo, ky është shekulli i gabuar, në këtë shekull duhet të gjej shpirtin tim te ky njeri, me të cilin jam, nuk është e rastit që fati na ka bashkuar, duhet të ketë diçka, duhet"… dhe mundohesh, mundohesh… Sot nuk dua të mundohem më, e kupton? Nuk dua. Jam e lodhur nga betejat e heshtura që i kemi zhvilluar me vite. Ke mbytur njeriun e gjallë në mua, kam vdekur brenda, kam vdekur.

- Ti po më braktis përgjithmonë?

- Unë s'po të braktis. Ti më ke larguar me duart e tua kaherë.

- Po më braktisni të gjithë… Dorina, Diamanti... tani edhe ti.

- Edhe dikush tjetër, mbase. Pse nuk e thua që të ka braktisur dhe dikush tjetër?- Këtu Besa e shikoi Bujarin me ngulm në sy, derisa ai nuk mundi më t'i qëndrojë shikimit të saj dhe i vari sytë poshtë, në dysheme.- Ti më pate braktisur,- vijoi Besa, kur e pa se ai nuk kishte kurajë as ta pohonte e as ta mohonte se ishte, vërtetë, i braktisur edhe nga një tjetër njeri, që nuk bënte pjesë as në familje e as në gjak, vetëm se kishte qenë një vegim... vegim.- Më braktise, por unë nuk ta ktheva shpinën edhe atëherë kur ti e meritoje.- Zëri i Besës mori tashmë një ton të thekshëm dhimbjeje.- Heshta. Heshta sepse nuk doja ta pranoja të shihja një Bujar tjetër në ty. Shpresoja të isha gabim… mundohesha t'ia mbushja mendjen vetes se ti mund të ishe në ndonjë krizë të moshës, në një asi gjendje deliri kur burri dëshiron të përjetojë ndonjë adoleshencë të vonuar…

- Ti… ti dëshiron të më thuash se e di për… për...- pyeti Bujari kokulur.

- Për Natyrën? He!Thuaje! Natyrisht se e di. E kam ditur gjithmonë.

- Po si ashtu…- Bujari kapi fytyrën me duar nga turpi.- Atëherë ti ke folur për këtë me Shpëtimin?

- Me Shpëtimin? Zot i madh sa i përciptë që je. Ti vërtetë më mendon aq budallaqe? Mendon se gruaja nuk e ndjen kur burri i saj përvëlohet për trupin e tjetrës? Për pasionin e vjedhur? Mendon se nuk kam vuajtur sa herë visheshe e rregulloheshe për të? Se si më injoroje dhe më nënçmoje në praninë e saj? Se si i bëje shuk fletët e studimeve në kopsht nga marazi i madh. Mendon se nuk i vija re, Bujar? Je gabim. I kam vënë re të gjitha qysh në fillim. Me kohë kam dashur të bisedoj me ty, por pastaj mendova të të lë hapësirë. Dashuria nuk bëhet me zor, mendoja, nuk krijohet nga asgjëja, nëse nuk është aty vetvetiu. Pastaj iu drejtova Shpëtimit, natyrisht pasi ishte ndarë me të shoqen. Ishte ai që më bindi të të qëndroja pranë, të ruaja familjen, ishte ai që më bindi se Natyra nuk ia vlente. Se miqësia jonë ishte aq e çmuar sa nuk do ta përballonte të më shihte tek vuaj, se Diamanti e Dorina kishin nevojë për një strehë të sigurt… dhe… dhe… dhe pastaj fëmija jonë shkoi. Me të edhe një pjesë e imja. Tjetra pjesë e vetes sime ishte për ju, për ty e Diamantin. Ti e thërrmove copën tënde, e shkele, tani do të jetoj vetëm për të, për tim bir. Besoj se ia vlen.

- Ti po më lë kështu?

- Do të lutem për shëndetin tënd Bujar. Pavarësisht të gjithave, unë nuk ta dëshiroj të keqen. Unë nuk do t'i them Diamantit; ti bëj ç'të duash. Më duhet një kohë të qëndroj vetëm me mendimet e mia, me ndjenjat e mia. Do të ndahemi një herë kështu, pastaj do të vendos.

- Të ndahemi? Të shkurorëzohemi?- Bujari fliste pa ditur fare se çfarë nxirrte nga goja, ishte nën stres.

- Të shkurorëzohemi nuk do të ishte fundi i botës, Bujar. Por shumë lehtë do të mund të ishte fundi i botës tënde dhe simes. Mirupafshim.

XV

Mëngjesi e gjeti Bujarin të mbledhur kruspull në kanape. Nuk kishte më lot për të derdhur, sytë i ishin shterur. Vazhdonte të shikonte në një pikë në dysheme. Dukej thuajse më nuk mund ta befasonte asgjë, thuajse asnjë dënim më nuk do ta frikësonte, ishte pajtuar me të gjitha. Ndjenjat i ishin topitur, sikurse një njeriu që e çojnë për ta pushkatuar.

Cingëroi telefoni dhe e trembi. Kush do të jetë tani? Besa? U ngrit dhe kapi receptorin.

- Po?- u lajmërua shkurt.
- Baba, jam unë, Diamanti.
- Po bir, si je?– i tha me një zë që i dukej i panjohur
- Mirë. Akoma jemi në kryeqytet. Po ti baba, ç'ke? Më dukesh disi i ngjirur në zë. Je sëmurë ndonjë gjë?
- Jo, Diamant. Ende nuk e kam pirë kafenë, ndaj s'më del akoma zëri mirë.

- Eh, të ka mësuar keq mami ty, – bëri shaka Diamanti.- Gjithmonë të pret kafeja e ngrohtë. Po vërtetë, a është mami aty? Doja të bisedoja edhe me të.

- Jo, nuk është…- u bë gati për të thënë diçka më tepër, por pastaj vetëm përsëriti: - Nuk është në shtëpi.
- Pse, ku është? Herët paska dalë.

- Nuk e di. Kur u zgjova kishte dalë. Sigurisht ka shkuar për gjëra të freskëta deri në treg.

- Ah po, mami im e mirë. Qysh tani më mungojnë ushqimet e saj. Mirë, atëherë, do thërras edhe një herë para nisjes. Nëse nuk mundem, ju lajmërohem me të mbërritur atje. Sot do të nisemi.

- U bë, Diamant. Rrugë të mbarë, bir!

- Baba, më thuaj, të lutem, mos je mërzitur gjë? Je mirë?

Bujari vdiste nga dëshira për t'i treguar, për ta ndarë këtë që e mundonte, por u kujtua si i pat thënë Shpëtimi se as me ndjenjat nuk duhet bërë egoist, se duhet menduar edhe për qetësinë dhe lumturinë e të tjerëve, sidomos të atyre që të duan, ndaj i tha:

- Mirë jam, Diamant, në fakt jam shumë mirë. Tani do të dal pak për një shëtitje edhe unë, koha është e bukur.

- Oh, ma hoqe brengën. Kalofsh mirë, pra, baba. Mirë u dëgjofshim.

- Ju përcjelltë e mira, bir. Mirupafshim!

Bujari ofshau thellë nga shpirti. Ndjeu po atë zbrazëtirë të madhe përbrenda. Shkoi në banjë, lau sytë disa herë dhe u shikua në pasqyrë. Imazhi i tij aty po e shikonte me fytyrën e një njeriu të pjekur, por të frikësuar, të braktisur dhe të vetmuar. Nga sytë mund të dalloje pikëllimin e njeriut që kishte bërë pa dashje të mbeste pa të afërmit e tij. Pa familjen dhe miqtë, pa punën dhe çdo gjë që e konsideronte të shenjtë.

Shikoi në kalendar. Ishte ditë e hënë.

"Ah, - u kujtua- sot kam ditën e psikoterapisë. Po qe se nuk jam vonë, po shkoj. Nuk më ka mbetur shpresë tjetër, madje as njeri tjetër që do të dëshironte të më dëgjojë, veç doktorit".

Ora po tregonte nëntë. U vesh shpejt e shpejt dhe doli. Pastaj u kujtua se nuk e dinte adresën e psikiatrit. Ta thërriste Shpëtimin? Jo, nuk kishte fytyrë, ishte sjellë me të padrejtësisht dhe ai sigurisht nuk do të dëshironte të fliste me të. U kujtua pak dhe shikoi nëpër xhepa për kartëvizitën e mjekut. E gjeti brenda kuletës.

Pas pak doli në rrugën kryesore dhe zuri një taksi. Ishte kredhur thellësisht në mendime.

Derisa po shikonte nëpër dritaren e veturës, mendonte me zemër të ndrydhur, të bërë shuk si letër:

" Çfarë ndodhi me familjen tonë, çfarë ndodhi… pse u shpërndamë kështu?".

Dhe përsëri ndjente faj, faj, faj… ishte i padurueshëm tensioni që i jepte ky fakt.

Pas pak u gjet para një shtëpie të bukur të lyer tërë ngjyra të ngrohta. Nuk dukej si klinikë.

- Jeni i sigurt se është kjo adresë? – e pyeti taksistin.

- Kjo është. Kam ardhur këtu sa herë. Shihni se shtëpia ka edhe një hyrje anash.

- Faleminderit.

Bujari e pagoi taksistin dhe zbriti. Hyri në oborrin e shtëpisë dhe doli anash saj. Vërtetë që kishte edhe një hyrje tjetër dhe sipër saj një mbishkrim, ku lexoi:

Klinika "Ylberi", ndërsa më poshtë emri i mjekut: dr. Lum Burimi.

" Kjo është" tha dhe hyri brenda. Një grua rreth të dyzetave rrinte në recepcion.

- Urdhëroni, zotëri! – i tha.- Keni sot takim me doktorin?

- Po. Në ora dhjetë. Quhem Bujar Spahiu.

Ajo shikoi regjistrin.

- Po, qenka radha juaj, pra. Hyni në atë derën në fund të korridorit dhe uluni, mjeku do të vijë shumë shpejt t'ju thërrasë.

- Faleminderit.

Dhoma e mjekut dukej si një dhomë e zakonshme shtëpie. Kishte një tavolinë pune, një kanape, ca kolltukë, një raft me libra. Më tutje ishte edhe një televizor.

" Ky thuajse jeton këtu" mendoi Bujari. Ndoshta kjo është edhe klinika edhe shtëpia e tij". Mori një revistë që e gjeti aty mbi një komodinë dhe filloi ta shfletonte, por mendja i rrinte te shumë gjëra: çfarë do ta pyeste mjeku, ku është tani Besa, po Diamanti a do nisej sot apo nesër, pse shkoi, pse ndodhi vdekja e Dorinës, pse u mashtrua me Natyrën, pse, pse, pse…

Zëri i mjekut e zgjoi nga mendimet.

- Mirëdita, Bujar, të lumtë mik, qenke i saktë si sahati,- dëgjoi zërin e dr. Lumit.

- Mirëdita,- ia ktheu Bujari, – erdha ashtu si e patëm lënë.

- Bukur. Shumë mirë. Si kalove këto ditë? A pushove si të pata thënë?

Bujari çoi nëpër mend të gjitha ngjarjet e ditëve të kaluara. I dukej thuajse kishin qenë tri vite, e jo tri ditë.

- Nuk pata nevojë të qëndroj shtrirë, doktor. Atë ditë u çlodha mirë dhe të nesërmen isha në rregull. Kjo sëmundja ime po paraqitet, si të thuash… me episode.

- Po a e ke vërejtur ti kur po paraqitet më së shpeshti?

- Po. Zakonisht kur tensioni nervor është shumë i madh, pra kur më vjen ndonjë lajm tronditës. Organizmi im po reagon në mënyrë të tillë, nuk di pse.

- Dhe çfarë janë këto lajme?

- Lajme lidhur me problemet e jetës, të familjes… dhe… dhe kohëve të fundit edhe të vdekjes së sime bijë. Jam bërë shumë i ndjeshëm, jam shumë i ngarkuar mendërisht. Sikur kam diçka brenda vetes që dua ta flak jashtë, por nuk mundem. Ose nuk di se si.

- Pra, na del se sëmundja jote, në fakt nuk është sëmundje.

Bujari u mendua. Vërtetë ashtu dilte.

- Po çfarë është, pra, doktor? Unë po ndjehem keq ato çaste. Më zihet fryma, më merren mendtë, zemra fillon të më rrahë shpejt e fuqishëm, ndjej frikë dhe pastaj më errësohen sytë. Ndjej një frikë të pa papërballueshme, por nuk e di pse, as për çfarë…

- Është kjo që thua. Një jetë me probleme, me emocione. Një fazë e vështirë nëpër të cilën po kalon dhe trupi yt reagon në këtë mënyrë. Do të mundohemi ta gjejmë rrugën e duhur së bashku.

- Do të shërohem tërësisht?

- Kjo nuk është sëmundje, Bujar, ndaj dhe nuk ka barëra që shërojnë. Por ka barëra që të ndihmojnë që shërimi yt të përshpejtohet. Dhe shërimi varet plotësisht nga ti. Nga lufta dhe dëshira jote për ta tejkaluar. Është një gjë që i ndodh kujtdo, sidomos në këto kohëra të ngarkuara, që po jetojmë. Duhet ta kesh dëshirën e duhur për të dalë nga kjo situatë.

- Dhe pastaj kur të shërohem, nuk kam më rrezik nga kjo?

- Ke rrezik si dhe çdo njeri tjetër, që është kandidat potencial për t'u thyer nga sfidat e jetës. Ti nuk je mbinjeri, Bujar, ndaj dhe kuptoje se nuk të kanë ndodhur gjëra të jashtëzakonshme. As kjo fazë, pra. Tani… do më tregosh pak për veten? Çfarë ke ndjerë këto ditë, si po i përjeton situatat; edhe për fëmijërinë tënde.

Bujari ngurroi, por pak nga pak filloi të lehtësohej. I tregonte mjekut si e kishte humbur nënën, përjetimet e tij si i vogël, bisedat me lumin dhe gjëra tjera. Pastaj krejt papritmas tha:

- Mbrëmë më la edhe gruaja ime. Më braktisi. Mori valixhet dhe shkoi.

- Ku shkoi?

- Në hotel, pastaj do të jetojë diku tjetër, nuk e di. Edhe djali im udhëtoi për në Afrikë. Më braktisën të gjithë. Vajza, vogëlushja ime vdiq në aksident vitin e shkuar. Kam mbetur vetëm.

- Si po ndjehesh tani vetëm? Je më i lirshëm?- pyeti doktori gati me një buzëqeshje.

- Si mund të ndjehet një njeri i vetmuar, i braktisur nga të gjithë, doktor?
- Nuk e di. Ma thuaj ti.
- Ndjehet keq, i zbrazët, i pavlerë… i, i, i padobishëm, i dërrmuar, i, i, fajshëm e i penduar… i humbur..
- I humbur për çka?
- Se më kanë braktisur, ndaj.
- Unë nuk mendoj se të kanë braktisur. Ti the se vajza të ka vdekur, kjo nuk është braktisje, është proces, është fatkeqësi. Djali ka ikur pse ka gjetur rrugën e tij dhe kjo është tani fatmirësi. Ndërsa gruaja, pse iku ajo?
- Pas një zënke,- dhe Bujari i tregoi për skenën që kishte bërë.
- Pra, edhe gruaja nuk të ka braktisur plotësisht, por ka pasur nevojë për hapësirë. Ti nuk e ke pasur këtë nevojë asnjë herë?
- Po, por jo atëherë kur tjetri është i dobët.
- Je i sigurt për këtë?

Bujari u bë grusht. Iu kujtua gruaja e tij e sëmurë, nata në shi. Pastaj u kujtua se gruan nuk e kishte përcjell asnjë herë, as në analiza, as në shëtitje, as e kishte pyetur si je. Dhe nuk ishte merakosur fare për të. Sa i vrazhdë kishte qenë me të!! Kushedi si është ndjerë ajo ato ditë, aq më shumë që e kishte ditur edhe për flirtin e tij me Natyrën.

- Jo. Edhe unë e kam bërë,- ia ktheu me turp.
- Çdokush ka arsyet dhe mënyrat e veta si reagon ndaj dikujt tjetër, ndaj nuk duhet ta paragjykojmë. Duhet të provojmë të gjejmë mënyrën si t'i përballojmë vetë sfidat e jetës, kupton?
- Po, por ende nuk e kuptoj pse e kam bërë, pse jam treguar aq i ulët. Pse nuk kam pasur mëshirë. Si kam mundur të tregohem aq i pashpirt.
- Sepse je njeri, ndaj. Njeriu nuk jeton në përralla ku personazhet janë të ndara në negative dhe pozitive, Bujar. Njeriu kalon nëpër jetë nga një situatë në tjetrën, varësisht prej rrethanave, kushteve dhe shumë faktorëve të tjerë që e rrethojnë në momente të caktuara. Kjo është jeta. Rregulla të prera si me thikë nuk ka.
- Por unë... unë kam bërë një gabim të pafalshëm.
- Ke vrarë njeri?
- Me një farë mënyrë, po. Bijën time. Familjen, veten.
- Hajde, më thuaj pse mendon kështu. Mos u ngut. Thuaji të gjitha ato që mendon t'i thuash.

Bujari u hamend. Po si t'i tregonte një njeriu të panjohur fshehtësitë e veta? Për këtë ishte një pacient, një numër. Pastaj tha me vete: "E çfarë kam më për të humbur? Asgjë. Ky është shpresa ime e vetme".

I tregoi një herë për humbjen e nënës, pastaj për martesën me Besën, zbrazëtinë që ndjenin në mes me kalimin e viteve; pastaj i foli për Natyrën, skenën e dashurisë me të, të cilën ende nuk e dinte në kishte ndodhur vërtet apo jo, mashtrimin me paratë, për Shpëtimin, Diamantin, Dorinën…

Doktor Lumi e dëgjonte me vëmendje dhe herë pas here i bënte ndonjë ndërhyrje ose ndonjë pyetje të shkurtër.

Pastaj Bujari sikur u lodh. Uli kokën me turp dhe tha:

- Ka kohë që me ndjek një ëndërr… një hije që kërkon të më vrasë.
- Si duket ajo hije?
- Është e frikshme, si fantazmë e shëmtuar.
- Ka provuar të të mbysë?
- Jo, por më ka dhënë gjithmonë dhimbje dhe më ka kërcënuar. Unë veç ik, i largohem.

- Po ti pse ikën?
- Nga frika.
- Frikë nga kush, nga çka? Mundohu të kujtohesh!
- Nuk e di. Nuk e kam të njohur.
- Domethënë nga frika prej së panjohurës. Apo jo? Ti frikësohesh prej së ardhmes, prej së panjohurës. Frikohesh nga çfarë mund të të sjellë jeta.
- E vërtetë.
- Ti ishe fare i ri kur të vdiq nëna?
- Nuk e di, nuk më kujtohet...
- Nuk të kujtohet kur humbe nënën tënde?
- Jo. Nuk më kujtohet në kam qenë ndonjë herë i ri.
- Çfarë ke ndjerë atëherë, a ishin të njëjtat ndjenja edhe kur humbe Dorinën?
- Po. Më mundonte një ndjenjë faji, që më duket se më vinte prej braktisjes.
- A e ndjen këtë edhe ndaj gruas sate tani?
- Po.
- Edhe ndaj Diamantit?
- Po.
- Çfarë mendon, pse të kanë braktisur?
- Sepse e kam merituar. Jam sjellë keq ndaj tyre, nuk kam arritur t'i afroj sa duhet, nuk u kam dhënë ngrohtësi sa duhet. Shkurt, nuk jam sjellë mirë me ta.
- Njësoj sikur ke menduar se nëna të ka braktisur meqë je lagur te lumi?

Bujarit iu mbushën sytë me lot. Mori frymë thellë dhe pas pak tha:

- Po, pak a shumë, po.
- Domethënë ti mendon se njerëzit që i do të braktisin kur nuk sillesh mirë me ta?
- Po.
- Mendon se të braktisin pse i do, apo pse nuk je sjellë mirë me ta?

Bujari u mendua.

- Të dyja,- tha dikur.
- Dhe çfarë ke ndërmarrë për këtë?
- Nuk e di.
- Mendoje më mirë, Bujar. Çfarë ke bërë që mos të të braktisin?
- I kam provuar të gjitha: mirësjelljen, lutjen, ndonjëherë edhe të kundërtat e këtyre.
- Po dashurinë? Ke provuar tua japësh këtë? – ngriti vetullën psikiatri.
- Shpresoj se po, kur e di se i dua më shumë se veten time.
- Por… ke provuar t'ua japësh?- përsëriti doktor Lumi.
- Por... por... nuk mund t'ua jepja sepse pastaj… pastaj…- iu ngushtua Bujarit fyti.
- Sepse pastaj do të të braktisnin? Kështu? Njësoj si nëna juaj?
- Po- tha Bujari. – Do të më braktisnin. Frikohesha t'u ofroj dashuri, nga frika se do të më braktisnin. Gjithmonë më kanë braktisur ata që i dua.
- Dhe pastaj? Si e ke menduar zgjidhjen?
- Kam provuar të mos i dua. Kam provuar të mos u tregoj se i dua. Kjo më ka dhënë një farë sigurie se do t'i kem gjithmonë pranë.

Bujari nisi të qante pa zë. Doktor Lumi qëndronte në heshtje fare pa e ndërprerë. Pastaj, kur mendoi se u qetësua pak, i tha:

- Martesa juaj ka qenë e zbrazët, Bujar, dhe ti je munduar ta plotësosh atë me mirësjellje në fillim, ndërsa gruaja jote këtë e ka bërë me dashurinë dhe kujdesin e përkushtuar ndaj familjes, ndaj teje, punës tënde në shkencë. Në fakt, këtu është gabimi i saj. Ajo i ka mbushur zbrazëtirat e shpirtit të saj duke pranuar, si të thuash, të jetë viktima jote. Kjo të ka bërë të ndjehesh me faj. Të mendosh se nuk po bën sa duhet për të. Dhe pastaj çfarë ke bërë? Ke provuar që intimitetin e zbrazët martesor ta plotësosh me afera jashtëmartesore. Pse e ke krijuar atë hendek ftohtësie mes gruas dhe teje? Këtë ti e di më mirë. Sigurisht nga kjo që thoni edhe vetë, nga frika për ta dashur.

- Po pse atëherë e desha Natyrën? E pse jo gruan time?

- Natyra ka paraqitur për ty një ikje nga realiteti, një dritare, e cila do të mbyllte gjithë atë erë, atë stuhi që frynte nëpër shtratin tuaj martesor dhe që jua akullonte shqisat. Ti atëherë kishe nevojë të hyje në pendlat e ngrohta të dikujt, të ndjeheshe ngrohtë dhe i sigurt. Nuk ishte e rëndësishme të kujt ishin ato pendla. Ti ishe në gjendje të paguaje për to.

- Por unë mendoja se e doja. Për Natyrën, them.

- Ti nuk e kishe të rëndësishme ta doje, aq sa kishe nevojë që dikush të të donte, të ishte i dashuruar në ty, të të dhuronte dashuri pa fund, pa kushte, pa halle, pa probleme. Dashuri të pastër prej përralle. Kishe nevojë të ikje nga realiteti. Në momentin që ky realitet është përplasur në fytyrën tënde, edhe dashuria është fashitur.

- Por çfarë nëse ajo nuk do të ishte mashtruese, kjo më mundon… unë... isha i gatshëm të ikja me të.

- E mundur. Por në momentin që ajo do të shndërrohej në njeri të zakontë, sa të përballej me problemet e jetës, me mungesën e parave, me nevojën për kujdes ndaj fëmijëve, ti do ta humbje sërish interesimin për të. Gjërat që fillojnë shpejt, zakonisht mbarojnë shpejt. Qenia njerëzore, ashtu siç ka nevojë për krijimin e miteve, ashtu edhe yshtet edhe t'i shkatërrojë ato, kur modelet mbi të cilat i ka vënë bëhen të tejkaluara, të përditshme, të harxhuara.

- Por, megjithatë, unë është dashur ta di kufirin. Shqetësohem pse nuk i kuptoja këto gjëra atëherë? Pse nuk vlerësoja time shoqe, familjen, gjërat e mira që më jepte mjedisi im, por përkundër i hidhja sytë jashtë tij, për ta kërkuar gëzimin e lumturinë diku tjetër?

- Kur njeriu është i pakënaqur, i palumtur thellë brenda vetes së tij,- mjeku u ndal pak dhe shtoi:- dhe unë të përjetoj të tillë- e shikoi prapë dhe tha:- Në këtë rast, pra, dalëngadalë e humb ndjenjën për vlerat e caktuara njerëzore e jetësore. Ty, në fakt, ndoshta do të të mjaftonte vetëm një puthje e thjeshtë me dashuri, më shumë se përqafimi i shkrirë në pasion. Ti kishe nevojë vetëm për këtë të parën. Këtë duket se gruaja jote kishte harruar tanimë të ta jepte, ndërsa e njohura e re, me ojnat dhe hiret e saja femërore, ishte gati të ta dhuronte. Deri diku. Pastaj të braktisi. Natyrisht, ajo mund t'ia lejonte vetes këtë sepse ka qenë në pozicion më të mirë se ti, dhe s'ka pasur asnjë ndjenjë për ty. Të është afruar për të tjera motive. Ajo ka pasur një projekt, një plan, ku ti ke qenë vetëm një lodër. Por, mos e gjyko, sepse këtë të drejtë, domethënë që të lozë me ty, ia ke dhënë vetë ti. Ishte një pikë e rrezikshme e pakënaqësisë tënde të brendshme, e boshllëkut tënd shpirtëror, në kapërcellin e jetës që po rrëshqiste gjithnjë teposhtë. E që dashnorja jote e re e shfrytëzoi për punët e saj. Por, mos e mundo veten, pse të gjithë ne njerëzit jemi të etur për një jetë, ku shpirti do të jetë së paku i mbushur përgjysmë.

- Unë ndjehesha plotësisht i zbrazët. Sado që mundohesha, zbrazëtia më thellohej edhe më shumë,- tha Bujari.

- E kuptoj. Po fëmijët? U ke ofruar afërsi fëmijëve gjatë rritjes së tyre?

- Jo sa duhet. Besoj se kam qenë diçka i vrazhdë me ta. Sidomos me djalin.

- Pse? A e ke menduar pse pikërisht me të?

- Jo. Por e di se e kam dalluar nga vajza. Kam qenë deri diku i ftohtë me të.

- E ke parë gjë si konkurrent, si sfidues?

- Jo.

- Çfarë, pra?

- Nuk e di. Ndoshta… ndoshta…

- Çfarë? Thuaje çfarë mendon.

- Ndoshta kisha nevojë ta përbuz, ashtu si më përbuzte babai im… nuk e di.

- Babai yt? Këtë nuk ma ke thënë deri tani.

- Po. Babai im. Ishte një njeri që pinte. Ishte gjithmonë i vrazhdë, më nënçmonte, nuk i gëzohej kurrë të arriturave të mia. Më përbuzte kur qaja për nënën, më thoshte se jam i dështuar, se i tillë do të jem gjithmonë. Një herë më pat pështyrë pse kisha marrë notë më të dobët.

- Të rrihte?

- Po. Një herë më pat mavijosur aq shumë, sa që mësuesi më pyeti çfarë kishte ndodhur. E gënjeva se kisha rënë nga pema. Nuk më besoi. Më pa me dhimbsuni dhe nuk tha gjë. Kjo më dhembi më shumë se rrahjet e babait.

- Por, a e ke pyetur ndonjëherë babanë pse të ka bërë të vuash aq shumë? Pse e ka pasur këtë sjellje jo normale me ty?

- Jo, nuk e kam pyetur. Por në mua kam pasur gjithmonë një mllef të grumbulluar që t'i hakmerrem dikur.

- E ke bërë?

- Jo. Ai vdiq. Nuk kontaktonim fare me vite. Jetonte me vëllain tim, ndërsa unë isha në studime. Punoja njëkohësisht, sepse nuk dëshiroja të më ndihmonte. Momentin që vdiq, u ndjeva se m'u bë një padrejtësi e madhe nga jeta.

- Sepse mbete pa baba?

- Më mbeti peng që nuk munda të flas me të, nuk munda të shfryhem… Kisha nevojë ta bisedoja e të kuptoja pse më kishte trajtuar ashtu gjatë të gjithë fëmijërisë sime, pa nevojë. Isha djalë i mbarë. Kisha ca shejtanllëqe si gjithë fëmijët e tjerë... por isha i mbarë… Doja ta pyesja tim atë pse… pse?… Doja ta bëja të vuante për këtë.

- Dhe pastaj ?

- Pastaj i premtova vetes se unë kurrë nuk do të jem një prind i tillë.

- E mbajte premtimin?

Bujari uli kokën.

- Duket se jo gjithaq. Duket se jam shfryrë në djalin tim pastaj.

- Unë besoj se vetëm ke qenë i frikësuar se do t'i përsërisësh gabimet e babait dhe duke e larguar djalin, në fakt, ke dashur ta mbrosh atë prej vetes tënde. Çdokujt në jetë i ndodh të kalojë nëpër një fazë ku grumbullon mllef, hidhërim dhe kjo ndjenjë nuk kalon edhe kur arsyeja që e ka shkaktuar të ikë, të zhduket, të soset. Këto situata na ndodhin në shtëpi, në punë, mes miqve. Por duhet të mbesin ashtu siç janë: mllef, i cili në rastin më të mirë do të duhej shfryrë në personin që na e ka shkaktuar. Por kur të kalojë në dëshirën për hakmarrje, atëherë gjërat vështirësohen,– tha psikiatri dhe vazhdoi:

- Dëshira për ta dënuar njeriun , i cili na ka dhënë shumë dhimbje, pavarësisht me ose pa vetëdije, nuk është asgjë e re, por është e pashërueshme, nëse nuk e di mënyrën e duhur për ta hequr. Është si një sëmundje kronike, që nuk të shqitet, por të ha, të jep dhimbje, të mbyt.

- Por si ta luftoj, si ta heq?- pyeti Bujari

- Mendoje pra vetë, Bujar. Nëse për shembull ti i ke krijuar dhimbje birit tënd, çfarë do të dëshiroje që ai të bëjë ndaj teje?

Bujari u mendua pak më gjatë.

- Të më falë. Të më falë. Nuk kam dashur ta lëndoj.

- Po pra, të të falë. Ndaj edhe ti duhet të falësh, Bujar. Së pari vetveten, pastaj edhe të tjerët. Të falësh është të kthehesh në jetën normale, të bëhesh ai që je: njeri. Të falësh është t'i ofrosh së pari vetes tënde qetësi, të vendosësh qetësi brenda vetes, pra.

- Por unë, unë nuk mund ta harroj çfarë ka bërë prindi im me mua. Se si jam ndjerë më i lidhur pas nënës pastaj, desha s'desha - tha Bujari me zërin gati si të një fëmije.

- T'i tejkalosh ca gjëra, nuk është si t'i harrosh, Bujar,- tha psikiatri.- Atij që na ka dhënë dhimbje, me ose pa dashje, mjafton t'ia bëjmë me dije se nuk jemi ndjerë mirë, se nuk ka bërë mirë. Dhe kaq. Pastaj bëhemi zot të situatës dhe i tejkalojmë. Sepse shih,- vazhdoi ai,- të falësh i ndihmon vetvetes, e rregullon situatën brenda vetes, më kupton? Vë baraspeshën ndërmjet shpirtit dhe arsyes. Pavarësisht se dikush na ka përbuzur, nënçmuar, na ka nxjerrë jashtë vetes, ne nuk kemi të drejtë në hakmarrje, sepse kjo nuk na çon askund pos shkatërrimit tonë. Këtë nuk kemi të drejtë t'ia bëjmë vetes. As njerëzve të tjerë pastaj.

Bujari u mendua. Vërtetë dukej ashtu. Ndjehej plotësisht i dërrmuar nga biseda, por njëkohësisht shumë i lehtësuar. I dukej thuajse po e shihte botën me sy të tjerë, thuajse gjërat po vinin dalëngadalë në vendin e vet, thuajse çdo gjë tani po merrte kuptimin e duhur.

- Duhet të fal, doktor. E di. Do të mundohem.

- Duhet të falësh, Bujar. Kështu do të largohesh nga dhimbja jote dhe do të mendosh më lehtë në të ardhmen. Madje do ta ndërtosh atë shumë më të mirë. Por, duhet të falësh, por edhe të kërkosh të të falin.

Bujari ngriti sytë dhe shikoi mjekun. Ai po i buzëqeshte ashtu sikur të jepte kurajë një mik i mirë. Madje tani e vërejti se ai fare nuk e kishte pasur mantelin e bardhë. Ishte sikur të bisedosh me dikë që mund të të ndihmojë ta ndash dhimbjen.

"Si me Shpëtimin", u kujtua dhe ndjeu turp nga ajo që kishte bërë ndaj tij e ndaj Besës.

Doktor Lumi vazhdoi:

- Sot kemi biseduar gjatë, Bujar. Zakonisht kështu kalon takimi i parë. Sa të njihemi, pra, sa unë ta njoh gjendjen tënde. Pastaj do ta kemi më lehtë, do ta shohësh. Do t'i gjesh përgjigjet gjatë rrugës që kemi për të bërë. Me rëndësi është të heqim pengesat e para. Si ata gjembat që na i çjerrin këmbët. Për sot e kemi kryer. Ndjehesh më mirë tani?

- Po. Faleminderit, doktor.

- Asgjë. Do të punojmë bashkë, mos ki merak. Tani çfarë do të bësh, do të kthehesh në shtëpi?

- Jo. Një herë do të shkoj diku në një vend tjetër. Ndjej nevojë të shkoj në atë vend ku s'kam qenë kaherë. Është koha.

- Epo mirë, shko atëherë. Neve shihemi të premten, mirë? Të vete mirë?

- Po. Mirupafshim.

- Mendo për këto që folëm. Procesi është i gjatë dhe i mundimshëm, por do t'ia dalësh. Le të jetë kjo si një detyrë shtëpie.

- Po, gjithsesi. Mirupafshim.

Bujari doli dhe kërkoi sërish një taksi. Ishte krejtësisht në mendime, por bota i dukej më e kthjellët.

- Për ku, zotëri?- e pyeti taksisti.

- Në varreza, - tha Bujari dhe shikoi tej dritares.

XVI

Brenda dyerve të hekurta, që rrinin gjithnjë hapur, mbretëronte qetësi e paskajshme. Dëgjoheshin bilbilat që këndonin nëpër degët e lisave të gjatë, të cilët bashkë me pishat rrethonin atë vend nga të gjitha anët.

Bujari mendoi se banorët e atyshëm ishin gjithsesi të qetë, larg kësaj bote të vrazhdë, larg dhimbjeve, larg një jete të rrejshme ku njerëzit kapeshin fytafyt me njëri-tjetrin për të marrë pak gjë më shumë, për të qenë pak më të lumtur se të tjerët, pak më të pasur se të tjerët, vetëm për pak më shumë.

Ecte ngadalë i zhytur në mendime dhe kërkonte me sy varrin e së bijës. Banesën e përhershme të saj. "Ajo nuk ka varr,- kishte thënë atë ditë të rëndë, kur Dorina iku përgjithnjë.- Ajo ka atje një shtëpizë të vogël, të bukur. Diellhëna ime nuk mund të mbyllet në varr".- A do të mund ta përballonte këtë gjë? Nuk kishte ardhur më që nga dita e varrimit; kishte menduar se nuk mundej të duronte atë dhimbje të pikur si klithma e zogut. Po sot erdhi. Po nëse do të humbte ndjenjat? Ah, jo, jo, nuk do të strukej pas emocioneve këtë herë. Nuk do të fshihej pas një sëmundjeje të trilluar nga ndërdija e tij, që yshtej ta shpëtonte nga dhembja e realitetit të vrazhdë. Kishte nevojë ta bënte këtë, kishte nevojë të ndjente dhembje, kishte nevojë të fliste me Dorinën.

Te dyert ishte roja e varrezave, ndërsa brenda tyre nuk dukej asgjë e gjallë, pos natyrës. Bujari ecte kokulur, në zemër mirënjohës për këngën e bilbilave, të cilën mendonte se ia dhuronin shpirtrave që banonin në botën e përtejme.

"Jam afruar, ja edhe pak dhe do arrij, bëhu i fortë!", i urdhëronte vetes. Ktheu në të djathtë, në pikën prej nga i kishte treguar Besa se shihej edhe pllaka, që ia kishin ngritur prej mermeri. Hapat i dukeshin të rënda, thuajse po ecte me këpucë dheu.

"Si kam mundur të mos vij deri më sot?", habitej me veten e tij. Ndjente një dëshirë të papërmbajtshme për të arritur sa më shpejt pranë së bijës. Ngriti sytë dhe ja tek ishte. Një pllakë e bardhë, mbi të cilën ngrihej pastaj një skulpturë që paraqiste diçka në mes të një vashe, engjëlli dhe fëmije. Sapo u bë gati të afrohej, pa figurën e një njeriu të përkulur mbi varr. Nuk ishte Besa, jo. Ky ishte një djalosh i ri që po përkëdhelte pllakën dhe ia vinte lulet e freskëta përmbi.

"Prit, i tha vetes,- mos jam gabim, mos jam hutuar. Aty nuk qenka varri i Dorinës, qenka dikush tjetër". Eci edhe pak me hapa të pasigurta. "Zot i madh, por këtu duhej të ishte, këtu!"

Djaloshi ndjeu zhurmën e hapave të dikujt pas supeve të tij dhe u ngrit menjëherë në këmbë. Për ca momente u panë sy më sy. Ishte i ri, ndoshta ca vite mbi të njëzetat, pak i dobët dhe i zbehtë. Kishte flokë të gjatë, të mbledhura mbrapa në një bisht dhe, megjithëse Bujarit nuk i pëlqente kur meshkujt mbanin flokët e gjatë, vuri re se këtij djaloshi i kishin vërtetë shumë hije. Largoi sytë nga ai dhe mori kthesë të ndërronte rrugë. Ndonëse ishte hutuar fare, nuk e dinte nga mund të kërkonte tjetër. Pas shpine dëgjoi zërin e djaloshit

- Zotëri, prisni! Mos shkoni! Jeni gjë babai i Dorinës?

- Po,– iu përgjigj Bujari dhe u ndal. – Ku e di ti? Nga më njeh?

- Unë… unë… në të vërtetë nuk ju njoh prej së afërmi.

Bujari tashmë ishte afruar te varri i vajzës së tij. Nga pllaka e shikonte fotografia e Dorinës, e cila ishte e buzëqeshur. Dukej thuajse çdo moment do thoshte: Ç'kemi, babi? Të dua fort , e di këtë? E pastaj do të qeshte përsëri….

U ul skaj varrit dhe iu drejtua djaloshit:

- Po mirë, atëherë pse jeni te varri i bijës sime?

- Unë... unë e njihja Dorinën. E kisha mike të mirë.

- Vërtetë? Nuk e dija. Po si quhesh ti e kush je? Ishit gjë miq në shkollë?

- Quhem Baton. Jam student i mjekësisë. Dorinën nuk e njihja nga shkolla. Jemi njohur në një vend të... të…, – tha sikur i zënë ngushtë, por pastaj mori frymë thellë e vazhdoi: - Shikoni, ne në fakt jemi njohur në spitalin e qytetit.

- Spitalin e qytetit? Unë nuk mbaj mend që Dorina të jetë shtruar ndonjë herë në spital. Mos e ke ngatërruar gjë?

- Jo zotëri, - tha Batoni.- Deshi të vazhdonte diçka, por pastaj u ndal.

- Po si atëherë? Dorina nuk ishte as nxënëse e mjekësisë. S'po kuptoj, çfarë kërkonte ajo në spital?– pyeti Bujari disi duke menduar në vete, thuajse po kërkonte diçka nëpër kujtime. Dhe pastaj sikur u kujtua:- Ndoshta vizitonte ndonjë shoqe të sëmurë?

- Jo, nuk ka pasur një shoqe të sëmurë. Në të vërtetë po, ka pasur shumë miq të sëmurë... por, jo…- u hutua Batoni dhe vazhdoi:- Zotëri, duket se nuk e keni njohur këtë anë të Dorinës. Ajo ka qenë e lajmëruar si vullnetare për t'u ndihmuar të sëmurëve qoftë në spitale, qoftë nëpër shtëpi të pleqve. Atë e adhuronin të gjithë. Ishte aq e sjellshme, e ëmbël, e durueshme. Ta mendosh se e bënte vetëm nga dëshira e pastër për të ndihmuar. Zotëri, keni pasur një vajzë të rrallë,– tha Batoni në fund duke e shikuar Bujarin diçka me turp, por me një interesim, thuajse donte të çmallej për Dorinën.

Bujari kishte mbetur pa fjalë.

Dorina vullnetare? Dorina ndihmonte të sëmurët? Dorina, të cilën e mendonin të brishtë, të dobët dhe të llastuar, iu ndihmonte njerëzve në nevojë, u jepte forcë, kurajë, ua kthente dëshirën për jetë. Ajo! Dorina e tij e vogël kishte një zemër kaq të madhe?!

- Unë vërtetë nuk e kam ditur. Jo, nuk e kam ditur këtë, – tha Bujari me një krenari të përzier me përmallim.- Por ti ende nuk më tregove si e ke njohur Dorinën?

- Do t'jua tregoj, zotëri. Por një herë do t'ju lë vetëm me bijën tuaj. Kur të kryeni vizitën, ju pres jashtë varrezave, mund të shkojmë për ndonjë kafe.

- Gjithsesi. Të lutem më prit. Dua të dëgjoj çdo gjë për vajzën time, çdo gjë.

Batoni pohoi me kokë, u ngrit dhe ia bëri me dorë.

Bujari shikoi përsëri Dorinën. Iu bë sikur ajo i tha: "Eh, nuk të besohet, ë? Por unë dëshiroj të më kujtosh përsëri si të vockël, të më duash si diellin, hënën dhe botën tënde, mirë?".

- Mirë,- tha Bujari me zë dhe buzëqeshi. Iu duk aq reale pyetja që e kishte ndjerë nga Dorina, thuajse e kishte aty pranë. Dhe pastaj filloi t'i fliste thuajse ajo ishte aty:

- Dorina ime!, vajza ime! Jeta ime!Duket se kam filluar të njoh anën tënde të pjekur pas vdekjes tënde. Jam krenar që të kam,- mori frymë thellë,- që të kemi pasur, bija ime. Dua të jem mirënjohës ndaj jetës, që na lejoi të të kemi pranë gjithë ato vite, të jetojmë me ty. Kam ardhur të të fal dhe të të kërkoj falje, e dashura ime, fëmija im. Të kam fajësuar se më ke lënë, se më ke braktisur, se më ke dënuar për të gjitha që kam bërë. Por tani e di se ti nuk ke bërë kështu, ti vetëm… vetëm ke ikur. Ke shkuar në një vend më të mirë… O Zot, sa të dua, sa kam mall!,- uli kokën Bujari dhe puthi pllakën e ftohtë. Lotët i pikonin mbi mermer dhe krijonin aty liqene të vegjël ku lahej dhimbja.

- Nuk dua të brengosesh më për mua, Dorina, të lutem prehu e qetë. Dua ta lejoj shpirtin tënd të shkojë. E di se tani do të mundoheshe ta zgjidhje çdo situatë, e di. Por, unë do të mundohem të jap prej vetes të gjitha, të bëj ashtu si do të dëshiroje ti, ashtu si do të doje ti… që të ishin gjërat. Këtë herë vërtetë do të mundohem, bijë, të lutem vetëm… vetëm më trego rrugën e duhur. Më trego si ta gjej veten, si ta gjej njeriun në mua. Si ta gjej jetën e të jetoj me të, më kupton, të lutem, a më dëgjon?- e pyeste Bujari me zë të ulët të bijën përmes fotografisë.

- Të lutem, më fal Dorina, më fal për të gjitha. Më fal se nuk rregullova frenat, se nuk shkova të marr veturën… oh,- ofshau thellë… Më fal se nuk isha aty kur mbylle sytë, babai yt është një… një… një… - kapi fytyrën me duar.- Oh, unë nuk të kam merituar, unë nuk ju kam merituar asnjërin. Më fal, bija ime…

.....

Kishte pak kohë që Bujari kishte ndalur lotët. Pas takimit me psikiatrin dhe me varrin e Dorinës, ndjehej një njeri tjetër. Më i ndjeshëm, por më i fortë. I trishtuar nga realiteti i jetës, por dhembshëm i fuqishëm për ta përballuar. Nuk kishte gjë për të humbur. Ai duhej ta rifitonte gjënë më të çmuar që e kishte humbur. Njeriun në veten e tij.

Kështu do ta donte Dorina. E dinte se ajo besonte në të. Gjithmonë i kishte qëndruar pranë, edhe kur ai e largonte me vrazhdësi.

Kur po largohej, iu duk se la një pjesë të zemrës së tij bashkë me Dorinën. E puthi me sy imazhin e saj dhe u nis drejt daljes.

Ca hapa më tutje në rrugë po priste Batoni. Kishte një biçikletë me vete, të cilën e kishte mbështetur për një shtyllë. Kur e pa që Bujari po afrohej i doli përpara.

- Ejani, zotëri Bujar, më tutje ka një restorant të vogël, pimë aty nga një kafe e bisedojmë.

- Po emrin si ma di?- e pyeti Bujari.

- Oh, Dorina fliste për ju tërë kohën. Gati më dukej se ju njihja.

Ecën bashkë duke shkëmbyer ndonjë fjalë rreth studimeve të tij. Tani po jetonte në kryeqytet, kishte zënë një shtëpi së bashku me disa shokë të fakultetit.

- Ke menduar për specializimin?- e pyeti Bujari rrugës.

- Po, po gjithsesi, por tani është herët të flasim, kam goxha vite përpara. Por, po, e di qysh tani se çfarë kam dëshirë. Besoj onkologjinë.

- Onkologjinë? Kjo fushë më duket ca e frikshme. Nuk të duket vështirë të merresh me njerëzit që kanë aq pak gjasa për të jetuar? A nuk është vështirë të përpiqesh t'i ndihmosh një njeriu pa e ditur nëse do të jetojë më? T'i japësh shpresë edhe atëherë kur ai vetë e ka humbur atë?

- Vështirë është. Por jo të gjithë e humbin shpresën. Shumica luftojnë deri në fund, pavarësisht rezultatit. Njeriu shfrytëzon rezervat në momentet e vështira. Pastaj ka shumë që shërohen edhe kur mjekësia të ketë ngritur duart nga ata.

- Ashtu? Po ti ku e di? Keni bërë praktikë në këto reparte?

- Jo, zotëri. Kam qenë njëri prej këtyre njerëzve, prej pacientëve.

Bujari heshti. Ky djalosh i brishtë kishte qenë pacient në një repart të tillë të frikshëm, kishte luftuar me vdekjen dhe e kishte fituar?

Pasi u ulën, djaloshi porositi kafetë dhe i buzëqeshi përsëri. Dukej i kënaqur që e kishte takuar, sikur shihte ndonjë mik të vjetër ose e përkujtonte diçka në të. Kishte fytyrë të këndshme dhe në të loznin dy sy të zgjuar.

- Më thuaj si e njohe Dorinën?- më në fund e pyeti Bujari.

- Eh, është paksa histori e gjatë.

- Unë kam gjithë kohën e duhur, Baton, të lutem! Kam nevojë të dëgjoj për të.

- E kuptoj,– tha shkurt Batoni pastaj sikur hyri brenda kujtimeve.- Para tre vjetësh, kur po bëhesha gati të filloja studimet, vërejta ca njolla të zeza nëpër trup. Në fillim mendoja se jam vrarë diku, se janë hematoma. Uh më falni, ia nisa unë të flas me terma mjekësore…

- Jo, jo vazhdo, unë e di ç'janë hematomat. Pastaj?

- Kisha ca dhimbje të pashpjegueshme, por nuk dëshiroja t'i brengos prindërit, mendova se jam vrarë diku me biçikletë, meqë unë isha një sportist, kisha marrë shumë medalje si çiklist. Ndodhte që gjatë ushtrimeve të rrëzohesha ndonjë herë. Por, me kohë dhimbjet u shpeshtuan dhe ndjeja marramendje. U paraqita te mjeku, që e kishim në klubin e çiklistëve. Ai nuk i dha shumë rëndësi, por më propozoi të bëja analiza të mëtutjeshme. Tha sigurisht nuk je ushqyer me rregull, mos u brengos. Megjithatë, unë bëra analiza të tjera, ashtu sa për të hequr brengën. Mbaj mend ditën kur shkova t'i marr. Mjeku specialist kishte një fytyrë të ngrysur dhe ndonëse përpiqej të buzëqeshte, isha i sigurt se do ma kumtonte ndonjë lajm të keq. Ashtu dhe ndodhi. Më tregoi se kisha leuceminë. Në fillim m'u duk se isha në një ëndërr të keqe, ose mjeku po fliste për dikë tjetër. Por sytë e mjekut më sollën në vete.

- Çfarë bëre, si reagove?

- Një herë asgjë. Pastaj kalova në dëshpërim. Do të vdisja!!! Asgjë nga planet e mia si sportist, si mjek, asgjë nga jeta. Do të vdisja nën torturat e një sëmundjeje të egër. Në gjithë atë makth, mjeku përpiqej të më shpjegonte se kisha një mundësi shpëtimi, se gjithsesi mund të shpëtoja nëse bëhej transplantimi i palcës kurrizore. Por unë nuk e dëgjoja fare, për mua jeta ime mbaronte aty.

- Si ua tregove prindërve?

- Ata e përjetuan shumë rëndë. E dini, ne edhe nuk mbaheshim aq mirë materialisht, ndaj ishte edhe një brengë më tepër: paratë. Vërtetë njerëzit thonë se shëndeti është më i rëndësishëm se paratë, por në kohërat e sotme po nuk pate para dhe je i sëmurë, si t'ia bësh? Askush nuk ta zgjat dorën, askush.

- E vërtetë, - tha Bujari. Instinktivisht i shkoi mendja te babai i Jetës, Arbeni, që ishte edhe ai në një hall të tillë.

- Pastaj filluan analizat e vështira, torturat. Lashë edhe shkollën. Prindërit ishin me mua gjithkah, shitën shtëpinë dhe kaluan në një apartament më të vogël. Kjo më bëri që të ndihem akoma më me faj. E pastaj fillova të fajësoj të tjerët. E kisha shumë vështirë, isha inatosur me gjithë botën. Pse po më ndodhte kjo gjë? Pse mua? Pse? Më e vështira ishte të humbësh shpresat, zotëri Bujar. Eh, atëherë je i sëmurë vërtetë, je dorëzuar. Ky ishte problemi im më i madhi. Më kishte mundur frika. Bashkë me padëshirën për të luftuar, më kishin mundur më zi se sëmundja. Më shtrinë në spital, megjithëse e shihja të kotë çdo përpjekje që bënin. Iu thosha të më linin të vdisja, isha i ashpër me prindërit e mi, me vëllain tim më të vogël. Një ditë më shkoi mendja të vrisja veten.

"Oh Zot!- pëshpëriti Bujari në kokën e tij.- Pse njeriu gjithmonë mendon në këtë zgjidhje kur rrugët i mbyllen? Pse? Ku e dimë se përtej asaj bote nuk na pret ndonjë dënim edhe më i rëndë?".

- Gati e kisha vendosur,- vazhdoi Batoni.- Do të pija gjithë barërat kundër dhimbjeve, do të bëja diçka. Le të çliroheshin kështu prindërit e të tjerët nga barra që kishin. Ashtu e konsideroja unë veten, si barrë. Pra, e bëra planin, do të vdisja. Do t'i bëja inat edhe vdekjes duke e shkaktuar para se ajo të vinte.

- Dhe çfarë ndodhi?

- Ndodhi… ndodhi mrekullia. Dorina! Ajo kishte ardhur atë ditë në spital për të punuar si vullnetare. Hyri në dhomën time gjithë jetë. Në fillim e prita vrazhdë, madje i bërtita. I thashë të dilte jashtë, por ajo më buzëqeshte. I anashkalonte budallallëqet e mia.. Më ndihmonte me ilaçet, më fliste, por unë sillesha si kalama i keq. Një ditë, në fund të orarit ajo u kthye përsëri. Pa fjalë më ngriti e më vuri në karrocë.

"Ku po më çon, i thashë, në ferr?". Ajo tha:

"Jo, po të dërgoj në një vend plot me engjëj, do ta shohësh".

“Mirë fort, iu përgjigja me ironi,- paskam menduar se engjëjt kanë vdekur të gjithë. Ose kanë qenë vetëm në përralla”.

-Ku të dërgoi?- e pyeti Bujari me kureshtje.

- Në repartin e fëmijëve të sëmurë me kancer. U futëm brenda. Ishin disa shtretër me fëmijë, që pothuajse sa kishin parë jetën. U tmerrova. Me gjithë ato fytyra të zbehta, të ënjtura nga barërat,me tuba nëpër gjymtyrë ata prap mundoheshin të buzëqeshnin!!!Dukej se kështu e sfidonin vdekjen, e cila pamëshirshëm endej mbi shtretërit e tyre, ku iu dergjeshin trupat e njomë. I bënin ballë gjithë atyre vuajtjeve duke qeshur sepse… sepse ishin fëmijë. Ishin engjëj. Nuk i kishin bërë askujt asgjë të keqe dhe ishin dënuar të vdesin. Pse, o Zot, u pyeta, pse? Sa kriminelë jetojnë rrugëve duke vrarë njerëz, sa kriminelë përjetojnë pleqëri të thellë, sa shumë njerëz të këqij në botë ia dalin me lehtësi në jetë. Pse? pse?.. E ndjeva veten si budalla i llastuar, zoti Bujar. Afër atyre krijesave të vogla engjëllore u ndjeva aq i dobët. U turpërova pa masë. Dorina ma kishte gjetur pikën e duhur. Prej atij momenti vendosa të luftoj për jetën.

- Biseduat me Dorinën pastaj?- pyeti Bujari me zë të mbytur.

- Po. Shumë herë. U bëmë miq. Ajo… ajo ishte pika ime e vetme e shpresës që më kishte mbetur. Ajo… ajo ishte drita ime në fund të tunelit, zotëri Bujar. Me kohë, unë... unë... isha dashuruar në të.

Bujari u habit. Pastaj u përmblodh dhe tha:

- Po ajo? Dinte gjë ajo?

- Besoj se e ka kuptuar. Por, ajo ishte shumë e mençur, e përkryer. Asnjë herë nuk më ka lënduar, asnjë herë nuk i keqpërdorte ndjenjat e mia. Vetëm më jepte forcë. Pastaj më transplantuan palcën. Ma dhuroi vëllai im i vogël. Mbaj mend Dorinën kur më vizitoi mua dhe vëllain. E dini çfarë tha?

- Çfarë?

- Më tha se aq shumë i dhimbsej vëllai im, sa që do të donte të ishte e mundur që ajo të ma dhuronte palcën. Ajo... ajo donte t’ia merrte dhimbjen çdokujt, qoftë atë shpirtërore, qoftë atë fizike.

- Eh… Dorina, bija ime, - ofshau Bujari, - brenda vajzës së hareshme e të pabrenga ke fshehur gjithë hallet e botës. E ne nuk kemi ditur asgjë. Asgjë. Asnjë herë nuk na ka munduar me asgjë.

- Ajo fliste për ju tërë kohën. Për prindërit, për vëllain, por posaçërisht për ju, zoti Bujar.

- Vërtetë? Frikohem të të pyes çfarë mendonte bija ime për mua, Baton.

- Oh, zotëri Bujar, ajo ju kishte idhull, ju adhuronte. Ju ishit shembull për të.

- Unë? Ah, kam frikë. Kam frikë se nuk kam qenë dhe nuk jam aq i përkryer sa më ka paraqitur bija ime.

- Ju keni qenë i përkryer për të. Kjo ishte me rëndësi. Ajo ju donte me gjithë zemër. Fliste me krenari për ju, donte edhe ju të ishit krenar për të.

- Por, unë isha… isha.

- Sigurisht. Por ajo donte të arrinte në jetë, të bënte edhe karrierë. T’ju bënte edhe juve të lumtur.

- Oh, ajo na ka bërë të lumtur me vetë prezencën e saj. Po pastaj, Baton, me ty ç’u bë, si u shërove?

- Po. Ndodhi mrekullia dhe pas shumë muajve më lëshuan në shtëpi. Analizat treguan se isha shëruar në tërësi. Fatkeqësisht, jo të gjithë kishin fatin tim, jo vetëm për t’u shëruar, por edhe për ta pasur Dorinën afër. E dini, zoti Bujar? Kur erdha në shtëpi, prindërit më treguan se ajo kishte organizuar edhe grumbullimin e parave në shkollë për shërimin tim. Më ka mahnitur.

- Po pastaj, e takove më?- pyeti Bujari.

- Po. Më vizitoi një herë në shtëpi bashkë me ca miq të tjerë. Dallohej disi nga të tjerët. Apo ndoshta mua më dukej ashtu ngase isha i dashuruar në të. Rrezatonte një gjë që nuk mund të shpjegohet me fjalë. Sikur ndjeheni mirë afër dikujt, ndjeheni i sigurt. Ju jep një ngrohtësi të paimagjinueshme që ju bën të ndiheni i qetë brenda vetes suaj.

- Dorina e kishte këtë forcë?

- E kishte. Ndoshta ishte e pavetëdijshme, por ajo ishte… ishte si një engjëll. Unë jam i bindur se ajo është engjëll tani,- tha djaloshi e pastaj u ngrys:- Për aksidentin e kam kuptuar nga gazeta. Isha në kryeqytet dhe po shkoja në ligjërata. Rrugës hapa gazetën dhe u ndesha me fytyrën e Dorinës. Një pjesë e imja nuk e pranonte këtë gjë. Ia fillova të qaj në rrugë. Pastaj u ktheva në banesë dhe bëra gati rrobat. Erdha në varrim. Mezi kam qëndruar në këmbë. Prej atëherë e vizitoj rregullisht në varreza, i flas, i tregoj për studimet. Dhe e dini çfarë? Më duket thuajse prapë më jep forcë edhe nga ajo botë. thuajse e kam si engjëll që më mbron, më këshillon, - tha Batoni dhe pastaj shtoi:

- Kemi qenë te ju për vizitë ato ditë, por sigurisht nuk ju kujtohet. Ka pasur shumë njerëz…

- E mundur, ato ditë nuk më kujtohen mirë, kam qenë në mjegull. Por, më fol ende për të, të lutem më trego ç'u bë pastaj mes jush?

- Pas ca kohe, kur u forcova, vazhdova me studimet, por për sportin ishte herët. Në anën tjetër doja ta takoja Dorinën, nuk mund ta harroja kurrsesi. U interesova dhe e kuptova ku studionte. E prita para shkollës dhe dolëm për një kafe. Isha aq i dashuruar në të, sa që po të pranonte, do të martohesha me të menjëherë.

Bujari ofshau. Ai e kishte menduar ende si foshnjë, derisa Dorina e tij kishte ngjallur emocionet e forta të një burri që dëshironte ta kalonte me të jetën.

- I the për dashurinë tënde?

- Në fillim jo. Biseduam rreth shërimit tim, rreth kthimit në jetë. Iu falënderova me gjithë zemër, por ajo nuk donte të ndjehej e veçantë.

"Ti ke luftuar vetë,- më thoshte,- por nëse e konsideron se unë të kam ndihmuar, atëherë me vjen vërtetë mirë. Sepse çdokush ka nevojë të kapet për një qëllim, për një arsye të fortë që do ta shtyjë përpara dhe kjo gjë kam qenë unë për ty. Nuk është e rastit asgjë. Pra, as ajo që kam ardhur të punoj vullnetarisht aty ku ti ke humbur shpresat, e kupton?", më thoshte. "Janë forca më të mëdha se ne forcat e Universit, i rregullojnë gjërat më mirë.".

- "Por unë fitova mbi vdekjen, Dorina ",- i thosha- Pata fat në jetë, ashtu siç pata fat të të takoj ty…", – mundohesha t'ia them disi zjarrin që më vlonte.

"Baton, jetojmë në këtë botë për ta kërkuar lumturinë, jo për ta gjetur. Kjo e dyta është pothuajse e pamundur. Por, ndodh edhe na buzëqesh fati ndonjë herë. E gjejmë. Dhe pastaj prapë vazhdojmë dhe e kërkojmë. Është në natyrën njerëzore. Çfarëdo zgjedhjeje dhe kombinimi që bëjmë në jetë, nuk na jep të përkryerën që do ta dëshironim dhe që do të na bënte të kënaqur plotësisht. E di pse?" - më pat pyetur.

" Pse?" i thashë.

" Sepse atëherë nuk do të kishim çfarë të kërkonim sërish në jetë. Duhet gjithmonë të hulumtojmë brenda dhe jashtë vetes, Baton. Duhet ta gjejmë njeriun brenda nesh. Çfarë na bën të lumtur? Ty? Mua? Si mund të ndjehemi të plotë dhe të kemi përsëri ende për të kërkuar? Ende për të dhënë? Këtë duhet kërkuar. Të marrësh nga jeta dhe të dhurosh jetë më tutje".

" I ke teoritë të komplikuara" i pata thënë.

" Eh, ne vajzat kështu jemi, të gjitha të komplikuara", vazhdonte pastaj me qeshje.

Bujari ishte plotësisht i tronditur.

"Të marrësh jetë dhe pastaj ta dhurosh më tutje". Vajza e tij e vogël kishte thënë një të vërtetë të madhe jetësore që ia lëkundi zemrën.

Batoni i fliste akoma për të, por Bujari tanimë ishte diku tjetër. Vajza e tij po i dërgonte një mesazh, e dinte këtë, ishte më se i sigurt.

- Baton, – i tha me një zë të vendosur dhe duke u ngritur njëkohësisht në këmbë.- Jam shumë i lumtur që të takova. Nuk e ke idenë sa më ke ndihmuar. Sot më ke bërë… më ke bërë ta shoh edhe një anë tjetër të Dorinës, të flas me të. Të falënderoj nga zemra, Baton. Do të dëshiroja të shihemi përsëri. Por tani do më falësh, më duhet të shkoj.

- Sigurisht. Edhe unë jam i kënaqur që ju takova. M'u duk se pata një pjesë të Dorinës afër,- tha Batoni dhe u ngrit edhe ai. Pastaj mori biçikletën dhe tha:

- E shihni? E kam filluar nga pak edhe sportin. E dini pse? Për Dorinën. Do ta bëj për të. Do të përpiqem që ta marr trofeun për të. E kam ëndërr që një ditë ta hap një spital dhe ta quaj sipas saj. E dini si thoshte Dorina?

- Si?- tha Bujari.

- Jeto për ëndrrën tënde Baton, jeto për ta realizuar, mos lejo vetëm të ëndërrosh se po jeton!

Bujari u përlot. Ia dha dorën Batonit dhe i tha:

- Jam i lumtur që je shëruar, biri im. Të dëshiroj vetëm suksese dhe shëndet. Mos më harro dhe eja të na vizitosh.

- Gjithsesi,- i tha Batoni dukshëm i prekur. – Ndoshta ishte Dorina që na bëri të takohemi.

- Po. Jam i sigurt se ishte. Tani më fal, kam një urgjencë, për të cilën u kujtova tash. Dorina më bëri ta shoh.

- Epo atëherë ngutuni. Duhet të jetë diçka e mirë. Mirupafshim.

"Të marrësh jetë dhe pastaj ta dhurosh më tutje... Të marrësh jetë dhe pastaj ta dhurosh më tutje", - mendonte Bujari derisa taksisti ngiste për në adresën ku i kishte thënë ai.

XVII

Nata kishte rënë qëkur, por Bujarit nuk i flihej. Dita e kaluar kishte qenë aq shumë e ngarkuar me emocione, sa nuk mund të qetësohej kurrsesi. Ndjente pikëllim e gëzim, trishtim e lumturi bashkë. Kishte nevojë ta ndante këtë me dikë, të fliste, të kërcente, të qante. Kishte nevojë ndoshta për gruan e tij. Çfarë i duheshin emocionet kur nuk kishte njeri afër për t'i ndarë ato.

Shikoi orën. Po shkonte një pasmesnate.

"Nuk thirri as Diamanti", mendoi. Sa shumë e hante kjo zbrazëti, kjo heshtje që ia shurdhonte veshët. Shkoi te pianoja dhe preku lehtazi ca tasta. Tingujt mbushën dhomën. Iu duk se nëpër notat vallëzonte shpirti i Dorinës. I preku lehtas edhe disa herë dhe pastaj hapi krahët dhe e përqafoi pianon.

"Të faleminderit, o mike e vjetër, më solle për ca çaste të shtrenjtën time afër" – i tha pa fjalë.

Vraponte, vraponte nëpër ca rrugë të ngushta, që dukeshin pa fund. Befas u ndal. Ktheu kokën. Edhe hija u ndal.

" Nuk dua të iki më, bëj çfarë të duash, po deshe më vrit" i thoshte Bujari.

" Jo, edhe unë jam lodhur".

Hija kishte marrë formën e njeriut. Bujari iu afrua dhe e shikoi mirë. U tmerrua. Hija ishte vetë ai, tamam ai.

" Pse po më ndjek, pse po më nxjerr shpirtin?".

" Nuk të kam ndjekur, ti ke ikur nga unë".

"Po kush je ti? Pse dukesh si unë?".

" Jam ti".

" Pse kërkon të më vrasësh, pse?".

" Çdokush në jetë provon ta mbysë anën e vet të mirë, kur lodhet prej saj. Njeriu ka nevojë të jetë ndonjëherë i keq, është njerëzore…kufiri është krejt i vogël…i padukshëm".

"Po pse s'më mbyte, pra, pse më mundon?".

"Sepse ti ike drejt vetes përsëri…drejt anës tjetër".

Hija po zhbëhej dhe Bujarit iu duk se mori formën e tij kur kishte qenë fëmijë. Ndjeu një farë dhembshurie për të…

Cingërima e telefonit e bëri të zgjohej, ndonëse për disa sekonda qëndronte mes dy botëve pa u shkëputur. Faqet i kishte mbi kapakun e pianos dhe ndjeu se qafa i ishte zënë keq. U ngrit dhe mori receptorin.

- Alo…

- Bujar, jam Besa. Mirëmëngjesi.

- Mirëmëngjesi, Besa,- u habit me qetësinë e vet.

- Po të lajmërohem të të tregoj se jam mirë. Dje jam sistemuar në një banesë në pjesën tjetër të qytetit.

Bujari heshti. Çfarë t'i thoshte? T'i kërkonte të kthehej? Ti thoshte se duhej të bisedonin, se mbase ai ishte gabuar, se ishte shpejtuar në gjykim? Jo, nuk e kishte atë të drejtë, duhej ta respektonte vendimin e saj. Edhe ajo duhej të mendonte.

- Shpresoj të ndjehesh mirë, Besa. Vërtetë dua të ndjehesh mirë.

- Desha të di si je, si ia ke bërë për të ngrënë, a ishe te mjeku? – e pyeti ajo.

"Eh Besa, Besa,- mendoi Bujari,- akoma brengoset për mua".

- Mirë jam, - i tha dhe u kujtua se vërtetë nuk kishte ngrënë asgjë gjatë gjithë ditës së djeshme.- Diamanti u lajmërua dje. Kurse unë shkova te mjeku dhe pastaj isha në…

- Ku ishe? Çfarë të tha mjeku?

- Është histori e gjatë, por asgjë për t'u brengosur. Mos u bëj merak. Dola pastaj për një kafe,- tha Bujari pasi u mendua ca. Nuk ishte momenti për t'i treguar për varrezat. As për Batonin, shokun e Dorinës. Pastaj shtoi:- E ke vendosur të qëndrosh aty?

Heshtja që pasoi në linjë iu duk e gjatë një shekull. Pyetja kishte qenë ca e beftë dhe e papërcaktuar, çfarë donte t'i thoshte me të? E pyeste vetëm se do të rrish aty, apo se a do të kthehesh këtej më ? Më në fund Besa u përgjigj:

- Një herë po, Bujar. Do të qëndroj këtu, nuk e di sa. Pronarja e shtëpisë është një grua në vite dhe mbesa e saj ka nevojë për mësime pianoje. Mendoj t'i kthehem pak notave, do ta provoj. Në një farë mënyre me mbesën e saj do të jemi nxënëse të njëra-tjetrës.

- Gëzohem për ty,- i tha Bujari dhe për herë të parë ndjeu se vërtetë po gëzohej me lumturinë e tjetrit, megjithëse kjo do të thoshte se ajo do të qëndronte larg tij.

- Faleminderit, Bujar. Çfarë tha Diamanti?. Ti… i the gjë?

- Jo, jo. Mirë ishte, edhe Mimoza ishte mirë.

- Besoj se tani ata kanë arritur në Afrikë. Ndjej mall qysh tani për të e për Mimozën.

- Ashtu është. Edhe unë ndjej mall. Për të gjithë...

- Dua të vij për të marrë ca gjëra që më duhen. Do jesh në shtëpi?

- Dëshiron ti që të jem?- Bujarit nisi t'i rrahë zemra me forcë.

- Si të duash... Ndoshta më mirë mos të shihemi për një kohë.

Bujarit iu shtrëngua zemra. Mori frymë thellë dhe tha:

- Mirë. Besoj se do të dal kah mesdita dhe nuk kthehem deri në mbrëmje.

- Mirë, pra, – tha Besa.- Ditën e mirë.

- Mirupafshim,- tha Bujari, por Besa nuk ia ktheu, mbase e kishte lëshuar receptorin, a nuk deshi t'i përgjigjej.

Kur e lëshoi receptorin, ndjeu se brenda vetes iu lidh një nyje ndjenjash. Por duhej të kalonte nëpër këtë, duhej. Ishte një fazë e nevojshme pa të cilën gjërat nuk mund të bëheshin më mirë. Ishte rruga e cila patjetër duhej bërë.

Tani duhej të bënte atë, që kishte filluar. Mori notesin dhe pa numrin e Shpëtimit. Ngriti përsëri receptorin, por u step, iu kujtua ngjarja e fundit me të në park. Po nëse ai do ia mbyllte telefonin? Po nëse do ta fyente? Po nëse do t'i thoshte se nuk kam kohë të bisedoj me njerëz të tillë... Gjithsesi, nuk kam rrugë tjetër për ta kuptuar, duhet ta thërras, mendoi. Të dalë ku të dalë.

Dora i dridhej derisa shtypte butonat e numëratorit . Zilja filloi të binte, por asgjë, nga ana tjetër, asnjë përgjigje.

"Nuk qenka në shtëpi", tha me vete. E provoi edhe një herë. Zilja përsëri ra gjatë, dhe mu atëherë kur donte ta ulte dëgjuesen, dëgjoi një zë të përgjumur:

- Urdhëroni,- tha zëri, i cili nuk ishte i Shpëtimit. Ishte zëri i një gruaje të re .

Bujari mbeti për ca çaste pa gojë. A thua Shpëtimi është martuar përsëri? Mos është kthyer ajo... ajo Natyra?.. Jo, jo, nuk ishte zëri i saj.

- Alo, kush është? – dëgjoi përsëri.

- Mirëdita,– u përgjigj më në fund.

- Mirëdita, kush ju duhet?

- Desha Shpëtimin, nëse ka mundësi. Jam Bujari, mi…- u hamend para se të thoshte fjalët "miku i tij" dhe shtoi:- fqinji i tij.

- Po. Kam dëgjuar shumë për ju. Ja tani po e thërras, pritni vetëm një çast, ju lutem.

- Ju faleminderit,- tha Bujari ende i habitur. Zemra i rrihte shpejt.

- Baba!- dëgjoi zërin e gruas në anën tjetër të telefonit, që thërriste nëpër shtëpi.- Të kërkon zotëri Bujari, miku yt.

" Oh Zot, qenka vajza e tij, paskam harruar tërësisht në fëmijët që ka"- mendoi Bujari. Pas pak dëgjoi zërin e Shpëtimit:

- Urdhëro! – iu duk disi zëri i tij i ftohtë dhe gati zemërak.

- Mirëdita, Shpëtim. Jam Bujari. Si je?

- Urdhëro, Bujar, të duhet gjë?- tha Shpëtimi disi dymendjesh duke injoruar pyetjen e Bujarit për shëndetin. Këtij iu duk se dëshironte ta kryente sa më shpejt bisedën. Vërehej se zemërimi ende nuk i kishte kaluar, ndonëse përpiqej të ishte i mirësjellshëm.

- Shpëtim, doja…doja të takoheshim, nëse ke mundësi. Kam ca gjëra për të të thënë.

- Nuk e di. Çfarë duhet të bisedojmë?

- Nuk janë gjëra për telefon. Të lutem, nëse ke pakëz mundësi. Nuk do të të marr shumë kohë.

Tjetri u mendua ca, pse vonoi të përgjigjej.

- Mirë, - tha më në fund. – Ku dëshiron të takohemi?

- Ku të duash. Diku ku mund të bisedojmë në qetësi. Janë ca gjëra shumë delikate.

- Atëherë, dëshiron të vish tek apartamenti im? Këtu nuk na pengon askush.

- Po. Por, mos ju pengoj unë gjë?

- Jo. Mos ta zgjasim në telefon, po të pres.

- Mirë. Të faleminderit. Do të jem aty pas një ore. Mirë?

Rrugës për te Shpëtimi i kujtoheshin shumë gjëra. Sa të largët dukeshin tani, thuajse kishte qenë një njeri tjetër ai miku i mirë që ia kishe dhënë dorën bujarisht në atë kohë kur ishte rrokullisur në humnerë. Po, natyrisht, nëse tani ndjeheshin të ftohtë në mes tyre, faji nuk ishte i Shpëtimit, por i Bujarit, pse vetë i kishte rënë me shkelm asaj miqësie, vetë e kishte vënë në dyshim të rëndë mikun e tij të mirë.

Herën e kaluar kur kishte shkuar te Shpëtimi kishte kërkuar Natyrën lidhur me paratë. Zot, sa e shpifur që i dukej kjo gjë… sa e ndyrë… dhe Shpëtimi e kishte pranuar, e kishte ngushëlluar, e kishte shpëtuar nga situata; ishte sjellë me të si miku i mirë. Le që edhe paratë ia kishte dhënë pa kompensim. Nuk e kishte gjykuar për asnjë moment rreth asaj që ia kishte bërë pas shpine, nuk ia kishte përmendur kurrë atë gjë, po veç e kishte justifikuar, sikur ky të ishte një çunak i ri e i papërvojë. Ndërsa ky menjëherë, me dyshimin e parë, shkon si kalama dhe i bën skena në rrugë një njeriu të tillë. Pse kishte bërë ashtu, pse, pyetej. Si e kishte kaluar kufirin aq lehtë, si nuk e kishte parë se të tjerëve ua kishte mbushur kupën kaherë e ata nuk ia kishin derdhur në fytyrë. Ndonëse e kishte merituar.

Te dera i doli vajza e Shpëtimit. Ishte rreth të tridhjetave. Kishte një fytyrë të bukur dhe Bujarit iu kujtua fotoja e gruas së vdekur të tij. Vajza ishte tërësisht e ëma.

- Mirëdita, ju jeni sigurisht zotëri Bujari,- tha ajo.

- Po. Mirëdita.

- Urdhëroni brenda. Ja, babai do të vijë menjëherë.

Bujari hyri dhe instinktivisht u drejtua te dhoma, në të cilën e kishte pritur Shpëtimi herën e fundit. Ishte si sallon pritjeje.

- Oh, jo jo andej, ju lutem,- i tha e vajza gjithë mirësjellje.– Ajo dhomë tani është e zbrazët, s'keni ku të uleni, ejani në dhomën e ndejës, këtu afër kuzhinës.

- Po blini mobile të reja? – pyeti Bujari tek po ecnin korridorit.

- Jo, jo. Në të vërtetë babai po shpërngulet. Do të vijë të jetojë afër nesh në kryeqytet! – tha vajza me tërë gëzimin e një fëmije që do ta kishte prindin afër. Ajo tani në Shpëtimin gjente babanë dhe nënën bashkë.

Bujari ndjeu se diçka ia shqeu zemrën. Po e linte edhe miku më i mirë. Po shkonte... Po shkonte atje ku ndjehej më mirë. Afër njerëzve të dashur. Ndërsa ky i kishte larguar të gjithë. Ishte larguar nga të gjithë.

Hynë në dhomë dhe Bujari ndjente se po i dridheshin paksa këmbët.

- Mirëserdhe, Bujar,- dëgjoi zërin e Shpëtimit.- Më fal për mjedisin e ngushtuar. Tani kemi mbetur në dy dhoma, madje kemi hequr ca gjëra edhe nga dhoma e fjetjes.

- S'ka gjë. Këtu ndjehem fare mirë. Si je Shpëtim?- mundohej Bujari të dukej sa më i qetë.

- Mirë, mirë…po ti si ke qenë?- tha tjetri.

- Mirë.

Vajza e Shpëtimit pas pak solli kafenë. Atmosfera në mes dy burrave ishte ende mjaft shtrënguese, ndonëse Shpëtimi mundohej që të sillej sa më lirshëm. Por pikërisht mirësjellja e tij deri diku e ftohtë, e bënte Bujarin të ndjehej ngushtë. Pasi pinë kafetë duke shkëmbyer fjali të zakonshme rreth shëndetit, rreth motit e ca çështjeve të tjera aktuale politike të vendit, hyri përsëri e bija e Shpëtimit, tani e veshur me mantel. Në dorë mbante tabakun me ca pije të ftohta. I vendosi në tavolinë dhe tha:

- Unë tani po ju lë, sepse kam ca punë për të kryer. Zotëri Bujar, më vjen mirë që ju njoha. Babai më ka treguar shumë për ju . Do të doja ta takoja me shumë kënaqësi edhe zonjën tuaj. Ju lutem përshëndeteni nga ana ime.

- Faleminderit, do t'ia përcjell patjetër,- tha Bujari me zemrën copë.

Vajza e puthi të atin në faqe dhe Bujarit iu ngroh zemra nga një ngrohtësi e tillë at e bijë. Pasi ajo doli, Shpëtimi e hapi bisedën:

- Tani mund të flasim lirisht, si është puna?

- Shpëtim, para se të filloj, dua të më dëgjosh shkurt një gjë tjetër. Kam qenë këto ditë në psikoterapi; kam qenë edhe në varreza. Kam kuptuar ca gjëra më mirë. Do ta vazhdoj shërimin tim edhe me seanca të tjera. Por sot, dua… dua të të kërkoj ndjesë, e kam tepruar, e di. Nëse mundesh, të lus të më falësh.

- Bujar, - tha Shpëtimi me keqardhje, por tjetri e ndërpreu:

- Jo, të lutem, më lejo të ta them. Ti ke qenë mik i mirë me mua edhe atëherë kur nuk e kam merituar; në të vërtetë të është dashur të më përbuzësh, por ti je vënë ashtu si vihen njerëzit me shpirt të madh.

- Të pata thënë, Bujar, nuk ia vlente Ajo.

- Sidoqoftë. As unë nuk ia vleja. Isha bashkuar me fundërrinat. Por ti arrite ta shohësh pjesën time të mirë, dhe bëre çmos ta nxirrje në pah. Besove në mua edhe kur unë nuk besoja në veten time, më ke ndihmuar në çdo anë. Po them edhe lidhur me Besën. Ajo... ajo më ka treguar pastaj gjithçka.

- Ti ke një grua të zgjuar dhe besnike, që i njeh vlerat e familjes. Ajo të ka qëndruar gjithmonë afër, edhe kur ti nuk ishe pranë saj.

- E di. Tani i shoh të gjitha. Kam qenë i bekuar, por i verbër. Kam qenë i rrethuar me dashuri, por zemrën e kisha plot urrejtje e mllef. Kërkoja prehje në gjërat e pavlera, në njerëzit që nuk më përkujtonin në asgjë. Kisha nevojë të qëndroja me dikë që nuk më paraqiste asgjë. Kur më kujtohet si kam reaguar shpesh si fëmijë… një moment isha njeri i afërt, pas pak sillesha me vrazhdësi dhe budallallëk. Vetëm ata që më kanë dashur, më kanë duruar. Por, çdo gjë ka kufi, e di. Edhe durimi i atyre që të duan. Frikësohem se i kam humbur të gjithë me sjelljet e mia. Jam treguar shumë i papjekur, i pamatur. Më vjen turp kur e mendoj si jam dukur në sytë tuaj. Me vite kam menduar se unë po bëj diçka të madhe, studime, shkencë, ndërsa kam lënë anash të dashurit e mi, miqtë. Nuk kam pyetur për ndjenjat e tyre. Unë… unë kam qenë aq i padobishëm… kam jetuar si parazit… kam qenë aq i varur prej tyre dhe ata më kanë dhënë çdo gjë pa kushte. Njësoj sikur ti. Kur e mendoj më mirë, nuk më kujtohet hera e fundit kur kam bërë diçka për ta. Kur u kam kryer ndonjë punë, kur ua kam plotësuar ndonjë dëshirë. E kam mashtruar veten me pamjen e një njeriu të madh, kurse brenda meje ka qenë një njeri i zbrazët, i vogël e mendjengushtë. Më vjen ndot nga kjo gjë…

- Bujar, mos e tepro, mos e fajëso veten kaq shumë. Mjaft e ke dënuar. Ti je njeri dhe njerëzit gabojnë. Asnjëri nga ne nuk jemi të pagabueshëm. Mendoje martesën time të dytë, ndonëse martesë e vërtetë nuk ishte: gati sa nuk i humba edhe fëmijët e mi për një argëtim thuaja të momentit. Në të vërtetë njeriu është krijuar si qenie e lirë. Dhe kur i përshtatet normave shoqërore, ndjehet i penguar. Dikush përballet më lehtë më këtë, dikush jo dhe vazhdon e lufton për lirinë e tij, ashtu si e dëshiron ai. Prandaj njerëzit duhen kuptuar edhe atëherë kur veprojnë ndryshe prej të tjerëve. Është... është në natyrën njerëzore.

- Të lutem edhe një herë të më falësh, Shpëtim. Dua të bëj ç'është e mundur të fitoj sërish miqësinë tënde.

- Zemërimi është pjesë e jetës, pra edhe mes miqve. Ti ke pasur të drejtë të dyshosh, ndërsa reagimi yt ishte vërtetë i ngutshëm. Sidoqoftë, kjo tanimë i përket së kaluarës. Ti duhet t'ia falësh vetes. Të tjerët pastaj do të të falin më lehtë, sepse do të jesh njeri tjetër. Pastaj ti ke edhe Besën, ajo do të të kuptojë. Jam i bindur se kaherë të ka falur.

- Shpresoj. Tani vërtetë nuk e di çdo bëhet mes nesh,- tha Bujari.

- Pse thua kështu?

- Ti nuk e di se Besa më ka braktisur?

- Jo. Si mendon se të ka braktisur?

- Nuk jeton më me mua në shtëpi. Ka shkuar në një apartament me qira. Sot më tha se do të japë orë mësimi për piano. Kam mbetur fare i vetëm, Shpëtim. Ndoshta nuk do të kthehet kurrë më.

- Mos u ngut, lëre të qetë. Ajo ka nevojë për hapësirë tani. Unë jam i bindur se ajo do ta marrë vendimin e duhur për të dy.

- Kësaj i frikohem unë. Mos vallë ndarja do të jetë vendimi i duhur për të.

- Mos mendo më të keqen tani. Nuk e besoj këtë. Ju keni një jetë të tërë së bashku.

- Oh, Shpëtim, mua më duket se vdekja e vajzës më ka bërë t'i shoh gjërat ndryshe. Pra edhe Besën. Më duket thuajse mu kur fillova të jetoj në plot kuptimin e fjalës me të, ajo më la.

- Ti ke kohë që i ke lënë gjërat të zhvillohen si kanë dashur, Bujar. Sikur lë njeriu barishtet të lëshojnë shtat nëpër oborr. Dhe tani dëshiron t'i marrësh të gjitha frytet në dorë menjëherë. Është e pamundur. Ashtu sikur është e pamundur që kopshti të marrë përsëri pamjen e duhur pa e punuar, pa e ujitur. Tani të duhet kohë, ashtu sikurse u duhet kohë edhe atyre pemëve e luleve të bukura të marrin frymë sërish, e kupton?

- Fare mirë, ti ke gjithmonë përgjigjet e duhura, Shpëtim.

- Eh, shpresoj. Nuk është gjithmonë ashtu.

- Dua të të lus edhe diçka,– i tha Bujari.

- Para se të ma thuash, duhet unë të të tregoj një gjë tjetër.

- Për çfarë është fjala?

- Bujar, unë mendoj të largohem që këtu. Shpresoj ta kryej punën tënde, çfarëdo që është, para se të largohem.

- Po. Më tregoi bija jote. Ka ndonjë mundësi ta ndërrosh mendjen?

- Bujar, kur erdha këtu bleva dy apartamente afër njëra-tjetrës dhe i bashkuam. Krijuam një hapësirë të madhe me shumë dhoma. Mendoja se tani që ndoshta do ta gjeja dashurinë sërish, do të kisha një jetë më të rehatshme, do vinin nipat e mbesat, djali e vajza… miqtë… Do të kisha një strehë komode kur të kthehesha nga udhëtimet dhe një çerdhe të ngrohtë, ku do ta kaloja kohën, meqë isha para pensionimit. Por, ashtu si shkuan punët, mbeta vetëm. E sheh? Nuk të ka ndodhur vetëm ty. Vetëm se gabimet e mia ishin ndryshe.

Bujari u mendua. Vërtetë ashtu ishte.

- Pra, ka një kohë që jetoj vetëm. Në moshën tonë njeriu ka nevojë për njerëz. Sidomos për ata me të cilët ka kaluar shumë gjëra në jetë. Kam miq të shumtë, por çdokush ka jetën e vet. Edhe fëmijët po ashtu. Pavarësisht se duan të na qëndrojnë pranë, ata nuk mund ta zëvendësojnë boshllëkun që të lë mungesa e shokut të jetës.

- E kuptoj.

- Megjithatë vajza ime një ditë më propozoi të shkoja në kryeqytet e të jetoj me ta. Ka një apartament të bukur.

- Ty të pëlqen ta bësh këtë?

- Sinqerisht mes nesh? Jo dhe aq. Kam nevojë për hapësirë tani. Eh, ne pleqtë jemi të çuditshëm, kërkojmë edhe njerëz rreth vetes, por edhe hapësirë e qetësi. Më kupto, Bujar, nuk dua t'i bëhem barrë askujt.

- Ti nuk je plak, Shpëtim. Ti kërkon njerëz, është e kuptueshme. Madje askush nuk të kupton më shumë se unë tani. Askush s'ka dëshirë të jetojë vetëm, pos shpirtrave të humbur, madje edhe ata kërkojnë vendin e tyre.

- Po. Ashtu është. Unë në të vërtetë e dua këtë qytet, jam lindur këtu. Ka qetësinë, kulturën e bukurinë e tij. Është vend ideal për të jetuar. Madje edhe vajzës sime i pëlqen.

- Po pse ikni atëherë?

- Rrethanat u krijuan të tilla, Bujar. Vajza punon atje, është pediatër. Edhe djali jeton në atë qytet. I druhem ca kaosit, që do të më duhet ta përballoj në atë qytet gri, por së paku do t'i kem afër mbesat e nipat.

- Po, je me fat që i ke. Çfarë do të bësh me gjithë këtë apartament?

- Do ta shes. Momentin që sistemohem te vajza.

- Do ta ndjej mungesën tënde, Shpëtim. Vërtetë tani kam nevojë më shumë se kurrë për miq.

- Unë do ta ndjej mungesën e çdo gjëje që më lidh me këtë vend,- i tha Shpëtimi dhe shtoi:- Tani ma thuaj kërkesën tënde.

***

Bujarit i kaloi dita duke shëtitur i kredhur në mendime e plane. Kishte kohë që nuk kishte kaluar rrugicave të ngushta me kalldrëm që të çonin kah kalaja e qytetit. Nuk kishte faj Shpëtimi që nuk donte ta linte këtë qytet. Ishte aq i bukur sa, vetëm një shikim në të, të bënte të ndjeheshe sikurse i dashuruar. Befas i lindi edhe një mendim, si formë propozimi. Tha me vete: "A do ta pranonte Shpëtimi këtë? Nuk e besoj. Mund t'i duket një ide e çmendur".

Kur u kthye në shtëpi, pa filxhanin e larë, me të cilin kishte pirë kafenë Besa. Shkoi në dollapin e saj dhe pa se kishte marrë edhe një pjesë të rrobave. Ndjeu se po i shqyhej zemra, por pastaj, krejt befas, u ndie i qetësuar me idenë e re që kishte thurur në kokë.

Atë natë bëri gjumë të qetë.

XVIII

Shtëpia ku Besa jetonte me qira ishte në fund të një rrugice të ngushtë pa krye, që nuk dilte askund. Ishte një shtëpi gati njëqindvjeçare, por e mbajtur mirë, dhe e restauruar shumë herë, meqë ishte vepër e një mjeshtri artist. Ishte si të thuash një relikte artistike. Jashtë kishte një fasadë ngjyrë mjalti, në të cilën pastaj shiheshin ca trekëndësha të mëdhenj, që mbanin brenda të vizatuara hardhitë e rrushit plot fryte. Kokrrat e rrushit dukeshin thuajse të vërteta. Në katin e dytë shihej një ballkon i vogël, që mbahej nga dy shtylla të gjata, të cilat ngriheshin anash derës së katit të parë. Ballkoni me ata parmakët të punuar si statuja të vogla nuk përdorej kurrë, por shtëpisë i jepte një hijeshi të veçantë arkitektonike. Në të dy anët e tij fillonte një pjesë me tulla të kuqe, e cila e përcillte kulmin në një linjë. Ajo pjesë shkëlqente nga llaku, me të cilin e lyenin çdo vit me kujdes, kështu që dukej thuajse dielli po e rrihte më së forti mu aty.

Thuhej se dikur në këtë shtëpi kishte jetuar mjeku i qytetit, i vetmi mjek që kishte qyteti atëherë, kur nuk ishte kaq i madh sikur sot. Dhe thuhej, po ashtu, shumë njerëz kishin shkuar tek ai për tu vizituar pa qenë fare të sëmurë, vetëm nga meraku për të parë shtëpinë e famshme.

Vila kishte ndërruar shumë pronarë e banorë nëpër dekada, po tani dukej në të kishte gjetur prehje një grua në moshë, e cila dikur kishte qenë aktore e njohur teatri. Ajo ishte vajza e kësaj shtëpie, bijë e vetme e prindërve të pasur. Tashti jetonte thuajse e vetme, megjithëse mbesa e saj rrinte më shumë me të. Lëshonte ndonjë dhomë me qira, por e bënte rrallë, më shumë për shkak të njohjeve ose nëse vërtetë e shihte të arsyeshme. Besa i kishte pëlqyer menjëherë. Iu duk një grua me dinjitet, e kulturuar dhe e matur. Dukej se bashkë me plaçkat e saj, bartte edhe një dhimbje të ndryrë diku brenda. Me vete kishte edhe një mace të bukur që e quante Midi. U kuptuan me pak fjalë dhe zonja Jolanda ia ofroi njërën dhomë, tamam atë dhomë të cilën ajo e konsideronte të shenjtë, meqë aty ishte rritur e kishte kaluar fëmijërinë e saj.

Shtëpia ishte shumë e këndshme edhe përbrenda. Të gjitha dhomat ishin të mëdha e me tavane të larta. Dritaret e shumta ndaheshin me ca rombe të drunjtë dhe kështu dukeshin copa-copa, gati si piktura, meqë edhe xhamat dallonin nga njëri-tjetri. Diku ishin të mjegullt, pastaj në mes të kthjellët, ndërsa në pjesën e lartë ishin me lule. Disa prej tyre, që mund të ishin thyer nëpër vite, ishin zëvendësuar me xhama të zakontë, meqë ishte vështirë t'i gjeje në kohërat e sotme ato lloj xhamash antikë.

Besa kishte dy muaj që banonte aty dhe asnjëherë nuk e kishte bezdisur të zonjën e shtëpisë me praninë e saj. Mëngjeseve dilte deri në treg dhe shpesh blinte edhe gjërat që i duheshin asaj. Punonte rreth kopshtit, lexonte, dhe shpesh mbyllej në dhomë. Dy a tri orë në ditë kalonte me mbesën e Jolandës, së cilës i mësonte notat muzikore dhe e ushtronte mbi piano; pastaj, kur kishte mbaruar me të, vishej e dilte për të bërë dy hapa në rrugë. Ndonjë herë edhe bisedonin si grua me grua, por asnjëherë nuk i kishte treguar Jolandës ndonjë gjë rreth familjes ose fatit që e kishte sjellë në këtë derë; dhe ajo nuk e kishte nxitur, meqë mendonte se çdo arkë e shpirtit i ndryn kujtimet e veta.

Mbesa e Jolandës, Hera, ishte afro dhjetë vjeçe. I biri, Arturi, babai i Herës, të cilin e kishte djalë të vetëm, ishte arkitekt i njohur. Gruaja e tij rridhte nga një familje minatorësh, të cilët nuk kishin pasur shumë mundësi shkollimi. Jolanda i kishte përkrahur shumë në dashurinë e tyre dhe ishte bërë ajo shkak që nusja e saj të vazhdonte shkollimin edhe pas martese, ndërsa kjo ia ruante të bijën. Kur nusja i mbaroi studimet dhe arriti të bëhej inxhiniere, bashkë me të shoqin, Arturin, krijuan një ndërmarrje të suksesshme ndërtimesh. Kishin lidhje pune edhe me firma të huaja dhe mu për këtë gjendeshin shumë shpesh jashtë vendit. Të gjithë u pajtuan se nuk ishte mirë për vajzën e vogël të ndërronte vendet aq shpesh, duke ndjekur prindërit kudo ku shkonin, prandaj e lanë me të gjyshen. Kështu mbesa ishte lidhur shumë me gjyshen e saj.

Hera ishte vajzë e këndshme. Po ta shihje me kujdes, i ngjante shumë gjyshes së saj. Besa e vërente se si Jolanda ndonjëherë e ndiqte të mbesën e saj kah fliste, e pastaj humbej nëpër mendime thuajse e kërkonte imazhin e vet diku mes fletëve të zverdhura të librit të jetës. Vajza ishte shumë e suksesshme në shkollë, dhe shumë e lidhur me natyrën, e tërhiqte çdo gjë lidhur me të, që nga bimët e vogla e deri te shpezët. Herë-herë kishte ndodhur të sillte në shtëpi ndonjë qen a mace të braktisur, për të cilët pastaj kujdesej me javë të tëra. Ose humbej në kopshtin e shtëpisë, ku i ati kishte mbjellë pemë të ndryshme, pisha e brej, dhe i thërriste ato me emra të llojllojshëm. Kur i ujiste i thoshte gjyshes:

- E sheh atë pishën atje? Ajo është Nazelia. E quajnë kështu sepse ka shumë naze, është edhe pakëz mendjemadhe. Ia thotë mendja se të tjerat nuk janë aq të hijshme sa ajo. E sheh bredhin atje tani? Është Adoleshenti, shih si i lëviz degët kur e spërkas me ujë, duket se nuk ia ka qejfi t'ia prish flokët e sapo krehura. Shiko gjyshe, shihe atë bredhin e vogël atje, ai është Lazdrani; i ka hije të lazdrohet ca pse është më vogëlushi i kopshtit. Apo jo, gjyshe? Ha, ha, ha. Shihe si shkundet kur e laj, gjyshe, thuajse thotë: uh, uh më fërko edhe pak këtu, ma laj shpinën edhe pak, edhe pak!

Gjyshja e dëgjonte dhe qeshej bashkë me të. Ndonjëherë i dukej se Hera kishte të drejtë, se pishat e brejt vërtetë bënin siç thoshte ajo. Ajo fliste me ta, pikëllohej kur i shihte kokëvarur. Ndodhte që afër tyre të mbillte ndonjë lule, që t'i bënin shoqëri njëri-tjetrit. Ishte një fëmijë me shpirt të bukur. Jolanda mahnitej e i mbushej zemra me këto veti të së mbesës.

Një mbrëmje derisa po rrinin bashkë, Jolanda i tha së mbesës:

- Hera, a e di kush mund ta ndryshojë njeriun më së shumti në jetë?

- Nuk e di. Ndoshta paraja, gjyshe?

- Po flas për ndryshimet e mira, kur njeriu bëhet edhe vetë më i mirë.

- Paj gjyshe, të bëhesh i pasur, nuk është mirë?

- Është. Sado që njerëzit nuk e thonë, një nga ëndrrat e tyre parësore është të mos jenë të varfër, pra të kenë pasuri. Por, ta lëmë këtë, unë të pyeta çfarë mund ta ndryshojë njeriun shpirtërisht, si thua ti?

- Nuk e di, ua gjyshe më mahnite me këto enigma.

- Nuk mendon se dashuria mund ta bëjë këtë?

- Sigurisht. Po pse mi bën këto pyetje, gjyshe Jolanda?

-Sepse të kam mbesë, sepse dua të bisedojmë hapur. Pra, ti e pranon se mund të jetë dashuria?

- Po. Sigurisht që po. Ja për shembull unë e dua aq shumë Midin, sa që ndonjë herë dëshiroj të ndryshoj e të bëhem mace edhe vetë.

Jolanda qeshi me të madhe:

- Kë të drejtë, bija ime. Madje të duash një qen a një mace është pothuaj njëlloj si të duash një njeri.

-Po ti, gjyshe, s'po më thua se çfarë është dashuria?

-Po, ke të drejtë, Hera. Dashuria është ndjenja më e bukur e njeriut.
është forca që e lëviz jetën, e çon të shkojë përpara. Por njëkohësisht është e brishtë sikur perlat e vërteta.

-Oho, e kuptova, si në filmat që shikon ti, në ato telenovelat. Ha, ha, ha.

Qeshi edhe Jolanda, pastaj nisi t'ia shpjegojë prapë:

-Por duhet ta dish një gjë, – dhe fytyra e Jolandës mori pamje më serioze.- Jo vetëm dashuria ndaj një mashkulli ose ndaj një femre, por dashuria në përgjithësi është ilaçi që i duhet gjithë botës. Mund të jetë dashuria për prindin, për fëmijën e porsalindur, për vëllain ose motrën, për natyrën. Dashuria lëviz malet, Hera, ndryshon jetën nganjëherë, – tha Jolanda dhe pastaj shtoi:- Duhet ta mbash në mend këtë. Ja, hajde, më thuaj tani se sa veta don ti? A ke shumë dashuri në atë zemrën tënde të vogël?

- Po gjyshe. Kam dashuri për ty.

- Vetëm për mua? Ua sa pak dashuri që paskeee….

- Por kjo dashuri është e maaaadhe, – tha Hera.– Kurse zemra ime është e vogël, ja kaq, dhe nuk nxë shumë.- Pastaj, si u mendua një hop, shtoi:

-U, po. E dua babin, mamin, kopshtin, shtazët, shkollën... e dua… e dua…uuu sa shumë gjëra që dua!

- E shikon, pra, se dhe zemra jote vogël paska vend për shumë dashuri. Tani më dëgjo: a do më duash edhe kur të jem ende më plakë?

- Oh jo, ti nuk do të plakesh kurrë,- u hodh Hera dhe e përqafoi gjyshen.

- Po pianon e do?

- Pianon? Nuk e di. Unë nuk jam pianiste, nuk kam talent. Por kam ca dashuri edhe për pianon. Dua t'i ndjell notat me gishtat e mi. Ndoshta më sjellin fat, – fliste Hera me mençurinë e një vajze të rritur.

- Si po mendon fat? Se një ditë kur të rritesh do të vijë princi i bukur dhe ti do t'i biesh pianos, e?

- Jooo,- qeshte Hera,- ç'më duhet princi mua, nënë Nanda, do të mërzitem tërë ditën e mbyllur në pallat. Unë dua të jetoj e lirë në natyrë, ndoshta në ndonjë kasolle prej druri, e rrethuar me shumë kafshë dhe pemë nga të gjitha llojet.

- Oh, jam e bindur se do ta bëje ti, djallushë...

Kur Besa, në bisedat e pakta për veten, i kishte treguar se dikur kishte studiuar për pianiste, Jolanda i ofroi që t'i jepte ca orë mësimi mbesës së saj. Kështu do t'ia zbriste edhe qiranë. Besa një herë nuk kishte besim se do ta bënte dot, ehu kaq vite të shkuara qëkur i kishte lënë studimet, por Jolanda e nxiste përditë që ta provonte. Atëherë Besa u ul para pianos dhe e vuri Herën në prehër duke ia marrë të dy doçkat vogla në pëllëmbët e saj.

Dita që kalonte, Jolanda mendonte se kishte fituar edhe një mike të mirë në këtë grua. Ishte një njeri në të cilin mund të mbështeteshe. Kishte dëgjuar, po ashtu, se Besa kishte humbur të bijën, por asnjëherë nuk e kishte pyetur për këtë. Ishte mësuar ta çmonte mëvetësinë e tjetrit për t'i mbajtur kujtimet përbrenda. Besa do ia tregonte vetë historinë e saj, nëse do ta shihte të arsyeshme.

- Gjyshe, gjyshe do ta dëgjosh sonatën time që sapo kam mësuar? – i tha Hera një ditë teksa Jolanda po hynte në derë me shportat e mbushura plot.

- Gjithsesi. Nëse shpëtoj gjallë nga këto të shkreta shporta,- tha Jolanda duke bërë enkas se i rëndonin për kiamet.

- Oh,- vrapoi Hera, - më fal gjyshe nuk të pashë, m'i jep mua.

- Të faleminderit, – i tha Jolanda e mbushur frymë dhe i buzëqeshi Besës që po qëndronte afër pianos. E kuptoi se ato të dyja sapo kishin mbaruar orën e mësimit.

- Do ta dëgjosh tani? Të lutem, të luteeem! Mezi po pres ta dëgjosh. Kam kohë që po të pres, të lutem gjyshe. Eja tani me mua, – i thoshte Hera, duke e kapur për dore Jolandën.– Ulu këtu në kanape dhe rehatohu mirë. Tani do të çlodhesh me notat e mia. Mos duartrokit pa mbaruar, mirë?

- Mirë.

Hera vrapoi si flutur te pianoja dhe mori pamjen e dikujt që do t'ia fillonte një gjëje me shumë rëndësi. Qëndroi drejt para gjyshes së saj dhe Besës, sikur ato të ishin publiku që kishin ardhur për ta dëgjuar, u përkul paksa me hijeshi duke i përshëndetur me kokë, dhe, si e drejtoi trupin, u ul pranë pianos. Hodhi notat e para me pak pasiguri dhe pastaj nisi të lëshohej ngadalë, ngadalë porsi lumi i qetë. Jolanda mbeti e habitur me suksesin e mbesës së saj.

"Sa shumë paska përparuar", tha e gëzuar me vete.

Pastaj u kthye kah Besa, që t'ia dhuronte një shenjë falënderimi. U step. Në sytë e Besës hetoi një dhimbje të thellë. Dukej thuajse çdo notë që luante Hera asaj i jepte një kamxhik në shpirt. Sikur ajo dhembja, ajo goditja që ta përgjak çdo gjymtyrë, që ta topit çdo shqisë, por që njëkohësisht duhet ta durosh. Duhet. Sepse të kujton në diçka të humbur, në diçka të dashur. Dhe po nuk i përjetove të gjitha dhimbjet, duket se edhe ajo gjë e çmuar zhduket. Ndaj vazhdon të vuash, është e vetmja mënyrë.

Për fat sonata u krye shpejt. Jolanda e pa se Besa e mblodhi veten dhe u përpoq të buzëqeshte.

- Të lumtë, Hera, je shumë e mirë, më ke mahnitur,- e përqafoi Jolanda mbesën e saj të vogël.

- Kam mësuesen më të mirë në botë,- iu kthye Hera Besës dhe e përqafoi.– Të dua shumë, teta Besa, - i tha.

- Edhe unë të dua shumë,- i tha Besa dhe iu përlotën sytë.- Tashti mua më falni se kam ca gjëra për të kryer në dhomën time, – u ngut dhe pa pritur përgjigje humbi pas derës së saj.

Atë natë Jolanda nuk vuri gjumë në sy. Ç'kishte në këtë grua, që po ia dërrmonte shpirtin? Dhimbja për vajzën, po, por... pse nuk ishte në shtëpinë e saj? Kishte dëgjuar ca fjalë, por Jolanda nuk ishte tip që i ndiqte thashethemet. Nuk ua vinte fare veshin.

Ishte vonë, mesi i natës, kur iu bë se dëgjoi hapa nëpër shtëpi. U orientua se vinin nga dhoma e Besës.

U ngrit, doli nga dhoma e saj dhe qëndroi heshtazi në korridor. Po, po Besa ishte zgjuar dhe ikte e vinte nëpër dhomë. Ç'të kishte vallë? Pse rrinte zgjuar? U afrua më tepër. Të trokiste në derë? T'i thoshte se iu duk se mos ka hyrë kush në shtëpi dhe kështu të fillonte muhabetin me të? Mbase kjo grua kishte nevojë që dikush, pra Jolanda, t'ia ngucte kujtimet e ta bënte t'ia hapte zemrën. Kushedi se çfarë mban aty brenda. Por mendoi se nuk ishte në rregull t'i ndërhynte në këto çaste mëvetësie, se gjithsesi nuk ishte e udhës t'ia prishte privatësinë e saj.

Derisa ishte me këtë mëdyshje në mendje, hapat aty në dhomë u ndalën dhe dëgjoi zhurmën e trupit të Besës që u fërfëllua në shtrat. Prapëseprapë dukej që Besa nuk ishte qetësuar. Jolanda dëgjoi të qarët e saj; qante ashtu siç mund të qante zemra e një nëne që kishte humbur krijesën e saj. Qante siç mund të qante një grua që kishte humbur dashurinë e saj. Qante siç mund të qante një njeri, që kishte prekur ferrin ende pa vdekur.

XIX

Provoi t'i hapte sytë ngadalë, por gjërat i dukeshin të mjegullta, pa formë. Kishte ndjenjën se koka i ishte ngjitur për jastëku, i dukej shumë e rëndë. Para syve shihte tavanin e bardhë mbushur me drita neoni, që i dukeshin akoma si yje të vegjël.

"Ku jam? " e pyeti veten, meqë ende nuk po mblidhte kujtesën si duhet.

Kishin kaluar shumë ngjarje në disa muaj dhe e tëra po i dukej gati si ëndërr.

Në gjithë atë bardhësi vërejti një figurë që po i afrohej dhe pas pak iu përkul mbi shtrat.

- Bujar, u zgjuat! Urime! Si po ndjeheni?

Bujari vuri re se njeriu që i rrinte mbi kokë mbante bluzë të bardhë; u kujtua: ishte mjeku. Mu atëherë u përmend nga dhimbja që po ndjente nën brinjë, sidomos nga ana e majtë. Gjërat filluan t'i qartësoheshin para syve, por edhe në kokë. Tanimë kujtohej mirë për atë që kishte ndodhur, ose që duhej të kishte ndodhur, dje në sallën kirurgjike të spitalit.

- Doktor, u krye? U krye me sukses? – mezi e pyeti mjekun, që vijonte t'i rrinte mbi krye, dhe ndjeu se çdo orvatje për të lëvizur i shkaktonte dhembje.

- Po, Bujar, operacioni u krye me shumë sukses. Urime edhe një herë. Por, më tregoni si po ndjeheni?

- Sikur më ka shkelur treni,- tha Bujari dhe buza i shkoi shtrembër si në buzëqeshje.

- Natyrisht, ju sapo kaluat një operacion të vështirë. Tani për tani provoni të pushoni. Mirë? Çdo ditë e më tepër do të forcoheni,– dhe mjeku ia shtrëngoi krahun.– Jam shumë krenar me ju.

- Faleminderit,- tha Bujari dhe posa mjeku u nis të dilte, e ndali: - Doktor, më thoni, si është?

- Miku juaj?

- Po.

- Transplantimi shkoi shumë mirë. Por kemi ende rrugë për të bërë me të. Si të shkojnë ca ditë do të shohim më së miri rezultatin përfundimtar. Mos u brengosni. Nuk dua të ngut, por çdo gjë do vejë mbarë. Tashti pushoni, zoti Bujar. Ju jeni njeri shumë i fortë, ju lumtë!

- Doktor, dua ta shoh! Ju lutem dua ta shoh!

- Nuk bën, tani ai është akoma nën narkozë. Pastaj… pastaj edhe ju jeni shumë i dobët tani për tani.

- Ju lutem, doktor! - e pa Bujari me sy lutës. Doktori nisi të dorëzohet.

- Mirë. Por pasi të zgjohet, mirë? Ju premtoj se do të vij vetë personalisht dhe do t'ju marr t'ju çoj në dhomën e tij, – iu përgjigj mjeku duke ia shtrënguar dorën sërish. Bujari mbylli kapakët e syve në shenjë falënderimi dhe fytyra i mori një pamje të qetë. Tashmë ishte kthjellur mirë, por ende nuk mund të lëvizte. Hodhi shikimin rreth vetes. Ishte i rrethuar nga shumë aparate që tregonin punën e organeve të tij vitale. Asnjëherë nuk kishte qenë më i sigurt se kishte bërë veprimin e duhur. Por, ndihej aq i vetmuar... Iu shfaq fytyra e Besës dhe ndjeu therje më të madhe se nga vetë plaga që kishte nën ijë. Tani ajo ishte larg, shumë larg tij. Ajo ishte në vendlindjen e tyre, ndërsa nuk kishte asnjë dijeni rreth Bujarit dhe rrethanave në të cilat ai gjendej. Po sikur ta thërriste e t'i tregonte? Jo, nuk ishte koha, nuk kishte të drejtë t'ia kërkonte këtë. Nëse Besa do të dëshironte ta shihte, do të duhej ta bënte vetëm nga zemra e saj.

Tanimë, pak shpresa kishin mbetur për këtë, mendoi Bujari. Kishin kaluar gati gjashtë muaj prej që ishte larguar dhe kishin kontaktuar fare pak. Ndonjë herë Bujari dilte pasditeve dhe rrinte brenda xhamave të ndonjë shitoreje a restoranti duke pritur që ajo të shfaqej. Por, ndodhte rrallë, fare rrallë që ta shihte. Duket se edhe ajo i kishte ndërprerë fare shëtitjet, apo nuk dilte ndoshta mu nga fakti se mund të takohej me Bujarin.

Diamanti e kishte kuptuar ndarjen e prindërve diku pas muajit të parë që kur e ëma ishte larguar nga shtëpia. Pastaj edhe Besa ia kishte treguar, pasi ai kishte nisur të brengosej pa masë, meqë ajo nuk po i paraqitej në telefon. Madje ai kishte menduar edhe udhëtimin prapa, tërheqjen nga misioni që kishte nisur së bashku me Mimozën, vetëm e vetëm që t'u ndodhej pranë prindërve në këtë situatë të vështirë mes tyre. Ndaj, e ëma, me ta kuptuar shqetësimin e tij, e thirri dhe i tha se është larguar me vetëdashje, se kishte nevojë për pak hapësirë, se donte të provonte pak veten si mësuese e pianos. Por, nuk ia përmendi incidentin me Bujarin e Shpëtimin në park. Diamanti ishte djalë i zgjuar. Ai e dinte se gjërat nuk ishin aq të lehta, si ia paraqiste e ëma, madje ia kishte thënë edhe asaj, se po mendonte të kthehej e të merrte vesh mirë se ç'kishte ndodhur, pasi, sipas tij, ikja e larg familjes, në një dhe të huaj, në një kohë kur ata kishin aq shumë nevojë për të, kishte qenë e gabuar. Por e ëma e kishte lutur të mos ndërmerrte asgjë. Ishin gjëra të cilat prindërit e tij duhet t'i zgjidhnin mes vete një herë e mirë.

- Mimoza, kam frikë se prindërit e mi do të ndahen,- i ishte qarë një herë të fejuarës së tij Diamanti, kur po ktheheshin nga puna e mjekut që bënin gjatë ditës.

- Nuk besoj, Diamant. Familja jote ka shumë dashuri brenda saj, por rruga derisa ta gjejnë ka qenë pak më e vështirë për ta.

- Po pse, atëherë, pse? Pse ndodh kjo me familjen time, pse jemi shpërndarë kështu?

- Lëri ta bëjnë atë rrugë, Diamant. Do shohësh se do bëhet mirë. Ca gjëra duhet të kalohen për të arritur te caku i mirë.

Pas kësaj ai kontaktonte më shpesh me prindërit, por i ndrydhej zemra sa herë që duhej t'i thërriste në numra të ndryshëm. Në fillim e pati të vështirë sa të gjente numrin e telefonit të shtëpisë ku po banonte e ëma, pse ajo i bënte bisht e nuk ia tregonte. Kurse kohët e fundit kishte humbur lidhjet me të atin. Kishte kohë që po provonte të lidhej me të, por ai s'po e ngrinte receptorin. Diamanti nisi të shqetësohej. Mos ishte i sëmurë? Mos kishte shkuar diku, mos kishte bërë ndonjë gjë të keqe? O Zot!, mendoi Diamanti, po edhe unë ç'bëra që erdha këndej. Ndoshta po të kisha qenë atje nuk do të ndaheshin, por do të qëndronin bashkë së paku nga shkaku im. Babai nuk ishte mirë edhe nga gjendja shpirtërore, si e lashë unë kështu? Po mamanë? Duhet të bëj diçka, duhet…

***

Besa ishte në kopsht me Midin, kur Jolanda i thirri nga brenda:

- Besa! Diamanti në telefon, shpejto!

Gruaja lëvizi këmbët dhe sakaq u dha në sallon, ku ishte telefoni. E mori receptorin.

- Alo, Diamant, bir, sa më ka marrë malli, si je? Po Mimoza?- po i thoshte të gjitha fjalët me një frymë.

- Mirë jam, mama, mos u brengos për mua. Mimoza po ndjehet disi e lodhur. Kam nisur të frikësohem mos është e sëmurë. Këtu klima dallon shumë nga e jona. Është shumë ngrohtë, vapë e madhe, ndërsa atje ku punojmë nuk ka shumë... komoditet. Prandaj po mendoj se nuk i përshtaten mirë kushtet, duket e rraskapitur...,- po fliste shpejt e shpejt Diamanti dhe Besa në ato pak sekonda po ndjente sikur nuk po fliste me të birin, i cili nuk e kishte kurrë zakon të ankohej nga asgjë. Dhe fluturimthi i regëtiu në mendje se mos vallë, ai po ia bënte kaq të vështirë jetën atje apostafat për ta bindur se duhej të kthehej?.. E kishin biseduar njëherë këtë punë para disa ditësh dhe ajo ia kishte prerë shkurt se nuk duhej të brengosej për ta, kurse ja tashti, Diamanti po gjente një tjetër shkak për t'i thënë se duhej të kthehej. Ndërkohë i tha të birit:

- E ka vizituar mjeku, Diamant? Pse keni pritur deri tani?

- Do të shkojmë së shpejti, mama. Po presim edhe ndonjë ditë dhe, po nuk i kaloi, do të shkojmë menjëherë te mjeku. Madje ata i kemi këtu, jetojmë e punojmë bashkë.

- Më brengose shumë. Të lutem më lajmëro menjëherë sapo të jetë vizituar.

- Mama unë jam i brengosur edhe për një gjë tjetër,- i tha Diamanti me një zë pak më të ulët.

- Çfarë, bir? – pyeti nëna tashmë e frikësuar.

- Ke kontaktuar me babanë tani shpejt?

- Jo. Ka kohë që nuk jemi dëgjuar në telefon.. Ndoshta mbi një muaj. Në fakt kam provuar, por ai nuk e ngre receptorin. Nuk e di pse, kam menduar se mbase ka shkuar diku nga ndonjë kushëri i tij. Po pse, Diamant, çfarë ka ndodhur? – pyeti Besa tashmë e trembur. Zemra e saj nuk duronte dot më lajme të hidhura.

- Nuk e di, mama. Por ka kohë që nuk më përgjigjet në telefon. Një herë mendova se mos ishte rastësi, por javën e fundit e kam thirrur çdo ditë, ndërsa tri ditët e fundit disa herë në ditë. Nuk lajmërohet fare. Jam shumë i brengosur.

- Tani u brengosa edhe unë. Por u brengosa edhe për Mimozën.

- Mos mbaj dert për Mimozën, mama. Jam unë me të. Jam i bindur se është punë klime, Mimoza është pak e ndjeshme.

- Do të provoj të lidhem me babanë tënd, Diamant. Po nuk m'u përgjigj, do të shkoj vetë në shtëpi të shoh si është puna.

- Të faleminderit, mama.

- Çfarë thua bir? Edhe unë jam e brengosur për babanë tënd.

Djaloshit iu ngroh zemra. Do të bënte çmos që prindërit e tij t'i shihte sërish bashkë. Diamanti e dinte se edhe me t'u kthyer nga Afrika, ai do të mbetej në kryeqytet me Mimozën, fillimisht me studimet e pastaj edhe më tej. Kishin planifikuar që jetën ta kalonin në qytetin që u ofronte më shumë mundësi. Pastaj, Diamanti nuk ia kishte thënë prindërve, por ai nuk mund ta mendonte më jetën në shtëpinë që ia kujtonte në çdo moment motërzën e tij të humbur.

***

Kishin kaluar ndoshta disa orë kur mjeku u kthye në dhomë. Duket se ndërkohë Bujari kishte fjetur sërish, meqë nuk i kujtohej më asgjë.

- Bujar, Bujar! – mos flini më. Hajde, tani do t'ju dërgoj ku ju kam premtuar,- dëgjoi zërin e mjekut.

Bujarit iu hap fytyra. U ngrit ngadalë me ndihmën e infermieres, që po i buzëqeshte nga ana tjetër e krevatit. Ajo ishte e huaj, por ai e kuptonte pothuajse çdo fjalë që i thoshte, ndonëse nuk merrte guximin të fliste. Doktori ishte shqiptar, nga vendi i Bujarit, por punonte në shtetin tjetër. Kishte shkuar për t'u specializuar atje, pastaj kishte mbetur për të punuar e për të jetuar. Shpëtimi ia kishte mundësuar të gjitha lidhjet me të; në fakt ai i kishte organizuar të gjitha: qysh nga analizat e para që nga udhëtimi deri te qëndrimi i të dy pacientëve në një spital të huaj të specializuar për ndërhyrjen që kishte kërkuar Bujari.

Teksa po e çonin me karrocë, Bujari shikonte dritat e shumta që vezullonin nëpër tavanet e korridoreve të gjata. "A thua kështu duket edhe rruga për në parajsë?,- mendonte.- A thua ku ishte tani Dorina e tij e shtrenjtë, cili engjëll kishte fatin të qëndronte afër saj?".

- Erdhëm, – tha doktori.- Jeni gati?

Bujari pohoi me kokë dhe mjeku hapi derën. Në mes të dhomës ishte një shtrat në të cilin ishte shtrirë një burrë i ri. Bujari ia bëri me shenjë infermieres që ta afronin tek ai.

- Arben! – e thirri.- Je zgjuar?

Burri ktheu sytë dhe sakaq u përlot. Deshi të zgjaste dorën, por u pengua nga tubat e vendosura nëpër duart e tij.

- Bujar! Oh, Bujar! Jam zgjuar jo nga gjumi, por nga vdekja. Të faleminderit, o burrë!

- Mjeku thotë se operacioni shkoi mirë, Arben. Jam shumë i lumtur për këtë. Mendo sa e lumtur do të jetë bija jote, Jeta.

- O, Zot, kam aq mall për të. Ndjehem ngushtë se mos po i bëhet barrë zotit Shpëtimit.

- Çfarë thua, ishte ideja e tij që ajo të qëndronte tek ata. E bija e Shpëtimit e do Jetën sikur e do edhe Besa, ime shoqe,- tha me dhimbje në zemër kur e përmendi të shoqen. Pastaj shtoi:- Më fal, Arben, nuk mund ta thërrisja gruan time, meqë nuk doja që ajo ta kuptonte për mua. Ky ishte një vendim që doja ta ndaja vetëm me veten time. "Dhe me Dorinën" deshi të shtojë, por e ndjente se nuk ishte rasti tashti.

- E kuptoj. Por, zoti Bujar, ju më dhuruat veshkën, më dhatë jetën, ndërsa unë, unë çfarë t'ju dhuroj, më thoni? Si t'jua kthej këtë që keni bërë për mua? – tha Arbeni gati me buzë në vaj.

- Ju më keni dhënë jetë atëherë kur pata vdekur,- i tha Bujari dhe nxori dy foto nga xhepi i pizhamës së tij. Në njërën ishte Dorina, në tjetrën Jeta.

- Shpresoj se nuk do të pendoheni për këtë që keni bërë, zoti Bujar.

- Më thirr vetëm Bujar! Tanimë jemi si vëllezër.

- Po… Bujar. Shpresoj se nuk do të pendohesh për këtë që ke bërë për mua, të jam borxhli i përjetshëm. Unë... unë do ta gjej një herë mënyrën se si të ta shpërblej këtë që bëre për mua. Megjithëse disa gjëra nuk kanë shpërblim.

- As mos e thuaj! Unë kam marrë jetë nga dikush tjetër dhe pastaj kam menduar të dhuroj më tutje. Ky ishte borxhi im që kisha për të kthyer.

- Je i sigurt? - e pyeti sërish Arbeni, ende pa e kuptuar mirë se si mund ta zhbironte këtë slogan të Bujarit.

- Plotësisht i sigurt. Ma tha bija ime, Arben. Ndonjëherë fjalët gjejnë rrugë hyjnore për të na ardhur deri në zemër e në mendje.

Arbeni pohoi me kokë. Tash diçka nisi të kuptojë për gjendjen e Bujarit, për "borxhin" ndaj të tjerëve, që ai thoshte. Faqeve iu rrokullisën dy lot mallëngjimi. Shfryu thellë me kraharorin që i dhembte nga gjendja ku ndodhej.

- Mendoj se tani është koha kur duhet të pushoni të dy,- tha mjeku dhe i foli infermieres në gjuhën a saj që ta kthente Bujarin në dhomë e tij. Pastaj i tha atij:

- Bujar, nuk keni dikë të familjes për t'ju vizituar?

- Jo,- i tha Bujari shkurt dhe uli kokën.

Mjeku e pa se pacienti po ndihej ngushtë, ndaj nuk e nguci më tutje. E përcolli te dhoma e tij dhe bashkë me infermieren po ktheheshin te pacientët e tjerë.

- Zoti Bujar është një njeri i mirë,- i tha mjeku infermieres.

- Ju e njihnit para se të vinte te ne?- pyeti ajo, duke e ditur se mjeku dhe pacienti ishin nga i njëjti vend.

- Jo. E kam takuar për herë të parë këtu në spital, - tha ai.

- Po ku e dini pra se është njeri i mirë?

- E cili mund t'ia dhurojë veshkën një njeriu të huaj?- iu përgjigj ai me një pyetje retorike.

Infermierja u ndal pak dhe e preku lehtë në krah.

- Ju thoni se zoti Bujar nuk e ka asgjë zotin Arben? Nuk kanë, për shembull, lidhje gjaku mes tyre?

- Asgjë.

- As vëlla, as kushëri, as? – hapi sytë e çuditur ajo.

- Jo. Ashtu siç më kanë informuar, ai vetëm e ka njohur nëpërmjet bijës së tij, që ka trokitur në derën e Bujarit për të shitur lule.

- Po si, atëherë, mos e ka paguar zoti Arben disi zotin Bujar për veshkën?

- Me çka? Po të them se zoti Arben është fare i varfër. Vogëlushja e tij shkonte derë më derë për të shitur lule e fruta për të nxjerrë bukën e gojës, për shkak se i ati dergjej në shtrat me veshkat copë. Përkundrazi, zoti Bujar ia ka paguar edhe shpenzimet e udhëtimit, të operacionit dhe të qëndrimit në spital. Miku im që ma ofroi, më ka thënë se zoti Bujar ka vënë edhe shtëpinë në shitje për këtë rast.

- Po pse e ka bërë, pra? Duhet të ketë ndonjë motiv, ndonjë arsye të fortë,- vazhdonte me pyetjet, dukshëm e befasuar, infermierja e huaj.

- Po të të them se e ka bërë vetëm nga dëshira e mirë, nga humanizmi, nuk do të të duket arsye e mjaftueshme?

- E pabesueshme. Kohët e fundit jemi mësuar të njohim aq shembuj sa të bindemi që interesi ta udhëheqë botën.

- Ja pra ku e kemi një rast për ta demantuar këtë, – tha mjeku disi me nota solemne .

- E mahnitshme! Atëherë bota ende nuk qenka gati për t'u përmbysur. Ky qenka një rast për tu shkruar një libër ose për t'u bërë një film, - foli infermierja me të vërtetë e mrekulluar nga një rast i tillë bamirësie pa interes, siç quante ajo.

- Eh,- tha mjeku,- jeta e vërtetë është një proces i mundimshëm. Mund ta quash si të duash, por e vështirë është. Çdokush përjeton filmin e vet, historinë e vet. Duhet të jemi të kënaqur kur bëhemi pjesë e këtyre gjërave të vogla që na e kujtojnë se jemi njerëz, se mund të bëhemi njerëz. Secili nga ne mund të bëhet i tillë vetëm nëse duam, vetëm nëse në neve ka pak dëshirë.

XX

Rrugës derisa po ecte me hap të shpejtë, Besës i dukej thuajse këmbët po e çonin prapa si valët e detit. Nuk kishte futur tërë natën gjumë së sy, ndërsa edhe Midi sikur e kishte ndjerë shqetësimin e saj dhe i kishte qëndruar pranë tërë kohën. Disa herë ishte ngritur te dritarja për të parë në kishte zbardhur. Nata i ishte dukur një shekull.

"A thua çfarë ka ndodhur me Bujarin?- mendonte teksa ecte ngutshëm rrugës,- Pse nuk është lajmëruar një kohë kaq të gjatë? Mos ka ikur gjëkund, mos e ka gjetur gjë?, i çonte të gjitha hamendjet e këqia në kokë.- Pse nuk mora një taksi, dreq o punë, do të kisha mbërritur tashti"- thoshte me vete dhe shpejtonte hapin akoma më shumë.

Pas pak arriti deri te rruga e njohur.

"Zot, sa shumë më ka munguar",- mendoi. Ktheu në rrugicën e saj dhe ndaloi para derës së gjelbër. Ndjeu mall, nostalgji. I sëmboi në zemër për atë jetë që kishte kaluar brenda mureve të asaj shtëpie, që kishte qenë për gati tridhjetë vite foleja e saj, foleja e tyre, dhe e zogjve që i kishin lindur e rritur aty. "Eh, zogjtë tanë të mjerë!" psherëtiu dhe u bë gati të futej në shtëpi. Po ishte në dilemë: t'i binte ziles apo ta shtynte derën me këmbë, ashtu siç bënte rëndomë kur kthehej nga pazari me duart të zëna nga torbat me ushqime? Sa absurde dukej tani kjo dilemë! Si kishte ardhur puna deri këtu, që t'i binte ziles në shtëpinë e saj, të cilën e kishin ndërtuar me aq mund e dashuri, ku kishin rritur fëmijët, ku ishte shkrirë një pjesë e jetës së saj. Aty, aty prej nga kishte përcjellë gjysmën e zemrës për në banesën e fundit…

Një herë e mendoi të hynte, ta hapte derën dhe të gjendej në oborrin e saj të dashur. Futi dorën në xhep dhe preku çelësat. Por prapë e step:

" Çfarë nëse Bujari nuk është vetëm?".

Ky mendim sikur e lëkundi pak dhe ndjeu një shqetësim të lehtë. A ishte e mundur se kishte gjetur dikë tjetër? Ndoshta dikë më të re, ndoshta dikë që nuk ia përkujtonte dhimbjet dhe pikëllimin…

Tundi kokën sikur dëshironte ta flakte çdo mendim të tillë.

"Do t'i bie ziles" tha me vete dhe i mëshoi butonit disa herë.

Një kohë të gjatë nuk u lajmërua askush. Besa provoi edhe një herë, ndërsa me dorën tjetër shtrëngonte fort çelësat brenda xhepit.

Mu atëherë kur po mendonte se nuk ishte askush brenda, dëgjoi ca hapa në oborr.

Zemra i rrahu më shpejt derisa po përpiqej të përmblidhte veten. Ç't'i thoshte Bujarit? Pse kishte ardhur? Do t'i thoshte se e ka dërguar Diamanti, se është brengosur, se…

- Besa! – dëgjoi zërin që nuk ishte i Bujarit dhe, megjithëse sytë po i shihnin mirë, truri nuk po ia pranonte dot fotografinë e një njeriu tjetër në derën e saj.

- Shpëtim! Po ti nga këtu? – e pyeti dukshëm e befasuar.

- Besa, oh Besa, eja brenda… është muhabet i gjatë… eja njëherë brenda…

Besa u fut në oborr, duke ecur sikur dikush po e komandonte me telekomandë; ndjehej komplet e robotizuar.

- Sa moti nuk të kam parë, Besa, eja brenda, mirë se ke ardhur! Më fal, ndoshta ke pritur shumë jashtë, por isha ende në gjumë, mbrëmë nuk kam fjetur mirë dhe sot mbeta mjaft vonë. Pastaj ne pensionistëve nuk na pret kush, e kemi të gjithë kohën për vete,- u përpoq të bënte pak shaka Shpëtimi përderisa Besa e ndiqte e befasuar e pa kuptuar asgjë. Tanimë ishte vërtetë shumë e brengosur. Diçka kishte ndodhur me të vërtetë, megjithëse rreth e përqark dukej thuajse nuk kishte lëvizur asgjë. Hyri brenda dhe iu duk thuajse e ndjeu aromën e shtëpisë, që i mungonte tash e sa kohë. Eci si e hipnotizuar dhe u ul në karrigen e parë.

Shpëtimi dukej i shqetësuar po ashtu, ndonëse mundohej të buzëqeshte. Besa e kishte vërejtur se kishte shumëçka për t'i thënë dhe se nuk po dinte nga t'ia niste.

- Dëshiron një kafe? Po e bëj për të dy, se edhe unë nuk e kam pirë. Mirë? – e pyeti Shpëtimi.

- Mirë, – tha Besa dhe pa se edhe ai po hezitonte kur u nis drejt kuzhinës, që në fakt ishte e saj.

Kur aroma e kafes së zier rishtas po mbushte dhomën, Besës iu duk thuajse do të eksplodonte nga padurimi për të mësuar gjithçka kishte ndodhur me Bujarin, me shtëpinë e saj...

- Shpëtim, të lutem më fal që nuk po të pyes për shëndetin, familjen… të gjitha që duhet… jam shumë e hutuar… të lutem, më trego çfarë ka ndodhur?

- Qetësohu, Besa! Do të t'i tregoj të gjitha. Të lutem qetësohu, nuk është asgjë për t'u brengosur,- mundohej të fliste Shpëtimi ndonëse zëri i tij ishte i mbushur frymë të tepërt.

- Ku është Bujari, pse nuk lajmërohet? Çfarë ka ngjarë, pse je ti vetëm këtu? – i radhiste pyetjet Besa pa i pritur përgjigjet.

- Të lutem Besa, qetësohu, Bujari është mirë… por… por nuk është këtu. Ka kohë që nuk është këtu.

- Si nuk është? Në shtëpi nuk është? Ku është, kur vjen? – vazhdonte ajo me pyetjet.

- Nuk është në shtëpi. Në të vërtetë…- mori frymë thellë Shpëtimi dhe pastaj vazhdoi me një herë me të lëshuar frymën:- Në të vërtetë nuk është fare në qytet, as brenda shtetit.

- Shpëtim, çfarë ka ndodhur? Mos ka ikur? Mos ka pasur ndonjë thyerje nervore? Ti duhet ta dish, Shpëtim, meqë... meqë të ka lënë ta ruash shtëpinë, apo jo?

Shpëtimi hamendej dhe kishte ndrydhur buzët. Kishte ulur kokën dhe po e sillte filxhanin në pjatë.

- Apo jo, Shpëtim? – e përsëriti pyetjen Besa.

- Në fakt, jo, Besa.

- Si po mendon jo?

- Nuk jam duke e ruajtur shtëpinë. Jam duke ruajtur diçka… dikënd tjetër…

- Si nuk je duke e ruajtur shtëpinë? Atëherë pse je këtu?

- Besa… Besa unë e kam blerë shtëpinë tuaj. Unë… unë tani jetoj këtu, ka një muaj,– tha Shpëtimi dukshëm i shqetësuar, pa i ngritur fare sytë.

Besës iu rrotulluan të gjitha gjërat rreth kokës. Shtëpia e saj nuk ishte më e saj? Mu atëherë pa se disa nga orenditë ishin ndryshe. Edhe ajri brenda tani po i dukej ndryshe.

- Ti e paske blerë shtëpinë tonë!? Si ma paska bërë Bujari këtë!? Po unë nuk u pyetkam fare? Kam vdekur? Ndërsa unë brengosem për fatin dhe shëndetin e tij! Më ka lënë në rrugë. Ndërsa unë e doja akoma, mendoja se kishim ende shpresë… Ai, ai më paska lënë në rrugë. Mirë ma ka bërë, çfarë prisja ndryshe…- fliste Besa si përçart, ndërsa Shpëtimi mundohej ta ndalonte me fjalë të buta, por ajo nuk dëgjonte fare.

- Më lër! Mos e shfajëso më! Unë… unë frikohesha për të, kisha merak a është mirë, çfarë e ka gjetur, ndërsa ai ma paska shitur shtëpinë, ka marrë paratë dhe ka ikur jashtë shtetit. Bukur! Shumë bukur! Shpresoj të jetë mirë. Sigurisht ka shkuar me dikënd, apo jo Shpëtim? Më thuaj të vërtetën, kam hak ta di, ka pasur borxh të ma thotë. Ma thuaj ti, të paktën.

- Besa, ndalu! Të lutem, ndalu!- dëgjoi zërin gati urdhërues të Shpëtimit. U ndal sikur dikush të kishte shtypur një pullë. Uli kokën dhe ndjeu lotët që po i rrokulliseshin faqeve.

- Besa, je në vete? Ç'janë këto që thua? Asgjë nuk është e vërtetë, asgjë, kuptove? Asgjë fare. Bujari nuk është i tillë, ai nuk ka bërë asgjë të keqe. Ti… ti nuk ia ke idenë çfarë ka bërë ai. Ai, ai ka bërë diçka që nuk e ka bërë askush!

- Atë që e ka lënë në rrugë familjen e vet? Po, vërtetë askush nuk e ka bërë deri sot. Askush!- vazhdonte Besa nëpër lot:- Ku është ai kur i duhet familjes, ku është? Ku në djall është?

- Është në spital, Besa.- Shpëtimit iu duke se mu tashti ishte rasti t'ia thoshte atë që duhej Besës.- Është në një klinikë jashtë vendit. Ka një muaj i shtrirë,- tha dhe pastaj fshiu sytë. Ktheu kokën mënjanë, ashtu siç burrat fshehin dhembjen. Mu atëherë kur Besës iu duk se do të thoshte edhe diçka, ai heshti.

- Në spital? - Besa e pa në sy.– Në spital, më the? Pse? Çfarë ka ndodhur? Është i sëmurë? Pse nuk më ka treguar. O Zot, pse na dënon kështu! Do të humbim edhe një anëtar të familjes, pse o Zot?- qante Besa dhe kishte ngritur sytë lart thuajse priste ndonjë përgjigje nga qielli.

- Besa, qetësohu, të lutem. Bujari nuk është i sëmurë. Në fakt... Oh, e dija se do të vinte kjo ditë, isha pothuajse i bindur se do të paraqiteshe në derë, por Bujari thoshte se nuk kishte shpresë se ti do të ktheheshe. Kishte pritur me ditë të tëra në oborr, vetëm të dëgjonte hapat e tua, ma tha vetë këtë. Ai të do, Besa, ai të do me shpirt, me zemër.

- Po pse është në spital? Ma thuaj, atëherë?- bërtiti Besa me një zë të dëshpëruar dhe instinktivisht u ngrit në këmbë.

- Bujari ia ka dhuruar veshkën Arbenit, babait të Jetës. Ja pse është në spital. Të dy janë të shtrirë në të njëjtën klinikë. Kanë shkuar disa herë për analizat dhe dolën se Bujari ishte kandidat potencial. Nuk hezitoi asnjë minutë. Ishte aq i bindur se duhej ta bënte, erdhi tek unë, më lut t'i ndihmoj.

Besa u ul sërish. Dukej e shokuar.

- Çfarë thua? Bujari i dhuroi veshkën Arbenit? Po pse?

- Është vështirë ta them. Vetëm Bujari mund të ta sqarojë si duhet.

- Si ndodhi kjo gjë, si erdhi deri te kjo?.. O, Zot! Nuk mund ta imagjinoj dot… kjo është kaq e papritur, kaq e pabesueshme! Nuk e prisja këtë, nuk e prisja…

- E di, Besa. Vërtetë është e pabesueshme. Por ti ke një bashkëshort të mrekullueshëm, e di këtë? Rrallëkush e bën këtë vepër. Njeriu për njeriun sot mendon shumë pak. Pra, ai erdhi dhe më luti ta ndihmoja, t'ia organizoja të gjitha. U befasova pa masë, madje u përpoqa ta bind të kundërtën. Kur e mendoj sot, pyetem, pse e bëra këtë? Çfarë të drejte kisha që ta ndal një njeri t'i jepte jetë një njeriu tjetër? Por, ishte Bujari, Bujari që e njihja. Nuk po i flisja si mjek, por si mik. Megjithatë ai ishte i paluhatshëm. Më tha se do të hiqte dorë vetëm nëse veshka e tij nuk do të ishte e volitshme për Arbenin.

- Po si iu kishte mbushur mendja? Ia kishte kërkuar Arbeni këtë?

- Eh, Besa, kur të ta them nuk do ta besosh. Gjërat nisin diçka më larg. Bujari kishte qenë një ditë në varreza, dhe aty kishte takuar një djalosh, që kishte qenë i dashuruar në Dorinën. Kishin biseduar dhe prej atij momenti diçka ndryshoi në të. Bujari vërtetë dukej njeri tjetër, shumë i vendosur, njeri që dinte çfarë po bënte. Më beso, ishte i rilindur.

- Kur ka ndodhur kjo? – pyeti Besa.

- Më duket disa ditë pasi ke shkuar ti, aty pari… Ishte, pra në varreza, te Dorina, dhe, i nxitur nga disa rrethana, që i di mirë vetëm ai, u vendos ta bëjë këtë veprim kaq njerëzor.

- Dhe mua nuk më tha gjë? Nuk më konsideroi të denjë?

- Përkundrazi, Besa, i ke munguar pa masë në këtë rast. Donte ta ndante me ty, dhe vetëm me ty, këtë mendim, por më tha se nuk dëshironte të të prekte në ndjenja, nuk donte të të yshte që, për hir të këtij vendimi të tij, të bësh veprime për shkak të dhembjes, mëshirës, apo të mendoje se e kishe obligim. Ai ëndërronte vërtetë që ti të ktheheshe, por të ktheheshe si Besa e tij, si gruaja e tij e dashur. Të ktheheshe kur ti të ishe vërtetë e bindur për këtë.

Besës i rridhnin lotët sërish. Burri i saj e kishte kursyer nga vuajtjet. E kishte kursyer pas kushedi sa kohësh. Kishte treguar respekt për të, për ndjenjat, për vendimet e veprimet e saj!. Në moshën që ishin, respekti kishte më shumë rëndësi se vetë dashuria.

Pastaj u përmblodh pak dhe tha:

- Po pastaj? Çfarë lidhje kishte biseda me atë djaloshin dhe vendimi i Bujarit për t'i ndihmuar Arbenit?

- Nuk e di. Por më tha se asnjëherë si atë ditë nuk kishte biseduar më thellë me Dorinën. Asnjëherë më mirë nuk e kishte njohur bijën e tij. Më tha se e kishte ndjerë mesazhin e saj, se duhej ta çonte në vend.

" Ma tha bija ime", - më tha – "duhet ta bëj, Shpëtim, duhet të jap jetë" - kështu fliste sikur të kishte zbuluar diçka tejet të rëndësishme në jetën e tij.

- E kuptoj,- tha Besa.- Dorina na ka dërguar shumë mesazhe që andej, miku im. Duket se edhe vdekja e dikujt ndodh për t'i dhënë kuptim jetëve të tjera.

- Ashtu, po,- tha Shpëtimi e pastaj vazhdoi: - U mundova ta bind të të tregonte lidhur me vendimin e tij, së paku t'i tregonte Diamantit. E kotë. Thoshte se nuk kishte më të drejtë të përzihej në jetën tuaj, se po kërkonte të lante borxhin e gabimeve të veta që e kishin bërë të mbeste vetëm.

Të dy heshtën për pak. Ishin përplot emocione që nuk gjenin rrugë të mjaftueshme për të dalë jashtë. Pastaj Besa u kujtua:

- Po shtëpia? Çfarë ndodhi? Pse e shiti, çfarë bëri me paratë? Kemi mbetur pa asgjë? Po si e bleve ti?

- Besa, edhe kjo është histori më vete. Si të ta shpjegoj?- u ndal pak- Kur Bujari erdhi të më kërkonte ndihmë, unë isha duke u shpërngulur. Kisha kohë që jetoja vetëm, dhe më dukej e arsyeshme të shkoja pranë sime bije, megjithëse nuk më ikej nga këtu. Mosha ime kërkon njerëz, Besa, njerëz. Nuk kemi lindur të jetojmë vetëm.

- Eh, kujt ia thua… - tha Besa me mirëkuptim.

- I tregova Bujarit në mënyrë të sinqertë. I thashë se po shkoja te vajza në kryeqytet. Ajo kishte një apartament, por unë vërtetë doja njerëz, por nuk doja as ta humb edhe lirinë time. Lirinë e kisha këtu, por këtu më hante apartamenti, është shumë i madh.

- Po. Ju kishit bashkuar dy apartamente.

- Po. I tregova se po i shes të gjitha dhe po shkoj. Bujari u kthye pas disa ditëve e më tha se kishte një ide. Më tha se po e shiste shtëpinë e tij. I thashë, je çmendur? Çfarë do të thotë Besa, Diamanti, çfarë do bësh me paratë? Më tha se ju do ta kuptonit, se do ta përkrahnit, se do të ishit të të njëjtës mendje. Tha, kështu do të bënte edhe Dorina, ishte i sigurt…

- Po çfarë ishte ideja?

- Tha se, po të kuptoheshim bashkë, donte të ma jepte mua shtëpinë tuaj, ndërsa do të merrte apartamentet e mia, pra këto që kam këtu, domethënë të dyja ngjitur, si dhe atë të vajzës sime në kryeqytet, e cila në këtë rast do të transferohej këndej. Ishin apartamente të vogla krahasuar me shtëpinë tuaj.

- Po çfarë i duhej Bujarit apartamenti në kryeqytet? – pyeti Besa me habi.

- Ai i kishte planifikuar të gjitha me hollësi. Apartamentin e kryeqytetit e donte për Diamantin. Tha ta ketë nga prindërit, kur të kthehet. E dinte se ai, pra Diamanti, dëshironte të mbetej atje. E mendova mirë, ndonëse në fillim ideja m'u duk e çmendur. E thirra edhe vajzën me bashkëshortin e saj dhe ua thashë se ishte kjo mundësi për të gjithë. Për habinë time, ata e pritën shumë mirë, madje u gëzuan pa masë. Kishte kohë që ndiheshin ngushtë në apartament, por edhe në kaosin e kryeqytetit. Pastaj thanë se kështu do më kishin pranë, por edhe unë do të kisha pranë vajzën me të bijtë, pra nipat e mi. Bëmë një llogari me Bujarin dhe doli se, po ta bënim këtë ndërrim, duhej t'i jepja edhe ca para më tepër. Jo shumë. Shtëpia juaj ishte një ndërtesë e kushtueshme dhe ia vlente. Kështu bëmë, ia pagova Bujarit diferencën dhe ai të gjitha këto para i dha për operacionin e Arbenit. E beson këtë?

- E besoj. E paskam harruar këtë anë të Bujarit. Tanimë duket se ka gjetur Dorinën brenda vetes. – Dhe shtoi: - Ka pasur edhe ai ty për të të kthyer ca para, besoj.

- Për të gjitha jemi marrë vesh Besa, është punë e kryer tashmë- iu përgjigj Shpëtimi dhe vazhdoi me një ton të butë:

- Ju keni shumë për të biseduar bashkë, Besa. Keni shumë për t'i thënë njëri-tjetrit.

- Ashtu shpresoj, Shpëtim. Ndoshta nuk kemi humbur shumë kohë.

- Nuk keni humbur asgjë. Ndonjëherë gjërat ndodhin për të na çuar aty ku duhet, edhe pse ne i shohim si fatkeqësi. Ju jeni ndarë për t'u bashkuar përsëri, përgjithmonë, jam i bindur për këtë. Keni qëndruar me të panjohurën, për t'u njohur më mirë.

- Ndoshta. Por nuk ishte e lehtë. Akoma nuk është,- tha Besa mbushur gjithë dëshpërim. Ja, tani Bujari qëndron i shtrirë diku në spitalet e botës dhe unë nuk jam pranë tij. Si na erdhi puna kështu, bre Shpëtim?

- Ai të ka pasur gjithmonë me vete, ndryshe nuk do të ishte aq i fortë për ta bërë këtë që bëri.

- Mendon?

- Nuk mendoj, por e di. Ju ka pasur në mendje të gjithëve. Në mendje e në zemër.

- Kur kthehet, di gjë?

- Nuk e di. Tani janë në procesin e rehabilitimit. Por ti mund të shkosh atje, nëse do. Mund të shkojmë bashkë.

- Unë të shkoj atje? - pyeti Besa më shumë për vete.- Po nëse Bujari nuk dëshiron të më shohë? Të më ketë afër?

- Si mund ta thuash këtë? Kjo do të ishe ëndrra e tij e realizuar.

Besa futi dy duart në flokët e shprishur. Duhej të mendonte për këtë. Pastaj befas iu kujtuan disa gjëra menjëherë.

- Po Bujari u shpërngul në apartamentin tënd?

- I ka lëvizur plaçkat, por jo të gjitha. Një dhomë e ka rregulluar me gjërat e tua. Tha se ashtu do të të ndjente afër edhe nëse nuk do të kthehesh. Pastaj më ka lutur që t'i kryej disa gjëra në vend të tij. Kërkoi që këtë apartamentin ta kthej sërish në gjendjen e mëparshme, pra t'i bëj dy veç e veç.

- Ashtu? Po pse?

- Këtë do të ta thotë ai, nuk e di…

- Nuk e di, apo nuk do të ma thuash?

- Do të ta thotë vetë ai. Ndërsa vajza ime do të vijë këndej, pas një muaji, meqë duhet të bëjë kontratën e re të punës. Pastaj do të transferohet. Deri atëherë do ta pres.

- Sigurisht edhe ti ndjehesh i vetmuar, Shpëtim. Por je me fat, së shpejti do të jesh me bijën, me dhëndrin e me nipat. Do të të mbushet jeta.

- Në të vërtetë edhe tash nuk jam edhe aq i vetmuar, Besa. Unë… unë nuk jetoj fare vetëm,- po thoshte Shpëtimi me buzë në gaz, sikur fshihte diçka.

- Ashtu? Po me kënd? – i tha Besa dhe mu atëherë u kujtua se deri tani nuk e kishte pyetur asgjë për jetën e tij.

- Është një sekret i vogël…

- E kuptoj…

- …të cilin do ta zbulosh brenda pak minutave. Eja me mua, – i tha Shpëtimi dhe e zuri për krahu lehtazi. U ngjitën shkallëve, ndërsa Besa mezi po e mbante veten. I dukej thuajse edhe të rrahurat e saj që trokisnin fuqishëm brenda gjoksit, do ta zgjonin nga gjumi befasinë.

U ndalën para dhomës se Dorinës. Besës iu duk se iu ndal fryma. Kur Shpëtimi hapi derën ngadalë, Besa pa se në shtratin e së bijës flinte një krijesë e ëmbël, me flokët shpërndarë mbi jorgan. Befas e vogla u zgjua nga zhurma e derës dhe u kthye kah Besa, që kishte mbetur në këmbë si e ngurtësuar.

- Jeta! – e thirri Besa.

- Teta Besa, erdhe? Më në fund erdhe?- fliste Jeta e përgjumur, duke i fshirë gropëzat e syçkave me grushtet e saj si dy topa mëndafshi.

Besa u afrua dhe e përqafoi. U shkreh në vaj si fëmijë.

- E di se e kam lutur nënën në ëndërr që ti të kthehesh?- i tha Jeta.

Besa e shikonte me gjithë dashurinë e shpirtit, por nuk kishte fuqi t'i përgjigjej. Ndërsa Jeta u ngrit mbi shtrat dhe me gëzimin e fëmijës vazhdoi:

- E kam parë një natë mamin tim në ëndërr. Ishte e bukur, ashtu si ma ka treguar babi. E luta të kthehet, por më tha se ishte e pamundur, ajo ishte me engjëjt, me Dorinën, motrën time. Pastaj i thashë që, nëse ajo vetë nuk mund të kthehet, të bëjë të më kthehesh ti. E shikon, ma ka plotësuar dëshirën! - fliste Jeta dhe nuk i ndahej nga gjoksi.

Besa e mori në grykë, ndërsa Jeta ia fshinte lotët me cepin e pizhamës. Shpëtimi ishte mbështetur në derë dhe, ndonëse i prekur shumë thellë, merrte frymë i lehtësuar. Ofshante sikur t'i kishte pasur brenda barkut të gjitha telashet e botës dhe tani ishte liruar nga to.

- E di se babi im dhe xhaxhi Bujari tani janë vëllezër?- e pyeti Jeta Besën me pafajësinë e një fëmije.

- Po, zemër, e di.

- Xhaxhi Bujari ma shpëtoi babin nga sëmundja e rëndë. Do të kthehen së shpejti,- gurgullonte Jeta teksa zbrisnin shkallëve.

- Po, zemër, do të kthehen së shpejti.

- Ose ju do të shkoni tek ata,- tha Shpëtimi duke ia përkëdhelur kokën Jetës.

- Mund të shkojmë ne? Mund të shkojmë? - bërtiste Jeta dhe ia shkundte dorën Besës që t'i përgjigjej.

- Do ta shohim, shpirt. Nëse është e mundur edhe do të shkojmë,- i tha Besa dhe pastaj shtoi: - Shpëtim, të vjen keq, nëse e marr Jetën sot me vete? Ka edhe një vogëlushe atje ku jetoj unë dhe besoj ta kalojë mirë.

- Sigurisht, le të vijë. Unë e dija se kishit shumë mall për njëra-tjetrën, por Bujari ma kishte ndaluar të të tregoja. Jam shumë i lumtur që erdhe sot.

- Edhe unë. Duket mesazhi i Dorinës paska mbërritur edhe në zemrën time e të Diamantit. Por, ashtu siç ka qenë vogëlushja e babit në jetë, ashtu ia paska dërguar më së pari Bujarit mesazhin e saj. Ishte sugaresha e tij.

- Ajo ishte sugaresha e natyrës, manarja e saj. Njerëzit si Dorina lindin për ta bërë botën më të bukur.

- Të faleminderit, Shpëtim,- tha Besa.- Kjo është një gjë shumë e bukur për ta lumturuar një prind.

Të dy u panë me mirëkuptim, ndërsa Besa pastaj shkoi me Jetën, e cila kishte kohë që po e ngrehte për fustani. Brenda gjysmë ore u gjetën në rrugë. Gruaja ktheu kokën dhe e pa edhe një herë shtëpinë e saj. Iu duk se ajo i buzëqeshi dhe disi heshtazi i tha:

“ Shko tani… ti do t’ia dalësh! Do të bëhet mirë. Nuk ka gjë më të sigurt se kjo”.

XXI

Jolanda ishte duke lexuar një libër aty pranë dritares, kur pa nga oborri Besën që po hynte bashkë me një vajzë të vogël përdore. Po ecnin ngadalë dhe hap pas hapi ndalnin nga pak. Besa po ia tregonte vogëlushes oborrin me pisha, dhe si dukej ia thoshte edhe emrat e drurëve, ashtu siç ua kishte ngjitur Hera, pse vogëlushja qeshte sa herë që ajo ia tregonte me gisht një pemë. Edhe pse buzëqeshte me vogëlushen që kishte përdore, dukej mirë se Besa nuk ishte fort e qetë, madje vërehej një brengosje në fytyrën e saj.

- Hera, oj Hera! - i thirri Jolanda së mbesës që po shikonte televizor në dhomën tjetër.

- Urdhëro, gjyshe Nanda, – gjegji vajza dhe sakaq u gjend afër saj.

- Më duket të ka ardhur një shoqe, pa dil pak jashtë.

- Ua sa mirë, kush është? – pyeti vogëlushja dhe pa pritur përgjigjen u gjet te dera e hyrjes. Sakaq u dëgjuan zërat e vogëlusheve si cicërima, dhe pas pak minutave të dyja hynë brenda dorë për dore, ndërsa Besa pas tyre.

- Sa shpejt u bëtë shoqeeee! Mirë për Herën e kam ditur se është e shoqërueshme, por ti qenke vërtetë shumë e mirë. Pa hajde pak te gjyshja,- i tha Jolanda duke hapur krahët kah Jeta. Ajo kishte ulur kokën e ndrojtur, faqet i skuqnin nga emocionet. U afrua ngadalë në përqafimin e Jolandës.

- Jolanda, kjo është Jeta, e bija e Arbenit, një mikut tonë familjar, – tha Besa.

- Shumë bukur. Do të qëndrosh me ne, Jeta?

Vogëlushja ngriti sytë nga Besa pa ditur çfarë të përgjigjet.

- Do të qëndrojë disa ditë, derisa të kthehet i ati, pse tash nuk është këtu,- tha Besa në vend të saj.

- Ashtu, pse ku është i ati?– pyeti Jolanda.

Besa ofshau nga brendia e shpirtit. U pa me Jolandën sy më sy dhe mblodhi buzët në shenjë shqetësimi. Pastaj iu kthye vajzave:

- Pse nuk dilni të lozni pakëz bashkë? Hera, a do t’i bësh shoqëri Jetës?

- Me gjithë qejf, teta Besa. Eja, Jeta! Do të t’i tregoj miqtë e mi të gjelbër në kopsht! – bërtiti gëzueshëm Hera dhe e rrëmbeu Jetën për dore kur kjo akoma nuk kishte arritur të hapte gojën. Pas pak u dëgjuan zërat e tyre të gëzueshëm nëpër oborr.

- Fëmijët janë gëzimi i shtëpisë, Jolanda, apo jo?- tha Besa pa i shkëputur sytë nga dritarja.

- Po, vërtetë janë. Ndonjëherë mendoj se Herën e kemi llastuar më tepër se ç’duhet, por në anën tjetër, kur ta mendosh, sa pak kohë kalojmë në jetë si fëmijë? Diçka pak më shumë se një dekadë. Rritemi aq shpejt, sa pastaj na duket se kjo pjesë e jetës na ka kaluar si në një film. Lum ai fëmijë që ka mundësinë ta llastojnë atë pak kohë sa është i vogël- tha Jolanda.

- Ose lum ai prind që ka aq kohë me fëmijën e vet sa për ta llastuar e për t'u ngopur me të,– tha tani Besa duke ofsharë dhe vuri dorën te zemra.

Jolandës iu ndrydh shpirti. E pa me dhimbsuni nënën që po mundohej ta prekte kujtimin e së bijës mu brenda zemrës.

- Askush nuk ngopet kurrë me fëmijën e vet, Besa, edhe po të jetonte njëqind vjet.

Jolanda nuk arriti ta kryente fjalinë kur Besa u shkreh në vaj. Vrapoi në dhomën e saj dhe u përplas mbi shtrat. Jolanda mbeti si e gurëzuar. Asnjëherë nuk kishte hyrë në dhomën e Besës, asnjëherë nuk kishte dashur t'i përzihej në jetën e saj, por këtë herë disi sikur e ndjente se duhej të vepronte ndryshe.

U ngrit ngadalë dhe u afrua të dera. Prej brenda ndiheshin qartë ngashërimet e gruas që po e mbyste dhimbjen nën jastëk.

Trokiti lehtë disa herë dhe mbajti vesh. Ngashërimet u ndalën dhe pastaj dëgjoi hapat që u afruan te dera.

- Jeta, ti je? – pyeti zëri andej derës e që dridhej akoma, megjithëse gruaja mundohej ta ndryshonte në të mirë. – Ja po vij, vetëm sa të laj pak fytyrën, më paska zënë një gjumë i lehtë…

- Besa, jam unë Jolanda. Të lutem hape derën.

Pasoi një heshtje. Pastaj zhurma e çelësit dhe kërcëllitja e lehtë e derës.

- Besa, a mund të hyj? Doja të bisedojmë pak.

- Të bisedojmë? Mirë… mirë… urdhëro brenda,– tha Besa me një zë të mekët e të pavendosur, dukshëm e pa përgatitur për këtë ballafaqim me Jolandën.

Jolanda hyri dhe i ra menjëherë në sy se dhoma e Besës ndriste nga pastërtia dhe rregulli. Mbi komodinën e vogël pranë shtratit rrinte fotografia e saj familjare, ku shiheshin ulur një burrë i pashëm me syze dhe dy fëmijë, vajzë e djalë, ndërsa pas tyre në këmbë ishte Besa. Kishte flokë të gjatë dhe fytyrë të qeshur. Afër fotografisë, mbi komodinë, ishte një libër, ndërsa pak më tej albumi me fotografi.

- Besa, - filloi Jolanda, – ka kohë që ke ardhur në shtëpinë time dhe të konsideroj si një mike të vërtetë. Je një grua shumë e mirë. Ndaj më dhemb kur të shoh se vuan, se të shqyhet shpirti dhe nuk flet, që e mban brenda dhimbjen si ta kesh miken më të mirë.

- Eh, duket jam miqësuar me të, duke e pasur shoqëruese të përhershme,- tha Besa.

- Me mua mund të flasësh lirshëm, si mikja me miken, si shoqja me shoqen, si gruaja me gruan, por edhe si motra me motrën. Kemi nevojë ta hapim zemrën ndonjëherë.

- Po, po,- tundi kokën Besa në shenjë pohimi,- por, e dashur Jolanda, unë nuk dua askënd ta shqetësoj me telashet e mia. Sot njerëzit kanë hallet e veta, nuk dua t'ua ngarkoj edhe të miat në shpinë.

- Besa, ç'flet kështu? Hallet duhen ndarë me dikë, kështu bëhen më të lehta për t'i bartur. E di sa kam pasur dikur nevojë për këtë? Ta kem dikë të më këshillojë, të ndajë me mua hallin tim?- foli Jolanda më shumë për vete dhe kur e pa Besën që ishte ndalur me kureshtje, tha:

- Ta lëmë për herë tjetër atë muhabetin tim. Më trego ti tani. Çfarë të mundon?

- Eh, Jolanda…gjërat kanë ecur me një kah shumë të shtrembër për mua. Një herë humba vajzën, pastaj burrin. Tash kam humbur edhe vetë rrugën time.

- Si, burrin? Nuk më ke folur asnjë herë për të, por unë e di kush është.

- Oh, Jolanda, është histori e gjatë.

- Unë nuk po shkoj askund e dashur. Kam gjithë kohën e duhur për të të dëgjuar. Pastaj miqtë për çfarë janë? – foli Jolanda me zërin e mikeshës së vërtetë, çfarë i kishte munguar Besës një kohë të gjatë.

- Unë dhe Bujari jemi ndarë për pak kohë. Në të vërtetë… në të vërtetë unë e braktisa. Ishte e vetmja rrugë, e vetmja mënyrë. Gjërat ishin ftohur shumë mes nesh.

- Pas vdekjes së vajzës? – e pyeti Jolanda.

- Ti e ke ditur humbjen e Dorinës? – e pyeti edhe Besa.

- Po,- pohoi Jolanda.- Më fal se u nxitova me pyetjen.

- Jo, jo, por nuk më kishe thënë gjë deri tashti, kaq kohë që kam këtu.

- Nuk kam dashur të ta prek plagën. E kam lënë ta bisedonim kur të vinte dita.

- Po, të faleminderit për këtë. E çmoj shumë. Jo, Jolanda, me Bujarin nuk ishim ftohur pas Dorinës. Prej kohësh mes nesh kishte shumë akull, por gjërat u përkeqësuan më tej pas vdekjes së saj. Kur dy njerëz ftohen nga njëri-tjetri, pason një farë faze e njohjes së dytë mes tyre.

- Si mendon?

- Paj, shiko. Një herë e ke njohur ashtu si ke dashur ta njohësh, kur i merr vetëm anët pozitive, je plot mirëkuptim e tolerancë. Pastaj vijnë gjëra të tjera jo aq të këndshme që i sjell jeta. Ti pastaj e sheh se përrallat janë vërtetë vetëm përralla. Në fakt, ti e ke ditur këtë gjithmonë, por gjithmonë shpreson se me ty do të ndodhë ndryshe. Mendon se ti je tjetër, se partneri yt është tjetër... se ju jeni një përjashtim prej botës së tërë. Gjatë gjithë kësaj kohe gëzohesh, pikëllohesh, fyhesh, toleron, mirëkupton. Dhe vjen një ditë kur lodhesh… lodhesh shumë. Dhe mu atëherë kur mendon se ke afër vetes dikë që e njeh mirë dhe se do të të afrojë një ngushëllim, një fole të ngrohtë dhe buqetë fjalësh mirëkuptimi, se do të të thotë "mos ki dert, jam unë këtu për ty"... ti sheh me tmerr se edhe ai është lodhur nga ti. Edhe ai pret të njëjtin mirëkuptim. Ndërsa ti nuk e ke vullnetin për t'ia dhënë, sepse konsideron se ia ke dhënë gjithçka dhe se është koha jote për të marrë tani. Se ke dhënë mjaft. Ke vuajtur e duruar. Ke parë, çfarë nuk ke parë dhe nuk je verbuar. Dhe mendon se e meriton një respekt, dreqi e marrtë, të paktën një respekt, edhe në mos pastë dashuri…

- Të ka munguar ky respekt ty?

- E kisha në fillim, Jolanda, por atëherë nuk ishte ajo gjëja më e duhur për mua. Kisha nevojë për dashuri, pasion. Isha e re. Nuk doja ndjenja të shtira, të lyera me bojën e një respekti. Doja të isha qendra e botës për burrin tim, qendra, të bëjmë gjërat më të çmendura në botë. Por jo, ai kishte për mua vetëm respekt, asgjë më tepër.

- Po mirë, domethënë respekt paske pasur. Pse thua se gruaja meriton ta ketë pas vuajtjeve. Me sa shoh unë ti e ke pasur.

- Por nuk e kisha tani kur më duhej, Jolanda. Jo tani. Tash kur më duhej respekti e mirëkuptimi më shumë se kurrë, më mungonin. Bashkë me dashurinë. Nuk i kisha asnjërën në kohën e duhur.

Pastaj Besa i rrëfeu Jolandës shkurtimisht jetën e saj me Bujarin, aferën e tij me një tjetër, miqësinë me fqinjët, studimet e tij, dëshirën e saj për piano. Një herë përmendi Dorinën, por e kapërceu shpejt atë temë. I foli për Jetën, për Arbenin, Shpëtimin… dhe pastaj mori frymë thellë, u ndal pak dhe përsëri vendosi të fliste për bijën e saj. Për të gjitha rreth saj. Dukej se ia ndjente edhe aromën kah fliste për të. Qante dhe fliste, ndërsa Jolanda nuk e ndërpriste fare, sepse e dinte se Besa kishte nevojë për këtë zbrazje. Ajo kishte nevojë dhe Jolanda do të ishte aty për të. Në fund fare, Besa i foli për Diamantin dhe Mimozën, për brengën rreth saj, që nuk ishte mirë, siç i kishte thënë i biri. Se si ai, Diamanti, tani mendjen e kishte sa tek e shoqja, sa te prindërit që po jetonin të ndarë dhe, bash për këtë, po mendonte ta linin në mes misionin e të ktheheshin. Pastaj i tregoi se si kishte shkuar sot në shtëpi, se e kishte gjetur aty Shpëtimin e se ai tani ishte pronari i ri i saj. Me dy fjalë, ia tregoi edhe gjestin human të Bujarit dhe se ai gjendej tani në një klinikë jashtë vendit bashkë me babanë e Jetës.

- Me pak fjalë kjo ishte e tëra. Siç e sheh, jam një mal me halle, apo jo? - i tha Jolandës me një buzëqeshje të hidhur, ndërsa faqeve i rridhnin akoma lotët. Ndjehej e lodhur pas gjithë këtij rrëfimi, që kishte zgjatur më shumë se një orë.

- Ashtu si çdo krijesë tjetër me dy këmbë që sillet në këtë botë duke kërkuar kuptimin e jetës, - ia ktheu Jolanda dhe vazhdoi:- Ke vendosur tani se çfarë do të bësh me Bujarin? E ke menduar?

- Nuk e di, Jolanda. Nuk e di a është çasti i duhur për vendim. Nuk dua tani që për shkak të këtij veprimi të tij, të ndërmarr vendime të ngutshme. Nuk dua që për shkak të obligimit t'i afrohem pa qenë e sigurt se dua me shpirt t'i qëndroj pranë, e kupton?

- Me sa kuptova, as Bujari nuk e ka dashur këtë, apo jo? Nuk të ka treguar për mu për këtë, – tha Jolanda.- Të ka lënë të vendosësh atëherë kur ti ta mendosh më së miri, kur ta mendosh dhe ta ndjesh me zemër. Dhe ti duhet ta pyesësh mirë veten tënde, para se të marrësh këtë vendim.

Besa mbeti pak e shtangur. Jolanda kishte të drejtë, por kjo në vorbullën e emocioneve të larmishme nuk e kishte menduar më thellë.

- Po, ke të drejtë. Ndaj dhe kur më tha Shpëtimi se do të ishte mirë ta vizitoj në spital, nuk dita çfarë t'i përgjigjem. Akoma jam e shushatur, Jolanda. Jo vetëm nga ajo sjellja e tij në park, kur mendoi se kam një aferë me mikun tonë më të mirë, por në përgjithësi. Aty unë gjeta shkasin për të ikur. Mendova se u mbush kupa. Ndërsa tani, nuk jam e sigurt, ende nuk e di se çfarë ndjej. Nuk e di.

- Po pse nuk e mendon këtë, pse nuk e pyet veten? Mendon se ende nuk është koha?

- Nuk e di. Nuk e kam pyetur, ndoshta mu nga frika se çfarë përgjigje do të marr. Ndoshta nuk dua ta di.

- Frikohesh se do ta kuptosh përfundimisht se gjërat kanë mbaruar mes jush? Se ka ardhur fundi? Se nuk e do më?

- Jo. Frikohem nga zbulimi se e dua akoma.

Jolanda qeshi dhe ia hodhi krahun në supe.

- Eh, Besa, Besa. E di si mu ke dukur? Si një vajzë e re e dashuruar.

Qeshën bashkë. Pastaj Besa fshiu fytyrën dhe i tha:

- Jolanda, të faleminderit. Vërtetë kisha nevojë të zbraz shpirtin. Dhe gjeta tamam kohën e "duhur" – tha duke e theksuar me buzë të mbledhura fjalën e fundit

- Pse thua kështu? Nuk ka kohë të duhur për këtë. Thjesht vjen momenti dhe kaq.

- Paj, them ngaqë mora Jetën me vete për herë të parë. Sigurisht i kam munguar këtë kohë që kam qenë këtu, po mendoj tërë këto muaj. Dhe tani nuk më del boll, por vij dhe bëhem qaramane derisa ajo sigurisht po më kërkon ku jam.

- Po, po, ti veç mendo ashtu. Lum si ti! Pa eja pak e afrohu te dritarja, moj e gjorë…- i tha Jolanda duke qeshur me të madhe. Besa u afrua dhe përtej xhamit pa se si vajzat ishin kapur për dore rreth një bredhi, ndërsa Midi kërcente sa te njëra sa te tjera. Gajaseshin së qeshuri, teksa e hutonin macen që kishte fituar edhe një shoqe të re.

- Dhe ti çfarë ishe duke më thënë, më fal se harrova, mos po thoshe gjë se i mungoje Jetës? – vazhdoi Jolanda duke e shpotitur.

- Ndonjëherë minutat që neve na duken shekuj, për fëmijët janë veçse një pikë e përjetuar momenti, mjafton të jenë në shoqërinë e duhur.

Pastaj fytyra i mori një pamje serioze dhe vazhdoi:

- Sa mirë që harrojnë shpejt fëmijët, Jolanda. Jam e lumtur për këtë dhuratë që u ka bërë natyra fëmijëve. Kur e shoh Jetën dhe e mendoj se vetëm para pak kohe, ndoshta nuk është bërë edhe një vit, që trokiti si një shitëse e varfër në derën tonë. Jetonte në një kasolle të rrënuar me babanë të sëmurë, Arbenin… fliste për nënën e vdekur sikurse ajo të kishte faj për humbjen e saj. Dukej thuajse mbante gjithë telashet mbi shpinë. O Zot, Jolanda, por unë fare nuk e kam menduar se me ardhjen e Arbenit ata duhen përsëri të kthehen në atë kasolle! Sa e tmerrshme, duhet të bëjmë diçka! Nuk dua t'i prishet vogëlushes ky gëzim mu tani, kur e shoh se nuk dallon fare nga gjithë fëmijët e lumtur. Mund të japim pak disi. Oh, sa pak mund ta bëjë të lumtur një fëmijë!

- Pak thua? Po ju i keni falur jetën prindit të saj, i keni falur jetën edhe vetë Jetës. Tani e shoh prej kujt e kanë marrë vetinë e bamirësisë fëmijët tuaj.

- Po. Shpëtimi më tregoi se Bujari ka takuar një djalosh që e kishte dashur vajzën time. Ishin takuar te varri i saj. I kishte treguar diçka rreth një pune vullnetare që bënte Dorina në spital e për të cilën ne nuk dinim gjë. Por më tej Shpëtimi nuk dinte. Më tha se Bujari do m'i thoshte të gjitha kur të kthehet. Ajo ka qenë vërtetë me një shpirt shumë të ndjeshëm për gjithkënd.

- Por edhe Diamanti, apo jo? – tha Jolanda.- Me sa kuptova, ai paska shkuar të ndihmojë të sëmurët e të varfrit në Afrikë.

- E vërtetë. Më beso se nuk e kisha menduar në këtë mënyrë. E mendoja vetëm se dëshironte të largohej nga dhembja. Të faleminderit që më bëre ta shoh djalin tim edhe nga një kënd tjetër.

- Po ç'thua, Besa! Ty nuk të ka shpëtuar kjo gjë, jam e bindur. Unë vetëm ta përkujtova.

- Jo, Jolanda, ndonjëherë nëna nuk e sheh fëmijën si duhet, vetëm ngase është nënë. Nga brenga nuk ia sheh virtytet, nga dashuria nuk ia sheh të metat. Ti e di këtë më mirë se unë. E ke Arturin.

- Po,- tha Jolanda, – madje ndonjëherë edhe kur ia sheh ndonjë të metë, ia fal. Për shumë arsye.

- E çfarë arsye më e madhe të duhet nga vetë fakti se je nënë?

- Ka edhe arsye të tjera,- tha Jolanda mendueshëm dhe të dyja heshtën. Pastaj Jolanda e theu e para qetësinë: - E di, Besa, ka pasur raste që jam pyetur a thua pse i duhemi ne njerëzit Zotit? Ai i ka të gjitha, mundet të gjitha, krijon çfarë të dojë. Ç'i duhemi ne atij? Vetëm për t'i dhënë kokëçarje me brengat tona? Për të na dëgjuar lutjet tona çdo sekondë? Për të na dhuruar jetën, për të cilën i ankohemi pastaj tërë kohën? Çfarë i duhemi, a thua pse na ka krijuar kur nuk i duhemi ama bash asgjë.

- Dhe gjete ndonjë përgjigje për këtë? Më habite, e dashur mike, zakonisht njerëzit pyeten a na duhet neve Zoti apo jo. Por, pse i duhemi ne Zotit, këtë nuk e kisha dëgjuar, që të jem e sinqertë. Më trego pra, e gjete përgjigjen që kërkoje?

- Po, e gjeta. U mundova të gjykoj ashtu siç nuk kisha gjykuar kurrë. Dhe pastaj thashë: E çfarë na duhen neve fëmijët tanë? Pse i lindim? Pse i krijojmë? Na japin telashe si fëmijë, na sëmuren, na japin dhimbje, bëhen ashtu si duam apo si nuk duam, na lusin, nuk na lusin, na pëlqen çfarë bëjnë, ndonjë herë nuk na pëlqen. Na mundojnë, nuk na dëgjojnë, na lënë pa gjumë... por ne i duam gjithsesi, i duam pa kushte. I krijojmë, i lindim, i rrisim. I ndihmojmë të bëhen njerëz. Ne jemi aty vetëm për t'i përkrahur e për t'ua treguar udhën e duhur. Sepse janë fëmijët tanë. A nuk është pra kështu edhe me Zotin? I duhemi sepse jemi fëmijët e tij.

- Kjo është gjëja më e bukur që kam dëgjuar, Jolanda.

- Të faleminderit. Por ti kthehemi tani përsëri punës tënde me Bujarin. Do të shkosh ta vizitosh në klinikë, siç e kishte menduar ai miku juaj, Shpëtimi?

- Nuk e di, vërtetë nuk e di. Më shumë jo. Sonte duhet ta lajmëroj edhe Diamantin. Ai nuk di gjë. Ndonjëherë me duket thuajse jemi pjesë të një filmi, ku çdo gjë është nën tension tërë kohën.

- Me rëndësi është që filmi të ketë fundin e lumtur, Besa. Po ti mendoje edhe pak. Ndoshta brenda teje mund ta gjesh arsyen e duhur për të shkuar. Unë po dal për pak të shoh vajzat. Më vonë, pasi ato të flenë, mund të bisedojmë sërish. Kam edhe diçka për të të thënë.

- Mirë. Po vij edhe unë me ty, – tha Besa dhe dolën të dyja në kopsht.

Vajzat ishin ende duke luajtur dhe zërat e tyre dëgjoheshin nga larg. Ishin thuajse moshatare dhe dukeshin si binjake. Kishin gjetur njëra-tjetrën.

Jolanda u bashkëngjit në lojën e tyre dhe Besës i dukej tashti edhe ajo si një fëmijë. "Epo tekefundit çfarë është jeta përveçse një fëmijëri e zgjatur?- mendoi Besa.- Ne të gjithë brenda vetes kemi të fshehur një fëmijë të frikësuar nga mosha jonë, nga përgjegjësitë që bartim pa qenë të gatshëm për to" mendoi.

Ndërsa vajzat po luanin, tashti e bërë me to edhe Jolanda, Besa shkoi në kuzhinë dhe përgatiti ca petulla të ngrohta, nga ato që i bënte gjithnjë për Dorinën. Dukej më e qetë tani, arriti të bënte edhe ca ëmbëlsira dhe nuk ndjente lodhje me gjithë ditën e ngarkuar me emocione.

- Teta Besa, teta Besa!, – u dëgjuan cicërimat e vajzave që vraponin brenda shtëpisë të mbushura frymë. - Ua, teta Besa, sa aromë e mirë! Uh, teta Besa, deshëm të të pyesim diçka… Prit, na jep nga një petull… -flisnin të dyja duke ndërprerë njëra-tjetrën të mbushura frymë dhe me fytyra të skuqura nga loja.

- Ngadalë, ngadalë, me rend. Çfarë do më pyesni?

- Po ja, - nisi Jeta…- deshëm… deshëm… nëse ty s'të vjen keq… që unë….

- Duam që Jeta të flejë sonte në dhomën time, bashkë me mua,- e plotësoi Hera, ndërsa Jeta shikonte sa andej-këndej, nga frika se mund e hidhëronte zemrën e tetës së saj të dashur.

- Ashtu, e? Sapo e njohe Herën, mua më harrove fare, e?

- Oh jo, jo…- iu var në qafë Jeta.- Unë ty të dua shumë, por dua të fle me Herën sepse, sepse….

- Sepse jeni shoqe kollomoqe, apo jo? – u tha Besa duke qeshur dhe ua shkuli nga pak faqet të dyja vogëlusheve që fluturuan nga gëzimi.- Po hajde tani, lani duart të hamë.

Derisa po bënte gati tavolinën, iu kujtua Dorina kur e shpotiste, kur i thoshte se ka dilemë për petullat, t'i hante me mjaltë apo me reçel. Iu kujtua fytyra e saj e hareshme kah ia nxirrte gjuhën. Dhe për një moment qeshi me gjithë lotët që i ishin grumbulluar në sy.

"Eh, bija ime... do të mbetesh përgjithnjë fëmijë i hareshëm në kujtimet e mia, më mungon shumë, shumë".

XXII

Vajzat kishte kohë që po flinin. Besa ishte tashmë e qetë. Nuk e merrte gjumi, ndaj duke menduar se edhe Jolanda mund të kishte fjetur, doli në sallonin e madh ku rrinin dhe hapi televizorin. Ora kishte kaluar një pas mesnate. Në program po jepnin një film serial të mërzitshëm, por Besa nuk e kishte fare mendjen aty, ndonëse ia kishte ngulur sytë ekranit. Koka i ziente nga mendimet.

Çfarë të bënte me Bujarin? Të shkonte tek ai? Si do ta priste? Çfarë nëse ai nuk e dëshironte një gjë të tillë? Pastaj, nëse shkonte, çfarë kuptimi kishte kjo? Çfarë mesazhi do t'i jepte atij? Se tanimë ishin miq të mirë? Apo se do të kthehej si gruaja e tij? Besa u rrënqeth deri në vesh nga ky mendim, por nuk e dinte se nga ndjenja e mirë që i erdhi si grua e Bujarit, apo nga frika për të qenë sërish me të.

- Nuk po fle? – dëgjoi zërin e Jolandës që po i afrohej me një tufë letrash në dorë. Besa e pa. Dukej e lodhur dhe e plakur, më shumë se zakonisht.

- Jo,- iu përgjigj mikes së saj,- nuk më zë gjumi. Mendova se ti kishe fjetur. Dola pak këndej që të mund t'i rregulloj mendimet, t'i organizoj më mirë. Ndihem jashtë vetes, Jolanda. Sikur trupi im është një kuti që përmban ato pjesëzat e fotografisë që duhet formuar, e kupton? Si ato lojërat enigmë, që vetëm pasi të kesh vënë në vendin e vet pjesëzën e fundit, atëherë të shfaqet para syve figura.

- Po. Hera ka shumë të tilla. I ndihmoj shpesh për t'i vënë në vendet e duhura. Në të vërtetë është loja jonë e preferuar.

- E pra. Ndjej se jam një grusht me të tilla pjesëza. Dhe secila prej tyre përmban ose një emocion ose një mendim, tjetra një veprim, problem, vendim, dhembje, pikëllim. Ndjehem shumë e hutuar, shumë e paaftë për ta vënë secilën pjesë në vendin e duhur.

- E kuptoj. Por e di çfarë?

- Çfarë?

- Ndoshta nuk duhet të lodhesh shumë për të kërkuar se cila është më e mira për ta filluar. Thjesht vëre të parën. Pastaj të tjerat do t'i përshtaten. Do të lidhen se s'bën njëra me tjetrën. Kështu funksionon jeta.

- Ke të drejtë. Po unë nuk e di çfarë të bëj, Jolanda. Më duhet një shtytje, një këshillë. Nuk iu lajmërova as Diamantit, e lashë për nesër, pse e dija se edhe ai do më pyeste se çfarë kam ndërmend të bëj.

- Nuk ka zgjidhje që të bie në kokë sikur molla ose dardha e atyre fizikanëve, mikja ime.

Të dyja qeshën. Besa e admironte prirjen për humor të hollë të Jolandës.

- Molla ose dardha të bie mu në tepe të kresë, po ty s'të vjen asgjë e mençur në mendje. Pos faktit se po të dhemb koka. Këtu është dallimi.

Qeshën përsëri dhe pastaj Jolanda zbrazi dy duart mbi tavolinë. Aty ranë shumë zarfe të zverdhura nga koha. Besa i pa një herë letrat, pastaj Jolandën dhe priste e heshtur se çfarë do t'i thoshte ajo.

- Sonte më thirri Arturi,- filloi Jolanda ngadalë sikur donte të niste një histori.- Ai më thërret shpesh, por edhe gruaja e tij. Jam shumë e lumtur që i kam, e që më kanë dhuruar edhe Herën. Por, sa herë i dëgjoj zërin Arturit, sa herë e shoh… më kujton babanë e tij. Arturi është kopja e tij. Në pamje dhe në karakter.

- Ka vdekur burri juaj?

- Ka vdekur. Kaherë. Më duket thuajse ka kaluar një shekull prej asokohe. Por... nuk ka qenë burri im. Nuk arriti të ishte.

Besa hapi sytë, por nuk tha gjë. E la Jolandën të vazhdojë.

- Kur isha shumë e re, ndoshta shtatëmbëdhjetëvjeçare, shkova për të parë një shfaqje në teatër. Shkoja për herë të parë. Më impresionuan dritat e teatrit, loja e aktorëve. Më pëlqeu gjithçka. Atë natë e vendosa brenda vetes: do të bëhesha aktore! Të nesërmen ia thashë mendimin prindërve të mi, por ata u hodhën përpjetë. Babai më mbylli në dhomë dhe më mbajti një ligjëratë të gjatë. I quante aktoret e teatrit si gra të paturpshme, 'vajza të dala nga defteri', thoshte. Për mua, që rridhja nga një familje e nderuar dhe e kamur, sipas babait profesioni i aktrimit ishte skandali më i madh që mund të bëja. Por unë isha e vendosur. Fillova të shkoj fshehurazi në teatër, fillimisht si shikuese, e më vonë fillova njohjet e para me aktorët. Ishin të njohur me situatën time, ndaj e dinin se nuk guxoj të aktroj në shfaqjet që realizonin. Por më ftonin që të shijoj provat e tyre, të shuaj etjen për aktrim së paku atëherë kur nuk kishte publik në sallë. Ai që më ndihmonte më së shumti ishte një djalosh diku njëzet e tre vjeç, që vinte nga shtresa punëtore. Në atë kohë kjo shtresë shihej me përbuzje, pse ishte e vobektë.

- Kam frikë se ashtu shihet edhe tani, – tha Besa duke menduar instinktivisht në Arbenin.

- Eh, ke të drejtë, gjërat nuk kanë ndryshuar edhe aq, por kjo është temë tjetër…- tha Jolanda dhe sikur mendoi pak e pastaj vazhdoi:- Pra, nisëm të dashuroheshim fshehtas, zemra ime kishte filluar të njihte rrahjet e para të dashurisë. Filluam të mendonim jetën tonë, familjen. Nuk e di si ndodhi, por babai e kishte zbuluar dashurinë tonë. Një ditë, kur u ktheva në shtëpi më priti si i tërbuar. Nëna nuk guxonte të thoshte asnjë fjalë, por edhe ishte në anën e tij. Babai ma flakareshi aq shumë fytyrës, sa që u rrëzova përdhe. Më quajti mosmirënjohëse, të pafytyrë. Vajzë që po luante me nderin e familjes. Isha e dërrmuar, por edhe e frikësuar njëkohësisht. Babai im ishte njeri i ashpër, i vrazhdë, ndonëse bota e njihnin si njeri të butë e të sjellshëm.

- Ndoshta edhe kohërat kanë qenë të tilla, – tha Besa

- Ndoshta.

- Po çfarë ndodhi pastaj?

- Më mbyllën në shtëpi. Por a mbyllet dashuria në kafaz? I riu nuk njeh frikën ashtu si vetë dashuria. Kështu edhe unë lidha miqësi më të fortë me shërbyesen që punonte te ne. I jepja edhe ndonjë monedhë që të më sillte letrat e aktorit tim dhe atij t'ia dërgonte të miat. Kaloi një kohë dhe prindërit e mi menduan se e kisha harruar tanimë dashurinë time, apo dashuriçkën, siç e quanin ata, dhe filluan nga pak të më lëshonin jashtë, por gjithmonë në shoqëri të shërbyeses. Kështu unë fillova ta takoj përsëri njeriun tim të vetëm që më ofronte dashuri, ndërsa shërbyesja na bënte roje derisa unë rrija në banesën e tij të varfër me qira. Ai nuk ishte as nga qyteti. Pas disa muajve fillova te ndjehem çuditshëm. Isha shumë naive dhe ia thashë nënës sime. Ajo dyshoi menjëherë dhe më çoi fshehurazi te një mjek në qytetin tjetër. Doli se isha shtatzënë. Jolanda mori frymë thellë dhe u ndal për ca çaste, thuajse po përgatitej për të treguar për stuhinë më të hidhur që kishte pasuar:

- Nëna ime zuri kokën dhe me t'u kthyer në shtëpi i tregoi babait. Mund ta marrësh me mend tërbimin e tij. Përveç shuplakave të tjera, më quajti të përdalë, të fëlliqur…

Unë qaja sepse me naivitetin tim e kisha menduar se ata do të zbuteshin me ta kuptuar se do bëheshin me një mbesë ose nip, por nga sjellja e tyre e ashpër kuptova se , kjo as që iu shkonte ndërmend. Bija e tyre i kishte turpëruar dhe duhej mbuluar ky turp sa më shpejt e sa më mirë. Për fatin tim, shtatzënia kishte një kohë të mirë që kishte ndodhur, ndaj dhe aborti nuk mund të bëhej. Pasi e shoshitën gjerë e gjatë, prindërit e mi, kundër dëshirës sime, më dërguan larg te një kushërirë e babait tim. Ajo nuk dallonte shumë nga im atë, ishte grua e pashpirt. Nuk linte vend a kuvend pa ma përkujtuar se kisha bërë diçka të pandershme, se ishte gjynah buka që po ma jepnin. Kishin bërë një marrëveshje me prindërit e mi, që posa të lindja, të ma dërgonin fëmijën në jetimore. Për fat të mirë e kuptova këtë nga bija e kushërirës, e cila ishte vajzë e mirë dhe kishte po ashtu një histori të dhembshme dashurie, ndaj më kuptonte. Pak para lindjes, ika. Dola natën dhe ika.

- Ku shkove?- e pyeti Besa. Jolanda me historinë e saj jetësore kishte bërë që Besa, për herë të parë pas shumë kohësh ta harronte të sajën.

- Kah më çuan këmbët. Në fillim u fsheha në një kishë. Më strehuan derisa linda. Arturin.

Besa kishte kapur gojën me duar. I dukej se po ta lëshonte dorën, do t'i dilte një bërtimë e madhe.

- Po me babanë e Arturit çfarë ndodhi? – pyeti dikur, si e përmblodhi veten.

- Ai kishte vazhduar të më dërgonte letra. Këto letra që po i sheh këtu janë një pjesë e tyre. Nëna ime nuk m'i kishte dhënë, por edhe nuk i kishte hedhur. I kishte fshehur, kushedi pse. Mua më kishin kërcënuar, m'u kishin betuar se po ta takoja edhe vetëm një herë me dashurinë time të jetës, do ta vrisnin. Isha shumë e frikësuar. Babai im ishte njeri me influencë dhe mund të bënte gjithçka.

- Po pastaj, kur ike, pse nuk e kërkove?

- Një kohë qëndrova e fshehur, një herë nga frika se do ma merrnin Arturin, por edhe nga frika se çfarë do të bënin me mua. Më vonë fillova ta kërkoj. Vishesha me rroba të vjetra për të mos më njohur askush, ndërsa pas shumë kohësh shkova te banesa e tij e varfër ku banonte. Ata që gjeta aty nuk dinin asgjë për të. Atëherë shkova në teatër, në shtëpinë e tij të dytë. Dhe aty… aty u përballa me të vërtetën e tmerrshme.

- E kishin vrarë? – pyeti Besa e shqetësuar.

- Jo. Por i vdekur ishte. Askush nuk e dinte se si e pse kishte vdekur. Dikush thoshte nga tuberkulozi, dikush se kishte vrarë veten. Por miku i tij më tha se në të vërtetë ai kishte vdekur nga dashuria e humbur. Ndjeva se m'u shqye shpirti, Besa. M'u shqye shpirti dhe nga unë dolën të gjitha bishat e fjetura brenda, të gatshme për të shqyer botën e poshtër, botën hipokrite… botën e mallkuar që jeton veç për botën, për surratin, jo për ndjenjat… Ehhh!- shfryu nga brenda shpirtit Jolanda. Nisën t'i rridhnin lotët, thuajse po e përjetonte sërish atë çast aq të rëndë të jetës.

- Ndoshta dëshiron të vazhdosh ndonjë herë tjetër? – i tha butësisht Besa, kur e pa sa e trishtuar ishte.

- Jo, jo,– e mblodhi veten Jolanda dhe vazhdoi:- Atë ditë u betova se nuk do të martohem kurrë. E pse ta bëja? Të mundohesha sërish të krijoj një jetë tjetër me copëzat e asaj së kaluarës? Jo, nuk mund ta bëja. Më jepte shumë dhembje.

- Çfarë bëre pastaj?

- Nuk e di. Por e di se ndihesha tjetër. E fortë. Ndryshe. Thuajse nuk mund të më bënte askush asgjë. Nuk ndjeja më frikë. Edhe prindërit e mi më dukeshin të vegjël, të vegjël fare. U punësova në teatër. Me kohë arrita të bëhem aktore e njohur.

- Po. Kam dëgjuar shpesh të flitet për ty. Bile më kujtohet që kam lexuar diku edhe për jetën tënde, por asgjë nga këto që më tregove tani, - tha Besa.

- Eh, e dashur, biografitë publike janë përralla me vegsh. Por nejse, kështu funksionojnë ca gjëra në këtë botë me shumë fytyra. Funksionojnë me pafytyrësi.

- Po.

- Kaluan shumë vite dhe Arturi po rritej. Nuk fitoja shumë para me punën time, por më mjaftonin për të jetuar e për të rritur e shkolluar tim bir. Isha e lumtur. Pa dashurinë time të jetës, por e lumtur, ngaqë kisha pjesën e tij, Arturin, birin tonë. E shihja përditë të rritej dhe kjo më jepte forcë më tepër.

Për habinë time, një ditë filluan të më vijnë letra nga prindërit, tashmë të plakur. Më ftonin t'i vizitoja, kërkonin ta shihnin nipin. Jam e bindur se i ka shkruar nëna në emër të të dyve, meqë babait vështirë t'i ishte zbutur zemra. Por edhe zemra ime ishte bërë gur tashmë. Letrat e tyre i flakja në zjarr. Pastaj më njoftuan se më vdiq babai. Kishte kërkuar të më thërrisnin, donte të më kërkonte falje. Nuk shkova. Provova të ndjej diçka, së paku ngaqë e kisha pasur baba. Kot. Nuk ndjeja asgjë. Nuk shkova as në varrim. Nuk mund ta falja, ishte shumë e dhembshme për mua.

- E kuptoj. Si dashuria, si urrejtja, japin dhembje,- tha Besa.

- Po. Vazhdova me jetën time deri sa një ditë, kur po dilja nga provat, pashë se te shkallët më priste një grua. Kishte kokën të mbuluar me shall, nuk mund t'ia shihja mirë fytyrën. I kalova përskaj dhe kur po largohesha ndjeva se e thirri emrin tim. M'u ngjeth mishi. Ishte nëna ime.

- U ktheve?

- U ktheva. E shikova e heshtur, pa fjalë. Ishte plakur shumë, mezi mbahej në këmbë. Për habinë time fillova të ndjej dhimbsuri për të, megjithëse e luftoja atë ndjenjë, e luftoja me shpirt. Por më dhimbsej, ashtu si të dhimbset një qenie njerëzore, jo si nënë.

- Çfarë të tha? - e pyeti Besa

- Qante. Mezi fliste nga lotët. Kërkonte të kthehesha në shtëpi. Ishte e sëmurë. Donte ta shihte nipin e saj, Arturin, mu atë nipin që donin ta jepnin në jetimore, që e quanin kopil, bastard, e kupton? Mu atë. -Jolanda bënte pyetjen pa pritur ndonjë përgjigje.Sikurse donte ta bindte Besën se vërtetë ishte ashtu dhe vetëm ashtu. Dukej thuajse brenda saj ende kishin mbetur gjurmë të mllefit të dikurshëm që nuk falej.

- Ehh,- lëshoi Besa një pasthirrmë dhembjeje. - Pranove t'i takosh gjyshe e nip?

- Kurrsesi. E dëgjova tek fliste dhe kuptova se para vetes kam një njeri të panjohur. Të panjohur fare. Ngaqë ajo nuk kishte provuar të më njihte, më kishte larguar pa më njohur dhe nuk më kishte dhënë shansin ta njoh. Për mua ishte e huaj. E dëgjova pa ia thënë asnjë fjalë. Tha se e ndjente se do të vdiste shpejt, se donte ta falja, se donte t'ia linte shtëpinë nipit. Por mua nuk më bënte përshtypje, fare, fare. U largova përsëri pa fjalë. Më luste t'i thosha ndonjë gjë, vetëm një fjalë… por nuk ia thashë. Doja të vuante, doja të ndjente dhimbje sikur unë.

- Ndryshove mendje pastaj? – pyeti Besa sërish.

- Unë nuk do ta ndryshoja kurrë. Por ma ndryshoi biri im. Ishte afro dhjetëvjeçar, sa Hera sot. I tregova se ka një gjyshe, e cila dëshiron ta shohë, por se nuk kishte qenë aq e mirë me mua. Nuk i tregova se nuk e kishin dashur, nuk doja t'ia ngulisja në kokë ndjenjën se ka qenë i padëshiruar nga ata. Por i thashë se nuk mund t'ia falja ca gabime dhe kaq.

- Çfarë të tha yt bir?

- Më tha mençurinë e botës fëmijërore të pafajshme. Tha: "Mami, po unë kur gaboj pse ti më fal gjithnjë?".

- Sepse të kam fëmijë, iu përgjigja.

"Po gjyshen kush do ta fali? A e ka ajo mamin e vet që t'ia falë gabimet?" – më pyeti.

- Jo, nuk e ka- i thashë.

"Atëherë falja ti", më tha. Po qe se edhe ti gabon ndonjë herë, unë do të të fal gjithmonë",- tha sërish. Këtu Jolandës iu drodh zëri.

- Mendova gjatë, e mora djalin për dore dhe shkova. Shkova në shtëpinë e saj. Nëna ishte e shtrirë, por u mundua të ngrihej. E përqafonte Arturin, por edhe ai atë. Unë mundohesha të qëndroja pak më larg, ndonëse zemrën e kisha të dërrmuar. Pse, o Zot, pse? Pse gjithë këto dhimbje vetëm për shkak të paragjykimeve të mykura të shoqërisë, që kërkojmë symbyllazi t'u përshtatemi, ndërsa jemi vetëm qenie të dobëta njerëzore?

- Qëndruat gjatë?- pyeti Besa me padurim.

- Nuk e di. Por kur do të iknim, nëna ime më tha të kërkoja tek arka e saj. Më tha se do të gjeja aty thesarin tim. Gjeta letrat. I mora pa fjalë dhe shkuam bashkë me tim bir. Nuk i kërkova as sqarime, as arsyetime. Ishin të kota, të kaluara. I kam lexuar e rilexuar shumë herë ato letra. Lexoja mes rreshtave, i ktheja për së mbari e për së prapthi, a thua se në çdo lexim mos gjeja diçka të re. Më dukej se prej tyre buronte energji, dashuri, gjithçka që më jepte forcë.

- U pajtuat pastaj?

- E di që kam ndryshuar prej asaj dite. Së paku kam provuar t'i shoh gjërat ndryshe. Për hir të birit tim, pastaj dashurisë sime të vdekur, vetë jetës sime. Nëna më tha se kishte gabuar ngase ka menduar se kështu do të ishte nënë e mirë. Ngaqë ka menduar se ka bërë veprimin e duhur për të më ruajtur nga të këqijat e botës. Por që më vonë e ka kuptuar se ka gabuar dhe se ka dështuar. Ashtu siç gabojnë të gjitha qeniet njerëzore, Besa. Si unë, si ti, si Bujari yt. Nuk ka personazhe negative e pozitive në botë, mikja ime, nuk ka. Të gjithë njerëzit, në rrethana të caktuara, veprojnë si të mirë ose si të këqij. Është vështirë të shihet kjo.

- Shumë e vështirë,- tha Besa.

- Të gjithë gabojmë, por të falësh është gjëja më humane, më bujare në botë. T'ia falësh tjetrit ashtu si do të dëshiroje të të falnin edhe ty. T'i bësh demonët e tu të largohen, meqë ndihen rehat afër shpirtit tënd të trazuar.

- Ti thua t'ia fal Bujarit, këtë dëshiron të ma thuash, Jolanda?

- Bujari është pjesë e Dorinës, ashtu sikur Arturi im ishte pjesë e dashurisë sime. Nuk po flas si pjesë trupi, nuk po flas si copa biologjike. Janë pjesë të dashurisë, të kujtimeve të përbashkëta. Dorina jeton në ju të dy, e kupton? Unë humba dashurinë e jetës, por gjeta vetveten, Arturin, tekefundit gjeta edhe nënën. Arrita ta njoh para vdekjes së saj me gjithë të metat e dobësitë. Mallkova veten se kisha lejuar të bëhem pre e paragjykimeve, sedrës së lënduar. Ndoshta duke mos njohur të metat e nënës sime, do t'i përsërisja tek Arturi. Kështu më ndihmoi të jem nënë më e mirë, por edhe njeri më i mirë. Bujari është pjesë e jetës tënde, dashuria e jetës tënde. E kush tha se ajo duhet të jetë e përsosur? Respekt, emocione, përkujdesje…të gjitha pjesë të jetës së përbashkët janë. Janë dashuri të gjitha. Dhe njeriu mund ta gjejë e ta gjejë rishtazi dashurinë. Ajo vjen e shkon si rrezet e ngrohta që shpërthejnë retë e qiellit për të ikur sërish. Puna është t'i kapësh në çast, të lejosh të të ngrohin shpirtin sërish, të çajnë akullin. Sepse po i humbe përsëri atëherë kur i ke rigjetur, mund të të mbesë shpirti i ngrirë përgjithmonë.

- Ti i ke rigjetur?

- Po. Dikush mund të thotë se nuk jetohet me kujtimet, por unë jam pjesë e tyre, po ashtu edhe babai i Arturit, gjyshi i Herës. Ai më dërgon dashuri përmes tyre. Po deshe të ndjesh dashuri sërish, duhet ta zbrazësh zemrën nga mllefi, zemërimi dhe urrejtja. Bashkë nuk ka vend për to. Zemra është e vogël për të gjitha. Duhet t'i thuash lamtumirë edhe pikëllimit, e dashur. Duhet ta lësh edhe njeriun e dashur e të humbur të shkojë i lirë në botën e përtejme. Nuk mund ta mbash të lidhur me zinxhirë… nuk mundesh… lejoje të shkojë i lirë dhe njëkohësisht liro zemrën tënde.

Gratë heshtën për pak kohë. Besa ngriti kokën dhe pa orën. Ishte afër agut. Ndjehej e lodhur ashtu siç ndjehet sportisti në maratonën më të gjatë e të lodhshme, por i gëzuar se po arrinte cakun. Befas ngriti kokën dhe tha:

- Jolanda, mund të të pyes diçka?

- Po. Thuaje lirisht.

- Dëshiron të shkojmë nesër bashkë në varreza? Më duket se kemi nevojë ta bëjmë këtë.

Jolanda buzëqeshi.

- Po, e dashur, patjetër. Do të shkojmë. Ishte koha.

XXIII

Bujari hapi sytë. Iu duk se kishte fjetur një vit të tërë. Ndjehej shumë më mirë fizikisht, po edhe shpirtërisht. Gjithsesi mendja i shkoi menjëherë te njerëzit e tij të shpirtit. Mendoi se, edhe pse kishte kaluar kohë nga operimi, nuk kishte marrë asnjë lajm nga Besa e nga Diamanti.

"Por, natyrisht,- ngushëllonte veten,- ata nuk e dinë. Unë vetë nuk kam dashur që ta dinin".

Edhe Arbeni ndihej shumë më mirë. Fakti që ai më nuk bënte dializë, kishte ndikuar që organizmi i tij të çlodhej. Tani, me kërkesën e tyre të përbashkët, i kishin vendosur në të njëjtën dhomë, kështu kishin kohë të bisedonin dhe njëkohësisht t'ia hiqnin mërzinë e spitalit njëri-tjetrit. Klinika kishte edhe një kopsht të madh plot gjelbërim dhe ndonjëherë bënin aty shëtitje të shkurtra bashkë, aq sa ua lejonte mjeku.

- U zgjove, Bujar? – dëgjoi zërin e shokut të tij të dhomës.

- Po. Mirëmëngjesi. Si fjete mbrëmë, Arben?

- Oh, Bujar, kam parë një ëndërr të tmerrshme. Ende jam paksa nën ndikimin e saj. Më duket se edhe kam qarë natën, – fliste Arbeni ngadalë e akoma i trishtuar.

- Epo ëndërr është, mos u preokupo dhe aq. Unë për vete nuk ua var fare, sepse pastaj të marrin gjysmën e ditës duke i deshifruar. Nuk janë asgjë, veçse një farë përmbledhjeje e përjetimeve, e veprimeve, dëshirave dhe ndjenjave tona. Por, nuk e besoj se mund të parashikojnë ndonjë gjë.

- Ashtu është,- i tha Arbeni, - por unë nuk po mërzitem për ndonjë parashikim të ëndrrës. Pashë sikur isha ende i sëmurë rëndë, në terrin e kasolles sime. Sikur dihej se do vdisja brenda disa ditësh. Afër meje qëndronte gruaja ime e vdekur tashmë, e veshur e tëra në të bardha dhe më mbante ballin. Kërkoja me sy Jetën, derisa e pashë që ishte fshehur pas derës me shpinën e kthyer kah unë. Desha t'i thërras, por nofullat më ishin bashkuar aq fort, sa që çdo shtrëngim më jepte dhimbje të mëdha, madje ndjeja sikur më copëtoheshin dhëmbët. Gruaja më buzëqeshte, por, edhe pse e dija se ishte gruaja ime, e ndjeja disi si të huaj. Edhe ajo rrinte diçka larg, disi sikur më jepte kurajë që po vdisja. As qante, as fliste… kishte një shprehje pa emocione. Doja t'i thosha që të kujdeset për Jetën pasi të vdes, por ajo më shikonte disi sikur donte të më thoshte se, do të donte por s'mundej. Se kishte për të shkuar diku. Në atë moment u hap dera e kasolles sonë dhe u futën brenda ca njerëz. Thanë se Jetën do ta dërgonin në jetimore. Unë qaja, por ata sikur nuk e shihnin këtë, as më dëgjonin, as më shihnin.

“Unë nuk kam vdekur akoma, bërtisja, ma lini vajzën”, por ata vazhdonin punën e tyre dhe e hiqnin zvarrë. Jeta më pa me keqardhje, por nuk tha gjë. Kur dolën jashtë e kapa fustanin e bardhë të gruas por ai disi u shndërrua në një farë pallto fëmije. Marr pallton dhe kujtohem e kujt është. Më bie ndërmend se kësi pallto ka pasur një nxënës i imi i varfër kur isha arsimtar.

- Vërtetë e kishte ai nxënës apo vetëm në ëndërr? – e pyeti Bujari.

- Po, po e kishte vërtetë, vërtetë… por tani e kam harruar punën e tij nga gjithë këto halle që kam pasur. Por ai nxënës është diku, një Zot e di, ndoshta e ka braktisur shkollën sikur Jeta ime një kohë. Kur të shërohem plotësisht, do ta kërkoj.

- Patjetër ta kërkosh. Po si përfundoi ëndrra?

- E mora pallton dhe e vesha. E dija se jam një burrë me fëmijë, por prapë disi ndihesha si fëmijë, sikur prapë isha fëmijë. E dija se jam i sëmurë, se po vdes, por përsëri ndjeja një forcë, një dëshirë për ta gjetur Jetën.

- Dhe siç e sheh jetën e ke gjetur,- i tha Bujari duke buzëqeshur.

- Jetën ma falët ju. Vërtetë nuk besoja se në botë ka akoma njerëz të mirë sikur ju.

Bujari ofshau thellë.

- Të gjithë njerëzit janë vetëm njerëz. Pos se reagojnë ndryshëm në situata të ndryshme, Arben.

- Bujar…- vazhdoi Arbeni,- seç ndjej mall për Jetën, vajzën time. Ajo është gjithçka që kam. E di se sigurisht ju dukem egoist, se duhet të mendoj se sa me fat që jam që gjendem tash në këtë spital, për të cilin unë kam mundur vetëm ta ëndërroj. Por, përsëri ndjej mall deri në dhimbje për të. Po numëroj ditët deri sa ta shoh sërish.

- E kuptoj,- tha Bujari. – Por ti ke fatin që do ta shohësh së shpejti tët bijë, Arben. Unë bijën time nuk do ta shoh më kurrë. Megjithatë, e di se duket e palogjikshme, por asnjë herë nuk e kam parë më mirë se pas vdekjes së saj. Ajo më ka udhëzuar, madje edhe për veprimin që kam marrë me ty.

- Do të dëshiroja ta vizitojmë varrin e saj, Bujar, së bashku, kur të kthehemi.

- Gjithsesi.

- Thonë se njeriu vdes atëherë kur e harrojnë të gjithë. Vajza juaj do të mbetet e gjallë, për sa kohë që kujtimi i saj do të vazhdojë të jetë në zemrat tuaja. Që do të thotë përgjithmonë.

- E vërtetë. Të lumtë goja, mik i dashur.

- Kur mendoja se po vdisja, Bujar, nuk më dhimbsej fare jeta ime. Ajo ishte e shkatërruar me të gjitha. I papunë, i sëmurë, i varfër. Por kisha brengë të madhe për Jetën, çfarë do të bëhej me time bijë? Ku do të shkonte, kush do të kujdesej për të? Mundohesha ta imagjinoj fytyrën e saj kur të rritet, së paku ta shihja në mendjen time, meqë nuk besoja ta shihja vërtetë të rritur. Një ditë u luta gjatë në qetësi. Thashë: më hap një dritare, o Zot! Mi mbyll të gjitha dyert e mia, por më hap një dritare për Jetën. Së paku të vdes i qetë…- këtu Arbeni fshiu lotët.- Se edhe vdekjet po dallojnë, Bujar. Ndryshe vdes ai që e ka zemrën plot dhe të qetë.

- Ke të drejtë,– tha Bujari

- Duket se m’u dëgjuan lutjet. Nuk shkoi shumë ditë dhe Jeta kishte hasur në derën tuaj. Kur më tregoi atë ditë, paksa u frikësova. Kush ishin këta njerëz, pse po vinin? Nuk më shkonte ndërmend se ju po më sillnit në shuplakat tuaja ditët e mia të mira.

Bujari buzëqeshi dhembshëm, sikur kujton njeriu disi një ngjarje të largët me nostalgji.Sepse në atë kohë kishte Besën afër.

Dy burrat heshtën dhe secili ra në mendimet e veta. Dukej thuajse fjetën përsëri. Në dhomë kishte hyrë lazdrueshëm rrezja e diellit, që po lozte me perdet, ndërsa ndalej herë pas here në sytë e Arbenit dhe i jepte shkëlqim gjurmëve të lotit që i kishte mbetur nën qepallat e poshtme.

Kushedi edhe sa do te zgjaste kjo qetësi, sikur të mos cingëronte telefoni te koka e Bujarit. Ky e ngriti me një farë dileme receptorin, i bindur se thirrja do të ishte për dikë tjetër, madje për ato pak sekonda vriste mendjen si do ia bënte t'i thërriste këtej.

- Alo, – u përgjigj duke u hamendur.

- Baba! – dëgjoi në anën tjetër dhe Bujarit iu duk se ishte në ëndërr.

- Baba! A je ti? – dëgjoi sërish zërin e Diamantit dhe mu atëherë kur po bëhej gati të përgjigjej, ndjeu se lotët iu grumbulluan në sy sikur pikat e sapodala nga burimi, duke formuar kështu një lum të rrëmbyeshëm, që ia zuri grykën. I dukej se po të nxirrte vetëm edhe një tingull të vetëm, lumi do të shpërthente sikur të kishte çarë pendën.

- Ju lutem, a mund të flas pak me zotin Bujar Spahiu, është babai im,- foli Diamanti, duke menduar se mund të ishte paraqitur dikush tjetër në telefon.

- Diamant…- pëshpëriti Bujari, ndërsa lotët i rridhnin faqeve.

- Baba, ti je, po pse nuk flet? Baba, a je mirë? Zot i madh, sa jam i brengosur…

- Mirë jam, Diamant. Jam shumë i emocionuar që të dëgjova zërin, prandaj. Më fal, bir… më ke munguar shumë. Po ku e dite ti se unë jam këtu?

- Baba nuk po e zgjas më tej sepse këtu ka zhurmë, nuk po të dëgjoj mirë. Unë jam nisur për te ti. Tashti jam në Europë, po të thërras nga aeroporti, ku po pres aeroplanin tjetër. Brenda dy orëve jam atje. Do të flasim për të gjitha.

- Je me Mimozën?

- Jo. Mimoza nuk erdhi, sepse nuk ndjehet aq mirë. Po bën ca analiza. Është rraskapitur nga puna e lodhshme. Nuk po e zgjas tani, të thashë. Flasim atje për të gjitha.

- Mirë bir, do të shihemi pra,- tha Bujari duke i fshirë lotët me cepin e çarçafit.

- Uh po, prit, edhe diçka… baba. A e ke afër zotin Arben? Mos thuaj ndonjë gjë që ai të kuptojë se po të pyes për të; e pra a e ke afër?

- Po, – tha shkurt Bujari

- Mos i trego, por zoti Shpëtim është nisur bashkë me Jetën për të ardhur te ju. E kemi organizuar që të nisemi në të njëjtën ditë dhe të takohemi të gjithë atje.

- Ashtu? – Bujari mezi po e mblidhte veten që të mos e vërente Arbeni. – Epo mirë. Kur do të vish pra? – e pyeti ai kinse e kishte fjalën për atë vetë, por që Diamanti e kuptoi për cilët e pyeti.

- Besoj se ata arrijnë para meje, meqë janë më afër dhe linja e tyre vjen direkt. Tani po më mbaron kartela telefonike. Mirupafshim së shpejti, baba!

- Mirupafshim, bir, mezi po pres të të shoh,- tha Bujari dhe e mbajti receptorin në vesh edhe pakëz kohë pasi që dëgjoheshin sinjalet e linjës së ndërprerë. Frikësohej mos po linte një fjalë, një tingull të Diamantit pa dëgjuar.

- Ishte Diamanti? Biri yt? – e pyeti Arbeni kur pa se ai e la receptorin mbi aparatin telefonik.

- Po. Po vjen sot. Pas nja dy orësh është këtu. Kështu tha. Të përshëndeti edhe ty.

- Faleminderit. Lum si ti. Po të vjen djali. E di çfarë, Bujar, ndonjëherë po e ndjej veten shumë fajtor para familjarëve të tu.

- Pse thua?

- Sepse mund të më shohin si njeriun që i ka marrë veshkën babait te tyre. Një i huaj që ka marrë një pjesë trupi nga babi i tyre.. Me vjen turp.Disi ndjehem ngushtë.

- Nuk është turp të jesh i sëmurë, miku im. Sëmundjen e marrin për turp vetëm injorantët, thuajse është zgjedhja e vetë njeriut.. As nuk ke pse turpërohesh para familjarëve të mi. Unë kam vendosur vetë të ta jap veshkën, ti nuk ma ke kërkuar këtë gjë. Ata më përkrahin, jam i sigurt. Po të ishte gjallë vajza ime, besoj ajo do të ta propozonte këtë ide para meje. Ose do të të ofronte veshkën e saj.

- O Zot i madh, Bujar, kur më flisni për vajzën tuaj, më kaplon një farë ngrohtësie në zemër, një qetësi në shpirt.

- Më vjen mirë, Arben. Ajo vërtetë ka qenë një diell, para të cilit të gjitha lulet hapin petalet me kënaqësi.- Bujari mori frymë thellë dhe buzëqeshi dhimbshëm i përhumbur në mendime. Pastaj shtoi:- Më thuaj, çfarë do të bëjmë sot? Do të dalim pakëz pas mëngjesit? Mos kërko të ta shtyejë karrocën tënde mu ajo infermierja e bukur. He he… mendon se nuk e kam vënë re se si e shikon? - e ktheu Bujari bisedën në humor.

Arbeni qeshi. Vërtetë një infermiere që vinte shpesh në dhomën e tyre i kishte rënë në sy. Ajo ishte e huaj, mezi merreshin vesh. Por kishte ca sy te bukur sorkadheje që e bënin Arbenin të dridhej shpirtërisht para hireve te saj. Infermierja e bukur ia kishte zgjuar ndjenjat e fjetura të një burri, ndjenja, për të cilat kishte menduar se i kanë vdekur.

- Bujar, Bujar, ty nuk të shpëton gjë… vërtetë e bukur është, por ç'e do.

- Pse, ç'e do? Ti je i ri, ke kohë për të gjitha.

- Ndoshta,- tha Arbeni duke buzëqeshur dhe bëri të ngrihet nga shtrati. Vuri maskën e bardhë mbi gojë, te cilën duhej ta mbante së paku gjashtë muaj nga shkaku i infeksioneve që mund të merrte. Filluan të dy të visheshin.

- A thua kur do të na lëshojnë të shkojmë në shtëpi, Bujar?- pyeti Arbeni.

- Besoj shpejt. Mjeku më tha brenda disa ditëve, ndoshta më së shumti një javë. Mua më tha se mund të shkoj qysh pas dy ditëve, por unë i kërkova të qëndroj deri sa të jesh gati edhe ti.

Arbeni e pa me sy falënderues.

- Sa mirë. Vetëm edhe një javë dhe do shoh pëllumbeshën time!

***.

Dy gra po ecnin krah për krahu rrugës për te varrezat. Posa hapën dyert e mëdha, ndjenë se një qetësi disi jotokësore, mistike, zotëronte aty. Lisat e gjatë lëkundeshin lehtas, era dukej thuajse mundohej të bënte sa më pak zhurmë. Diku-diku të zinte syri ndonjë njeri të përkulur para ndonjë varri. Besa i shihte dhe i ndjente shumë të afërt.

"Nuk jam vetëm,- mendonte,- edhe shumë njerëz të tjerë kanë humbur të dashurit e tyre".

Jolanda ecte pak më rëndë, shikonte varret dhe dukej thuajse ishte kthyer në një botë të saj të largët, në të cilën kishte jetuar dikur, në një jetë tjetër. Ishte e tëra brenda kujtimeve te saj.

- Kështu e ka kjo jetë. Vrapo-vrapo dhe në fund të gjithë këtu do të vijmë,- tha Besa pas një kohe që kishin ecur pa folur.

- Mirë që është ashtu,- tha Jolanda.- Çfarë do bëhej po të jetonim përjetësisht? Njeriu është pjesë e natyrës, dhe si i tillë lind, jeton dhe vdes. Asgjë nuk është e rastit në natyrë, asgjë. Edhe ne kemi mision në këtë botë: vijmë, kryejmë punën tonë dhe ikim.

- Vërtetë po, – tha Besa dhe shtyu me këmbë ca gjethe që kishin rënë përtokë.

“ Njeriu është mu sikur këto gjethe,- mendoi,- sikur një gjethe e vetme në trungun e madh të jetës”.

- A je pyetur ndonjë herë ku shkojnë shpirtrat? – e pyeti befas Jolanda.

- Gjithnjë. Ndonjëherë dëshiroj që ta besoj se ka parajsë, ndonjëherë mendoj se ndoshta diku në këtë univers të gjerë ka ndonjë planet ku do të shkojmë pasi të vdesim, ku ta dish. Po të ishte ashtu, do të isha shumë më e qetë. Por, ndonjëherë, në ato momentet e mia të këqija, frikësohem se nuk ka gjë më tej… nuk ka… them se jetojmë këtë jetë dhe pastaj zhdukemi në një hiç. Në botën e hiçit.

- Dhe frikësohesh për shkak të Dorinës, apo jo?

- Pikërisht. Frikësohem nga mendimi se mund të mos e shoh më. Vërtetë njerëzit e kanë të ardhmen gjithmonë të panjohur dhe kjo është ajo që i frikëson më së shumti.

- E di çfarë, Besa? Njerëzimi gjithmonë ka dashur ta njohë ardhmërinë. Ku po shkon, çfarë do bëhet më tej. Por a e ke menduar se sa më e panjohur për ne është e kaluara. Në fakt nuk e dimë fare fillin tonë. Dëshirojmë ta dimë ku po shkojmë, por akoma nuk e kemi zbuluar nga kemi ardhur.

- Epo kështu është, jetojmë në mister.

Ecën edhe për një kohë sërish në heshtje.

- Ja arritëm, – tha Jolanda, e cila ishte ndalur para një varri me një pllakë dukshëm të vjetruar. Në mes të saj ishte e skalitur fotografia e një djaloshi të ri, i cili dukej shumë më i ri se që ishte Diamanti tani.- Këtu është,- tha me një ofshamë të thellë.

- Sa i ri paska qenë,- tha Besa.

- Sot do të ishte mbi shtatëdhjetë vjeç,- ia ktheu Jolanda dhe u ul skaj varrit pa ia larguar sytë fotografisë. Besa ndjeu se duhej të largohej pak më tej dhe t’i linte dy shpirtra të dashuruar të bisedonin në heshtje.

Bëri ca hapa ngadalë rrugës së kalldërmtë, përmes varreve të shumtë. Të gjithë këta që flenë këtu dikur kanë frymuar mbi tokë, mendonte, ndërsa tani ishin bërë banorë të barkut të saj. Secili kishte një histori, secili kishte pasur gëzime e vuajtje. Secili kishte vdekur ndryshe.

Posa e pa fotografinë e një fëmije, Besës iu ngushtua zemra. Ishte fytyra e një vogëlushi që po e shikonte nga pllaka e gurtë me buzë të qeshura. Dukej aq i gjallë me atë pamje të pafajshme thuajse çdo moment do t’ia dëgjonte kumbimin e të qeshurës fëmijërore.

Largoi sytë e përlotur, bëri dy-tre hapa dhe pa kah Jolanda. Ajo akoma po qëndronte e ulur para pllakës së varrit.

“Ka nevojë të çmallet, le të qëndrojë edhe një kohë aty” mendoi Besa dhe vazhdoi rrugën.

Pas pak Jolanda ia mbërriti dhe i tha:

- Do të shkojmë te Dorina tani? – dhe e mbështolli më mirë shallin rreth kokës.

- Po. Është pak më tej, tek ajo kthesa tjetër,- tha Besa.

Mikeshat vazhduan rrugën dhe u zhdukën pas kthesës me lisa të gjatë.

***

-

Bujari me Arbenin ishin ulur në një bankë në kopsht. I pari po lexonte gazetën, me aq sa mundej të kuptonte nga gjuha e vendit ku ishin, ndërsa tjetri sodiste lulet dhe barin e brishtë.—

- E di si po më duket vetja?- i tha Bujarit me një zë që i dilte ndryshe nga maska që kishte vënë para gojës.

- Si?

- - Si ata këngëtaret ekscentrikë e hipokondrikë, që venë maska kundër bakterieve dhe smogut, ngaqë u druhen shumë sëmundjeve e mikrobeve.

- Mua më dukesh më shumë si kirurg,– e shpotiti Bujari,- madje ndonjë herë më dukesh si Babadimri.

Të dy filluan të qeshnin dhe Bujari pa se Arbenit me t'iu kthyer shëndeti, i ishte kthyer edhe humori i mirë.

- Kam frikë se do të më duhet t'ju lus të hyni brenda,– dëgjuan infermieren e preferuar të Arbenit, që u ishte afruar.

- Nuk mund të na lini edhe pak, vetëm pak? – i tha Bujari.

- Jo. Sidomos zotëri Arbenin,- i tha ajo në gjuhën e saj dhe pastaj foli edhe disa fjalë të tjera.

- Çfarë thotë?- e pyeti Arbeni që nuk kuptonte fare nga gjuha e infermieres së bukur.

- Duhet të shkojmë. Eja të futemi brenda. Kjo mikesha jote nuk po na lë rahat. Duket se edhe mjeku po të pret në dhomë.

- Të tha se kam vizitë mjekësore?

- Nuk e di. Por më tha se po të presin brenda.

- O Zot! Shpresoj të mos më marrin sërish gjakun për ndonjë analizë.

- Nuk e besoj. Megjithëse, ti tashti je si molla, mund edhe të japësh pak gjak për të tjerët.

Të dy qeshën sërish dhe u futën brenda spitalit. Bujari po e shtynte karrocën e Arbenit dhe kur arritën para derës, i tha:

- E di që ndonjë herë ëndrrat e këqija dalin për mirë?

- Ti sikur the që ato nuk parashikojnë asgjë.

- Nuk parashikojnë. Por bëjnë që dëshirat e tua të bëhen më të forta dhe me një farë mënyre përpiqen t'i realizojnë. Për shembull, në atë ëndrrën që pe mbrëmë ti s'ke dashur ta lëshosh Jetën të shkojë, je çmendur nga frika se mund të mos e shohësh sërish.

- Po, e pastaj?

- Kështu ëndrra bën që në jetën reale ta shohësh sa më shpejt, e thërret afër vetes, dhe ajo, në vend që të largohet...

- Babiiii, - bërtiti Jeta kur Bujari hapi derën, dhe iu hodh të atit në qafë.

Arbeni kishte mbetur i hutuar aq shumë sa që sytë i kishte zgurdulluar tej mase, ndërsa mundohej të thoshte diçka, që në fakt, nuk e dinte edhe vetë se çfarë.

- Ti… ti e ke ditur, Bujar? E ke ditur?

- Po. Por nuk është faji im, dëshironin të ta bënin befasi.

- Babi, sa më ka marrë malli, sa i bukur dukesh! Oh, babi, sa të dua… ja ku të kam përsëri... Më dukej se s'do të ktheheshe më kurrë.

Bujari i shikonte babë e bijë duke u përqafuar dhe për një moment iu ndrydh zemra. Ai nuk e kishte bijën e tij për ta shtrënguar në gjoks. U largua ngadalë, por sapo ktheu shpinën, ndjeu dy duar të vogla përreth belit.

- Xhaxhi, Bujar! Oh, xhaxhi Bujar sa më ka marrë malli edhe për ty. Ti je xhaxhi im i mirë dhe më ke munguar pa masë,- e puthi Jeta në të dy faqet kur Bujari e ngriti lart. Sytë po i ndrisnin nga gëzimi.

- Vërtetë? Vërtetë të kam munguar, pupulakja e xhaxhit?

- Vërtetë, shumë, shuuuuuuumë,- bëri Jeta duke hapur duart.

- Edhe ti më ke munguar, Jeta. Më keni munguar të gjithë.

- Të ka munguar edhe teta Besa? – e pyeti pafajshëm vogëlushja, ndërsa Arbeni, i cili e dinte punën e Bujarit, shtrëngoi buzët dhe për të ndërruar temë dhe i tha Jetës:

- Lëre xhaxhin tënd rehat tani. Eja të të përqafoj edhe pak, moj zemra e babit.

- Në të vërtetë më ka munguar teta jote Besa,– megjithatë iu përgjigj Bujari, duke u përpjekur që të merrte pamjen e njeriut serioz që po fliste me një të rritur, në mënyrë që Jeta ta ndiente veten të rëndësishme.

- Epo mirë që është kështu. E di pse? – tha tani edhe ajo me shumë seriozitet që të bënte të shkulesh gazit.

- Jo, nuk e di, e pse kështu?

- Sepse edhe ti i mungon asaj.

Të dy burrat u shikuan me habi. Pastaj Bujari e pyeti:

- Po ti nga e di këtë?

- Është sekret. Nuk mund të ta them. Por që i mungon, i mungon.

- Epo mirë. Kaq më mjafton,– i tha Bujari duke qeshur tashmë dhe duke e përqafuar me shpirt.

- Por ti nuk do t'i tregosh që të kam thënë unë, e? – i tha Jeta dhe e vuri gishtin tregues në buzë, në shenjë ruajtje sekreti.

- Besa-besë,- i tha Bujari duke ia dhënë dorën.– Tani më thuaj ku është xhaxhi Shpëtimi?

- Shkoi të bisedonte me mjekun dhe njëkohësisht ta priste xhaxhi Diamantin, e kanë lënë të takohen para derës së spitalit,- iu përgjigj Jeta dhe pastaj iu hodh prapë të atit në qafë.

– O sa shumë kam për të të treguar, për Midin, për gjyshen Jolanda, që e thërrasim edhe gjyshe Nanda, pastaj për shoqen time më të fundit, Herën, pastaj për pishat dhe shkurret me emra… pastaj…- fliste vajza me faqe te skuqura nga gëzimi e sikur po i tregonte vetëm babait të saj në vesh.

- Ngadalë, ngadalë… nuk dua të m'i thuash të gjitha njëherësh, ruaji ca për në shtëpi,– i tha Arbeni duke ia shkulur faqet.

Bujari pa nga dritarja tek po afrohej Shpëtimi me mjekun dhe me Diamantin, që mbante një strajcë rrobash në shpinë.

Ua bëri me dorë, por ata nuk e panë, ndaj doli në korridor që t'i priste.

Me t'u takuar me Diamantin, e përqafoi si asnjëherë më parë. Edhe i biri ishte shumë i përmalluar për të.

- Po si nuk na tregove fare, ore babi? Si na e bëre kështu fshehtas? Po pse? Do të të qëndroja afër, ja për këtë...

- Nuk ka rëndësi, Diamant. Unë vetë desha kështu. Kisha nevojë të kaloj nëpër këtë. Pastaj nuk isha vetëm. Kisha Arbenin afër, pastaj edhe mjekun tonë të mirë, që është edhe miku i zotit Shpëtim. Ju kisha juve me mua, e kisha Dorinën, ja mu këtu, – preku ai zemrën.- Ajo më ka dhëne forcë më së shumti.

- E besoj. Por megjithatë është dashur të na tregosh.

- Po ti si e kuptove?

Shpëtimi e Diamanti u shikuan në heshtje dhe Bujari e mori me mend se ai do t'i kishte thënë. Nuk i tha asgjë më, por e pyeti për të fejuarën:

- Si është Mimoza, pse po bën analiza?

- Ka ca kohë qe ndjehet e rraskapitur, ka ca alergji te vogla. Ndoshta edhe do të kthehemi së shpejti. U bënë më shumë se gjashtë muaj.

- Si ta shihni ju më mirë, – i tha Bujari dhe pastaj e tërhoqi mënjanë.– Diamant, po mami e di?

- Nuk e di.

- Nuk e di mami, apo ti nuk e di nëse ajo e di?

- Oh, ma bëre lëmsh. Nuk e di nëse ajo e di.

Bujari ndjeu keqardhje. Sikur dëshironte që Besa ta dinte. Kështu ndoshta do të vinte për ta vizituar, ndoshta do të bëhej diçka. Vërtetë nuk i pëlqente që ajo të kthehej tek ai vetëm nga ndjenja e dhembshurisë. Por, i mungonte… oh sa i mungonte.

- Mirë,- i tha shkurt dhe pastaj iu kthye edhe Shpëtimit:

- Të faleminderit për të gjitha, Shpëtim. Për shtëpinë, banesën, Jetën. Të kam shumë borxh.

- Nuk më ke asnjë borxh. Nuk ishte gjë e madhe për ta bërë.

- Cilën shtëpi?- pyeti Diamanti.

- Eja Diamant, kemi shumë për të biseduar.

- Edhe ne,- tha Jeta e cila tashmë e kishte zënë edhe Diamantin përdore.

- Por jo para se unë t'ju them diçka të rëndësishme, – tha Shpëtimi me një ton që dukej thuajse do të bënte një deklaratë shumë solemne. Të gjithë heshtën dhe ai foli:

- Mjeku sapo ma tha se do t'ju lirojnë pas tre ditësh. Unë e Jeta do të qëndrojmë këtu derisa të kryhen të gjitha formalitetet e pastaj do të kthehemi të gjithë së bashku.

- Urraaa, – bërtiti Jeta e gëzuar.

- Ëndrra më doli vërtetë mirë,- tha Arbeni duke ia shkelur syrin Bujarit.

***

Po atë mbrëmje, ndërsa Bujari, Arbeni, Diamanti e Shpëtimi po bisedonin për ngjarjet e përjetuara ditëve të fundit, shumë kilometra larg, në një tjetër tokë, dy gra rrinin në ballkonin e shtëpisë duke pirë kafenë e me mendje të shpërndarë.

- Të faleminderit, Besa, – i tha Jolanda me një buzëqeshje të dhimbshme mikes së saj.

- Për çfarë?

- Ti e din kur duhet t'i qëndrosh njeriut afër e kur larg. Të admiroj për këtë.

- Për çfarë e ke fjalën, Jolanda?

- Për sot te varrezat. Kisha nevojë t'ia thosha dy fjalë dashurisë sime dhe ti e ndjeve këtë. Na le vetëm për pak çaste. Të jam mirënjohëse.

- Oh, Jolanda, as mos e thuaj.

- Jo, por po mendoj për më gjerë; tash jam e sigurt se ti e din kur duhet t'i largohesh dhe kur duhet t'i qëndrosh afër atij që e do.

- Mendon se e di vërtetë? – pyeti Besa duke e kuptuar për çfarë po fliste Jolanda.- Por unë jam në dilemë të madhe. Si ta kuptoj se e di?

- Jam e bindur se ti e di tanimë.

Diku larg një zog i trembur shpejtoi drejt folesë së ngrohtë.

XXIV

Po kthehesin në shtëpi. Shpëtimi kishte marrë përsipër të gjitha obligimet rreth biletave, bagazhit dhe gjërave tjera, ndërsa Bujari dhe Arbeni qëndronin ulur brenda barit të aeroportit me nga një gotë lëng frutash përpara. Duhej edhe një orë derisa të fillonte fluturimi. Brenda aeroportit kishte shumë shitore plot me mallra të ndryshme gjithfarësh, por askush nga ata nuk ishte i interesuar t'ua hidhte sytë, as për të blerë e as për të parë. Secili ishte i zënë me mendimet dhe planet e veta.

Vetëm vogëlushja Jeta kërcente e gëzuar sa andej-këndej, dhe hutohej para vitrinave të ndriçuara, ndërsa Arbeni ia tërhiqte vërejtjen të mos largohej shumë. Kishte frikë mos humbiste në gjithë atë mori njerëzish, ndaj nuk ia ndante sytë. Bujari e shikonte Shpëtimin, i cili me gjithë vitet që kishte, ishte shumë vital dhe i lëvizshëm, sikur në vitet më të mira të rinisë.

"Vërtetë kam pasur fat me këtë mik, nuk e kam merituar" mendoi ai.

Mënyra se si e kishte krijuar miqësinë me Shpëtimin e bënte të rrëqethej, por megjithatë i vinte mirë që kishte ndodhur. Ndryshe nuk do ta kishte njohur mirësinë e tij.

"Nga çdo e keqe del ndonjë e mirë" mendoi sërish.

Diamanti kishte ikur një ditë përpara. Bujarit i dhimbsej, sepse e shihte mjaft të brengosur për Mimozën, për të atin, por edhe për të ëmën. Ende e kishte dhimbjen e humbjes së motrës, por mundohej ta përballonte me shumë burrëri, aq më tepër iu ofronte kurajo edhe të tjerëve.

- U lajmërua Diamanti? – e pyeti Arbeni, thuajse ia kishte lexuar mendimet që kishte në kokë.

- Jo akoma,- ia ktheu Bujari.- Shpresoj të ketë mbërritur shëndosh e mirë. Jam pakëz i brengosur për të, më duket thuajse mban peshën e shumë brengave mbi shpinë. Është i ri, kam frikë se thyhet. Më duket se tani do të isha i gatshëm të duroja të gjitha vuajtjet e botës, vetëm të mos i përjetojnë fëmijët e mi. Në të vërtetë, i vetmi fëmijë, që më ka mbetur tani.

- Eh, kështu janë prindërit. Dhe mirë që është kështu. Por mos u brengos për Diamantin, ai është i ri, do t'i përballojë të gjitha .

- Ashtu shpresoj.

Nga altoparlantët dëgjohej zëri i spikeres që tregonte nisjet e aeroplanëve. Bujari pa Shpëtimin që po afrohej me ca letra në dorë.

- Jeni gati? – i pyeti i entuziazmuar.– Ku është Jeta? Tani duhet të shkojmë drejt asaj daljes andej dhe të vendosemi brenda avionit. Po afron koha e nisjes.

Të dy burrat ulën kokën. Asnjëri prej tyre nuk e kishte menduar si do të ishte momenti i kthimit. Njëri mendonte apartamentin, në të cilin nuk kishte jetuar ndonjëherë dhe vetminë që e kërcënonte në ditët që po vinin. Ndërsa tjetri, me gjithë rininë e tij, e mendonte kasollen e varfër dhe skamjen, që e kishte të fshehur ende pas portës.

- Jeta,- i thirri Shpëtimi vogëlushes,- hajde bija ime se tash do të nisemi.

"Do të mundohem të punësohem, vetëm sa të forcohem pak",- i jepte vetes kurajë Arbeni.

- I kam rregulluar të gjitha rreth kthimit tuaj,– u tha Shpëtimi.– Këto ditë kam telefonuar në shtëpi dhe të gjitha janë gati. Vajza ime ka ardhur për ca ditë dhe është marrë me përgatitjet për ardhjen tuaj. Mos u brengosni.

Arbeni e shikonte pa fjalë. E ç'mund të rregullohej në shtëpinë e tij të varfër? Do të ishte i lumtur që pullazi i shkatërruar mos të pikonte më. Pastaj, me tu forcuar, do të bënte çmos të rregullonte çështjen e banimit. Duhej ta bënte, së paku për hir të së bijës, ajo do t'i jepte forcë. Jeta ia kishte dhënë edhe një shans, duhej të bënte çmos! Kishte aq shumë kohë që ishte dergjur në shtrat, sa që i dukej thuajse edhe bota kishte ndryshuar shumë ndërkohë. Gati kishte harruar si është të bësh jetë normale. Tani ishte koha e tij. Nuk donte më të qëndronte pa lëvizur. Ndjehej sikur një njeri që posa i ishin kthyer sytë dhe donte të shihte çdo gjë, edhe fluturimin më të vogël të fluturës. Por, si do t'ia bënte në fillim fare pa para? Çfarë do të hanin? I vinte turp t'ia thoshte këtë Bujarit, ai tashmë i kishte dhënë pjesën e trupit të tij, çfarë të kërkonte më shumë? I vinte turp, shumë turp.

U ngritën dhe, si kaluan kontrollin e dokumenteve, u futën nëpërmjet një tuneli që të çonte drejt e në brendi të avionit. Ulëset i kishin shumë afër njëri-tjetrit. Në një treshe karrigesh ishin ulur Bujari e Arbeni me Jetën në mes, ndërsa krejt afër tyre në rreshtin tjetër përbri ishte ulur Shpëtimi.

- Kur shoh këto aeroportet luksoze, më kthehet dëshira të jetoj nëpër metropolet e botës, – tha Shpëtimi që ishte ulur në skaj afër dritares. – Ka diçka magjike të jetosh në qytetet e mëdha. Dritat e shumta, rrugët e gjera, turmat e njerëzve, godinat shumëkatëshe. Jeta në qytetin e vogël vërtetë të ofron qetësi, por është e vakët, provinciale. Ndoshta kjo ndjenjë më vjen kështu, e përkohshme. Jam i bindur që pas disa ditë jetese në metropol, sërish do të kërkoja atë folenë time të ngrohtë e të qetë.

- Edhe njerëzit janë më të afërt në mes vete në qytetet e vogla. Po të jetonim për shembull ne të dy në ndonjë metropol, ndoshta edhe në të njëjtën godinë, besoj se do të ndjeheshim për njëri-tjetrin vetëm si dy fytyra të huaja, shumë-shumë mund të ndërronim ndonjë përshëndetje të ftohtë mes nesh, apo jo? Nuk e di pse robotizohen njerëzit në atë mënyrë, kur dihet se çdonjëri ka nevojë për ngrohtësinë e tjetrit, për ndihmën, fjalën, këshillën,- tha Bujari mendueshëm.

- Bota ka ndryshuar shumë. Dinamika e jetës, forca e biznesit, teknologjia dhe të arriturat e tjera, kanë bërë që njeriu të humbë paksa nga njerëzorja. Por edhe pa këto arritje nuk mund të bëjmë. Ndryshe tani do të na duhej të udhëtonim tri ditë në vend të tri orëve.

- Po, natyrisht. Megjithëse unë gjithmonë kam pasur frikë nga fluturimi,- tha Bujari.- Në udhëtimet e shpeshta, kur ligjëroja nëpër universitetet e tjera, gjithmonë merrja me vete ndonjë tabletë qetësuese. Kisha një farë angështie, më zihej fryma. Kur dridhej aeroplani në ndonjë boshllëk ajror, më lëshonte shpirti.

- Ende e ke atë frikë?

- Prita se do ta kem, por jo, nuk e ndjej më. Duket se kur njeriu përballet me frika më të mëdha, ajo e para ikën. Në një farë mënyre të bëhet njësoj.

- Çdo njeri ka mënyrat e veta për t'i përballuar frikët dhe streset. Janë pjesë e pandashme e jetës.

- Dëshironi gjë për të pirë, zotërinj? – i pyeti gjithë mirësjellje stjuardesa që po kalonte përbri.

- Jo, faleminderit, unë do të marr vetëm gazetat, – tha Shpëtimi.

- Unë dua, unë dua… - u hodh gëzueshëm Jeta.

Stjuardesa i buzëqeshi hijshëm dhe, bashkë me pijen freskuese, i ofroi edhe ca ëmbëlsira të paketuara bukur. Ishte kënaqësi ta shohësh këtë fëmijë të hareshëm që po përjetonte gëzime të tilla të befta, të paprovuara ndonjëherë. Pas pak, kishte mbështetur kokën në krahun e babait të saj dhe ashtu ia kishte ngulur sytë dritares; dukej e përhumbur me shikimin e kredhur nëpër retë e bardha atje tej në hapësirën e paanë. Herë pas here kafshonte me shije ëmbëlsirën dhe thithte me një pip të hollë lëngun e shijshëm që kishte brenda kënaçja e metaltë.

***

Diamanti po qëndronte te pritorja e klinikës ku kishin ardhur për rezultatet e analizave. Mimoza ishte ulur afër tij krejt e zbehtë në fytyrë dhe ai, nuk e dinte a e kishte ajo nga frika e rezultateve apo nga ndonjë sëmundje misterioze. Përgjithësisht, Mimoza ishte e durueshme dhe nuk ankohej kurrë. Por sot vërtetë dukej e rraskapitur. "Ndoshta gabuam që erdhëm këtej,– mendonte Diamanti në heshtje.- Mbase nuk kam menduar sa duhet për shëndetin e Mimozës, për mamin e babin… nuk e di ç'më gjeti, pse desha të vijmë… Edhe Mimoza deshi, madje kjo ishte e para që ma futi në mendje, por unë duhej ta mendoja më mirë. Natyrisht këtu nuk ka qenë aq e lehtë. Kemi punuar në shumë spitale e strehimore të varfra dhe frikësohem mos ka marrë ndonjë sëmundje të keqe…" vazhdonte ta dënonte veten ai. – Vetëm le t'i dalin analizat mirë, o Zot, nuk mund ta përballoj edhe një humbje, nuk mundem"- ktheu shikimin kah Mimoza dhe ia zuri dorën me ngrohtësi. Ajo i buzëqeshi me mundim.

- Je më mirë? – e pyeti.
- Mirë, mirë… a thua edhe sa do të presim? – pyeti me zë të mekur Mimoza.
- Nuk e di. Shpresoj jo shumë. Na mbyti kjo vapë e mallkuar.
- Po bëjmë durim edhe pak. Ndërkohë, mundohu të më gjesh pak ujë, të lutem.

Derisa Diamanti u afrua tek aparati i ujit të ftohtë, iu duk se dëgjoi mbiemrin e Mimozës, të shqiptuar çuditshëm nga infermierja afrikane. Shpejtoi hapin bashkë me gotën në dorë dhe i ndihmoi Mimozës të ngrihej. Pasi piu pak ujë, atë e mori infermierja.

- Ju mund të pritni jashtë, – iu kthye ajo djaloshit, – po qe nevoja, mjeku do t'ju thërrasë.

Atij iu ngrys fytyra. Pse të mos hynte me të, pse të mos i qëndronte afër? Çfarë nëse do t'ia kumtonin ndonjë lajm të tmerrshëm, çfarë nëse alivanosej? Duart filluan t'i dridheshin teksa e kishte ndrydhur gotën e plastikës duke u munduar të bëhej i fortë.

Një herë u ul, por nuk e zinte vendi. Çfarë lypte këtu, pse nuk ishte tani në vendin e tij, afër familjes, afër shtëpisë? Kishte aq shumë mall për njerëzit atje, për atë vjeshtën e vendit të tij me pyje e kodra të kuqërremta që e rrethonin.

Minutat kurrsesi nuk kalonin dhe dukej thuajse ajo dera, së cilës i ishte hequr ngjyra qëmoti, nuk do të hapej kurrë. Filloi të sillej andej-këndej nëpër korridorin e ngushtë dhe u ndal atëherë kur vuri re se disa nga njerëzit që po prisnin sikur ai, kishin filluar ta shikonin çuditshëm.

- Në djall!- mendoi me nervozizëm,- aq më bën, dua të plas, nuk kam më durim. Po nuk më thirri mjeku brenda edhe disa minutave, do të hyj vetë.

Sikur ta kishte ndjerë padurimin e tij, infermierja hapi derën dhe Diamanti mbajti frymën; kërkoi të hetonte ndonjë shenjë emocioni në fytyrën e saj, por ajo dukej krejt e qetë. Infermieria shikoi përreth dhe pas dy sekondash, shikimi iu ndal në fytyrën e tij, që e ndiqte me sy. Ia bëri me dorë dhe kur ky u afrua, i tha qetë:

- Mund të futeni brenda tani. Mjeku dëshiron t'ju shohë.

Ndonëse e kishte pritur me padurim thirrjen e tij, Diamantit iu këputën fare këmbët . Pse dëshironte ai ta shihte? Çfarë do t'i thoshte? Sigurisht kishte për t'u kumtuar ndonjë lajm të tmerrshëm, ndaj duhej të ishin të dy. Më jep forcë, o Zot!- mendonte teksa po ecte nëpër korridorin e ordinancës së mjekut.

Brenda ishte një dhomë e bardhë, me disa orendi të thjeshta. Në një cep të një kanapeje ishte ulur Mimoza, e cila dukej pakëz e frikësuar.

- Ku është mjeku? - e pyeti Diamanti me të hyrë.
- Shkoi në dhomën tjetër, si duket që t'i marrë të gjitha analizat e mia.
- Po deri tani çfarë bëri? Ç'të tha?
- Më kontrolloi. Nuk më tha asgjë. E pyeta, por tha se dëshironte që lajmin të na e kumtonte të dyve bashkë.
- Të tha pse? Pse donte të na e kumtonte të dyve bashkë?
- Jo. Kam pakëz frikë, Diamant. Ç'mund të jetë?
- Mos u brengos, nuk besoj të jetë ndonjë gjë serioze,- i tha Diamanti, ndonëse për vete zemra i dridhej fort.– Sigurisht më ka thirrur ngase ti nuk do t'ia kuptosh mirë gjuhën. Unë jam këtu tani, mos u frikëso,– ia shtrëngoi dorën duke i buzëqeshur e duke i mbyllur kapakët e syve në shenjë qetësie e përkrahjeje.

Nuk shkoi shumë dhe në dhomë hyri mjeku. Ishte një burrë trupvogël, që mbante në shuplakat e tij të plota një tufë letrash.

- Mirëdita, – iu drejtua ai Diamantit dhe djaloshi u kujtua se kishte harruar për ta përshëndetur, meqë ishte përqendruar tërësisht në shprehjen e syve të mjekut.
- Mirëdita,– ia ktheu.
- Ju jeni i fejuari i... i zonjushës Mimoza? – pyeti duke e shqiptuar mezi emrin e saj.
- Po,- u përgjigj shkurt Diamanti dhe nuk po e priste dot minutën kur ai t'i linte mënjanë gjithë këto hollësira të kota e t'u thoshte shpejt se si ishte puna.
- Mirë. Ne i kemi kryer të gjitha analizat dhe…
- Çështja është serioze? – e ndërpreu pa dashje Diamanti dhe në çast kafshoi buzën.
- Serioze është, por…
- Do të vdes? – tani u ngut Mimoza të bënte një ndërhyrje jo dhe aq me vend.
- Mos u ngutni, zonjushe. Ju lutem, qetësohuni. A jeni të gatshëm ta dëgjoni lajmin?

Diamanti dhe Mimoza u shikuan mes vete dhe shtrënguan duart.

***

Pas gati tri orësh udhëtimi, zëri i këndshëm i stjuardesës lajmëronte se së shpejti do të uleshin në tokë. "Ju lutem, kontrolloni rripat sigurues" fliste ajo. Gjithçka shkoi si duhet dhe pas ndonjë gjysmë ore të gjithë udhëtarët kishin dalë në hollin e aeroportit të qytetit të tyre. Vajza e Shpëtimit kishte kohë që po i priste në veturë. Me t'i parë, hapi derën dhe u doli përpara. U takua me Bujarin dhe Arbenin, pastaj përqafoi babanë e saj dhe Jetën. Të gjithë u vendosën në veturë dhe në çast u nisën drejt qytetit. Kishin ende edhe disa dhjetëra kilometra rrugë për të bërë derisa të mbërrinin në qytetin tyre.

- U lodhët rrugës, si kaluat? – i pyeti ajo të gjithë.
- Mirë , mirë.
- Unë u kënaqa shumë, – tha Jeta.- Ky aeroplani ishte edhe më i madh nga ai që shkuam. Nga dritarja ime, një pëllëmbë larg, ishin retë. Gati t'i zija me dorë.

- Pse nuk i more ca të m'i sillje dhe mua?- i tha vajza e Shpëtimit, kinse nuk e dinte se kjo gjë nuk mund të bëhej.- Mua më pëlqejnë shumë retë.

- Oooo, po dritarja ishte e mbyllur.

- Mbyllur?

- Po si mund të rri hapur një dritare aeroplani? Nuk është si në makinë.

- Aaaaa,- bëri prapë si e habitur vajza e Shpëtimit, për t'i dhënë kështu lezet shpjegimeve të sinqerta fëmijërore të Jetës.

- Mund të bëhesh pilote kur të rritesh,– i tha Jetës Shpëtimi.

- Vërtetë mund të bëhem? – pyeti vajza e emocionuar thuajse kishte prekur një zbulim të ri.

- Natyrisht, e pse jo?– ia ktheu prapë Shpëtimi.– Mund të bëhesh çfarë të duash, sidomos që tani vajzat udhëheqin botën.

- Ohoho!- gëzohej Jeta.- Pilote!

Rruga vazhdoi e qetë edhe për pak kohë. Arbeni shikonte i heshtur nga xhamat. Po mendonte se i kishte mbetur edhe fare pak kohë për të qenë në shoqëri me këta njerëz të mirë. Paskëtaj do të kridhej në atë kasollen e tij të mjerë, dhe... përsëri luftë për ekzistencë. Sa mirë që Jeta ishte ende e vogël për ta kuptuar gjendjen e rëndë ku ndodheshin. Nuk duhej që supet e saj të njoma të duronin barrën e rëndë të jetës. Ja, kishte vetëm pak kohë që kishte lënë bredhjet shtëpi më shtëpi për të shitur dy lule a një mollë e me ato para t'ia lehtësonte atij sadopak barrën e rëndë të jetës. Kishte vetëm pak kohë që ndjehej tamam si një fëmijë, që luante e bridhte e shkujdesur pa merak se do të ketë bukë në shtëpi, se do të ketë dritë në... në kasolle. Jo, ajo nuk duhej t'i dinte këto halle të jetës, që atë vetë e kishin zënë përfund. Nuk duhej t'i dinte, po si... si do të bënte që ajo të mos i dinte?..

Me të hyrë në qytet, vajza e Shpëtimit e drejtoi veturën kah apartamentet ku kishte banuar më parë i ati.

- Zotëri Bujar,- tha ajo,- apartamentin e kam rregulluar disi me orenditë tuaja. Besoj se do të ndiheni mirë në të.

- Jam i sigurt se po, – ia ktheu Bujari.- Po ju a u sistemuat diçka në shtëpi?

Gruaja e re u ndie ngushtë. Iu duk vetja në faj, thuajse ia kishte vjedhur këtij njeriu shtëpinë e tij, që e kishte ndërtuar me duart e veta. Bujari e vërejti këtë dhe i tha:

- Ishte shumë e madhe për mua tani. Kur shkojmë kah pleqëria, dëshirojmë që punët t'i kemi pakëz më të mbledhura. Apartamenti është një zgjidhje shumë e mirë.

- Eh po, se harrova,- u lidh Shpëtimi në bisedë.– Kam bërë një dalje të vogël prapa në mes të kopshtit të shtëpisë dhe oborrit të pallatit. Një arkapie, siç i thonë më duket turqisht. Kështu do ta shfrytëzosh përsëri mjedisin tënd të punës, Bujar.

- Jo… jo, kurrsesi, ai është kopshti juaj tash.

- Madje nuk e kemi ndryshuar fare, është mu sikurse e keni lënë. Edhe tavolina juaj është mu aty,- tha e bija e Shpëtimit dhe shtoi në çast:- Eh, shtëpia ka gjithë atë oborr përpara! Na del dhe na tepron.

- Kështu do të jemi edhe më pranë,- shtoi Shpëtimi.- Ndonjëherë do të më duhet dikë për ndonjë lojë shahu, a… cilat janë ato lojërat tjera të pleqve? Duhet edhe të mësoj tash.

Qeshën të gjithë që ishin në makinë, ndërsa Bujarit iu përlotën sytë. Kishte mall për librat e tij, për qetësinë mbi tavolinë. Por tanimë shumë gjëra kishin ndryshuar; eh, sa gjëra që kishin ndryshuar nga ajo kohë.

Posa mbërritën dhe një nga një nisën të zbrisnin nga vetura; vetëm Arbeni hezitoi të dilte jashtë. Priti se vallë dikush do ta përcillte bashkë me Jetën në kasollen e tij.

- Hajde, Arben, çfarë pret?- i tha Bujari duke e përkulur kokën te xhami i veturës.

- Unë… unë… ndoshta është më mirë të mos hyj. Ndoshta është më mirë të shkoj menjëherë në shtëpinë time. Ndoshta më duhet të porosis ndonjë taksi...

- Hajde,- i tha prapë Bujari.- Ti je në shtëpinë tënde.

- Jo me të vërtetë,- tha Arbeni.- E çmoj shumë mikpritjen tuaj, por koha është të shkoj në shtëpinë time. Edhe ju duhet të pushoni. Një ditë tjetër do ju vij për vizitë.

- Dhe unë po të them se je me të vërtetë në shtëpinë tënde,- i tha Bujari.

Arbeni e shikoi me habi. Ç'po i thoshte kështu ky?

- Eja brenda, do të flasim për të gjitha,- i tha prapë Bujari dhe e hapi derën e makinës që ai të zbriste. Arbeni zbriti dhe u nis pas Bujarit në mëdyshje, duke mbajtur përdore Jetën. Ishin edhe Shpëtimi me të bijën. Ngjitën shkallët ngadalë dhe sakaq u gjendën para një korridori të bukur me dy dyer.

- Arben, mirëserdhe në shtëpinë tënde të re! – i tha Bujari.

- Çfarë po thua, Bujar, në cilën shtëpi?

- Në apartamentin tënd. Kjo është dera jote. Kjo tjetra është e imja. Tani e pas do të jemi fqinjë të parë.

- Çfarë po thoni kështu? Nuk mundem! Nuk mund ta pranoj kurrsesi! Jeni në vete? Pak keni bërë për mua deri tani?

- Nuk mund të të lëmë të kthehesh në atë shtëpi tani pas operacionit, Arben. Edhe Jetës i duhet një kulm i vërtetë mbi kokë. Pastaj edhe mua do të më keni afër, edhe Shpëtimin… nipat e mbesat e tij.

Arbeni ia krisi të qarit. Ndjehej me të vërtetë shumë i prekur.

- Mos bëj kështu, Arben. Edhe për mua është më mirë. Paramendoje si një investim që kam bërë. Bile ta kam bërë pak hile, se do të ta vjedh pakëz dashurinë dhe praninë e Jetës. Do ta grabis ndonjëherë për ta pasur pak pranë meje.

Burri i ri nuk po qetësohej fare. Kishte mbuluar fytyrën me të dy duart dhe supet i dridheshin nga ngashërimi. Vajza ia shtrëngonte dorën dhe e shikonte me dhimbsuni derisa i tha:

- Babi, nëse ti nuk dëshiron të rrimë këtu, atëherë mund edhe të shkojmë në shtëpinë tonë të vjetër. Me rëndësi është që je shëruar. Por… mua më pëlqen të kem këtë familje të madhe, babi… më pëlqen të kem shumë xhaxhallarë e teta të mira, si i kam këtu.

- Po pra, edhe ne kemi të gjithë dëshirë të të kemi afër,- i tha Shpëtimi.

- E pra, Arben, qetësohu tani. Do të pranosh të qëndrosh këtu? Mirë?

Derisa po fshinte lotët, të gjithë e kishin drejtuar shikimin kah ai.

- Mirë,– tha më në fund,- po me një kusht.– Sapo të forcohem pak, do të mundohem t'i kthehem punës, jetës në përgjithësi. Dhe ju premtoj se do t'ia arrij të krijoj më shumë. Ju më dhatë mua, por edhe unë dëshiroj t'jua shpërblej mundin. Kur do të arrij të krijoj diçka, dua që apartamentin ta merrni prapa.

- Jo, është i yti tashmë, ne dëshirojmë ta mbash.

- Po, ju faleminderit. E di se ju doni dhe jua di për nder, për tërë jetën. Por, dua të më kuptoni. Është nderi im. Është punë principi. Keni bërë tashmë të pakufishmen për mua. Por edhe unë duhet të bëj. Duhet të bëj me duart e mia, për veten time e për time bijë. Po edhe për ju e për dikë që do të ketë nevojë, si pata unë.

Bujari pohoi me kokë. Nuk mund ta nënçmonte krenarinë e këtij burri të ndershëm.

- Mirë, – i tha,- por një herë mos mendo në këtë. Ka kohë.

Të gjithë u futën brenda. Jeta kërcente si sorkadhe dhe ia tregonte çdo gjë babait të saj.

- Shih babi… shih edhe këtë.

- Nuk ka aq shumë pajisje, por sa për fillim… – tha Bujari.

Arbeni e pa ende me fytyrë të përlotur. Tundi kokën dhe tha:

- Sa për fillim? Sa për fillim?... Oh , nuk di ç'të them… më mungojnë fjalët e duhura, o mik.

- Eja tani, nuk të duhet gjithë ky shqetësim. Shtrihu dhe pusho, e sheh se shtratin e ke gati,– i tha Shpëtimi.- Pastaj edhe Bujari ka nevojë për pushim.

- O sa mirë, do t'i kem të gjithë afër… të gjithë… - bërtiste Jeta.- Do ta kem afër edhe teta Besën, o sa shumë e dua teta Besën.

- Teta Besën? Shpresoj ta kesh, edhe unë shpresoj ta kesh sa më parë,- tha Bujari me buzët të shtrënguara.

- Tashmë më ka!- u dëgjua zëri i Besës që ishte mbështetur te dera e hyrjes. Po i shikonte me një fytyrë të dhembshur e të gëzuar.

- Besa! – Bujari mbeti pa frymë.- Besa… - përsëriti, ndonëse nuk e dinte pse, por ndjente nevojë ta thërriste, thuajse kishte frikë se do t'i humbte para sysh si ndonjë vegim.

- Mirëserdhe, Bujar, mirë se u kthyet të gjithë! – tha Besa e buzëqeshur dhe së pari u drejtua kah Arbeni e Jeta.

- Gëzohem që operacioni pati sukses, Arben. I duheshe Jetës. I duheshe kështu i shëndetshëm. Edhe neve na duhej një Jetë. Një Jetë e mbushur me jetë, me gëzim.

- Ju faleminderit shumë, zonjë, nuk kam fjalë për t'ju falënderuar,- mezi i shqiptoi fjalët Arbeni.

- Nuk ka pse. Mos më quaj zonjë. Më thirr Besa, tanimë do të jemi fqinj të afërt. Do të mundohem t'ju gjendem aq sa mundem.- Pastaj u kthye kah Bujari:

- Eja, Bujar, do ta shohësh apartamentin? Pastaj të gjithë kanë nevojë të pushojnë. Shpëtimi, Diella, Arbeni dhe vogëlushja. Keni bërë gjithë atë rrugë - tha.

Bujari e ndoqi Besën i heshtur dhe hynë brenda. Apartamenti ngjante shumë në shtëpinë që kishin pasur, ndoshta nga shkaku i orendive të njëjta apo falë atmosferës së ngrohtë që kishte krijuar Besa me praninë e saj. Iu duk se po ndjente edhe aromën e njohur të kafesë që ajo e përgatiste aq mirë. Nuk dinte çfarë të fliste, ishte i shtangur i tëri.

- Të kam përgatitur shtratin në dhomën e fjetjes. Ke nevojë të pushosh, tani edhe ti je operuar, mos harro. Ke nevojë të bësh kujdes më shumë për shëndetin.

- Po, po – i përgjigjej ai mekanikisht.- Ja po bëj një dush njëherë.

Më vonë, si mbaroi dushin, Bujari u shtri në dhomën që Besa e kishte përgatitur me kohë. Por si e kishte ditur ajo për gjithë këtë ngjarje, si? Ai kishte kërkuar të mos i tregonin.

Besa hyri me një tabaka në dorë ku ishin filxhanët me kafe. Për një moment, Bujarit iu duk thuajse asgjë nuk kishte ndryshuar në jetën e tyre, ja thuajse dje kishin qenë bashkë, thuajse kurrë nuk ishin ndarë… thuajse asgjë nuk kishte ndodhur… ishin gjithë ato vite të kaluara bashkë, por megjithatë çdo gjë dukej si një fillim i ri, po këtë herë i ndërtuar në themele shumë më të forta .

Ajo u ul në cep të shtratit dhe ia vuri filxhanin në komodinën afër kokës.

- Besa,- ia nisi Bujari duke mos guxuar ta shikonte mirë në sy,– si e more vesh, kur je kthyer?… Unë… unë jam shumë i befasuar, shumë i hutuar… nuk di ç'të them.

- Mos thuaj asgjë tani, kemi kohë për të biseduar, njëherë ke nevojë për të mbledhur forcat,- ia ktheu qetë ajo dhe shtoi:

- Nuk ka rëndësi si e kam kuptuar. Me rëndësi është se tani jemi këtu të dy. Është dashur të më tregosh për këtë që do të bëje, pse e ke fshehur? Nuk duhet ta dija unë?

- Nuk dëshiroja të të ngarkoj më. Mjaft pata marrë prej teje, mjaft të pata lodhur e shtrydhur. E ndjeja se duhet të të lija të lirë. Edhe tani… ja edhe tani… kam frikë se mos je kthyer nga mëshira, nga keqardhja për mua… ndonëse jam i gatshëm që ta pranoj edhe atë. Nuk dua të të humbas më, Besa. Nuk dua. Të lutem mos shko më!

- Kam ardhur sepse kam dashur të vij. Sepse dua të jem këtu, Bujar. Kemi bërë gjithë atë rrugë bashkë, por krejt papritur u gjendëm në një udhëkryq me shumë kahe, i cili na përplasi edhe në ca vende që nuk i deshëm. Pamë gjëra që nuk na pëlqyen. Përjetuam gjëra që na çanë zemrën më dysh, na shkulën shpirtin. Dhe ja ku u takuam sërish në dalje të udhëkryqit. Kjo tregon se rrugët që bëmë, thjesht duheshin bërë. Po të mos i kalonim, nuk do të arrinim ku jemi, nuk do ta gjenim njëri-tjetrin sërish.

Bujari ia shtrëngoi dorën. Ngriti sytë dhe falënderoi Zotin në heshtje. Pas kaq shumë kohësh ndjehej i qetë dhe i lirë.

XXV

Mëngjesi kishte kohë që kishte zbardhur. Shpëtimi hapi sytë me mundim dhe për disa çaste iu duk se ishte në apartamentin e vjetër. Pastaj sikur fotografitë u radhitën si duhet dhe ai e pa se gjendej në shtëpinë e sapo blerë të Bujarit. Edhe pse kishte disa javë që flinte aty, ende nuk ishte mësuar me shtëpinë e re. Ishte aq i lodhur nga dita e djeshme, sa që i dukej se mund të qëndronte tërë ditën i shtrirë.

"Eh, jam plakur, nuk jam më për ngjarje të lëmshta, të koklavitura,- mendoi.- Ajo që më nevojitet tash e pas është një jetë e qetë, të jem i rrethuar me njerëz të afërt e të dashur".

Shikoi orën mbi komodinë me sytë gjysmë të mbyllur.

"Oj, paska shkuar mesi i ditës,- qeshi me veten.- E pse po bëhem merak, ku do të shkoja, të hap shitoret e qytetit?". Buzëqeshi me shakanë që iu soll ndërmend dhe u ngrit ngadalë. Veshi papuçet, që ia kishte lënë e bija poshtë shtratit, dhe hapi dritaren. Ajri i freskët hyri brenda me vrull, sikur një turmë njerëzish që presin për biletat e koncertit të një këngëtari të njohur dhe turren brenda me t'u hapur dera.

- Oh, qenka ftohtë, shumë ftohtë,– tha Shpëtimi me gjysmë zëri .- Vjeshta vërtetë është në të mbaruar.

Doli nga dhoma dhe zbriti shkallët. Dëgjoheshin zhurma nga kuzhina; sigurisht e bija, Diella, po përgatiste mëngjesin.

- U zgjove, baba? – i tha ajo posa e pa të zbriste shkallët. – Të lashë të flije më gjatë meqë ishe i lodhur nga udhëtimi e nga të gjitha gjërat e tjera. Dje ka qenë një ditë e lodhshme për ty, sigurisht.

- Mirë ke bërë, Diella, shumë mirë. Sot, megjithëse pushova, po ndjehem si i rrahur me dru.

- Hajde, hajde baba, ti je ende i ri. Më shumë po ankohemi ne brezi ynë, se sa i juaji. Ju jeni kockë e fortë,- e shpotiti pak e bija më shumë për t'ia rritur moralin.

- Po pra. Edhe jemi. Mjafton çfarë kemi hequr me ju fëmijët, na keni plakur para kohe,– ia ktheu edhe ai po me shpoti.

E bija iu afrua dhe i dha një të puthur në faqe. U ulën bashkë për të pirë kafenë dhe Shpëtimi e pyeti:

- Kur do të vijnë nipat e mi dhe dashuria jote e jetës, dhëndëri im i dashur?

- Javën që vjen. Tash e pas do të jemi të gjithë bashkë. Jam shumë e lumtur. Të faleminderit, baba.

- Për çfarë?

- Për të gjitha.

- As mos e thuaj. Jam unë ai që kam përfituar nga gjithë kjo.

E bija i buzëqeshi me sy të përlotur.

- A thua si e kanë kaluar natën fqinjët tanë mbrëmë? - pyeti Shpëtimi pak nga kureshtja e pak për ta ndërruar temën e bisedës.

- Nuk e di, baba. Besoj se edhe ata kanë pasur nevojë për pushim. Të gjithëve na duhet pak kohë për t'u përshtatur në mjediset e reja. Kur njeriu shkon ku është më mirë, e gjen veten më lehtë, por kur shkon më ngushtë...

- Çfarë dëshiron të thuash?

- Po ja, frikohem se zoti Bujari do të ndjehet ngushtë në apartament, ka pasur gjithë këtë shtëpi.

- Jo, edhe ai e ka më mirë, bija ime. Shtëpia nuk është asgjë, është e bërë nga tullat, nga gurët e nga materialet e ftohta. Është njeriu ai që i jep shpirt. Bujari sot ka afër vetes ngrohtësinë që i nevojitet.

E bija pohoi me kokë. Mendoi gjatë në heshtje dhe sytë i kishin mbetur të fiksuar në një pikë të dyshemesë. Pas një heshtjeje disi të gjatë i ati e pyeti:

- Ka ndonjë gjë që të mundon?

- Jo…

- Nuk ndjehesh mirë, çfarë është? Mos ke bërë fjalë me burrin tënd?

- Jo baba, është diçka…diçka tjetër…

- Ma thuaj, pra.

- Kam frikë.

- Ke frikë? Pse, çfarë ka ndodhur?

- Baba… - ia filloi e bija sikur me hamendje.– Në kohën që ishe atje, në fakt pak ditë para se të niseshe, po shikoja lajmet dhe…

- Dhe, çfarë?…

- Në fund lajmëruan diçka për… për…

- Thuaje më, se më plase.

- Për Natyrën, baba. Për ish , ish-gruan... nuk di si ta quaj...

Shpëtimi mbeti pa fjalë. Ky emër i vinte aq i largët, gati i panjohur, ndërsa koha e kaluar me gruan e re i dukej si një ëndërr e largët, që të fiksohet diku brenda rafteve të trurit, ndonëse nuk ka asnjë rëndësi më për shpirtin. Thjesht mbetet si një ndodhi, si kujtim për diçka që dikur ka qenë pjesë e jetës, një pikë në rrugën që ke bërë; vetëm kaq.

"Dhe njerëzit mendojnë se unë jam i mençur, se gjithmonë bëj gjënë e duhur", mendoi.

- Baba! – e zgjoi e bija,- humbe në mendime.

- Po… po vërtetë… epo, çfarë deshe të më thuash? Jo prit! – sikur u kthjell.- Mos më trego, mos më thuaj asgjë, nuk dua ta di!

- Pse, baba?- e pyeti vajza e habitur.– Ç'është tani kjo, pse nuk dëshiron ta dish?. Unë…unë ka kohë që po hamendem për të ta treguar.

- Ja ashtu, nuk dua ta di. E di pse?

- Jo, pse?

- Sepse po të më thuash se ke dëgjuar diçka të mirë për të, nuk di si të them, kam frikë se nuk do të kënaqem, duke menduar se njerëzit si Natyra nuk e meritojnë një fund të lumtur, e kupton? Do të ndjej mëri a zhgënjim a dëshirë për hakmarrje dhe kjo më bën të keq, më trishton, sepse kjo hap derën e anës sime të errët. Më mirë të mos di gjë. Kam frikë nga ana e errët që, patjetër, ka vend në shpirtin tim. Nuk dua t'i jap frymë kësaj ane , nuk dua...

- Por, çfarë nëse lajmi është i keq?

- As këtë nuk dua ta di. Kam frikë se kjo do më bënte të ndihem mirë. Do të më dukej se fati megjithatë i ka marrë gjërat në duart e veta dhe i ka rregulluar. Kam frikë se do të kënaqesha për fatkeqësinë e saj, e kupton? Kam frikë se nuk do të jem i zoti ta ysht këtë ndjenjë të dobët. A më kupton tani?

- Kam frikë se jo, baba.

- Nuk ka gjë. Me rëndësi është se nuk dua ta sfidoj veten, e dashur. Nuk dua ta vë në provë, nuk dua ta shoh në pozitën e njeriut që kënaqet me fatkeqësinë e tjetrit, më frikëson kjo, më tmerron. Jo se mendoj se Natyra apo dikush njeri i lig nuk e ka merituar fatin e keq, por po mendoj se... ta shohësh veten se po kënaqesh pastaj në fatkeqësinë e atij personi ku ka rënë… kjo të bën gati të ngjashëm me të. Çfarë në fakt jemi të gjithë pak a shumë, pjesë të natyrës njerëzore.

- Domethënë, baba, nuk dëshiron të të them asgjë për Natyrën?

- Një pjesë e imja dëshiron. Por do ta luftoj.

- Mendoj se duhet ta dish, baba. Megjithatë, ka qenë pjesë e jetës tënde. Vërtetë për pak kohë, por ka qenë.

- Mirë, mirë,- lëshoi pak pe Shpëtimi, për të mos e munduar të bijën, me filozofimet e tij si prej një plaku të fantaksur, siç e quante ndonjëherë me ironi vetveten.- Por jo sot. Ndoshta… ndoshta ndonjë ditë do më tregosh ku gjendet, çfarë bën… Sa për ta ditur, mirë? Por jo tani.Të lutem.

- Mirë - i tha e bija. Por, pastaj shtoi:- Por ajo më nuk gjendet …

- Pst! Të thashë, asnjë fjalë.

- Mirë, – uli kokën e bija. Pas pak pyeti sërish:- Ti baba mendon se nuk ka një vijë që i ndan njerëzit në persona të mirë e të këqij?

- Nëse flasim për njerëzit e zakonshëm, pra jo për vrasësit, a për kriminelët e ndryshëm, edhe nuk ka, bija ime. Të gjithë ne në momente të ndryshme i kalojmë të dyja anët. Njeriu...

- Më ke intriguar, baba - e ndërpreu e bija- . Po njerëzit që i njohim, për shembull këta afër nesh?

- Cilët, për shembull, hajde!

- Për shembull teta Besa, ajo duket si një engjëll.

- Teta Besa është një grua me shumë virtyte e të meta. Ajo ka qenë gjithmonë në anën e njerëzve pozitivë, është një grua e ndershme e me shpirt të madh, por në ndonjë moment, dikujt mund t'i jetë dukur ndryshe.

- Kujt, për shembull, kur?

- Për shembull kur e la Bujarin. Ai ishte i thyer shpirtërisht. Ndërsa ajo kishte nevojë për hapësirë, ishte e lodhur nga të gjitha, nga vuajtjet, nga dhembja, nga gjërat që ndodhën në mes tyre dhe… dhe shkoi.

- Por baba ti më ke thënë se ka bërë mirë.

- Prapë po them se ka bërë mirë. Por të thashë edhe më herët, nga ndonjë kënd mund të duket egoizëm, e kupton?

- Po Diamanti, zoti Bujar, po unë baba, po ti?

- Nuk dua të flas për të tjerë tani, mundohu ta lodhësh vetë pakëz trurin tënd të vockël,– i tha Shpëtimi duke qeshur me kureshtjen e së bijës që ishte habitur me këto që po i dëgjonte nga i ati. Dhe pastaj mori një pamje më serioze dhe i tha:

- Por mund të të flas për veten time. Për këtë, po.

- Baba, ti je i përkryer,- i tha e bija.- Nuk dua të dëgjoj asgjë të keqe të thuash për veten tënde, e kupton? Asgjë. Ndryshe do të kesh punë me mua.

- Eh…- buzëqeshi dhimbshëm Shpëtimi.- Sikur të ishte ashtu... Por, nuk ka asgjë të përkryer, e mira ime, dhe e di pse? Jo sepse kjo është një klishe: "Nuk ka njeri të përkryer dhe pikë", – e tha Shpëtimi këtë duke i dhënë një zë tjetër, të huaj.– Jo, bija ime, nuk ka të përkryer ngaqë ajo që ty mund të të duket e shëndritshme, dikujt mund t'i duket e shëmtuar. Varet nga momenti, nga shijet, interesat, dëshirat, nga individi, rrethanat...

- Por, baba, ti nuk ke bërë kurrë asgjë të keqe.

- Ashtu kam menduar edhe unë. Por, a thua sa dhimbje u kam dhënë fëmijëve të mi me martesën time të dytë? Me atë lloj martese që bëra. Me kurorë, pa kurorë , ajo një lloj martese ishte. Ja, pra se si shkava në gabim.

E bija uli kokën.

- Nuk ishe i pari as i fundit që e ke bërë martesë të dytë, baba. Nuk ishte faji yt që nëna... që nëna... Jeta vazhdon për kë mbetet pas. Përndryshe ndjeheshe i vetmuar.

- Por jo të veproja në mënyrë të pamatur. Kisha humbur gruan, dashurinë time të jetës, a duhet të rrezikoja tani të humbisja edhe fëmijët e mi? Mendoj se duhej të bisedoja pak me ju, t'ju merrja mendim, e jo të prisja mirëkuptimin tuaj pa kusht, të prisja ta përqafonit vendimin tim menjëherë, të ishit të lumtur ngaqë isha unë. Jam treguar si një adoleshent i papjekur. Ja, kështu.

- Është e kaluar tashmë, baba. Lëre.

- Jo. Duhet ta them. Jam treguar shumë naiv, ndonëse të gjithë më mbajnë për të mençur. Nuk kam menduar fare si kam qenë në sytë tuaj, sa dhimbje ju kam sjellë.

- Por, baba, e thashë, ndjeheshe i vetmuar, kishe nevojë…

- Mjaft më arsyetove, bija ime. Është e vërtetë, ndjehesha i vetmuar. Ju shkuat rrugës suaj dhe unë mbeta krejtësisht vetëm, pa shoqen time. Kisha nevojë ta mbushja atë zbrazëti, atë gropë mu në mes të shpirtit. Dhe nuk po them se gabova që u martova. Ajo që kam gabuar ishte mënyra si e kam bërë atë martesë, e kupton, bija ime? Mënyra. Jo personi, meqë në vend të Natyrës ka mundur të jetë ndonjë grua tjetër, e tillë që të kishte mendim të jetonim bashkë. Por mënyra si kam vepruar me ju, pavarësisht personit me të cilin jam martuar, ka qenë e gabuar. Kam menduar se nuk më duhet mendimi juaj, se ju duhet ta pranoni dhe aq. Dhe a din çfarë me mundon më së shumti në gjithë këtë?

- Çfarë, baba.

- Se fati ka dashur që ju të provoni një ndjesi që unë vetë nuk e kam provuar. Mua nëna më ka vdekur vonë, nuk e kam ditur si mund të ndjehesh kur dikush tjetër vjen në vend të saj. Dhe pastaj, krejt lehtë, kam dashur që fëmijët e mi ta pranojnë këtë fakt si gjënë më të natyrshme në botë. Madje kur ju shihja ndonjëherë se nuk e kishit të lehtë, më pengonte, e di se jam treguar shpesh pa mend, pse mërzitesha edhe në ju. Prisja nga ju ta flaknit dhimbjen në çast dhe të adaptoheshit në rrethanat e reja menjëherë, thuajse u rilind nëna juaj. Nuk e kisha të rëndë, ngaqë nuk ishte nëna ime ajo që mungonte, por ishte e juaja.

- Por nëna ishte gruaja jote, baba.

- Po. Gruaja më e mirë në botë. Por jo nëna. Jo Nëna po them.– foli Shpëtimi dhe i rrodhën ca lot.

- Mos u pikëllo, baba, nuk mund të të shoh kështu. Nuk është koha.

- Jo, e dashur, por dua të them se…- tha Shpëtimi duke fshirë sytë,- se njeriu shpesh bëhet i keq, egoist, negativ. Edhe pa dashur. Këtë e kam kuptuar një ditë kur kam menduar për nënën time, të vdekur para shumë dekadave tashmë. Dhe pastaj a di çfarë bëra?

- Çfarë, baba?

- E paramendova sikur babai im ishte martuar me Natyrën, ndërsa unë isha i vogël. Nënën e paramendova të vdekur. Më erdhi aq zor, aq vështirë. Pastaj u kthjella. Thashë: o Zot! Po këtë e kanë përjetuar fëmijët e mi! Kam qarë, kam qarë shumë.

- Baba, ne jemi të rritur, të kuptojmë, ka qenë momenti i tillë.

- Megjithatë, duhet të kisha vepruar ndryshe. Shpresoj të ma falni një ditë.

- Oh baba,- e përqafoi e bija.– Ne të duam shumë, nuk kemi çfarë të të falim. Jemi të lumtur që të kemi. Vërtetë më vjen keq që gjërat rrodhën ashtu me Natyrën. Ajo… ajo ishte tip i tillë… Ti baba ndoshta edhe mund të gjesh dikë tjetër… nëse do, ne nuk kemi asgjë kundër… Madje...

- Oh, ç'më bëre të qesh tani, ç'më shkrive… thua të më marrë kush kështu të plakur, sikur jam?

- Ç'thua, baba, ti je sikur artist. Jam e bindur se vajzat akoma marrosen pas teje.

- Jo, bija ime, jo. Ato ma të mirat kanë burrat e tyre tashmë. Ndërsa për të tjerat jam plakur. E di çfarë? Tani më mjaftoni ju. Kam edhe miq të shumtë për ditët e pleqërisë. Vitet nuk e plakin njeriun, bija ime, njeriu plaket kur është i vetmuar. Kur nuk ka familje dhe miq.

- Atëherë ti do të mbetesh përgjithmonë i ri.

- Po, pra.

Në korridor u dëgjua cingërima e telefonit. Babë e bijë u shikuan me habi.

- Kush mund të jetë tani?

- Kushedi, – tha Shpëtimi.- Po shkoj unë.

Telefoni vazhdonte të cingëronte dhe Shpëtimi mbërriti ta kapë receptorin ende pa iu sosur durimi atij që ishte matanë.

- Alo?.. Kush është?

- Axha Shpëtim, jeni ju?

- Po...

- Diamanti jam.

- Ooo, Diamant, nuk ta njoha zërin, po si je mor bir?

- Mirë, mirë… Në të vërtetë shumë mirë, por nuk munda të kontaktoj me prindërit e mi. Ti e din ata nuk mbajnë celularë, babi sikur e kishte një por nuk e di ç'e bëri, as numrin nuk ia kam ditur. Nuk di si t'u lajmërohem, më vjen keq për shqetësimin.

- Ç'është ajo, Diamant! Nuk ke faj fare. Kjo gjë do të rregullohet shpejt, sepse kam bërë kërkesën që numri juaj të kalojë andej.

- Nuk mund t'i marr në numrin që keni pasur në apartament?

- Ai është i Arbenit tani e ai ndoshta është fjetur apo ka dalur, por e di si t'ia bëjmë? Unë po shkoj tek ata me celularin tim, ndërsa ti thirr brenda gjysmë ore, mirë? Ose unë po ua përcjell porosinë, si thua?

- Jo, axha Shpëtim, kam nevojë të flas goja-gojës me ta.

- Epo u kuptuam atëherë. Merr pas gjysmë ore. Mirupafshim.

- Mirupafshim.

- Uh prit, Diamant! Nuk të pyeta për Mimozën, si është?…

Në anën tjetër Diamanti kishte ulur receptorin dhe tani dëgjohej vetëm sinjali i mërzitshëm tu-tu-tu.

****

Bujari kishte kohë që ishte zgjuar. Ndjente ca dhimbje në shpinë. Mjeku i kishte thënë që janë të natyrshme. I mori barërat dhe u ul mbi tavolinë. Besa duket se ende po flinte. Shikonte me sy rreth e rrotull, sikur nuk e besonte se kishte ndërruar shtëpi. Nuk ishte penduar, ndonëse e dinte se apartamenti nuk mund t'u ofronte hapësirën që kishin pasur më parë.

"Le të më ofrojë ngrohtësi, më mjafton" mendoi.

U ngrit ngadalë dhe vuri kafenë. U gëzua nga fakti se po bënte gati dy filxhanë. I dukej e tëra si ëndërr, me gjithë këto që kishin ndodhur këto ditë...

- Mirëmëngjesi,- e dëgjoi Besën që i foli me të hyrë në derë.- Si ke fjetur, a ke pushuar si duhet?

- Më mirë s'bëhet!

- Po pse je munduar me kafetë, ja unë do t'i kisha bërë. Më kishte kapluar gjumi, ndonëse ti e di, zgjohem herët.

- Nuk ka gjë, po më jepte kënaqësi. E di çfarë? Më duket se apartamenti është më i mirë për moshën tonë. Disi është më i mbledhur. T'i mban brenda edhe mendimet.

Të dy qeshën.

Megjithatë Besa e bindi të ulet, priti derisa vloi kafeja dhe pastaj e hodhi nëpër filxhanë.

- Nuk mund ta besoj se je kthyer,- i tha dikur Bujari.

- Është paksa e çuditshme. Aq shumë gjëra kanë ndodhur ndërkohë, ndërsa ndonjë herë më duket thuajse asgjë nuk ka lëvizur.

- E di për çfarë frikohem tani. Ndoshta mund të të dukem i çmendur.

- Thuaje!

- Frikësohem mos shpirti i Dorinës shkon në shtëpi dhe nuk na gjen. Ose vjen në apartament e na gjen, por ndihet e huaj këtu.

- Jo, jo Bujar. Shpirti është shpirt dhe ai është aty ku i ka të dashurit e tij. Hapësira nuk ka rëndësi.

- Je e sigurt?

- Më se e sigurt. Dorina është me ne kudo që të jemi,- tha Besa dhe vazhdoi:– Një ditë kam menduar gjatë për humbjen që pësuam, në përgjithësi të gjithë ne. Dhe mendova se më keq nga ajo që thuhet "të kesh një herë e pastaj ta humbësh" është " të mos kesh kurrë dhe nuk ke çfarë të humbësh, thjesht s'ke dhe nuk ke". Mendoj se duhet të jemi të drejtë, Bujar. Kemi pasur shumë gjëra që janë të rëndësishme në jetë: fëmijët e mirë, fatin e mirë, familjen e mirë. Duhet të jemi të kënaqur, kjo është jeta. Duhet të jemi të lumtur se e kishim Dorinën aq sa e kishim. Të lumtur se dikush jetoi me ne e për ne, ndau me ne të keqen e të mirën, mori frymë afër nesh, ndau mendimet me ne, ndau dëshirat…na deshi Bujar, ashtu si e deshëm. Martesa jonë ishte si një barkë mes detit pa valë dhe ne, të mësuar në qetësi, nuk ditëm të gjendemi pastaj para furtunës së parë që u dha në breg.. Na u zu fryma nga zbrazëtia që na rrethoi, nuk dinim të ishim të pikëlluar ngaqë ishim mësuar të jemi të lumtur, ashtu siç ishim, edhe pse ajo lumturi nuk ishte. Ishte një martesë artificiale ku aktronim si bashkëshortë të kënaqur. Por që nuk na jepte dhimbje, fshiheshim pas saj si fëmijë. Çfarë mund të ndërtosh mbi asi lloj themelesh? Asgjë të fortë, natyrisht. Dhe pastaj kur u njohëm me trishtimin, kot i mëshonim murit me kokë.

- Ke të drejtë,– tha Bujari i përlotur.– Shpresoj se kemi marrë një mësim të mirë nga krejt kjo. Por e kam vështirë, Besa, e kam vështirë akoma, nuk mund të pajtohem ende me fatin që e humbëm.

- Fati duhet pranuar ashtu si është. Ti duhet të jesh i lumtur, sepse më i lumturi është ai që bën të tjerët të lumtur. Shih çfarë ke bërë me Arbenin, me Jetën… Kështu edhe mua më ke bërë të lumtur, dhe jam e sigurt se ke bërë të lumtur edhe Dorinën. Ti ke për kë të jetosh, dikush nuk e ka askënd as për të ndarë lumturinë, nëse e ka njohur. Ti e ke njohur, sepse e ke njohur Dorinën dhe tani e ke zemrën të pasur. Na ke neve, Bujar. Ndihesh akoma i humbur, por nuk je vetëm.

- Por fati është vërtetë i pamëshirshëm. Mu atëherë kur mendon se ke kohë të marrësh frymë, të grushton në shpinë. Ngrihesh, drejtohesh dhe prapë grushti tjetër. Kështu ky treni i jetës sonë ecën duke u hamendur, ndalet nëpër stacione dhe pastaj shpejton tutje. Dallojnë vetëm njerëzit që hipin në të: Disa mezi presin të ndalen e t'i fërfëllohen dikujt në përqafim, dikush nuk dëshiron të arrijë kurrë askund sepse s'ka çfarë i pret në stacion përveç pikëllimit. Të tjerët e kanë njësoj. Thonë çfarë është e shkruar do të ndodhë, – tha Bujari disi në mendime.

- Por, po të bënim si këta të fundit, çfarë do të ndodhte?!- tha tani Besa me optimizëm.- Nuk do të arrinim kurrë askund. Ne nuk mund të qëndrojmë dhe të presim të na shtypë orteku që është nisur drejt nesh e të mos lëvizim, ashtu si nuk mundemi të lejojmë të na gllabërojë deti me valë të mëdha, nëse kemi një dërrasë për t'u kapur e për të shpëtuar, për të mbijetuar. Nëse do prisnim që të bëhet çdo gjë si është e shkruar, atëherë do të duhej të prisnim derisa toka të hapet e të na kapërdijë, kur afër nesh kalon dora e ndihmës, dërrasa e shpëtimit, dora e mirë. Do ta shikonim në mënyrë fataliste si e largojnë valët përgjithmonë drejt hiçit, bashkë me neve.

- Por ndonjë herë fati na shtyn të bëjmë gjëra që me dëshirë do t'u ishim shmangur,– tha Bujari pak me keqardhje.

- Po. Por kjo ndodh jo pse është e shkruar, por sepse në atë moment ne kemi zgjedhur të veprojmë ashtu. Kemi të drejtë të gabojmë, nuk kemi të gjykojmë.

- Eh, Besa, çfarë do bëja pa ty… do të ma falësh ndonjëherë?

- Të dy duhet t'ia falim njëri-tjetrit dhe të gjejmë qetësi me veten tonë. Por tash e pas do të jemi të sinqertë me njëri-tjetrin. Mendoj se kjo na ka munguar prej fillimit. Pse tani të mundohemi të ndërtojmë kulla prej kujtimeve, të cilat do të rrënohen nga vala e parë e sfidave që do të na vijnë? Kemi një martesë që është e vërtetë, që është reale, nuk është e përkryer, po është solide. Ke të drejtë. Tani ndihem njeri tjetër.

U dëgjua zilja e derës dhe kur Besa e hapi, para saj gjendej Shpëtimi, të cilit i merrej fryma nga të shpejtuarit.

- Besa, kape celularin, filloi të cingërojë kur u ngjita shkallëve, Diamanti është.

Besa ia rrëmbeu nga duart, ndërsa Shpëtimi hyri brenda. Ia bëri me dorë se mund të gjendej vetëm dhe ajo u humb në dhomë të fjetjes.

- Mirëmëngjesi, Bujar!

- Oh, eja Shpëtim, mirëmëngjesi, qenke bërë i kuq flakë.

- Eh, më bëri biri yt. Plus që kam shtuar ca kilogramë tani në pension. I thashë të thërriste pas gjysmë ore, por ky nuk paska durim as dhjetë minuta. Mirë që arrita te dera.

- Diamanti është? Epo e ka marrë malli për të ëmën.

- E pyeta si është Mimoza, por e kishte mbyllur atë çast. Shpresoj të jetë bërë më mirë.

Mu atëherë nga dhoma tjetër u dëgjua një britmë e Besës dhe të dy burrat u ngritën në këmbë. Panë Besën që po afrohej e tëra në lot dhe mu atëherë kur Bujari hapi gojën ta pyeste, ajo bërtiti duke pasur akoma telefonin në dorë dhe duke iu gjuajtur në përqafim:

- Bujar! Do të bëhemi gjyshër! Mimoza është shtatzënë! Po kthehen muajin tjetër!.

Të dy burrat u panë një herë pa fjalë. Bujarit sikur i ishte marrë goja ndërsa Shpëtimi u përmblodh i pari dhe i tha:

- Urime, o mik, o sa jam i lumtur, jam shumë i lumtur për ju.

- Oh, Bujar, Arbeni më pat thënë se do të na ndodhë diçka e mirë… më pat thënë...- qante e qeshte Besa.

Bujarit i rridhnin lotët teksa përqafonte Besën. Fati ia kishte dërguar vërtetë dorën më të bukur të shpresës përmes valëve të shpirtit të trazuar.

XXVI

- Më shpejt, më shpejt! Hajde lëvizni, nuk e kemi tërë ditën në dorë.

- Oh, teta Jolanda, na mbyte, ja, edhe pak e mbaruam, - flisnin të mbushura frymë Hera e Jeta, që po bartnin kuti të mëdha dhe po i vendosnin në veturë.

- I keni ndarë mirë? – i pyeti Jolanda.

- Po, po, na ka ndihmuar teta Besa. Ja në këto kutitë këtu ka lodra, këtu ka rroba, në këto të tjerat ka ushqime.

- Mirë, mirë. Hajde, po nisemi tani. Duhet kohë për t'i shpërndarë.

Te dera doli Besa. Mbante edhe ca sende të tjera dhe, pasi i vendosi brenda veturës, ofshau thellë dhe tha:

- Më duket se këto janë të gjitha për sot. Qysh nesër do të organizohemi për javën tjetër, në rregull?- pastaj iu kthye Jolandës: – E dashur, mendon se do të funksionojë kjo shoqatë?

- Patjetër. Mjafton që mban emrin e Dorinës. Tani për tani, kemi pak donatorë, por me kohë do të shtohen, të jesh e sigurt. Organizatat vullnetare bamirëse janë gjithmonë të mirëpritura. Më vonë, kur të kemi ndihma më të mëdha, do të kujdesemi edhe për gjërat e tjera që u duhen nevojtarëve.

- Të faleminderit, Jolanda, për këtë nismë. Ndihem shumë e përmbushur, më rehatohet shpirti, më bën të ndjehem mirë.

- Edhe unë sikur jam përtërirë. Me këto dy dallëndyshet afër, jam bërë me krah edhe unë,– ia ktheu Jolanda dhe buzëqeshur duke i shikuar vajzat, që ishin skuqur pak nga ajri i ftohët e më shumë nga entuziazmi.

Ndonëse pranvera i kishte bërë hapat e para, ajri ishte akoma i freskët. Natyra kishte filluar të gjallërohej dhe, pavarësisht gjurmëve të dimrit, diku rrëzave të gardheve lulet e para kishin nxjerrë kokën.

- Mund të ndihmoj edhe unë ndonjë gjë? – u dëgjua zëri i Arbenit që kishte dalë në ballkon e po i vështronte. Fytyra i kishte marrë pamje të shëndetshme dhe sytë i ishin gjallëruar.

- Jo, jo, mjafton që na ke bërë listat e familjeve që kanë nevojë për ndihma. Ti i njeh më mirë.

- Po. Kam qenë pjesë e tyre. Ndaj dua t'u ndihmoj me shpirt.

- Baba, këto janë kutitë për atë nxënësin tënd me pallto të bardhë, të kujtohet ëndrra?

- Posi.

- Tani ngutuni, se pastaj keni mësimet. Mos harroni edhe vjershën!– u tha Besa vogëlusheve me një zë sikur qortues, por mbushur dashuri.

Vajzat ia bënë me dorë dhe u futën brenda veturës. Jolanda u buzëqeshi në shenjë përshëndetjeje dhe pastaj hyri edhe ajo. Ndonëse kishte vitet, Jolanda kishte ruajtur në fytyrë vijat e një vajze të re e të bukur sikur nga ndonjë pikturë e njohur. Ishte mishërimi i një gruaje të fortë, që e kishin kalitur vuajtjet, dhe e vajzës së brishtë e të thyeshme, që mbante brenda zemrës dashuri për të dobëtin.

- Mirupafshim!– iu bërtiti Besa nga pas e pastaj iu kthye Arbenit duke vënë dorën mbi vetull për t'u mbrojtur nga dielli:- Arben do vish për kafe? Edhe Bujari është zgjuar.

- E kush mund t'i rezistojë kafeve të tua, moj Besa?

- Po më bën qejfin.

- Jo, vërtetë. Eja t'i provosh të miat, pa të flasim!

Besa buzëqeshi dhe u fut brenda. Bujari ishte zgjuar dhe po lexonte gazetën. Kishte vënë syzat dhe ishte thelluar brenda saj, ndaj nuk e vuri re gruan kur hyri në dhomë.

- Çfarë thonë gazetat sot? – e pyeti Besa duke ecur përskaj tij.

- Oh, paske hyrë brenda,- tha ai duke hequr shikimin nga artikujt.– Paj, asgjë të mirë, si zakonisht. Kokë e këmbë lajmë të këqija. Ja shih, vendin e ka kapluar kriza politike, ekonomike, energjetike; gati nuk funksionon asgjë. Politikanët luftojnë për postet, populli vuan, ndërsa bota bën sehir sepse tekefundit ka halle të tjera. Ja shih edhe lajmet nga bota: diku luftëra, vrasje, aksidente, fatkeqësi të mëdha natyrore, njerëzore… mijëra të vdekur, thuajse ka arritur fundi i botës.

- Kot nuk thonë se për mediat lajmi i keq është lajm i mirë.

- Po. Dhe e di çfarë më çmendi fare?

- Çfarë?

- Ja shih, lexoj për një këngëtare budallaqe që nuk njeh as vendin e vet dhe nuk ka bërë as shkollën e mesme. Thuhet këtu se edhe zërin e ka të huazuar nga kompjuteri. Në intervistën e saj flet se nuk di si t'i shpenzojë paratë, ndaj ka vendosur t'i sigurojë këmbët në disa miliona dollarë. Ndërsa krejt afër saj është artikulli për fëmijët që vdesin nga uria. Dhe ta mendosh se kjo këngëtare bën popullaritet duke marrë pjesë gjoja në koncerte humanitare! Të plasësh fare.

- Kështu funksionon bota, Bujar. E di çfarë më duket më e keqja? Se mu në vendet e varfra bëhen luftëra, vjedhje e vrasje, thuajse nuk janë të dënuar mjaft tashmë. Sheh fëmijët e uritur, skelete të gjallë që mbajnë pushkët në dorë. Ata nuk e dinë as për kë e as për çfarë luftojnë. Por është mënyra e vetme që e kanë mësuar. Ua kanë mësuar, thuaj. Është e tmerrshme, e tmerrshme.

- Po, njëmend. Ndonëse kohët e fundit edhe në vendin tonë është shtuar varfëria. Nuk mund të duroj kur i shoh në televizor familjet, që nuk kanë asgjë në sofër, që s'kanë një pikë qumësht për fëmijët. Ta thotë zemra t'u ndihmosh, por pastaj del tjetra, dhe tjetra, dhe tjetra… E pastaj e kupton se nuk mund ta ndihmosh të gjithë botën dhe kjo të bën të ndjehesh aq i pafuqishëm e aq i padobishëm sa s'ka.

- Të paktën po bëjmë aq sa mundemi.

- Po. Ideja e Jolandës për këtë shoqatë bamirëse ishte fantastike. E di se ishin lajmëruar edhe disa nxënës vullnetarë për të ndihmuar?

- Po, më tregoi. Kjo është e mahnitshme. Në botë ka njerëz të mirë, Bujar.

Ndërkohë, u dëgjuan të trokiturat e Arbenit në derë dhe Besa e futi brenda.

- Nuk punon zilja? – pyeti sapo hyri.- Ka kohë që po i bie.

- Punon, por nuk kemi rrymë, – tha Besa .– Edhe kafetë i bëra me gaz.

- Eh, po vërtetë, harrova. Vaj halli për ata që nuk kanë ngrohje.

- E di që po gëzohem se po del pranvera? Mu për këta njerëz pa kulm mbi kokë. Së paku qiellin ta kenë pullaz të ngrohtë, – foli Besa me pezëm.

- Ke të drejtë, skamja është shumë e rëndë, sidomos kur ke fëmijë.

Që të tre heshtën për një kohë, secili me mendimet e veta. Dëgjoheshin vetëm zhurmat e filxhanëve kah përplaseshin në pjatat e tyre. Dikur Arbeni ofshau thellë dhe tha:

- Dua t' ju tregoj një gjë rreth meje.

- Po, Arben.

- Kanë kaluar disa muaj tashmë dhe unë jam forcuar. Mendoj t'i kthehem punës sime në arsim, e dua këtë punë, i dua nxënësit e mi.

- Është e mrekullueshme!– tha Besa.– Dhe nuk kërkon ndonjë mundim të madh fizik, që për ty është i papërballueshëm.

- Vërtetë paguhet pak, ju e dini. Arsimtarët janë të mënjanuar plotësisht nga shoqëria. Kur shoh profesorët e mi si presin në radhë para bankave për të marrë pensionin, që është baras me ndihmat sociale, më vjen të çmendem. Por, megjithatë, unë e dua këtë profesion.

- Patjetër. Por, a mendon se të kthejnë në punë pas kaq kohe?

- Drejtori i shkollës është një njeri i mirë. Gjithmonë ka pasur mirëkuptim për mua derisa nuk kishte më çfarë të bënte. Mundohej të organizonte fushata në shkollë për të më ndihmuar, por njerëzit sot nuk kanë as për vete. E thirra në telefon para disa ditësh dhe më tha se së shpejti do të hapet konkursi. Më tha se mua do të më jepnin përparësi, meqë kam qenë më parë në atë punë.

- Epo ky është një lajm i mrekullueshëm, – bërtiti Besa gjithë gëzim.

- Të thashë, lajmet e mira nuk gjenden nëpër gazeta, – ia priti Bujari dhe qeshën të tre.

- Një herë më pat shkuar mendja të iki jashtë shtetit, me t'u forcuar nga shëndeti. Ta marr edhe Jetën dhe të gjej ndonjë punë andej.

- Jooo, kurrsesi, – thanë bashkëshortët thuaja me një zë.

- Mjaft isha në kurrizin tuaj, kam nevojë të kthehem mbi këmbët e mia. Megjithatë e mendova mirë. Nuk dëshiroj të shkoj atje ku vajza ime do të ndjehet e huaj tërë jetën. Dua të qëndroj këtu. Mirë, keq, është vendi ynë. Duhet të përshtatemi për sa na ofron.

Besa pohoi me kokë dhe pastaj shtoi:

- Pajtohem plotësisht me ty, Arben. Edhe unë kam dëshirë ta shëtis botën, por pastaj përsëri të kthehem në folenë time. Njeriu me moshën lëshon rrënjë. Vërtetë ndonjëherë më duket thuajse këtë vend e ka marrë lumi, por është i yni, i të parëve tanë. Ndonëse gjithmonë e kam thënë se unë jam banore e planetit, askund nuk e kam shpirtin të qetë pos këtu.

- Po,– tha Arbeni.– Tani desha të bisedoj edhe një gjë me ju. Kanë kaluar këta muajt e krizës pas operacionit dhe mund të angazhohem më tepër.

- Rreth çkahit?

- Paj, e dini atë shtëpinë e vjetër që e kam pasur?

- Tani ishte rrënuar fare nga dimri, na tregoi Jeta ,– tha Besa.

- Po, por unë dëshiroj që sapo të bëj paratë e para, të filloj e të ndërtoj një shtëpi të vogël aty, sa për fillim. Të thjeshtë, njëkatëshe. Do të marr ndonjë kredi dhe do të kërkoj të bëj edhe ndonjë punë tjetër, së paku përkohësisht. Shpresoj në ndonjë organizatë ndërkombëtare, ata i paguajnë edhe pastruesit më shumë sesa shteti ynë paguan doktorët e shkencave dhe specialistët. Ti e di këtë më së miri, Bujar, je profesor universiteti.

- Po, po, eh… më bëre të qeshem nga sikleti, Arben. Po çfarë të bësh? Po të kisha mundësinë të zgjidhja, përsëri do të zgjidhja shkencën, unë nuk di zanat tjetër. Besa kaloi më mirë. Ja tani jep orë private pianoje për ca fëmijë parashkollorë dhe ia nxori paratë zanatit.

Të tre qeshën përsëri, ndërsa Besa tha:

- Vërtetë, po. Madje po ta kisha edhe ndonjë zanat tjetër do më pëlqente, për shembull të jem rrobaqepëse. Por një dëshirë që e kam pasur si e vogël, nuk mu ka plotësuar kurrë. Ka mbetur e fshehur gjithmonë, sekret.

- Vërtetë? – u habit Bujari.- As mua nuk ma ke treguar?

- As ty.

- Tani më bëre kureshtar, hajde na e thuaj!

- Më premtoni se nuk do të qeshni?

- Jo, jo kurrsesi,- thanë të dy burrat njëzëri.

- E pra, gjithmonë kam dëshiruar t'ia huazoj zërin tim ndonjë personazhi të filmave vizatimor. Mos qeshni tani, hë pra.

Bujari e Arbeni kishin mbetur gojëhapur. Pastaj i pari u përmblodh dhe, duke u munduar të ishte sa më serioz, i tha:

- Kjo qenka dëshira më e pazakontë që e kam dëgjuar të kërkohet nga një grua. Mirë, që gratë ëndërrojnë peliçe të shtrenjta, shtëpi luksoze dhe udhëtime rreth botës, të gjithë e dimë. Por t'ia huazosh zërin një personazhi nga filmi vizatimor? – tha Bujari me habi dhe pastaj filloi te qeshte.

- Të thashë se do të qeshesh.

- Oh jo, nuk qeshem ngase më duket e çuditshme dëshira jote, grua. Përkundrazi, qeshem sepse më gëzon fakti se ke ruajtur brenda vetes pjesën tënde më fëmijërore.

- Ndoshta dhe mund të të realizohet një ditë, – tha Arbeni.

- Nuk e besoj,- tha Besa. Ajo dëshirë është mësuar aq mirë me mua, sa tani e ka vështirë të zgjohet nga gjumi dhe të realizohet. E kam ushqyer mirë afër vetes. E ke vërejtur? Ndonjëherë mu kur mërzitemi nga ndonjë dëshirë e jona dhe e flakim tutje, ajo shpejton dhe realizohet. Por derisa e mbajmë ngrohtë afër vetes, asaj nuk i ngutet.

- I ke teoritë interesante,- tha Arbeni.- Por shih, edhe mund të realizohet, sepse ja, për shembull, unë pasi të punoj, mund të bëj ndonjë shfaqje me kukulla për fëmijë dhe ti mund t'ia huazosh zërin ndonjë personazhi pas perdes. Do ta bëje këtë?

- Me kënaqësi.

- Epo u morët vesh ju. Ju ka mbetur vetëm edhe kontrata e punës,– u tha Bujari duke qeshur.- Më pranoni mua për menaxher, grua? Meqë flitet se ata marrin përqindje të mëdha fitimesh.

Që të tre u shkulën gazit dhe pastaj Arbeni sikur u kujtua dhe vazhdoi:

- Eh po, se dolëm nga tema, pra, siç po e thosha, kam plane pune dhe vërtetë këtë herë mendoj se do t'ia dal. Ndjehem i fortë dhe plot elan për punë. Pra do të angazhohem me të gjitha, pa harruar edhe punën bamirëse në shoqatën e Dorinës tashmë. Dhe një ditë, kur ta ndërtoj shtëpinë, dua që apartamentin ta merrni prapa.

Të dy bashkëshortët u bënë gati për të folur diçka, por Arbeni ua preu me dorë dhe u tha:

- Ju lutem. Nuk dua të diskutoj për këtë. Tekefundit kjo gjë nuk do të ndodhë nesër. Por, dua ta respektoni vendimin tim, kam nevojë të bëj diçka në jetë për vete, për time bijë ,por edhe për të tjerët. Pra, një ditë, unë do ta ndërtoj shtëpinë time dhe ju mund t'ia bashkëngjisni sërish apartamentit tuaj pjesën tjetër. Keni bërë mjaft për ne.

- Por do t'ju kemi më larg pastaj.

- Jemi me një qytet. Pastaj Jeta e ka shkollën afër jush dhe jam i bindur se do të qëndrojë më shumë te ju se tek unë në shtëpi. Ajo tanimë ju konsideron si gjyshërit e saj.

- Edhe ne si mbesë e duam.

- Tani po iki, se dua të dal me mëngjes të kryej ca punë. Kam disa takime.

- Edhe me ndonjë vajzë? – e shpotiti Bujari.

- Lëre Arbenin rehat, – i tha Besa.

Arbeni ishte skuqur dhe po qeshte nën buzë. Dukej i turpëruar por shihej se nuk e hidhte poshtë edhe këtë që ia tha Bujari.

- Ndoshta një ditë, nuk e di. Por një herë dua të mendoj për ato që biseduam, të përgatis dokumentet për konkursin e shkollës, të luftoj që ta fitoj prapë punën time. Pastaj, po qe se ndodh ndonjë ditë, do ta bisedoj gjatë me Jetën, do ta pyes nëse do ta pranonte një gjë të tillë. Pa lejen e saj nuk do ta bëja kurrë. Nënën nuk mund t'ia zëvendësojë askush, por së paku të ketë një kujdes më tepër, një dorë gruaje, një këshillë femre kur të rritet.

- Edhe ti ke nevojë për një shoqe jete,- i tha Bujari.

- Njerkat nuk janë si nëpër përrallat, Arben,– tha Besa.- Vërtet mund të gjesh një grua të mirë që do të kujdeset për Jetën dhe për ty ashtu si duhet. Me zemër. Nuk domethënë se vetëm fjala nënë të kualifikon për person të shenjtë. Çfarë t'i thuash atyre që braktisin fëmijët e porsalindur nëpër bidonët e plehrave? Të quhen nëna ato?

- Ke të drejtë, Besa. Të faleminderit shumë. Vërtetë këto gjëra mund t'i bisedoj vetëm me ju të dy. Ju kam si prindër, si motër e vëlla. Jeni gjithçka që kam, jeni miqtë e mi më të mirë .

- Edhe ne ju duam, – tha Besa.

-Tani mirupafshim dhe ju faleminderit në kafe. Edhe pse e pjekur në gaz, ishte e mrekullueshme si gjithmonë.

- Vazhdo me këto lajka dhe vajzat do të të zënë derën, – i tha Besa duke e përcjellur.

Arbeni qeshte dhe e falënderoi me sy për dashamirësinë e saj. Për atë që ishte e këndshme, e afërt dhe e ngrohtë. I përshëndeti edhe një herë e shkoi.

"Është shumë djalë i mirë,- mendonte me vete Besa teksa po kthehej korridorit për në dhomë.- Vërtetë dëshiroj ta shoh të lumtur e të plotësuar, ndonëse ka edhe shumë rrugë e sfida për të kaluar". Hyri pak për të rregulluar dhomën tjetër dhe vëmendjen ia tërhoqi zëri i Bujarit. Me kë po bisedonte tani Bujari? Ajo nuk dëgjoi dikë të kishte hyrë.

U nis kah dhoma dhe kur hyri pa Bujarin që po sillej në dhomë me telefonin në krah. Fytyrën e kishte të çelur si petalet e lules afër diellit.

- Kush është? – e pyeti Besa më shumë me shenja se me zë, duke ia bërë me dije se nuk kishte durim derisa t'i tregonte.

- Është Diamanti, moj plakushë, ja prit, kij durim, aman, se ma shkule receptorin nga veshët. Diamant të përshëndes se mbeta pa vesh…

- Mirëmëngjesi, bir,– i tha Besa me të marrë në dorë receptorin. - Mirëmëngjesi, mama, – i tha Diamanti me një zë që tregonte se ndjehej fare mirë.

- Ky babai yt ka një orë që bisedon me ty dhe fare nuk më lajmëron mua në dhomën tjetër. Nuk e kisha dëgjuar zilen e telefonit, aman shyqyr që ky nuk punon me rrymë.

- Një orë? – qeshte Bujari…- po ishin vetëm tre minuta, moj…

- Mama, këtë vikend po vijmë në shtëpi për t'ju vizituar. Mimoza po ndjehet shumë mirë, tani nuk ka më asgjë nga ato simptomat që e mundonin. Por... është rënduar paksa. Kemi menduar të vëmë kurorë.

- E mrekullueshme, bir. Po dasmën?

- Mama, nuk dëshirojmë dasmë. Ndonjë drekë të thjeshtë për miqtë tonë dhe aq.

Besa vari buzët dhe heshti. Diamanti, me ta kuptuar heshtjen e saj, i tha duke qeshur:

- Hë, i vare buzët ti? Aman, mama, dasmat me qindra njerëz janë të tejkaluara tashmë.

- Por të kam një djalë…

- Po sa deshe ti? Një ekip futbolli?

- Jo, bre Diamant, por sikur nuk kishim ndonjë gëzim të madh moti në shtëpi.

- Mama, shih! Ne e kemi biseduar me Mimozën. Tani të dy, përveç studimeve, jemi të punësuar dhe i kemi ca para, meqë nuk paguajmë më qira. Na keni blerë apartamentin.

- Ju takon ta nisni jetën tuaj pa dy pleq të mërzitshëm mbi kokë,- i tha Besa.

- Mos e thuaj, mama. Kemi shumë nevojë për ju. Sidomos Mimoza, ti e di që asaj i mungon dashuria e nënës. Por duhet të jetojmë këtu, në kryeqytet, janë studimet, puna, perspektiva. Unë që jam afër diplomës tani, vështirë se mund t'i gjendem Mimozës rreth bebes sonë.

- E për çfarë jemi ne? Kur ta shohim një herë beben, vështirë se do të keni mundësinë të na e hiqni prej duarve.

- Besoj edhe ajo do lidhet shumë me ju, – tha Diamanti.

- Ajo? Ti the Ajo, Diamant? Fol tash, se më plase, a e the rastësisht apo?..

- Jo, jo mama, – qeshte me të madhe Diamanti. – Deshëm ta mbanim sekret, por ku më rri goja mua! – Po mami, është vajzë. Do ta keni një mbeskë. Jam i bindur se e keni dëshiruar të jetë vajzë,- tha përsëri Diamanti dhe, meqë s'po merrte përgjigje, vazhdoi:

- Mami, je aty? Mami! Fol tani, se më brengose.

- Këtu jam, bir, këtu, – foli Besa e mbytur nga lotët e gëzimit. – Por jam aq e emocionuar, bir, nuk mund ta besoj se po na vjen një mbesë… - tha duke mos menduar fare se Bujarin e kishte afër dhe i cili ishte rrëmbyer nga vaji.

- Hajde tani, mos m'u bëni si fëmijë qaramanë. Se pastaj, kur t'ju zgjohet bebja natën duke ju kënduar serenata, nuk do të gëzoheni kaq shumë.

- Oh bir, ju më keni dhuruar gëzimin më të madh në jetë.

- Mami, mendoje punën rreth drekës pra, mirë? Diçka e thjeshtë me miq e familjarë. Do të vinë edhe ca miqtë tanë.

- Me kënaqësi. Po shih, Diamant, unë nuk pritoj fare të përgatis për ju, por si thua nëse unë dhe babai yt të ta organizojmë në një restorant të bukur që e kemi parë skaj lumit? Ka nja dhjetë kilometra nga qyteti dhe kishte pamje të mrekullueshme e gatim të mirë, si thua?

- Ore, ti e babi po bëni qejf restoranteve, e? Ndaj i njihni kaq mirë,– qeshi Diamanti.– Epo mirë, mirë, ideja është shumë e bukur. Më pëlqen.

- Epo mirupafshim, bir.

- Mirupafshim. Dhe bëji babit të fala e ma përqafo.

Kur uli receptorin Besa e përqafoi Bujarin me gjithë fuqinë.

- Ky përqafim ishte vetëm për Diamantin, grua?

- Pak edhe për mua.

- Epo mirë, – i tha ai dhe ia ktheu përqafimin me shumë pasion. – Hajde gjyshe, – i tha.- Thonë se njerëzit çmenden më tepër nga dashuria në pleqëri. Eja këtu pranë meje!

- Nuk dua, ç'të gjeti ty?

- Asgjë. Ti më gjete. Eja të them.

- Jo nuk dua! – tha Besa dhe doli në korridor.

- Moj, mos më bëj të të ndjek,– tha Bujari dhe filloi t'i vraponte pas.

- Epo më zër pra,– i tha Besa duke ikur derisa vraponin nëpër shtëpi duke qeshur. Në fund Bujari e zuri dhe e dërgoi te shtrati.

- Je në vete, gjysh? Është mëngjes?

- Epo na qoftë ditë e mbarë pra,- po qeshte Bujari duke e mbërthyer të shoqen me gjithë fuqinë.

Ngadalë të qeshurat e tyre po shuheshin dhe pas derës së dhomës së fjetjes dy bashkëshortë po e gjenin veten sërish duke u bërë një.

***

Restoranti ishte i bërë i gjithë prej druri të punuar bukur si përjashta ashtu dhe përbrenda. Një mjedis aq i ngrohtë sa të bëhej të rrije aty tërë jetën. Jashtë, në të tri anët ishte sfondi me male e kodra të mbushura me pisha të gjata, gjelbëroshe, që lëshonin aromën e tyre deri brenda dritareve, ndërsa në njërën anë ishte lumi që gjarpëronte dhe me gurgullimën e tij të çlodhte veshët e të pastronte shpirtin. Në mjediset e brendshme, i zoti i lokalit, që thoshin se i vinte dore për kësi punësh, kishte krijuar ca kënde a qoshe të veçanta, diçka larg nga njëra-tjetra, ku secila familje a grup klientësh mund të rrinin e të dëfreheshin në një botë më vete, pa u përzier aspak me të tjerët. Madje, kudo që të uleshe, në cilëndo tavolinë të restorantit, mund t'i hidhje sytë përtej dritareve e të shihje copëza nga mrekullitë e natyrës, që të bëhej sikur të ishin peizazhe të pikturuara me aq natyrshmëri nga ndonjë dorë e papërsëritshme mjeshtërore. Edhe kjo, thoshin se ishte punë e mendjes krijuese të të zotit të restorantit. Madje tregonin se ky zotëri paskësh qenë për shumë vite jashtë vendit, në mërgim, ku kishte punuar nëpër restorante e hotele dhe, kur ishte kthyer, bashkë me një grusht parash që i kishte fituar e kursyer nga puna disavjeçare, kishte sjellë sidomos përvojën e atjeshme, se si mund të bëhej një hotel a një restorant, që të ishte edhe i bukur nga jashtë, edhe i këndshëm dhe funksionues nga brenda, pra një gjë e bukur dhe e veçantë. Tamam për këto vlera, Besa me Bujarin kishin zgjedhur bash këtë mjedis për të festuar martesën e Diamantit me Mimozën.

Miqtë kishin mbërritur dhe atmosfera ishte ngrohur sakaq. Nusja ishte veshur me një fustan të bardhë nusërie që e kishte përshtatur mirë për shtatzënësinë e saj. Dukej e lumtur, fytyra i qeshte dhe Besa, sa herë e shikonte, i mbushej zemra gjithë hare. Po bëhej edhe me një bijë të mirë. Me bijë e me mbesë njëherësh. I thoshte vetes në heshtje se do t'i gjendej nuses për aq sa do të kishte mundësi vetë, dhe për aq sa do të kishte dëshirë Mimoza. Besa ishte nga ata njerëz që nuk dëshirojnë t'u imponohen të tjerëve e t'i bezdisin me gatishmërinë a përkushtimin. Kështu, mendonte ajo, tjetrin e vë në mëdyshje dhe sikur e bën të pranojë pa qejf dorën a ndihmën tënde. I mjaftonte t'i shihte të lumtur dhe brenda zemrës e falënderonte Mimozën me shpirt, që ia kishte bërë të birin njeriun më të lumtur në botë. Ndërsa për të dy "pleqtë kokëshkretë", siç vetëquheshin në bashkësi me Bujarin ndonjëherë, dukej se më në fund jeta, e lodhur me mundimet e fatkeqësitë që u kishte përplasur, po tregohej bujare dhe e mirë.

Jeta dhe Hera kishin veshur fustane të njëjta dhe dukeshin si binjake. Më vonë Jeta u ngjit pas fustanit të Besës dhe i tha:

- Nuk mund të pres sa ta shoh motrën time të vogël, që e ka teta Mimoza mu në bark. Kur do të vijë? Nuk ka ndonjë mënyrë që të vijë më shpejt?

Besa qeshi me zemër.

- Do të vijë, shpirt, do të vijë shumë shpejt. Po sa motra u bëtë tani?

- Tri. Hera, unë dhe bebushja.

- Ke menduar ndonjë emër për të?

- Mund ta mendoj? - pyeti vajza tërë flakë.

- Natyrisht që mundesh. Edhe ti, edhe Hera, të gjithë do ta mendojmë nga një emër pastaj zgjedhim më të mirin, atë që do t'u pëlqejë të gjithëve.

- Po unë e kam qysh tani!

- Mirë, ma thuaj, pra.

Jeta u hesht, i shtrëngoi pak buzët e vogla sikur t'i porosiste që ta mbanin ndryrë aty sekretin e saj.

- Nuk e di a ta them.

-Ma thuaj vetëm mua, do ta mbaj sekret,- e qetësoi Besa. Buzët e vogla u hapën menjëherë sikur mezi kishin pritur:

- Engjëllushe.

- Engjëllushe? Po nga kjo tani?

- Paj sigurisht do të jetë si engjëll, pastaj engjëlli na sjell të mira, na mbron, është shpirt i mirë.

- Më pëlqen. Po qe se pajtohen prindërit, them do ta quajmë Engjëllushe.

- Pastaj mund ta thërrasim edhe Enxhi, për shembull, nëse bëhet këngëtare,- vazhdoi vajza.

- Pse, emrat e tjerë nuk bëhen dot këngëtare?

- Bëhen, por ato zakonisht i shkurtojnë emrat. Dhe mezi u del një emër i bukur, tamam për skenën. Ndërsa Engjëllushes sonë i del bukur, tamam modern. Enxhi, he, nuk të vjen si një notë muzike?

- Oh, oh, ti ia paske zgjedhur edhe profesionin. Pastaj për emra qenke tamam e prerë.

- Po pra, unë kam shumë plane me të, pastaj do ta bëj...

- Balerinë, ë? – qeshi Besa.- Por së pari ta presim të vijë, mirë? Pastaj do të shohim si ta quajmë e çfarë do ta bëjmë.

- Mirë, – tha vajza dhe u largua si flutura. Besa e pa se si po e kërkonte me sy Herën dhe pastaj, kur e gjeti, nisi t'i flasë në vesh e të qeshin e të kukurisin bashkë si dy gjinkalla. Pastaj vazhduan të sillen dorë për dorë rreth tavolinave. Duke i ndjekur ashtu të dyja, Besa i kaloi të gjithë njerëzit nëpër sy si në një film dhe u mbush në shpirt kur dukeshin fytyra të qeshura e të gëzuara, njerëz që për disa orë kishin harruar brengat e tyre të jetës dhe kishin ardhur për të ndarë gëzimin me një njeri që e respektonin. Natyrisht, çdonjëri syresh fshihte brenda vetes një histori, ku kishte dhembje, gëzime, halle e brenga; çdonjëri prej tyre ishte një ngjarje më vete, që po priste të zinte vend si një kapitull në romanin e madh të jetës, por sot ishin të gjithë këtu, të qeshur e të gëzuar. Besës iu duk thuajse për disa çaste u shkëput nga mjedisi dhe në qetësinë e saj të brendshme, po shihte në këto fytyra, vetëm një: atë të njeriut, të njeriut në përgjithësi. Të gjithë bashkë përbënin njeriun: ndonjëri prej tyre mu këto ditë po kalonte ndonjë vështirësi jetësore, ndërsa tjetri po përkundej në një gëzim, dikush po prekte majat, tjetri fundin. Dhe pastaj sërish qark.

- Dhe tani… - e trandi zëri i të shoqit që i kishte ardhur pas shpine duke rrahur një lugë pas një gote. Besës iu duk se dikush e lëshoi zërin e botës përsëri.

- ….Tani ju lutem pak qetësi. Dua të ngre një dolli,- tha Bujari me një gotë të mbushur përgjysmë.

Të gjithë u qetësuan dhe drejtuan shikimet kah ai.

- Dua të ngre dolli një herë për të porsamartuarit, – filloi ai.- Së pari për ty bir, për të gjitha momentet e bukura që na i ke dhuruar, për të gjitha ato që na ke dhënë, për dashurinë tënde. – Pastaj u kthye kah Mimoza: – Dhe për ty, Mimoza! Për bijën tonë të ardhshme. Të faleminderit që e ke bërë të lumtur djalin tonë, e ke bërë të ndjehet burrë dhe prind. Paçi të dy bashkë jetë të gjatë e gëzime. Qofshi të bekuar!

Bujarit iu kishin përlotur sytë dhe priti derisa të tjerët ndalën duartrokitjet. Pastaj vazhdoi:

- Dua të ngre edhe një dolli tjetër: për gruan time, për njeriun me të cilin kemi kaluar nëpër shumë furtuna e stuhi, nëpër gëzime e dhembje dhe me të cilën ia kemi dalë të jemi këtu sot, me ju, të dashur miq. Dua të ngre dolli për të gjithë ju që keni ardhur të ndani gëzimin me ne. Por një dolli të veçantë dua të ngre për Dorinën, bijën tonë engjëll, e cila me shpirtin e saj të bardhë na ka mësuar t'i duam më shumë njerëzit, t'i kuptojmë më mirë. Ta duam botën kështu si është, të provojmë të bëjmë diçka për të. Dua ta ngre këtë dolli për bijën time të vockël se…- këtu Bujarit i ngeli fjala në fyt, por pas një heshtjeje të shkurtër e mblodhi veten dhe vazhdoi: - ... se më ka ndihmuar të jem ndryshe. Të bëhem më i mirë. Ju faleminderit të gjithëve!

Pas kësaj u dëgjuan duartrokitje të gjata dhe fjalë gëzimi. Dhe Bujari e Besa qeshnin dhe qanin njëkohësisht. Çifti i ri u afrua dhe i përqafuan me zemër të dy, amë e atë. Filloi prapë muzika dhe të dy, Mimoza e Diamanti, u futën në vallen e çiftit. Bashkë me ta nisën të vallëzonin edhe mysafirët.

Besa ende përkundej në ëndërrime e nuk i hiqte sytë e përlotur nga Mimoza, nga kurmi i saj, që mbante në të një dritë të re, një ... Dorinë të re.

EPILOG

Derisa po ktheheshin me veturë në shtëpi, Besa e kishte hedhur shikimin nga dritarja.

E gjithë rruga ishte e rrethuar me male dhe me bukuri të tjera natyrore, ndërsa rrugës i përcillte lumi si mik i pandarë.

- Po mendon ndonjë gjë? – e pyeti Bujari.

- Jo. Vetëm po shikoja gjithë këtë bukuri. Kjo pjesë jashtë qytetit është e mrekullueshme, Bujar. Është fare afër qytetit, ndërsa prapë duket botë tjetër. Ajër i freskët, bukuri të mahnitshme ngado që të kthesh kokën. Dhe mendova, e di çfarë?

- Çfarë?

- Se edhe ndërtesat më të bukura të ndërtuara nga dora e njeriut, nuk janë asgjë para një bukurie të virgjër natyrore. Asgjë.

- E vërtetë. Edhe unë kam menduar në këtë, madje më tepër kohëve të fundit.

Besa e ktheu kokën kah ai.

- Çfarë dëshiron të thuash?

- Asgjë. Por dua të ndalemi pas disa minutave afër një vendi, bën?

- Bën, po pse?

- Ashtu. Jam i lodhur, dua të bëjmë një shëtitje në ajër të freskët.

- Mirë, pse jo. Edhe mua do më pëlqente.

Pas disa minutave Bujari e ndaloi veturën afër një bregu përskaj rrugës kryesore. Dolën jashtë dhe ngadalë u lëshuan për dore bregut teposhtë, që çonte kah një livadh i bukur krejt prej bari. Në fund të tij ishte lumi, përskaj të cilit lartoheshin plot lisa, pisha dhe drurë të tjerë.

- Të pëlqen? – i tha Bujari, me harenë e një djali të ri që po e çon përdore të dashurën e tij në një vend përrallor.

- Është si parajsë, vërtetë parajsë. Qenka i mrekullueshëm ky vend, Bujar. Nuk më paska rënë në sy sa herë kemi kaluar këndej.

- Nuk e ke vënë re, meqë ti shikon gjithmonë andej, lart kah malet. Por, unë ka kohë që sa herë kalojmë këndej, më tundet zemra kur e shoh këtë pjesë.

- Lum ai që e ka, duhet të jetë ndonjë fshatar nga këto anë.

- Eh, po po fshatar është, nga ata që e adhurojnë lumin, që e kanë atë si mikun më të mirë.

- Po qenka si ti, pra. Edhe ti e ke një lum për mik.

- Po, po si unë është, madje krejt njësoj,- tha Bujari duke dashur që t'ia cyste mendimin.

- Bujar, ti e njeh? Flet sikur ta kesh të njohur pronarin e këtij vendi.

- E njoh, por... jo aq mirë. Pse askush nuk e njeh veten aq mirë.

Tani Besa u step. Ç'po fliste ky? Çfarë ishte tani kjo farë filozofie e mbështjellë me enigma mes kthjelltësisë së natyrës! Mos ishte pak i dehur? I dehur me aromat e natyrës?

- Bujar, ç'më thua, lëri romuzet tani, se s'po të kuptoj fare… Çfarë lidhje ka tani njohja jote me këtë fshatarin, i cili po e adhuron lumin, dhe asaj sa e njeh ti veten? Mi bëre lëmsh të gjitha,- tha dhe e shikoi Bujarin në sy, por ai veç po qeshte pa folur dhe po e shikonte në sy Besën po ashtu. Dukej se po priste që ajo ta shtillte vetë lëmshin, ta gjente vetë përgjigjen e enigmave të tij.

- Mos po më thua se… se… Jo, jo nuk është e mundur! – tha Besa me sy të hapur shumë. Pastaj prapë sikur u zbut dhe vazhdoi me dyshim:- Mos po më thua se ai fshatar mund të jesh dora vetë?

- Bah, nuk po kuptoj fare se çfarë po mendon ti.

- Dhe kjo tokë mund të jetë e jotja? E? Hajde, më thuaj tani, se më shushate fare.

- Po të pajtohesh ti, them se mund të bëhet ndonjë gjë.

- Dhe ma thua kështu, si një përrallë dimri. Çfarë është kjo punë? Fol tani, se më çmende!

Bujari qeshte hareshëm, si në moshë të djalërisë, dhe e zuri Besën përdore.

- Ishte befasi, Besa, befasi për ty, gruaja ime! Ka kohë që e kam menduar, qysh para se të shkoj në operacion. Por gjërat ishin shumë të koklavitura dhe nuk diheshin shpenzimet. Biseda rreth kësaj toke filloi me një koleg të universitetit. Kishim kohë pa u dëgjuar dhe kur u takuam, dolëm për një kafe. Më ftoi t'i kthehem studimeve të mia.

- Uaa sa mirë, do ta bësh?

- Do ta kem vështirë në fillim, por do ta bëj, pse jo. Kam një libër që pret ta përfundoj. Pastaj ai më tregoi për këtë vend dhe më tha se ishte shumë i madh për të. Më ofroi ta blejmë bashkë, përgjysmë. Edhe ata janë vetëm burrë e grua, fëmijët u jetojnë jashtë. Pranova meqë çmimi ishte shumë i volitshëm, por me kusht që të më priste për paratë. Ai e bleu në tërësi dhe më tha se pjesa ime më priste mua, kur të isha gati mund ta merrja. Pasi u ktheva nga operacioni, bëra llogaritë dhe pashë se kisha aq para sa për ta nisur pagesën e pjesës sime, pjesën tonë, pra. Do ta paguaja me këste, kështu u pajtuam me shokun tim. Nuk është shtrenjtë. Por, nuk e bëra, meqë nuk e dija mendimin tënd. Që sot mund ta kryej këtë punë, natyrisht nëse ti je dakord.

- Nëse jam dakord? – Besa e shikoi me habi. I pëlqente që burri po ia kërkonte mendimin e saj.

- Po, Besa. E di çfarë kam menduar? Do ta ndërtonim një shtëpizë të bukur prej druri mu këtu dhe do kalonim gjithë verën këtej. Ç'thua? Unë do të merresha me librin tim, ti me çfarë të duash. Ose, pse jo, mund ta sillje edhe një piano këtu dhe të luaje a të kompozoje pjesët e tua, si Çajkovski, që muzikonte në shtëpinë e tij në mes të pyllit.

-Oh, ç'më bëre, Bujar? Mos jam unë ndonjë kompozitore e vërtetë?

-Ti je kompozitorja e jetës sime, Besa. Mua kjo më mjafton, dhe bile më tepron.

- E sheh, u bëre prapë e ri Bujar, gjithë frymëzim e fantazi.

-Këtu do të kishim qetësinë e duhur, do të jetonim pranë kësaj bukurie të mahnitshme, ndërsa prapë do të ishim afër qytetit,- u kthye Bujari nga përvijimet e planeve të tij.

- Po apartamenti, që e kemi poshtë në qytet?

- Në apartament do të jetonim dimrit. Ai është i mrekullueshëm për dimër.

- Po Diamanti, Mimoza, mbesat, nipat?..

- Të gjithë mund të na vizitojnë këtu dhe të vijnë e ta kalojnë verën me ne.

- Mirë, mirë, por shtëpizën, Bujar… shtëpizën me çfarë do ta ndërtojmë? Ku i kemi kaq shumë para?

- Do të shohim pas një kohe. Mund të marrim dhe ndonjë kredi, si gjithë bota. Po qe se dikur Arbeni vërtetë nuk dëshiron të vazhdojë jetën në apartamentin tonë, mund ta shesim, kështu mund t'i ndihmojmë edhe atij, dhe dalin mjaft edhe për ne.

- Bujar, je bërë tregtar i vërtetë!

- Vetëm me shpirtin nuk dua më të bëj pazar, e dashur, të tjerat i rregullojmë.

- Po mirë, si e ke menduar shtëpinë? Të vogël, me pamje prej lumi apo prej mali? Unë nuk e imagjinoj shumë të madhe. E dua një gjë të vogël, por të bukur, të bukur e të veçantë. A e pe se çfarë bukurie ka bërë ai i restorantit?

- Për shtëpinë kam shumë plane, ca i kam nxjerrë nga kompjuteri, ca duke parë edhe andej nga isha për operacionin. Gjithë sy isha, edhe pse ende nuk kisha fjalosur me ty. Po pate dëshirë do t'i shikojmë me kujdes dhe do të fillojmë ta ëndërrojmë së bashku shtëpizën tonë të bukur në natyrë. Në fillim do ta ndërtojmë në atë kuzhinën tonë në apartament, aty mbi tavolinën ku ti qëron patatet e dhe grin qepën. Në mes filxhanëve të kafesë. Dora-dorës derisa të mbërrijmë në pamjen që do të na pëlqejë më shumë. Ç'thua, ke pakëz kohë qysh sot?

- Oh, Bujar. Koha është gjithçka që kemi. Koha është pëlhura ku njerëzit pikturojnë jetën e tyre me furçat e shpirtit.

- Vërtetë? Sa mirë e the! Atëherë qysh sot nis e zgjidh ngjyrat më të bukura për ne.

Burrë e grua ecën përkrahu, derisa humbën përmes lisash e pishash. Tamam si në pikturën që do ta bënin bashkë, ku në mes do të ishin patjetër ata. Koha i gllabëroi, duke i dhënë jetës së tyre përmasa të tjera, brenda një pike të vogël të universit, të quajtur jetë.

FUND